



# Standardi për Shkëmbimin Automatik të Informacionit të Llogarisë Financiare në Çështjet Tatimore



Ky dokument dhe çdo hartë e përfshirë në të nuk cenojnë statusin e sovranitetit mbi asnjë territor, delimitimin e kufijve ndërkombëtarë dhe emrin e asnjë territori, qyteti ose zone.

**Ju lutemi, citojeni këtë botim si:**

OECD (2014), *Standardi për Shkëmbimin Automatik të Informacionit të Llogarisë Financiare në Çështjet Tatimore*, Botues: “OECD Publishing”.

<http://dx.doi.org/10.1787/9789264216525-en>

ISBN 978-92-64-21651-8 (versioni për printim) ISBN 978-92-64-21652-5  
(PDF)

---

## Contents

Shkurtesa dhe akronime .....	10
I. Hyrje .....	11
A. Historiku.....	11
B. Veçoritë kryesore të modelit global të shkëmbimit automatik të informacionit të llogarisë financiare .....	12
<b>2. Baza ligjore dhe operacionale për shkëmbimin e informacionit</b> .....	13
<b>3. Zgjidhjet teknike të përbashkëta dhe të pajtueshme</b> .....	14
<b>C. Panoramë e përgjithshme e standardit për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarisë financiare</b> .....	14
<b>1. Përmbledhje e Marrëveshjes Model të Autoritetit Kompetent</b> .....	15
<b>2. Përmbledhje e Standardit të Përbashkët të Raportimit</b> .....	15
<b>3. Komentet për Marrëveshjen CAA Model dhe CRS-në</b> .....	16
<b>4. Zgjidhjet teknike</b> .....	17
A. Marrëveshja Model Shumëpalëshe e Autoritetit Kompetent.....	18
MARRËVESHJA MODEL NDËRMJET AUTORITETEVE KOMPETENTE TË [JURIDIKSIONIT A] DHE [JURIDIKSIONIT B] PËR SHKËMBIMIN AUTOMATIK TË INFORMACIONIT TË LLOGARISË FINANCIARE PËR TË PËRMIRËSUAR PËRPUTHSHMËRINË TATIMORE NDËRKOMBËTARE .....	18
SEKSIONI 1 .....	19
<b>Përkufizime</b> .....	19
SEKSIONI 2 .....	20
<b>Shkëmbimi i informacionit në lidhje me Llogaritë e Raportueshme</b> .....	20
SEKSIONI 3 .....	21
<b>Koha dhe mënyra e shkëmbimit të informacionit</b> .....	21
SEKSIONI 4 .....	21
<b>Bashkëpunimi mbi pajtueshmërinë dhe zbatimin</b> .....	21
SEKSIONI 5 .....	22
<b>Konfidencialiteti dhe ruajtja e të dhënave</b> .....	22
SEKSIONI 6 .....	22
<b>Konsultimet dhe ndryshimet</b> .....	22
SEKSIONI 7 .....	22
<b>Afati i marrëveshjes</b> .....	22
B. Standardi i Përbashkët i Raportimit .....	23
Seksioni I: Kërkesat e përgjithshme të raportimit .....	23
Seksioni II: Kërkesat e përgjithshme të verifikimit të duhur .....	24
Seksioni III: Verifikimi i duhur për Llogaritë Paraekzistuese Individuale .....	25
Seksioni IV: Verifikimi i duhur për Llogaritë e Reja Individuale .....	28
Seksioni V: Verifikimi i duhur për Llogaritë Paraekzistuese të Njësive Ekonomike .....	29
Seksioni VI: Verifikimi i duhur për Llogaritë e Reja të Njësive Ekonomike .....	31
Seksioni VII: Rregullat e veçanta të verifikimit të duhur .....	32
Seksioni VIII: Termat e përkufizuara .....	33
Seksioni IX: Zbatimi efikas .....	45
A. Komentet për Marrëveshjen Model Shumëpalëshe të Autoritetit Kompetent .....	46
Hyrje.....	46

Koment për preambulën .....	47
Koment për seksionin 1 lidhur me përkufizimet .....	48
Paragrafi 1 – Përkufizimet .....	48
Paragrafi 2 – Rregulli i përgjithshëm i interpretimit .....	49
Koment për seksionin 2 lidhur me shkëmbimin e informacionit për Llogaritë e Raportueshme .....	50
Koment për seksionin 3 lidhur me kohën dhe mënyrën e shkëmbimit të informacionit .....	51
Paragrafët 1 dhe 2 – Shuma, karakterizimi dhe monedha e pagesës .....	51
Paragrafët 3 dhe 4 – Koha e shkëmbimit të informacionit .....	51
Paragrafët 5 dhe 6 – Modalitetet e teknologjisë së informacionit .....	52
Skema e CRS-së dhe udhëzuesi i përdorimit .....	52
Transmetimi i të dhënave duke përfshirë kodimin .....	52
Standardet minimale të përshtatshme .....	52
Kodimi .....	53
Metodat e transmetimit elektronik .....	53
Koment për seksionin 4 lidhur me bashkëpunimin për pajtueshmërinë dhe zbatimin .....	54
Koment për seksionin 5 lidhur me konfidencialitetin dhe ruajtjen e të dhënave .....	55
Paragrafi 1 – Konfidencialiteti duke përfshirë mbrojtjen e të dhënave personale .....	55
Paragrafi 2 – Shkelja e konfidencialitetit .....	56
Konfidencialiteti dhe ruajtja e të dhënave sipas Standardit të Përbashkët të Raportimit .....	56
Koment për seksionin 6 lidhur me konsultimet dhe ndryshimet .....	62
Paragrafi 1 – Konsultimet .....	62
Paragrafi 2 – Ndryshimet .....	62
Koment për seksionin 7 lidhur me afatin e marrëveshjes .....	62
Paragrafi 1 – Hyrja në fuqi .....	62
Paragrafi 2 – Pezullimi .....	62
Paragrafi 3 – Zgjidhja .....	63
B. Komentet për Standardin e Përbashkët të Raportimit .....	65
Hyrje .....	65
Koment për seksionin I lidhur me Kërkesat e Përgjithshme të Raportimit .....	65
Paragrafi A – Informacioni që duhet raportuar .....	65
Nënparagrafi A(1) – Adresa .....	66
Nënparagrafi A(1) – Juridiksionet e rezidencës .....	67
Nënparagrafi A(1) – NIPT-i .....	67
Nënparagrafi A(2) – Numri i llogarisë .....	67
Nënparagrafi A(3) – Numri identifikues .....	67
Nënparagrafi A(4) – Vlera ose bilanci i llogarisë .....	68
Nënparagrafët A(4) deri në (7) – Periudha e përshtatshme e raportimit .....	69
Nënparagrafi A(5)(a) – Të ardhura të tjera .....	69
Nënparagrafi A(5)(b) – Të ardhurat bruto .....	69
Nënparagrafi A(7) – Shumat bruto .....	70
Skema e CRS-së dhe udhëzuesi i përdorimit .....	70
Paragrafi B – Monedha .....	71
Paragrafët C deri në F – Përgjashtimet .....	71

NIPT-i dhe data e lindjes.....	71
Vendi i lindjes .....	72
Të ardhurat bruto.....	73
Koment për seksionin II lidhur me kërkesat e përgjithshme të verifikimit të duhur .....	74
Paragrafët A deri në C – Kërkesat e përgjithshme të verifikimit të duhur .....	74
Paragrafi D – Mbështetja tek ofruesit e shërbimeve .....	75
Paragrafi E – Procedurat alternative dhe të verifikimit të duhur për Llogaritë Paraekzistuese .....	75
Koment për seksionin III lidhur me Verifikimin e Duhur për Llogaritë Paraekzistuese Individuale .....	77
Paragrafi A – Llogaritë që nuk kërkohen të shqyrtohen, identifikohen ose raportohen .....	77
Paragrafi B – Verifikimi i duhur për Llogaritë e Vlerës së Ulët .....	77
Nënparagrafi B(1) – Testi i adresës së rezidencës.....	78
Nënparagrafët B(2) deri në (6) – Kërkimi elektronik i të dhënave.....	81
Nënparagrafi B(2) – Indiciet .....	82
Nënparagrafi B(5) – Procedura e veçantë .....	83
Nënparagrafi B(6) – Procedura e korrigjimit .....	84
Paragrafi C – Verifikimi i duhur për Llogaritë e Vlerës së Lartë .....	84
Nënparagrafi C(1) – Kërkimi elektronik i të dhënave .....	85
Nënparagrafi C(2) dhe (3) – Kërkimi manual i të dhënave .....	85
Nënparagrafi C(4) – Marrja në pyetje e menaxherit të marrëdhënieve .....	85
Nënparagrafi C(5) – Efekti i gjetjes së indicieve .....	87
Nënparagrafët C(6) deri në (9) – Procedurat shtesë .....	87
Paragrafët D dhe E – Koha e shqyrtimit dhe procedurat shtesë .....	88
Koment për seksionin IV lidhur me Verifikimin e Duhur për Llogaritë e Reja Individuale .....	89
Kërkesat për vlefshmërinë e vetëvërtetimeve.....	90
Korrigjimi i gabimeve të vetëvërtetimit .....	91
Vetëvërtetimet që furnizohen mbi bazë llogarie .....	92
Dokumentacioni i mbledhur nga persona të tjerë.....	92
Arsyeshmëria e vetëvërtetimit.....	93
Koment për seksionin V lidhur me Verifikimin e Duhur për Llogaritë Paraekzistuese të Njësive Ekonomike .....	94
Paragrafi A – Llogaritë që nuk kërkohen të shqyrtohen, identifikohen ose raportohen .....	94
Paragrafët B dhe C – Llogaritë që janë objekt i shqyrtimit dhe raportimit .....	94
Paragrafi D – Procedurat e shqyrtimit.....	95
Nënparagrafi D(1) – Procedurat e shqyrtimit për Mbajtësit e Llogarisë .....	95
Nënparagrafi D(2) – Procedurat e shqyrtimit për Personat Kontrollues .....	97
Paragrafi E – Koha e shqyrtimit dhe procedurat shtesë.....	98
Koment për seksionin VI lidhur me Verifikimin e Duhur për Llogaritë e Reja të Njësive Ekonomike .....	100
Nënparagrafi A(1) – Procedurat e shqyrtimit për Mbajtësit e Llogarisë .....	100
Vlefshmëria e vetëvërtetimeve .....	101
Arsyeshmëria e vetëvërtetimeve .....	102
Nënparagrafi A(2) – Procedurat e shqyrtimit për Personat Kontrollues .....	102
Koment për seksionin VII lidhur me Kërkesat e Veçanta të Verifikimit të Duhur .....	104
Paragrafi A – Mbështetja te vetëvërtetimi dhe Evidencat Shkresore .....	104
Standardet e njohurisë të zbatueshme për vetëvërtetimet.....	104

Standardet e njohurive të zbatueshme për Evidencat Shkresore .....	104
Kufizimet në të drejtën për të ditur .....	105
Paragrafi B – Procedurat alternative për Kontratat në Vlerë në Para të Gatshme dhe të Pensionit.....	106
Paragrafi C – Rregullat e totalizimit të llogarisë dhe të përkthimit të monedhës .....	107
Nënparagrafët C(1) deri në (3) – Rregullat e totalizimit të llogarisë.....	107
Nënparagrafi C(4) – Rregulli i përkthimit të monedhës .....	109
Koment për seksionin VIII lidhur me termat e përkufizuara .....	110
Paragrafi A – Institucioni Financiar Raportues .....	110
Institucioni Financiar Raportues .....	110
Institucioni Financiar i Juridiksionit Pjesëmarrës .....	110
Institucioni i Kujdestarisë.....	111
Institucion Depozite .....	112
Njësia Ekonomike e Investimeve .....	112
Aktiv Financiar.....	115
Shoqëri Sigurimesh e Specifikuar .....	115
Paragrafi B – Institucionet Financiare Joraportuese.....	116
Nënparagrafi B(1) – Në përgjithësi .....	116
Nënparagrafët B(2) deri në (4) – Organi Qeveritar, Organizata Ndërkombëtare dhe Banka Qendrore .....	116
Organi Qeveritar.....	116
Organizata Ndërkombëtare .....	117
Banka Qendrore .....	117
Fond Pensioni me Pjesëmarrje të Gjerë .....	117
Fond Pensioni me Pjesëmarrje të Kufizuar .....	118
Fond Pensioni i një Organi Qeveritar, Organizate Ndërkombëtare ose Banke Qendrore .....	118
Paragrafi C – Llogaria Financiare .....	122
Nënparagrafi C(1) – Në përgjithësi .....	122
Nënparagrafi C(2) – Llogari Depozite .....	124
Nënparagrafi C(3) – Llogari Kujdestarie .....	124
Nënparagrafi C(4) – Interesi në kapital .....	124
Nënparagrafët C(5) deri në (8) – Kontratat e Sigurimit dhe të Pensionit Vjetor .....	125
Nënparagrafët C(9) deri në (16) – Llogaritë Paraekzistuese dhe të Reja Individuale dhe të Njësive Ekonomike .....	127
Nënparagrafi C(17) – Llogaria e Përrjashtuar .....	129
Llogaritë e pensionit të pleqërisë dhe të pensionit .....	129
Llogaritë e favorizuara nga tatimet jo llogari pensioni pleqërie .....	130
Kontratat e sigurimit të jetës me afat.....	130
Llogaritë e pasurive .....	130
Llogaritë me garanci të bllokuar .....	130
Llogaritë e Depozitës për shkak të mbipagesave të pakthyera .....	131
Llogaritë e Përrjashtuara me rrezik të ulët.....	131
Paragrafi D – Llogari e Raportueshme .....	134
Nënparagrafi D(1) – Llogari e Raportueshme .....	134

Person i Juridiksionit të Raportueshëm .....	134
Person i Raportueshëm.....	135
NFE, NFE Pasive dhe NFE Aktive .....	137
Personat Kontrollues .....	139
Paragrafi E – Të ndryshme.....	140
Nënparagrafi E(1) – Mbajtësi i Llogarisë.....	140
Nënparagrafi E(2) – Procedurat për AML/KYC .....	142
Nënparagrafët E(3) dhe (4) – Njësia Ekonomike dhe Njësia Ekonomike e Lidhur .....	142
Nënparagrafi E(5) – NIPT-i .....	142
Nënparagrafi E(6) – Evidencat Shkresore.....	143
Kërkesat për vlefshmërinë e Evidencave Shkresore.....	144
Dokumentacioni i mbledhur nga persona të tjerë.....	145
Koment për seksionin IX lidhur me Zbatimin Efikas.....	146
Shtojcat.....	150
Shtojca 1 .....	151
Marrëveshja Model Shumëpalëshe e Autoritetit Kompetent.....	151
MARRËVESHJA MODEL PËR SHKËMBIMIN AUTOMATIK TË INFORMACIONIT TË LLOGARISË FINANCIARE PËR TË PËRMIRËSUAR PËRPUTHSHMËRINË TATIMORE NDËRKOMBËTARE .....	151
SEKSIONI 1 .....	152
<b>Përkufizime</b> .....	152
SEKSIONI 2 .....	153
<b>Shkëmbimi i informacionit në lidhje me Llogaritë e Raportueshme</b> .....	153
SEKSIONI 3 .....	154
<b>Koha dhe mënyra e shkëmbimit të informacionit</b> .....	154
SEKSIONI 4 .....	154
<b>Bashkëpunimi mbi pajtueshmërinë dhe zbatimin</b> .....	154
SEKSIONI 5 .....	154
<b>Konfidencialiteti dhe ruajtja e të dhënave</b> .....	154
SEKSIONI 6 .....	155
<b>Konsultimet dhe ndryshimet</b> .....	155
SEKSIONI 7 .....	155
<b>Afati i marrëveshjes</b> .....	155
SEKSIONI 8 .....	156
<b>Njoftimet e marra nga Sekretariati i Organit Koordinues</b> .....	156
Shtojca 2 .....	157
Marrëveshja Model Joreciproke e Autoritetit Kompetent .....	157
MARRËVESHJA MODEL NDËRMJET AUTORITETEVE KOMPETENTE TË [JURIDIKSIONIT A] DHE [JURIDIKSIONIT B] PËR SHKËMBIMIN AUTOMATIK TË INFORMACIONIT TË LLOGARISË FINANCIARE PËR TË PËRMIRËSUAR PËRPUTHSHMËRINË TATIMORE NDËRKOMBËTARE .....	157
SEKSIONI 1 .....	158
<b>Përkufizime</b> .....	158
SEKSIONI 2 .....	159
<b>Shkëmbimi i informacionit në lidhje me Llogaritë e Raportueshme</b> .....	159
SEKSIONI 3 .....	160

<b>Koha dhe mënyra e shkëmbimit të informacionit .....</b>	<b>160</b>
SEKSIONI 4 .....	160
<b>Bashkëpunimi mbi pajtueshmërinë dhe zbatimin .....</b>	<b>160</b>
SEKSIONI 5 .....	160
<b>Konfidencialiteti dhe ruajtja e të dhënave .....</b>	<b>160</b>
SEKSIONI 6 .....	161
<b>Konsultimet dhe ndryshimet .....</b>	<b>161</b>
SEKSIONI 7 .....	161
<b>Afati i marrëveshjes .....</b>	<b>161</b>
Shtojca 3 .....	162
Udhëzuesi i Përdorimit të Standardit të Përbashkët të Raportimit .....	162
Hyrje .....	162
<b>Si lidhet udhëzuesi i CRS-së me skemën e CRS-së .....</b>	<b>162</b>
Informacioni i skemës së Standardit të Përbashkët të Raportimit .....	163
<b>I. Koka e mesazhit .....</b>	<b>163</b>
<b>II. Person Palë_Lloji .....</b>	<b>166</b>
IIb. Lloji i NIPT-it.....	167
IIc. Emri i personit_Lloji.....	167
IId. Adresa_Lloji .....	170
IIE. Kombësia .....	172
IIIf. Informacioni i lindjes .....	172
IIIa. Kodi i vendit të rezidencës .....	173
IIIb. Numri i identifikimit të njësisë ekonomike (NI i organizatës_Lloji) .....	173
IIIc. Emri i organizatës.....	174
IVa. Institucioni Financiar Raportues .....	174
IVb. Grupi raportues .....	175
IVd. Numri i Llogarisë .....	175
IVe. Mbajtësi i Llogarisë.....	177
IVf. Person Kontrollues .....	178
IVg. Bilanci i Llogarisë.....	179
IVh. PAGESA .....	180
IVI. Raporti Përmbledhës .....	181
Transliterimi .....	181
Udhëzues mbi procesin e korrigjimit për Standardin e Përbashkët të Raportimit .....	181
<b>Udhëzuesi teknik .....</b>	<b>182</b>
<b>Shembuj të korrigjimit të Standardit të Përbashkët të Raportimit.....</b>	<b>184</b>
Shtojca A.....	187
<b>Koka e mesazhit (Seksioni I) .....</b>	<b>188</b>
<b>Lloji i emrit të personit .....</b>	<b>199</b>
<b>Lloji i organizatës palë (Seksioni III) .....</b>	<b>201</b>
<b>Sponsori dhe Ndërmjetësi (Jo të CRS-së) .....</b>	<b>202</b>
Shtojca B .....	202



<b>Hapësirat e emrave në skemën e CRS-së .....</b>	<b>202</b>
Shtojca 4 .....	204
Pyetësor shembull .....	204
1. Kuadri ligjor .....	204
2. Menaxhimi i sigurisë së informacionit .....	204
3. Monitorimi dhe zbatimi .....	208
Shtojca 5 .....	209
Qasje më e gjerë ndaj Standardit të Përbashkët të Raportimit .....	209
Hyrje .....	209
Seksioni I: Kërkesat e përgjithshme të raportimit .....	210
Seksioni II: Kërkesat e përgjithshme të verifikimit të duhur .....	211
Seksioni III: Verifikimi i duhur për Llogaritë Paraekzistuese Individuale .....	212
Seksioni IV: Verifikimi i duhur për Llogaritë e Reja Individuale .....	216
Seksioni V: Verifikimi i duhur për Llogaritë Paraekzistuese të Njësive Ekonomike .....	216
Seksioni VI: Verifikimi i duhur për Llogaritë e Reja të Njësive Ekonomike .....	218
Seksioni VII: Rregullat e veçanta të verifikimit të duhur .....	219
Shtojca 6 .....	221
Deklaratë mbi Shkëmbimin Automatik të Informacionit në Çështjet Tatimore (Miratuar më 6 maj 2014) .....	221
Shtojca 7 .....	224
Rekomandim i Këshillit mbi Standardin për Shkëmbimin Automatik të Informacionit të Llogarisë Financiare në Çështjet Tatimore .....	224

## *Shkurtesa dhe akronime*

### **A**

<b>EOI</b>	Shkëmbim Automatik i Informacionit
<b>CRS</b>	Standard i Përbashkët i Raportimit
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>FATCA</b>	Akti për Përputhshmërinë Tatimore të Llogarive të Huaja
<b>FATF</b>	Task Forca për Aksionin Financiar
<b>IF</b>	Institucion Financiar
<b>TI</b>	Teknologjia e Informacionit
<b>CAA Model</b>	Marrëveshja Model Shumëpalëshe e Autoritetit Kompetent
<b>OECD</b>	Organizata për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik
<b>TIEA</b>	Marrëveshja për Shkëmbimin e Informacionit Tatimor

## I. Hyrje

### A. Historiku

1. Duke qenë se bota është bërë gjithmonë e më e globalizuar, është më e lehtë për të gjithë tatimpaguesit që t'i bëjnë, mbajnë dhe menaxhojnë investimet nëpërmjet institucioneve financiare jashtë vendeve të tyre të rezidencës. Sasi të mëdha parash mbahen “*offshore*” dhe mbeten të patatuara deri në atë masë që tatimpaguesit nuk arrijnë të përmbushin detyrimet tatimore në juridiksionin e tyre të origjinës. Evazioni tatimor përmes “*offshore*” është një problem serioz për juridiksionet në të gjithë botën, qofshin vende të OECD-së ose jo, të vogla dhe të mëdha, të zhvilluara dhe në zhvillim. Shtetet kanë një interes të përbashkët në ruajtjen e integritetit të sistemeve të tyre tatimore. Bashkëpunimi ndërmjet administratave tatimore është thelbësor në luftën kundër evazionit fiskal dhe në mbrojtjen e integritetit të sistemeve tatimore. Një aspekt kyç i këtij bashkëpunimi është shkëmbimi i informacionit.

2. OECD ka një historik të gjatë të punës me të gjitha format e shkëmbimit të informacionit, me kërkesë, në mënyrë spontane dhe automatike, si dhe **Konventa Shumëpalëshe për Ndihmën e Ndërsjellë Administrative në Çështjet Tatimore dhe neni 26 i Konventës Model Tatimore të OECD-së mbi të Ardhurat dhe Kapitalin** ofrojnë një bazë për të gjitha format e shkëmbimit të informacionit. Veçanërisht në vitin 2009, u arrit shumë progres nga OECD, BE dhe Forumi Global për Transparencën dhe Shkëmbimin e Informacionit për Qëllime Tatimore në përmirësim të transparencës dhe shkëmbimit të informacionit me kërkesë.

3. Duke filluar nga viti 2012, interesi politik u fokusua gjithashtu mbi mundësitë e ofruara nga shkëmbimi automatik i informacionit. Më 19 prill 2013, Ministrat e Financës së G20-ës dhe Guvernatorët e Bankave Qendrore e miratuan shkëmbimin automatik si standardin e ri të pritshëm. Vendimi i G20-ës erdhi në vazhden e njoftimeve të mëparshme nga pesë shtete evropiane rreth qëllimit të tyre për të zhvilluar dhe pilotuar shkëmbimin shumëpalësh të informacionit tatimor bazuar në Marrëveshjen Model Ndërqeveritare për Përmirësimin e Përputhshmërisë Tatimore Ndërkombëtare dhe për të vënë në zbatim FATCA-n, të zhvilluar ndërmjet këtyre vendeve (Francë, Gjermani, Itali, Spanjë dhe Mbretëri e Bashkuar) dhe Shteteve të Bashkuara (“Modeli 1 IGA”). Më 22 maj 2013, Këshilli Evropian ra dakord unanimisht për të investuar përpjekjet parësore në zgjerimin e shkëmbimit automatik në nivel BE-je dhe global, si dhe mirëpriti përpjekjet e vazhdueshme të bëra në G8, G20 dhe OECD për zhvillimin e një standardi global. Më 12 qershor 2013 Komisioni Evropian miratoi një propozim legjislativ për shtrirjen e fushës së veprimt të shkëmbimit automatik të informacionit në direktivën e tij për bashkëpunimin administrativ. Më 19 qershor 2013, liderët e G8-ës mirëpritën raportin e Sekretarit të Përgjithshëm të OECD-së “Një hap drejt ndryshimit në transparencën tatimore”, që parashtron hapat konkrete që duhen ndërmarrë për të vënë në praktikë një model global të shkëmbimit automatik. Liderët e G8-ës ranë dakord për të punuar së bashku me OECD-në dhe në G20 për të vënë në zbatim menjëherë rekomandimet e dala prej tij. Më 6 shtator 2013 liderët e G20-ës u angazhuan drejt shkëmbimit automatik të informacionit si standardi i ri global dhe e mbështetën plotësisht punën e OECD-së, ku së bashku me shtetet e G20-ës kishin si synim ta prezantonin këtë standard të vetëm global në vitin 2014. Në shkurt të vitit 2014, Ministrat e Financës së G20-ës dhe Guvernatorët e Bankave Qendrore miratuan Standardin e Përbashkët të Raportimit për shkëmbimin automatik të informacionit tatimor të parashtruar në Pjesën II të këtij dokumenti. Deri në muajin maj të vitit 2014, mbi 60 juridiksione ishin angazhuar për të vënë menjëherë në zbatim Standardin e Përbashkët të Raportimit, duke përfshirë përkthimin e tij në legjislacionin e brendshëm. Gjithashtu, 44 juridiksione kanë rënë dakord për një axhendë të përbashkët për zbatimin e Standardit.

4. Modeli global i shkëmbimit automatik është hartuar në lidhje me informacionin e llogarisë financiare. Shumë juridiksione, si OECD dhe jo OECD, tashmë shkëmbejnë informacion në mënyrë automatike me partnerët e tyre të shkëmbimit si dhe në nivel rajonal (p.sh. brenda BE-së) për kategori të ndryshme të ardhurash dhe gjithashtu transmetojnë lloje të tjera informacioni si ndryshimi i rezidencës, blerja ose transferimi i pasurisë së paluajtshme, rimbursimi i tatimit mbi vlerën e shtuar, tatimi në burim, etj. Standardi i ri global nuk e kufizon dhe as nuk ka për qëllim të kufizojë llojet ose kategoritë e tjera të shkëmbimit automatik të informacionit. Ai përcakton një standard minimal për informacionin që duhet shkëmbyer. Juridiksionet mund të zgjedhin të shkëmbejnë informacion përtej standardit minimal të parashtruar në këtë dokument.

5. Me qëllim maksimizimin e efikasitetit dhe reduktimin e kostove për institucionet financiare, Standardi i Përbashkët i Raportimit mbështetet gjerësisht mbi qasjen ndërqeveritare për zbatimin e FATCA-s. Ndërkohë që qasja ndërqeveritare ndaj raportimit në kuadrin e FATCA-s devijon në disa aspekte nga CSR, dallimet janë derivat i natyrës shumëpalëshe të sistemit të CRS-së dhe aspekteve të tjera specifike të Shteteve të Bashkuara, veçanërisht koncepti i tatimit mbi bazën e shtetësisë dhe prania e një tatimi në burim të konsiderueshëm dhe gjithëpërfshirës në kuadrin e FATCA-s. Nisur nga këto veçori, që qasja ndërqeveritare ndaj FATCA-s është një sistem ekzistues më parë me ngjashmëri të mëdha me CRS-në, dhe progresi i parashikuar drejt pjesëmarrjes së gjerë në CRS, është në pajtim dhe në përputhje me CRS-në që Shtetet e Bashkuara të mos kërkojnë trajtimin e shikimit përmes apo transparencës për subjektet investuese në Juridiksionet Jopjesëmarrëse.

## **B. Veçoritë kryesore të modelit global të shkëmbimit automatik të informacionit të llogarisë financiare**

6. Me qëllim që modeli i shkëmbimit automatik të informacionit të llogarisë financiare të jetë efikas, duhet të hartohet specifikisht duke pasur në mendje përputhshmërinë tatimore të juridiksioneve të rezidencës në vend që të jetë një nënprodukt i raportimit të brendshëm. Gjithashtu, ai duhet të standardizohet me qëllim që të përfitojnë një numër sa më i madh juridiksionesh të rezidencës dhe institucione financiare ndërkohë që pranohet se disa çështje të caktuara mbeten për t'u vendosur nga praktika vendase. Avantazhi i standardizimit është thjeshtësimi i problemit, efikasiteti më i lartë dhe kosto më të ulëta për të gjithë aktorët e përfshirë. Përhapja e modeleve të ndryshme dhe të paqëndrueshme me shumë mundësi do të vendoste kosto të konsiderueshme si mbi qeverinë dhe mbi biznesin për mbledhjen e informacionit të nevojshëm dhe funksionimin e modeleve të ndryshme. Kjo mund të çonte në fragmentimin e standardeve, të cilat mund të sjellin kërkesa kontradiktore, duke rritur më tej kostot e përputhshmërisë dhe duke reduktuar efikasitetin. Si përfundim, duke qenë se evazoni tatimor është një çështje globale, modelet duhet të kenë shtrirje globale me qëllim që të adresohet problemi i evazionit tatimor “*offshore*” dhe jo thjesht të lokalizohet problemi, por edhe të marrë zgjidhje. Mund të nevojiten mekanizma për të nxitur përputhshmërinë me qëllim arritjen e këtij objekti.

7. Në vitin 2012 OECD-ja i paraqiti G20-ës raportin “Shkëmbimi automatik i informacionit: **Çfarë është, si funksionon, përfitimet, çfarë mbetet për t'u bërë**”,<sup>1</sup> i cili bën një përmbledhje të veçorive kryesore të një modeli efikas për shkëmbim automatik. Faktorët kryesorë të suksesit për shkëmbimin automatik efikas të informacionit financiar janë: (1) standardi i përbashkët për raportimin e informacionit, verifikimi i duhur dhe shkëmbimi i informacionit, (2) baza ligjore dhe operacionale për shkëmbimin e informacionit dhe (3) zgjidhjet teknike të përbashkëta dhe të pajtueshme.

<sup>1</sup> . OECD (2012), *Shkëmbimi automatik i informacionit: Çfarë është, si funksionon, përfitimet, çfarë mbetet për t'u bërë*, OECD, Paris, disponohet në [www.oecd.org/ctp/exchange-of-tax-information/automatic-exchange-of-information-report.pdf](http://www.oecd.org/ctp/exchange-of-tax-information/automatic-exchange-of-information-report.pdf)

## ***1. Standardi i përbashkët i raportimit, verifikimi i duhur dhe shkëmbimi i informacionit***

8. Një model efikas për shkëmbimin automatik të informacionit kërkon një standard të përbashkët për informacionin që do të raportohet nga institucionet financiare dhe që do të shkëmbehet me juridiksionet e rezidencës. Kjo do të garantojë që raportimi nga institucionet financiare është në përputhje me interesat e shtetit të rezidencës. Gjithashtu do të rrisë cilësinë dhe parashikueshmërinë e informacionit që po shkëmbehet. Kjo do të rezultojë në mundësi të konsiderueshme për shtetin e rezidencës për të rritur përputhshmërinë e tij dhe për ta përdorur informacionin në mënyrë optimale (p.sh. përmes krahasimit automatik me analizën e të dhënave dhe informacionin e përputhshmërisë brenda vendit).

9. Me qëllim kufizimin e mundësive që tatimpaguesit të devijojnë modelin duke i zhvendosur aktivet në institucione ose duke investuar në produkte që nuk mbulohen nga modeli, regjimi i raportimit kërkon një qëllim të gjerë në tre dimensione:

- **Qëllimi i informacionit financiar të raportuar:** Një regjim raportimi gjithëpërfshirës mbulon lloje të ndryshme të ardhurash nga investimet duke përfshirë interesin, dividendët dhe lloje të ngjashme të ardhurash, si dhe adreson situata ku tatimpaguesi kërkon të fshehtë kapitalin që në vetvete përfaqëson të ardhura ose aktive mbi të cilat janë shmangur tatimet (p.sh. duke kërkuar informacion mbi gjendjet e llogarive).
- **Qëllimi i mbajtësve të llogarive që janë objekt i raportimit:** Një regjim raportimi gjithëpërfshirës e kërkon raportimin jo vetëm lidhur me individët, por gjithashtu duhet të kufizojë mundësitë që tatimpaguesit të shmangin raportimin përmes përdorimit të subjekteve juridikë ndërmjetës ose strukturave të tilla. Kjo nënkupton se institucioneve financiare do t'u kërkohej të shohin përtej shoqërive guaskë, trusteve ose strukturave të ngjashme, duke përfshirë subjektet e tatueshme për të mbuluar situata ku, tatimpaguesi kërkon të fshehtë principalin, por është i gatshëm të paguajë tatimin mbi të ardhurat.
- **Qëllimi i institucioneve financiare që u kërkohej të raportojnë:** Regjimi i raportimit gjithëpërfshirës mbulon jo vetëm bankat, por edhe institucione të tjera financiare, të tilla si brokerat, mjete të caktuara financiare të investimeve kolektive dhe disa shoqëri të sigurimeve.

10. Përveç standardit të përbashkët mbi qëllimin e informacionit që do të mblidhet dhe shkëmbehet, modeli efikas i shkëmbimit automatik të informacionit financiar gjithashtu kërkon një standard të përbashkët për një tërësi procedurash të shëndosha të verifikimit të duhur që duhen ndjekur nga institucionet financiare për identifikimin e llogarive të raportueshme dhe për t'u siguruar që mbajtësi i llogarisë identifikon informacionin që kërkohej për t'u raportuar për këto llogari. Procedurat e verifikimit të duhur janë jetike sepse ato ndihmojnë në garantimin e cilësisë së informacionit që raportohet dhe shkëmbehet. Si përfundim, *feedback*-u i marrë nga juridiksioni marrës drejtuar juridiksionit dërgues lidhur me ndonjë gabim në informacionin e marrë gjithashtu mund të jetë një aspekt i rëndësishëm i një modeli efikas të shkëmbimit automatik. Ky *feedback* mund të kryhet në formën e një shkëmbimi spontan të informacionit, i cili është një tjetër aspekt i bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve tatimore në vetvete.

## ***2. Baza ligjore dhe operacionale për shkëmbimin e informacionit***

11. Tashmë ekzistojnë baza të ndryshme ligjore për shkëmbimin automatik të informacionit. Ndërkohë që traktatet dypalëshe, si ato të mbështetura në nenin 26 të Konventës Model Tatimore të OECD-së mbi të Ardhurat dhe Kapitalin, i lejojnë këto

shkëmbime, mund të jetë më efikase që të krijohen marrëdhënie për shkëmbimin e informacionit mbi bazën e një instrumenti shumëpalësh shkëmbimi. Konventa Shumëpalëshe për Ndihmën e Ndërsjellë Administrative në Çështjet Tatimore (Konventa),<sup>2</sup> ndryshuar në vitin 2011, është një instrument i tillë. Ajo parashikon të gjitha format e bashkëpunimit administrativ, përmban rregulla strikte për konfidencialitetin dhe përdorimin e duhur të informacionit, dhe lejon shkëmbimin automatik të informacionit. Një nga avantazhet e saj kryesore është shtrirja e saj globale.<sup>3</sup> Shkëmbimi automatik sipas Konventës kërkon një marrëveshje të veçantë ndërmjet autoriteteve kompetente të palëve, që mund të nënshkruhet nga dy ose më shumë palë, duke mundësuar kështu një marrëveshje të vetme me dy ose më shumë palë (ku shkëmbimi real automatik ndodh gjithmonë mbi baza dypalëshe). Më pas kjo marrëveshje ndërmjet autoriteteve kompetente aktivizon dhe “operacionalizon” shkëmbimin automatik ndërmjet pjesëmarrësve. Aty ku juridiksionet mbështeten në instrumente të tjera të shkëmbimit të informacionit, të tilla si traktatet dypalëshe, marrëveshja mes autoriteteve kompetente mund të kryejë të njëjtin funksion.

12. Të gjitha traktatet dhe instrumentet e shkëmbimit të informacionit përmbajnë dispozita strikte të cilat kërkojnë që informacioni i shkëmbyer të mbahet konfidencial dhe të kufizohet numri i personave kujt i jepet informacioni dhe qëllimet për të cilat mund të përdoret ky informacion. OECD-ja nxori një **Udhëzues për konfidencialitetin**,<sup>4</sup> i cili parashtron praktikën më të mira lidhur me konfidencialitetin dhe jep udhëzime praktike për mënyrën se si të garantohet një nivel i përshtatshëm mbrojtjeje. Përpara hyrjes në marrëveshje për shkëmbimin automatik të informacionit me një juridiksion tjetër, është thelbësore që juridiksioni marrës të disponojë kuadrin ligjor dhe kapacitetin dhe proceset administrative për të garantuar konfidencialitetin e informacionit të marrë dhe që ky informacion të përdoret vetëm për qëllimet e specifikuar në instrument.

### 3. Zgjidhjet teknike të përbashkëta dhe të pajtueshme

13. Zgjidhjet teknike të përbashkëta dhe të pajtueshme për raportimin dhe shkëmbimin e informacionit janë një element thelbësor në një sistem të standardizuar të shkëmbimit automatik, veçanërisht në atë që do të përdoret nga një numër i madh juridiksionesh dhe institucioneve financiare. Standardizimi do të reduktojë kostot për të gjitha palët e përfshira.

14. Formati teknik i raportimit duhet të jetë i standardizuar me qëllim që informacioni të mund të kapet, shkëmbehet dhe përpunohet me shpejtësi dhe efikasitet me kosto efektive dhe duhet të ekzistojnë metoda të sigurta dhe të pajtueshme të transmetimit dhe kodimit të të dhënave.

## C. Panoramë e përgjithshme e standardit për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarisë financiare

15. Pjesa II e këtij dokumenti përmban (A) një marrëveshje model me autoritetin kompetent (“Marrëveshja Model (CAA)”) dhe (B) standardin e përbashkët të raportimit

<sup>2</sup> Konventa Shumëpalëshe u hartua bashkërisht nga Këshilli i Evropës dhe OECD, dhe u hap për nënshkrim nga shtetet anëtare e të dy organizatave më 25 janar 1988. Konventa u ndryshua për t’iu përgjigjur thirrjes së G20-ës në Samitin e saj të Londrës në muajin prill të vitit 2009 për ta bashkërenduar atë me standardin ndërkombëtar për shkëmbimin dhe për ta hapur për të gjitha shtetet, veçanërisht për të garantuar se vendet në zhvillim mund të përfitojnë nga mjedisi i ri më transparent. Ajo u hap për nënshkrim më 1 qershor 2011.

<sup>3</sup> Për informacione të mëtejshme mbi juridiksionet që mbulohen nga Konventa, nënshkruesit dhe ratifikimet shihni [www.oecd.org/tax/exchange-of-tax-information/status\\_of\\_convention.pdf](http://www.oecd.org/tax/exchange-of-tax-information/status_of_convention.pdf).

<sup>4</sup> OECD (2012), *Garantimi i siguriës: Udhëzuesi i OECD-së për mbrojtjen e konfidencialitetit të informacionit të shkëmbyer për qëllime tatimore*, OECD, PARIS, disponohet në [www.oecd.org/ctp/exchange-of-tax-information/keeping-it-safe-report.pdf](http://www.oecd.org/ctp/exchange-of-tax-information/keeping-it-safe-report.pdf).



dhe verifikimit e duhur për informacionin e llogarisë financiare (CRS). Së bashku ato përbëjnë raportin e përbashkët të raportimit, verifikimin e duhur dhe shkëmbimin e informacionit për informacionin e llogarisë financiare.

16. Zbatimi i standardit do të kërkojë përkthimin e CRS-së në legjislacionin e brendshëm. Nënshkrimi i marrëveshjes me autoritetin kompetent, bazuar në model, më pas lejon vendosjen e shkëmbimit të informacionit mbështetur në instrumentet ligjore ekzistuese, si Konventa ose konventat dypalëshe për tatimin mbi të ardhurat. Shkëmbimi i informacionit gjithashtu mund të vihet në zbatim mbi bazën e një marrëveshjeje shumëpalëshe të autoritetit kompetent, ose juridiksionet mund të hyjnë në një marrëveshje shumëpalëshe ndërqeveritare ose disa marrëveshje ndërqeveritare që mund të jenë traktate ndërkombëtare në të drejtën e tyre të cilat mbulojnë si detyrimet e raportimit dhe procedurat e verifikimit të duhur të shoqëruara me një marrëveshje më të kufizuar me autoritetin kompetent. Baza ligjore mund të jetë gjithashtu legjislacioni i BE-së që mbulon elementë të CRS-së.

### ***1. Përmbledhje e Marrëveshjes Model të Autoritetit Kompetent***

17. Marrëveshja CAA Model lidh CRS-në dhe bazën ligjore për shkëmbim (si Konventa ose traktat dypalësh për tatimet), duke lejuar kështu shkëmbimin e informacionit të llogarisë financiare. Marrëveshja CAA Model përmban një sërë klauzolash “Meqë” dhe shtatë seksione, si dhe parashikon modalitetet e shkëmbimit me qëllim garantimin e fluksit të duhur të informacionit. Klauzolat “Meqë” përmbajnë referenca për rregullat e raportimit të brendshëm dhe verifikimit të duhur që qëndrojnë në themel të shkëmbimit të informacionit në përputhje me marrëveshjen e autoritetit kompetent. Ato përmbajnë referenca për konfidencialitetin, masat mbrojtëse dhe ekzistencën e infrastrukturës së nevojshme për një marrëdhënie efikase shkëmbimi.

18. Ajo përmban një seksion me përkufizime (Seksioni 1), mbulon llojin e informacionit që duhet të shkëmbehet (Seksioni 2), kohën dhe mënyrën e shkëmbimit (Seksioni 3) dhe konfidencialitetin dhe ruajtjen e të dhënave që duhen respektuar (Seksioni 5). Konsultimet ndërmjet autoriteteve kompetente, bashkëpunimi për pajtueshmërinë dhe zbatimin, ndryshimet në marrëveshje dhe afati i marrëveshjes, duke përfshirë pezullimin dhe zgjidhjen, trajtohen në Seksionet 4, 6 dhe 7.

### ***2. Përmbledhje e Standardit të Përbashkët të Raportimit***

19. CRS përmban standardin e raportimit dhe të verifikimit të duhur që qëndron në themel të shkëmbimit automatik të informacionit të llogarisë financiare. Juridiksioni që zbaton CRS-në duhet të disponojë rregulla që u kërkojnë institucioneve financiare ta raportojnë informacionin në përputhje me qëllimin e raportimit të parashtruar në Seksionin I dhe të ndjekin procedurat e verifikimit të duhur në përputhje me procedurat në Seksionin II deri në Seksionin VII. Termat e kapitalizuara që përdoren në CRS janë të përcaktuara në Seksionin VIII.

20. Institucionet financiare që mbulohen nga standardi përfshijnë institucionet e kujdestarisë, institucionet depozituese, subjektet e investimit dhe shoqëritë e sigurimeve të specifikuara, me përjashtim të rasteve kur ato paraqesin një rrezik të ulët të përdorimit për shmangie të tatimeve dhe përjashtohen nga raportimi. Informacioni financiar që duhet raportuar lidhur me llogaritë e raportueshme përfshin **interesin, dividendët, gjendjen ose vlerën e llogarisë, të ardhurat nga produkte të caktuara sigurimi, të ardhurat nga shitja e aktiveve financiare dhe të ardhura të tjera të gjeneruara lidhur me aktivet e mbajtura në llogaritë ose pagesat e bëra në lidhje me llogarinë**. Llogaritë e raportueshme përfshijnë llogari të mbajtura nga individët dhe subjektet (ku përfshihen

trustet dhe fondacionet), dhe standardi përfshin kërkesën e shikimit përtej subjekteve Pasive për të raportuar mbi personat përkatës kontrollues.

21. Procedurat e verifikimit të duhur që duhen kryer nga institucionet e raportimit financiar për identifikimin e llogarive të raportueshme janë të përshkruara në Seksionet II deri në VII. Ato bëjnë dallim ndërmjet llogarive individuale dhe atyre të njësive ekonomike. Ato gjithashtu bëjnë dallim ndërmjet llogarive paraekzistuese dhe të reja, duke pranuar se është më e vështirë dhe e kushtueshme për institucionet financiare që të marrin informacion nga mbajtësit e llogarive ekzistuese se sa ta kërkojnë një informacion të tillë në momentin e hapjes së llogarisë.

- **Për Llogaritë Paraekzistuese Individuale**, institucioneve financiare u kërkohet që t'i shqyrtojnë llogaritë pa zbatuar asnjë prag *de minimis*. Rregullat bëjnë dallim ndërmjet Llogarive të Vlerës së Lartë dhe të Ulët. Për Llogaritë e Vlerës së Ulët ato parashikojnë testin e adresës së përhershme bazuar në evidencat shkresore, ose Institucioni Financiar do duhet ta përcaktojë rezidencën mbi bazën e një kërkimi për indicie. Në rast të indicieve kontradiktore do të nevojitet një vetëvërtetim (dhe/ose evidenca shkresore), në mungesë të së cilës raportimi do të bëhet për të gjithë juridiksionet e raportueshme për të cilat nuk janë gjetur indicie. Për Llogaritë e Vlerës së Lartë zbatohen procedurat e shtuara të verifikimit të duhur, duke përfshirë kërkimin nëpër regjistra dhe testin e njohurive reale nga menaxheri i marrëdhënieve.
- **Për Llogaritë e Reja Individuale**, CRS kërkon një vetëvërtetim (dhe konfirmimin e racionalitetit të tij) pa prag *de minimis*.
- **Për Llogaritë Paraekzistuese të Njësive Ekonomike**, institucioneve financiare u kërkohet të përcaktojnë: a) nëse vetë Njësia Ekonomike është një Person i Raportueshëm, që mund të bëhet kryesisht mbi bazën e informacionit të disponueshëm (Procedurat AML/KYC (Kundër Pastrimit të Parave/Njih Klientin Tënd) dhe nëse jo, do të nevojitet një vetëvërtetim; b) nëse Njësia Ekonomike është një Njësi Ekonomike Jofinanciare Pasive (NFE) dhe, nëse po, rezidenca e Personave Kontrollues. Për një sërë mbajtësish llogarish, vlerësimi aktiv/pasiv është pothuajse i drejtpërdrejtë dhe mund të bëhet mbi bazën e informacionit të disponueshëm, për të tjerë kjo mund të kërkojë vetëvërtetim. Juridiksionet mund të zgjedhin që t'i lejojnë institucionet financiare të aplikojnë një prag, si p.sh Llogaritë Paraekzistuese të Njësive Ekonomike nën 250 000 USD (ose vlera ekuivalente në monedhën vendase) nuk janë objekt i shqyrtimit.
- **Për Llogaritë e Reja të Njësive Ekonomike**, duhen bërë të njëjtat vlerësime si edhe për Llogaritë Paraekzistuese. Sidoqoftë, duke qenë se është më e lehtë të merren vetëvërtetime për Llogaritë e Reja, pragu prej 250 000 USD (ose vlera ekuivalente në monedhën vendase) nuk zbatohet.

22. Seksioni IX i CRS-së përshkruan rregullat dhe procedurat administrative që pritet të ketë një juridiksion zbatues për të garantuar zbatimin efikas të CRS-së dhe pajtueshmërinë me këtë të fundit.

### 3. Komentet për Marrëveshjen CAA Model dhe CRS-në

23. Për secilin seksion të Marrëveshjes CAA Model dhe CRS-së, ka një Koment të detajuar që ka për qëllim të ilustrtojë ose interpretojë dispozitat e saj. Komentet janë në



Pjesën III të Raportit. Duke qenë se zbatimi do të bazohet në legjislacionin e brendshëm, është e rëndësishme të garantohet konsistenca në zbatim nëpër juridiksione për të shmangur krijimin e kostove të panevojshme dhe të kompleksitetit për institucionet financiare, veçanërisht për ato që veprojnë në më tepër se një juridiksion. Për disa situata të caktuara të kufizuara, në Komente janë parashikuar alternativa.

#### ***4. Zgjidhjet teknike***

24. Si përfundim, ky dokument gjithashtu përmban udhëzime mbi zgjidhjet teknike përkatëse. Ato përfshijnë skemat që duhen përdorur për shkëmbimin e informacionit dhe ofrojnë një standard lidhur me aspektet e TI-së për ruajtjen e të dhënave dhe konfidencialitetin, dhe transmetimin dhe kodimin për transmetimin e sigurt të informacionit në kuadrin e CRS-së. Shtojca 3 përmban një paraqitje në formë diagrami të skemës së CRS-së dhe udhëzuesin përkatës të saj. Siç parashikohet në Marrëveshjen Shumëpalëshe Model të Autoritetit Kompetent, Autoritetet Kompetente do ta përdorin skemën e CRS-së për qëllime të shkëmbimit të informacionit që duhet raportuar. Skema mund të përdoret edhe nga Institucionet e Raportimit Financiar për qëllime të raportimit të informacionit (siç lejohet nga legjislacioni i brendshëm). Aspektet e TI-së për ruajtjen e të dhënave dhe konfidencialitetin, dhe standardet e transmetimit dhe kodimit janë në Komentin në Seksionet 3 dhe 5 të Marrëveshjes CAA Model.

## II. Marrëveshja Model Shumëpalëshe e Autoritetit

### Kompetent dhe Standardi i Përbashkët i Raportimit

#### A. Marrëveshja Model Shumëpalëshe e Autoritetit Kompetent

##### **MARRËVESHJA MODEL NDËRMJET AUTORITETEVE KOMPETENTE TË [JURIDIKSIONIT A] DHE [JURIDIKSIONIT B] PËR SHKËMBIMIN AUTOMATIK TË INFORMACIONIT TË LLOGARISË FINANCIARE PËR TË PËRMIRËSUAR PËRPUTHSHMËRINË TATIMORE NDËRKOMBËTARE**

Meqë, qeveria e [Juridiksionit A] dhe qeveria e [Juridiksionit B] kanë një marrëdhënie afatgjatë dhe të ngushtë lidhur me ndihmën e ndërsjellë në çështjet tatimore dhe dëshirojnë të përmirësojnë përputhshmërinë tatimore ndërkombëtare duke e ndërtuar më tej këtë marrëdhënie;

Meqë, ligjet e juridiksioneve të tyre përkatëse [pritet t'u kërkojnë]/[u kërkojnë]/[u kërkojnë ose pritet t'u kërkojnë] institucioneve financiare që të raportojnë informacion lidhur me llogari të caktuara dhe të ndjekin procedurat e verifikimit të duhur, në përputhje me qëllimin e shkëmbimit të parashikuar nga Seksioni 2 i kësaj Marrëveshjeje dhe me procedurat e raportimit dhe verifikimit të duhur që përmban Standardi i Përbashkët i Raportimit;

Meqë, [Neni [...]] i Konventës për Tatimin mbi të Ardhurat ndërmjet [Juridiksionit A] dhe [Juridiksionit B]/[Neni 6 i Konventës për Ndihmën e Ndërsjellë Administrative në Çështjet Tatimore] ("Konventa")/[i ndonjë instrumenti tjetër ligjor të zbatueshëm ("Instrumenti")], autorizon shkëmbimin e informacionit për qëllime tatimore, duke përfshirë shkëmbimin e informacionit mbi baza automatike, dhe i lejon autoritetet kompetente të [Juridiksionit A] dhe [Juridiksionit B] ("Autoritetet Kompetente") për të rënë dakord për qëllimin dhe modalitetet e këtyre shkëmbimeve automatike;

Meqë, [Juridiksioni A] dhe [Juridiksioni B] disponojnë (i) masat e duhura mbrojtëse për të garantuar se informacioni i marrë në përputhje me këtë Marrëveshje do të mbetet konfidencial dhe do të përdoret vetëm për qëllimet e parashtruara në [Konventë]/[Instrument], dhe (ii) infrastrukturën për një marrëdhënie shkëmbimi efikase (duke përfshirë proceset për garantimin e shkëmbimeve në kohë, të sakta dhe konfidenciale të informacionit, komunikimet efikase dhe të besueshme, dhe aftësitë për të zgjidhur menjëherë pikëpyetjet dhe shqetësimet mbi shkëmbimet ose kërkesat për shkëmbime dhe për të administruar dispozitat e Seksionit 4 të kësaj Marrëveshjeje);

Meqë, Autoritetet Kompetente dëshirojnë të arrijnë një marrëveshje për të përmirësuar përputhshmërinë tatimore ndërkombëtare bazuar në shkëmbimin automatik reciprok sipas [Konventës]/[Instrumentit], dhe që është objekt i konfidencialitetit dhe masave të tjera mbrojtëse të parashikuara në dokument, duke përfshirë dispozitat që kufizojnë përdorimin e informacionit të shkëmbyer sipas [Konventës]/[Instrumentit];

Si rrjedhojë, nisur nga sa më sipër, Autoritetet Kompetente kanë rënë dakord si më poshtë:

## SEKSIONI 1

*Përkufizime*

1. Për qëllime të kësaj marrëveshjeje (“Marrëveshja”), termat e mëposhtëm kanë kuptimet vijuese:

- a) termi “[**Juridiksioni A**]” është [...].
- b) termi “[**Juridiksioni B**]” është [...].
- c) termi “[**Autoriteti Kompetent**]” është:
  - (1) në rastin e [Juridiksionit A], [...]; dhe
  - (2) në rastin e [Juridiksionit B], [...].
- d) termi “[**Institucion Financiar i [Juridiksionit A]**]” është (i) çdo Institucion Financiar që është rezident në [Juridiksionin A], por që përjashton çdo degë të atij Institucioni Financiar që ndodhet jashtë [Juridiksionit A], dhe (ii) çdo degë e një Institucioni Financiar që nuk është rezident në [Juridiksionin A], nëse ajo degë ndodhet në [Juridiksionin A].
- e) termi “[**Institucion Financiar i [Juridiksionit B]**]” është (i) çdo Institucion Financiar që është rezident në [Juridiksionin B], por që përjashton çdo degë të atij Institucioni Financiar që ndodhet jashtë [Juridiksionit B], dhe (ii) çdo degë e një Institucioni Financiar që nuk është rezident në [Juridiksionin B], nëse ajo degë ndodhet në [Juridiksionin B].
- f) termi “[**Institucion Financiar Raportues**]” është çdo Institucion Financiar i [Juridiksionit A] ose Institucion Financiar i [Juridiksionit B], sipas kontekstit, i cili nuk është një Institucion Financiar Joraportues.
- g) termi “[**Llogari e Raportueshme**]” është një Llogari e Raportueshme e [Juridiksionit A] ose një Llogari e Raportueshme e [Juridiksionit B], sipas kontekstit, me kusht që të jetë identifikuar si e tillë në përputhje me procedurat e verifikimit të duhur, në pajtim me Standardin e Përbashkët të Raportimit, që ekzistojnë në [Juridiksionin A] ose [Juridiksionin B].
- h) termi “[**Llogari e Raportueshme e [Juridiksionit A]**]” është një Llogari Financiare që mirëmbahet nga një Institucion Financiar Raportues i [Juridiksionit B] dhe mbahet nga një ose më shumë Persona të [Juridiksionit A] të cilët janë Persona të Raportueshëm ose nga një NFE Pasive me një ose më shumë Persona Kontrollues që është një Person i Raportueshëm i [Juridiksionit A].
- i) termi “[**Llogari e Raportueshme e [Juridiksionit B]**]” është një Llogari Financiare që mirëmbahet nga një Institucion Financiar Raportues i [Juridiksionit A] dhe mbahet nga një ose më shumë Persona të [Juridiksionit B] të cilët janë Persona të Raportueshëm ose nga një NFE Pasive me një ose më shumë Persona Kontrollues që është një Person i Raportueshëm i [Juridiksionit B].
- j) termi “[**Person i [Juridiksionit A]**]” është një individ ose njësi ekonomike që është identifikuar nga një Institucion Financiar Raportues i [Juridiksionit B] si rezident në [Juridiksionin A] sipas procedurave të verifikimit të duhur në përputhje me Standardin e Përbashkët të Raportimit, ose një pasuri e një personi të vdekur që ka qenë rezident i [Juridiksionit A].
- k) termi “[**Person i [Juridiksionit B]**]” është një individ ose njësi ekonomike që është identifikuar nga një Institucion Financiar Raportues i [Juridiksionit A] si rezident në [Juridiksionin B] sipas procedurave të verifikimit të duhur në përputhje me Standardin e Përbashkët të Raportimit, ose një pasuri e një personi të vdekur që ka qenë rezident i [Juridiksionit B].

- l) termi “**Numri i Identifikimit të Tatimpaguesit (NIPT)**” është NIPT-i në [Juridiksionin A] ose NIPT-i në [Juridiksionin B], sipas kontekstit.
  - m) termi “**NIPT-i i [Juridiksionit A]**” është një [...].
  - n) termi “**NIPT-i i [Juridiksionit B]**” është një [...].
2. Termat me germa kapitale, të papërkufizuar ndryshe në këtë Marrëveshje, kanë kuptimin që i është dhënë në atë kohë sipas ligjit të Juridiksionit zbatues të Marrëveshjes, kuptim i cili është në përputhje me kuptimin e përcaktuar në Standardin e Përbashkët të Raportimit. Çdo term i papërkufizuar ndryshe në këtë Marrëveshje apo në Standardin e Përbashkët të Raportimit, përveç nëse konteksti kërkon ndryshe ose Autoritetet Kompetente bien dakord për një kuptim të përbashkët (siç lejohet nga legjislacioni i brendshëm), kanë kuptimin që u është dhënë atyre në atë kohë sipas ligjit të Juridiksionit zbatues të Marrëveshjes, çdo kuptim sipas ligjeve tatimore në fuqi të atij Juridiksioni që kanë përparësi mbi kuptimin që i është dhënë termit sipas ligjeve të tjera të atij Juridiksioni.

## SEKSIONI 2

### *Shkëmbimi i informacionit në lidhje me Llogaritë e Raportueshme*

1. Në bazë të dispozitave të nenit [...] të [Konventës]/ [Instrumentit] dhe rregullave të zbatueshme të raportimit dhe verifikimit në përputhje me Standardin e Përbashkët të Raportimit, secili Autoritet Kompetent do të shkëmbejë çdo vit me organet e tjera kompetente, në lidhje me të cilat zbaton këtë Marrëveshje, mbi baza automatike, informacionet e marra në bazë të rregullave të tilla dhe të specifikuara në paragrafin 2.
2. Informacioni që do të shkëmbehet është, në rastin e [Juridiksionit A] në lidhje me çdo Llogari të Raportueshme të [Juridiksionit B] dhe në rastin e [Juridiksionit B] në lidhje me çdo Llogari të Raportueshme të [Juridiksionit A]:
  - a) emrin, adresën, NIPT-in, datën dhe vendin e lindjes (në rastin e një individi) të secilit Person të Raportueshëm që është Mbajtës Llogarie i llogarisë dhe, në rastin e çdo Njësie Ekonomike që është Mbajtëse Llogarie dhe që, pas zbatimit të procedurave të verifikimit të duhur në përputhje me Standardin e Përbashkët të Raportimit, është identifikuar se ka një ose më shumë Persona Kontrollues që janë Person i Raportueshëm, emrin, adresën dhe NIPT-in e Njesisë Ekonomike dhe emrin, adresën, NIPT-in, datën dhe vendin e lindjes së secilit Person të Raportueshëm;
  - b) numrin e llogarisë (ose ekuivalentin funksional në mungesë të një numri të llogarisë);
  - c) emrin dhe numrin identifikues (nëse ka) të Institucionit Financiar Raportues;
  - d) gjendjen e llogarisë ose vlerën (duke përfshirë, në rastin e Kontratës së Sigurimit në Vlerë në Para të Gatshme ose Kontratë Pensioni Vjetor, Vlerën në Para të Gatshme ose vlerën e mbylljes vullnetare) duke filluar në fund të vitit përkatës kalendarik ose në një periudhë tjetër të përshtatshme raportimi ose, nëse llogaria është mbyllur gjatë atij viti apo asaj periudhe, në mbylljen e llogarisë;
  - e) në rastin e një Llogarie Kujdestarie:
    - (1) shumën totale bruto të interesit, shumën totale bruto të dividendëve, dhe shumën totale bruto të të ardhurave të tjera të krijuara në lidhje me aktivet e mbajtura në llogari, në çdo rast paguar apo kredituar në llogari (ose në lidhje me llogarinë) gjatë vitit kalendarik ose një periudhe tjetër të përshtatshme raportimi; dhe
    - (2) të ardhurat totale bruto nga shitja apo shlyerja e aktiveve financiare të paguara apo të kredituara në llogari gjatë vitit kalendarik ose një periudhe tjetër të përshtatshme të raportimit në lidhje me të cilën Institucioni Financiar Raportues ka vepruar, si: kujdestar, ndërmjetës, kandidat ose ndryshe si një agent për Mbajtësin e Llogarisë;

- f) në rastin e ndonjë Llogarie Depozite, shumën totale bruto të interesit të paguar apo të kredituar në llogari gjatë vitit kalendarik ose një periudhe tjetër të përshtatshme raportimi; dhe
- g) në rastin e ndonjë Llogarie të papërs shkruar në nënparagrafin 2 (e) ose (f), shumën totale bruto të paguar apo të kredituar për Mbajtësin e Llogarisë në lidhje me llogarinë gjatë vitit kalendarik ose një periudhe tjetër të përshtatshme raportimi në lidhje me të cilën Institucioni Financiar Raportues është institucioni që ka detyrim ose debitori, duke përfshirë edhe shumën totale të pagesave të shlyerjeve të bëra për Mbajtësin e Llogarisë gjatë vitit kalendarik ose një periudhe tjetër të përshtatshme raportimi.

### SEKSIONI 3

#### *Koha dhe mënyra e shkëmbimit të informacionit*

1. Për qëllime të shkëmbimit të informacionit në Seksionin 2, shumë dhe karakterizimi i pagesave të bëra në lidhje me një Llogari të Raportueshme mund të përcaktohen në përputhje me parimet e ligjeve tatimore të Juridiksionit që kryen shkëmbimin e informacionit.
2. Për qëllime të shkëmbimit të informacionit në Seksionin 2, informacioni i shkëmbyer do të identifikojë monedhën në të cilën është shprehur çdo shumë përkatëse.
3. Në lidhje me paragrafin 2 të seksionit 2, informacioni do të shkëmbehet lidhur me [xxxx] dhe të gjitha vitet e specifikuara dhe do të shkëmbehet brenda nëntë muajve pas përfundimit të vitit kalendarik me të cilin lidhet informacioni. Pavarësisht nga fjalia e mësipërme, informacioni kërkohet të shkëmbehet vetëm lidhur me një vit kalendarik nëse të dyja Juridiksionet e tyre përkatëse kanë në fuqi legjislacionin që kërkon raportim në lidhje me vitin kalendarik që është në përputhje me qëllimin e shkëmbimit të parashikuar në seksionin 2 dhe procedurat e raportimit dhe të verifikimit të përfshira në Standardin e Përbashkët të Raportimit.
4. Pavarësisht paragrafit 3, informacioni që do të shkëmbehet lidhur me [xxxx] është informacioni i përshkruar në paragrafin 2 të seksionit 2, me përjashtim të të ardhurave bruto të përshkruara në nënparagrafin 2 (e) (2) të Seksionit 2.
5. Autoritetet Kompetente do të shkëmbejnë automatikisht informacionin e përshkruar në seksionin 2 në skemën standarde të raportimit të përbashkët në një gjuhë të zgjeruar të caktuar (XML).
6. Autoritetet Kompetente do të bien dakord mbi një ose më shumë metoda për transmetimin e të dhënave, duke përfshirë standardet e kodimit.

### SEKSIONI 4

#### *Bashkëpunimi mbi pajtueshmërinë dhe zbatimin*

Një Autoritet Kompetent do të njoftojë Autoritetin tjetër Kompetent kur Autoriteti i përmendur së pari ka arsye të besojë se një gabim mund të ketë çuar në informacione të pasakta ose të paplota, ose raportimi nuk është në pajtim, nga një Institucion Financiar Raportues, me kërkesat e zbatueshme të raportimit dhe procedurat e verifikimit në përputhje me Standardin e Përbashkët të Raportimit. Autoriteti Kompetent do të njoftohet të ndër marrë të gjitha masat e duhura, të disponueshme sipas legjislacionit të tij të brendshëm për të trajtuar gabimet ose papajtueshmërinë e përshkruar në njoftim.

**SEKSIONI 5*****Konfidencialiteti dhe ruajtja e të dhënave***

1. I gjithë informacioni i shkëmbyer është objekt i rregullave të konfidencialitetit dhe masave të tjera mbrojtëse të parashikuara në [Konventë]/[Instrument], duke përfshirë dispozitat që kufizojnë përdorimin e informacionit të shkëmbyer dhe, në masën e nevojshme për të siguruar nivelin e nevojshëm të mbrojtjes së të dhënave personale, në përputhje me masat mbrojtëse të cilat mund të specifikohen nga Autoriteti Kompetent dhënës, siç kërkohet sipas legjislacionit të tij të brendshëm.
2. Çdo Autoritet Kompetent do të njoftojë menjëherë Autoritetin tjetër Kompetent në lidhje me çdo shkelje të konfidencialitetit apo dështimin e masave mbrojtëse dhe për çdo sanksion dhe veprime përmirësuese pasuese.

**SEKSIONI 6*****Konsultimet dhe ndryshimet***

1. Në rast të ndonjë vështirësie që lind në zbatimin ose interpretimin e kësaj Marrëveshjeje, secili Autoritet Kompetent mund të kërkojë konsultime për zhvillimin e masave të duhura për sigurimin e përmbushjes së kësaj Marrëveshjeje.
2. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet me marrëveshje me shkrim të Autoriteteve Kompetente. Me përjashtim të rastit kur bihet dakord ndryshe, një ndryshim i tillë hyn në fuqi në ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe prej një muaji pas datës së nënshkrimit të fundit të marrëveshjes së tillë me shkrim ose datës së fundit të njoftimeve të shkëmbyera për qëllime të kësaj marrëveshjeje me shkrim.

**SEKSIONI 7*****Afati i marrëveshjes***

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi [...] / [në datën e fundit të njoftimeve të dhëna nga secili Autoritet Kompetent se juridiksionet e tyre përkatëse kanë ligjet e nevojshme për të vënë në zbatim Marrëveshjen].
2. Një Autoritet Kompetent mund ta pezullojë shkëmbimin e informacionit sipas kësaj Marrëveshjeje duke njoftuar me shkrim Autoritetin tjetër Kompetent se ka konstatuar se ka ose ka pasur papajtueshmëri të konsiderueshme nga Autoriteti tjetër Kompetent me këtë Marrëveshje. Ky pezullim do të hyjë menjëherë në fuqi. Për qëllime të këtij paragrafi, papajtueshmëria e konsiderueshme përfshin, po nuk kufizohet me, papajtueshmërinë me dispozitat për konfidencialitetin dhe ruajtjen e të dhënave të kësaj Marrëveshjeje dhe të [Konventës]/[Instrumentit], pamundësinë e Autoritetit Kompetent për të dhënë informacion në kohë dhe të mjaftueshëm siç kërkohet në bazë të kësaj Marrëveshjeje ose për të përcaktuar statusin e Njësive Ekonomike ose të llogarive si Institucione Financiare Joraportuese dhe Llogari të Përfshijtura në mënyrë të atillë që cenon qëllimet e Standardit të Përbashkët të Raportimit.
3. Secili Autoritet Kompetent mund ta zgjidhë këtë Marrëveshje duke i dhënë njoftim me shkrim për zgjidhjen Autoritetit tjetër Kompetent. Kjo zgjidhje do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe prej 12 muajsh pas datës së njoftimit të zgjidhjes. Në rast të zgjidhjes, i gjithë informacioni i marrë më parë sipas kësaj Marrëveshjeje do të mbetet konfidencial dhe do të jetë objekt i kushteve të [Konventës]/[Instrumentit].



## B. Standardi i Përbashkët i Raportimit

### STANDARDI I PËRBASHKËT I RAPORTIMIT DHE VERIFIKIMI I DUHUR PËR INFORMACIONIN E LLOGARISË FINANCIARE

#### Seksioni I: Kërkesat e përgjithshme të raportimit

A. Sipas paragrafëve C deri në F, secili Institucion Financiar Raportues duhet të raportojë informacionin e mëposhtëm lidhur me çdo Llogari të Raportueshme të këtij Institucioni Financiar Raportues:

1. emrin, adresën, juridiksionet e rezidencës, NIPT-in, datën dhe vendin e lindjes (në rastin e një individi) të secilit Person të Raportueshëm që është Mbajtës Llogarie i llogarisë dhe, në rastin e çdo Njësie Ekonomike që është Mbajtëse Llogarie dhe që, pas zbatimit të procedurave të verifikimit të duhur në përputhje me Seksionet V, VI dhe VII, është identifikuar se ka një ose më shumë Persona Kontrollues që janë Person i Raportueshëm, emrin, adresën, juridiksionet e rezidencës dhe NIPT-in e Njesisë Ekonomike dhe emrin, adresën, juridiksionet e rezidencës, NIPT-in, datën dhe vendin e lindjes së secilit Person të Raportueshëm;
2. numrin e llogarisë (ose ekuivalentin funksional në mungesë të një numri të llogarisë);
3. emrin dhe numrin identifikues (nëse ka) të Institucionit Financiar Raportues;
4. gjendjen e llogarisë ose vlerën (duke përfshirë, në rastin e Kontratës së Sigurimit në Vlerë në Para të Gatshme ose Kontratë Pensioni Vjetor, Vlerën në Para të Gatshme ose vlerën e mbylljes vullnetare) duke filluar në fund të vitit përkatës kalendarik ose në një periudhë tjetër të përshtatshme raportimi ose, nëse llogaria është mbyllur gjatë atij viti apo asaj periudhe, në mbylljen e llogarisë;
5. në rastin e një Llogarie Kujdestarie:
  - a) shumën totale bruto të interesit, shumën totale bruto të dividendëve, dhe shumën totale bruto të të ardhurave të tjera të krijuara në lidhje me aktivet e mbajtura në llogari, në çdo rast paguar apo kredituar në llogari (ose në lidhje me llogarinë) gjatë vitit kalendarik ose një periudhe tjetër të përshtatshme raportimi; dhe
  - b) të ardhurat totale bruto nga shitja apo shlyerja e aktiveve financiare të paguara apo të kredituara në llogari gjatë vitit kalendarik ose një periudhe tjetër të përshtatshme të raportimit në lidhje me të cilën Institucioni Financiar Raportues ka vepruar, si: kujdestar, ndërmjetës, kandidat ose ndryshe si një agjent për Mbajtësin e Llogarisë;
6. në rastin e ndonjë Llogarie Depozite, shumën totale bruto të interesit të paguar apo të kredituar në llogari gjatë vitit kalendarik ose një periudhe tjetër të përshtatshme raportimi; dhe
7. në rastin e ndonjë Llogarie të papërs shkruar në nënparagrafin A (5) ose (6), shumën totale bruto të paguar apo të kredituar për Mbajtësin e Llogarisë në lidhje me llogarinë gjatë vitit kalendarik ose një periudhe tjetër të përshtatshme raportimi në lidhje me të cilën Institucioni Financiar Raportues është institucioni që ka detyrim ose debitori, duke përfshirë edhe shumën totale të pagesave të shlyerjeve të bëra për Mbajtësin e Llogarisë gjatë vitit kalendarik ose një periudhe tjetër të përshtatshme raportimi.

- B. Informacioni i raportuar duhet të identifikojë monedhën në të cilën është shprehur çdo shumë përkatëse.
- C. Pavarësisht nënparagrafit A(1), lidhur me çdo Llogari të Raportueshme që është një Llogari Paraekzistuese, NIPT-i ose data e lindjes nuk është e nevojshme të raportohet nëse ky NIPT ose kjo datë lindjeje nuk është në regjistrat e Institucionit Financiar Raportues dhe nuk kërkohet të mblidhet nga ky Institucion Financiar Raportues sipas legjislacionit të brendshëm. Sidoqoftë, Institucionit Financiar Raportues i kërkohet të bëjë përpjekje të arsyeshme për të siguruar NIPT-in dhe datën e lindjes lidhur me Llogaritë Paraekzistuese deri në fund të vitit të dytë kalendarik pas vitit në të cilin këto Llogari janë identifikuar si Llogari të Raportueshme.
- D. Pavarësisht nënparagrafit A(1), NIPT-i nuk kërkohet që të raportohet nëse (i) NIPT-i nuk është lëshuar nga Juridiksioni përkatës i Raportueshëm (ii) legjislacioni i brendshëm i Juridiksionit përkatës të Raportueshëm nuk e kërkon mbledhjen e NIPT-it të lëshuar nga ky Juridiksion i Raportueshëm.
- E. Pavarësisht nënparagrafit A(1), vendi i lindjes nuk kërkohet të raportohet me përjashtim të rasteve kur Institucionit Financiar Raportues i kërkohet ta sigurojë dhe raportojë sipas legjislacionit të brendshëm dhe është i disponueshëm në bazën e të dhënave të kërkueshme në format elektronik e cila mbahet nga Institucioni Financiar Raportues.
- F. Pavarësisht paragrafit A, informacioni që duhet të raportohet lidhur me [xxxx] është informacioni i përshkruar në këtë paragraf, me përjashtim të të ardhurave bruto të përshkruara në nënparagrafin A(5)(b).

## Seksioni II: Kërkesat e përgjithshme të verifikimit të duhur

- A. Llogaria trajtohet si Llogari e Raportueshme duke filluar nga data në të cilën identifikohet si e tillë në bazë të procedurave të verifikimit të duhur në Seksionin II deri në VII dhe, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe, informacioni lidhur me një Llogari të Raportueshme duhet të raportohet çdo vit në vitin kalendarik pas vitit me të cilin lidhet informacioni.
- B. Gjendja ose vlera e llogarisë përcaktohet duke filluar nga data e fundit të vitit kalendarik ose një periudhë tjetër e përshtatshme raportimi.
- C. Në rastin kur pragu i gjendjes ose vlerës do të përcaktohet duke filluar nga dita e fundit e vitit kalendarik, gjendja ose vlera përkatëse duhet të përcaktohet duke filluar nga dita e fundit e periudhës së raportimit që përfundon me vitin kalendarik ose brenda atij viti kalendarik.
- D. Secili Juridiksion mund t'i lejojë Institucionet Financiare Raportuese që të përdorin ofrues shërbimesh për të përmbushur detyrimet e raportimit dhe të verifikimit të duhur të cilat i janë vendosur këtyre Institucioneve Financiare Raportuese, siç parashikohet në legjislacionin e brendshëm, por këto detyrime mbeten përgjegjësi e Institucioneve Financiare Raportuese.
- E. Secili Juridiksion mund t'i lejojë Institucionet Financiare Raportuese që të zbatojnë procedurat e verifikimit të duhur për Llogaritë e Reja për ato Paraekzistuese, dhe procedurat e verifikimit të duhur për Llogaritë e Vlerës së Lartë për Llogaritë e Vlerës së Ulët. Në rastin kur një Juridiksion lejon procedurat e verifikimit të duhur për Llogaritë e Reja që të përdoren për Llogaritë Paraekzistuese, vijojnë të zbatohen rregullat e zbatueshme për Llogaritë Paraekzistuese pavarësisht këtyre.



**Seksioni III: Verifikimi i duhur për Llogaritë Paraekzistuese Individuale**

Për qëllime të identifikimit të Llogarive të Raportueshme ndërmjet Llogarive Paraekzistuese Individuale do të zbatohen procedurat vijuese.

- A. **Llogaritë që nuk kërkohen të shqyrtohen, identifikohen ose raportohen.** Një Llogari Paraekzistuese Individuale që është një Kontratë Sigurimi në Vlerë në Para të Gatshme ose një Kontratë Pensioni Vjetor nuk kërkohet të shqyrtohet, identifikohet ose raportohet, me kusht që Institucioni Financiar Raportues e ka të ndaluar me ligj që ta shesë një Kontratë të tillë te rezidentët e një Juridiksioni të Raportueshëm.
- B. **Llogaritë e Vlerës së Ulët.** Lidhur me Llogaritë e Vlerës së Ulët zbatohen procedurat vijuese.
1. **Adresa e rezidencës.** Nëse Institucioni Financiar Raportues ka në regjistrat e tij një adresë aktuale rezidence për Mbajtësin e Llogarisë individuale bazuar në evidencat shkresore, Institucioni Financiar Raportues mund ta trajtojë Mbajtësin e Llogarisë individuale si një rezident për qëllime tatimore të juridiksionit në të cilin ndodhet adresa për qëllime të përcaktimit nëse ky Mbajtës i Llogarisë individuale është një Person i Raportueshëm.
  2. **Kërkimi Elektronik i të Dhënave.** Nëse Institucioni Financiar Raportues nuk mbështetet mbi një adresë aktuale rezidence për Mbajtësin e Llogarisë individuale bazuar në evidencat shkresore siç përcaktohet në nënparagrafin B(1), Institucioni Financiar Raportues duhet të shqyrtojë të dhënat e kërkueshme në formë elektronike që mbahen nga Institucioni Financiar Raportues për secilën nga indiciet vijuese dhe të zbatojë nënparagrafet B(3) deri në (6):
    - a) identifikimin e Mbajtësit të Llogarisë si rezident i një Juridiksioni të Raportueshëm;
    - b) adresën aktuale të postës ose të rezidencës (duke përfshirë kutinë postare) në Juridiksionin e Raportueshëm;
    - c) një ose më shumë numra telefoni në Juridiksionin e Raportueshëm dhe asnjë numër telefoni në juridiksionin e Institucionit Financiar Raportues;
    - d) urdhërpagesat periodike (të ndryshme nga ato që lidhen me një Llogari Depozite) për të transferuar fonde në një llogari që mbahet në një Juridiksion të Raportueshëm;
    - e) prokura e posaçme në fuqi momentalisht ose autoriteti nënshkruar që i jepet një personi me adresë në një Juridiksion të Raportueshëm; ose
    - f) udhëzimin për “ruajtjen e postës” ose adresën “në vëmendje të” në një Juridiksion të Raportueshëm nëse Institucioni Financiar Raportues nuk ka një adresë tjetër në dosjen e Mbajtësit të Llogarisë.
  3. Nëse në kërkimin elektronik nuk zbulohet asnjë nga indiciet e renditura në nënparagrafin B(2), atëherë nuk nevojitet asnjë veprim tjetër deri sa të ketë ndryshime në rrethanat që rezultojnë në një ose më shumë indicie që lidhen me llogarinë, ose llogaria bëhet një Llogari e Vlerës së Lartë.
  4. Nëse gjatë kërkimit elektronik zbulohet ndonjë prej indicieve të renditura në nënparagrafin B(2)(a) deri në (e), ose nëse ka ndryshime në rrethanat që rezultojnë në një ose më shumë indicie që lidhen me llogarinë, atëherë Institucioni Financiar Raportues duhet ta trajtojë Mbajtësin e Llogarisë si rezident për qëllime tatimore të secilit Juridiksion të Raportueshëm për të cilin është identifikuar një indicie, përveçse nëse zgjedh të zbatojë nënparagrafin B(6) dhe një prej përjashtimeve në këtë nënparagraf zbatohet lidhur me atë llogari.

5. Nëse në kërkimin elektronik zbulohet një udhëzim për “ruajtjen e postës” ose adresë “në vëmendje të” dhe nuk identifikohet asnjë adresë tjetër dhe asnjë indicie tjetër e renditur në nënparagrafin B(2)(a) deri në (e) për Mbajtësin e Llogarisë, në rendin më të përshtatshëm me rrethanat, Institucioni Financiar Raportues duhet të zbatojë kërkimin manual të të dhënave të përshkruar në nënparagrafin C(2), ose të kërkojë të marrë nga Mbajtësi i Llogarisë një vetëvërtetim ose evidenca shkresore për të përcaktuar rezidencat e këtij Mbajtësi Llogarie për qëllime tatimore. Nëse kërkimi manual dështon të përcaktojë një indicie dhe përpjekja për të marrë vetëvërtetimin ose evidencat shkresore nuk është e suksesshme, Institucioni Financiar Raportues duhet ta raportojë llogarinë si një llogari e padokumentuar.
6. Pavarësisht gjetjes së indicieve sipas nënparagrafit B(2), Institucionit Financiar Raportues nuk i kërkohet ta trajtojë një Mbajtës Llogarie si rezident të një Juridiksioni të Raportueshëm nëse:
  - a) informacioni i Mbajtësit të Llogarisë përmban një adresë aktuale poste ose rezidence në Juridiksionin e Raportueshëm, një ose më shumë numra telefoni në Juridiksionin e Raportueshëm (dhe asnjë numër telefoni në juridiksionin e Institucionit Financiar Raportues) ose urdhërpagesa periodike (lidhur me Llogaritë Financiare të ndryshme nga Llogaritë e Depozitave) për të transferuar fonde në një llogari të mbajtur në një Juridiksion të Raportueshëm, Institucioni Financiar Raportues merr, ose ka bërë shqyrtime të mëparshme dhe mban të dhëna për:
    - i) vetëvërtetimin nga Mbajtësi i Llogarisë i juridiksioneve të rezidencës së këtij Mbajtësi Llogarie që nuk e përfshin këtë Juridiksion të Raportueshëm; dhe
    - ii) evidencat shkresore që përcaktojnë statusin e paraportueshëm të Mbajtësit të Llogarisë.
  - b) informacioni i Mbajtësit të Llogarisë përmban një prokurë të posaçme aktuale ose autoritet nënshkrues dhënë një personi me adresë në Juridiksionin e Raportueshëm, Institucioni Financiar Raportues merr, ose ka bërë shqyrtime të mëparshme dhe mban të dhëna për:
    - i) vetëvërtetimin nga Mbajtësi i Llogarisë i juridiksioneve të rezidencës së këtij Mbajtësi Llogarie që nuk e përfshin këtë Juridiksion të Raportueshëm; ose
    - ii) evidencat shkresore që përcaktojnë statusin e paraportueshëm të Mbajtësit të Llogarisë.

**C. Procedurat e përmirësuara të shqyrtimit për Llogaritë e Vlerës së Lartë.** Lidhur me Llogaritë e Vlerës së Lartë, zbatohen procedurat vijuese të përmirësuara të shqyrtimit.

1. **Kërkimi elektronik i të dhënave.** Lidhur me Llogaritë e Vlerës së Lartë, Institucioni Financiar Raportues duhet të shqyrtojë të dhënat e kërkueshme në formë elektronike që mbahen nga Institucioni Financiar Raportues për secilën prej indicieve të përshkruara në nënparagrafin B(2).
2. **Kërkimi manual i të dhënave.** Nëse bazat e të dhënave të kërkueshme në formë elektronike të Institucionit Financiar Raportues përfshijnë fusha për, dhe kapin të gjithë informacionin e përshkruar në, nënparagrafin C(3), atëherë nuk është e nevojshme të kryhet një tjetër kontroll manual. Nëse bazat elektronike të të dhënave nuk e kapin të gjithë këtë informacion, atëherë lidhur me Llogarinë e Vlerës së Lartë, Institucioni Financiar Raportues duhet të shqyrtojë edhe dosjen aktuale kryesore të klientit dhe, nëse nuk ndodhet në dosjen aktuale kryesore të klientit, dokumentet vijuese që lidhen me llogarinë dhe që janë marrë nga Institucioni Financiar Raportues brenda pesë viteve të fundit për secilën prej indicieve të përshkruara në nënparagrafin B(2):

- a) evidencat shkresore më të fundit të mbledhura lidhur me llogarinë;
- b) dokumentacionin ose kontratën më të fundit për hapjen e llogarisë;
- c) informacionin më të fundit të marrë nga Institucioni Financiar Raportues sipas Procedurave AML/KYC ose për qëllime të tjera rregullatore;
- d) çdo prokurë të posaçme ose formë të nënshkruesve të autorizuar aktualisht në fuqi; dhe
- e) çdo urdhërpagesë periodike (të ndryshme nga ato lidhur me Llogaritë e Depozitave) për të transferuar fonde, aktualisht në fuqi.

**Përfshirje deri në masën që bazat e të dhënave përmbajnë informacion të mjaftueshëm.** Institucionit Financiar Raportues nuk i kërkohet të kryejë kërkimin manual të të dhënave të përshkruar në nënparagrafin C(2) për sa kohë informacioni i kërkueshëm në format elektronik i Institucionit Financiar Raportues përfshin sa më poshtë:

- a) statusin e rezidencës së Mbajtësit të Llogarisë;
  - b) adresën e rezidencës dhe adresën e postës së Mbajtësit të Llogarisë që ndodhet aktualisht në dosjen e Institucionit Financiar Raportues;
  - c) numrat e telefonit të Mbajtësit të Llogarisë që janë aktualisht në dosjen e Institucionit Financiar Raportues, nëse ka;
  - d) në rastin e Llogarive Financiare të ndryshme nga Llogaritë e Depozitës, nëse ka urdhërpagesa periodike për të transferuar fondet nga llogaria në një tjetër llogari (duke përfshirë llogarinë në një degë tjetër të Institucionit Financiar Raportues ose në një tjetër Institucion Financiar);
  - e) nëse ka një adresë aktuale “në vëmendje të” ose udhëzim për “ruajtje të postës” për Mbajtësin e Llogarisë; dhe
  - f) nëse ka ndonjë prokurë të posaçme ose autoritet nënshkrues për llogarinë.
4. **Marrja në pyetje e Menaxherit të Marrëdhënieve mbi njohuri reale.** Përveç kontrolleve elektronike dhe manuale të të dhënave të përshkruara më lart, Institucioni Financiar Raportues duhet ta trajtojë si Llogari të Raportueshme çdo Llogari të Vlerës së Lartë që i caktohet menaxherit të marrëdhënieve (duke përfshirë çdo Llogari Financiare që i shtohet Llogarisë së Vlerës së Lartë) nëse menaxheri i marrëdhënies ka njohuri reale se Mbajtësi i Llogarisë është Person i Raportueshëm.
5. **Efektet e gjetjes së indicieve.**
- a) Nëse asnjë prej indicieve të renditura në nënparagrafin B(2) nuk zbulohet në shqyrtimin e përmirësuar të Llogarive të Vlerës së Lartë përshkruar më lart, dhe llogaria nuk është identifikuar si një llogari e mbajtur nga një Person i Raportueshëm në nënparagrafin C(4), atëherë nuk kërkohen veprime të mëtejshme deri sa të ketë një ndryshim në rrethana të cilat rezultojnë në një ose më shumë indicie që lidhen me llogarinë.
  - b) Nëse ndonjë prej indicieve të renditura në nënparagrafin B(2)(a) deri në (e) zbulohen në shqyrtimin e përmirësuar të Llogarive të Vlerës së Lartë përshkruar më lart, apo nëse ka ndonjë ndryshim pasues në rrethana të cilat rezultojnë në një ose më shumë indicie që lidhen me llogarinë, atëherë Institucioni Financiar Raportues duhet ta trajtojë llogarinë si një Llogari të Raportueshme lidhur me çdo Juridiksion të Raportueshëm për të cilin identifikohet indicia, përveçse nëse zgjedh të zbatojë nënparagrafin B(6) dhe një nga përjashtimet në këtë nënparagraf zbatohet lidhur me atë llogari.

- c) Nëse në shqyrtimin e përmirësuar të Llogarive të Vlerës së Lartë përshkruar më lartë zbulohet udhëzimi për “ruajtjen e postës” ose adresa “në vëmendje të”, dhe asnjë adresë tjetër dhe asnjë indicie tjetër e renditur në nënparagrafin B(2) deri në (e) nuk identifikohet për Mbajtësin e Llogarisë, Institucioni Financiar Raportues duhet të marrë nga ky Mbajtës i Llogarisë një vetëvërtetim ose evidencë shkresore për të përcaktuar rezidencat për qëllime tatimore të Mbajtësit të Llogarisë. Nëse Institucioni Financiar Raportues nuk e merr dot një vetëvërtetim të tillë ose evidencën shkresore, ai duhet ta raportojë llogarinë si një llogari të padokumentuar.
6. Nëse Llogaria Paraekzistuese Individuale nuk është një Llogari e Vlerës së Lartë duke filluar nga data 31 dhjetor [xxxx], por bëhet një Llogari e Vlerës së Lartë duke filluar nga dita e fundit e vitit pasues kalendarik, Institucioni Financiar Raportues duhet t’i përfundojë procedurat e shqyrtimit të përmirësuar të përshkruara në paragrafin C lidhur me këtë llogari brenda vitit kalendarik që pason vitin në të cilin llogaria bëhet një Llogari e Vlerës së Lartë. Nëse bazuar në këtë shqyrtim kjo llogari identifikohet si një Llogari e Raportueshme, Institucioni Financiar Raportues duhet ta raportojë informacionin e kërkuar mbi këtë llogari lidhur me vitin në të cilin ajo është identifikuar si Llogari e Raportueshme dhe çdo vit në vitet në vijim, përveçse nëse Mbajtësi i Llogarisë pushon së qeni një Person i Raportueshëm.
7. Pasi Institucioni Financiar Raportues zbaton procedurat e shqyrtimit të përmirësuar të përshkruara në paragrafin C për një Llogari të Vlerës së Lartë, Institucionit Financiar Raportues nuk i kërkohet t’i rizbatojë këto procedura, përveç marrjes në pyetje të menaxherit të marrëdhënieve të përshkruar në nënparagrafin C(4), për të njëjtën Llogari të Vlerës së Lartë në vitet në vijim me përjashtim të rasteve kur llogaria është e padokumentuar, raste në të cilat Institucioni Financiar Raportues duhet t’i rizbatojë ato çdo vit derisa kjo llogari të pushojë së qeni e padokumentuar.
8. Nëse ka ndryshim të rrethanave lidhur me një Llogari të Vlerës së Lartë që rezulton në një ose më shumë indicie të përshkruar në nënparagrafin B(2) që lidhet me llogarinë, atëherë Institucioni Financiar Raportues duhet ta trajtojë llogarinë si një Llogari të Raportueshme lidhur me çdo Juridiksion të Raportueshëm për të cilin është identifikuar një indicie përveçse nëse zgjedh të zbatojë nënparagrafin B(6) dhe një prej përjashtimeve në këtë paragraf zbatohet lidhur me atë llogari.
9. Institucioni Financiar Raportues duhet të zbatojë procedurat për të garantuar që menaxheri i marrëdhënieve identifikon çdo ndryshim në rrethanat e një llogarie. Për shembull, nëse menaxheri i marrëdhënieve njoftohet se Mbajtësi i Llogarisë ka një adresë të re postare në Juridiksionin e Raportueshëm, Institucionit Financiar Raportues i kërkohet ta trajtojë adresën e re si një ndryshim në rrethana dhe, nëse ai zgjedh të zbatojë nënparagrafin B(6), i kërkohet të marrë dokumentacionin e duhur nga Mbajtësi i Llogarisë.
- D. Shqyrtimi i Llogarive Paraekzistuese Individuale duhet të përfundojë brenda datës [xx/xx/xxxx].
- E. Çdo Llogari Individuale Paraekzistuese që është identifikuar si një Llogari e Raportueshme sipas këtij Seksioni, duhet të trajtohet si një Llogari e Raportueshme në të gjitha vitet pasuese, përveçse nëse Mbajtësi i Llogarisë pushon së qeni një Person i Raportueshëm.

#### Seksioni IV: Verifikimi i duhur për Llogaritë e Reja Individuale

Për qëllime të identifikimit të Llogarive të Raportueshme ndërmjet Llogarive të Reja Individuale do të zbatohen procedurat e mëposhtme.

- A. Lidhur me Llogaritë e Reja Individuale, pas hapjes së llogarisë, Institucioni Financiar Raportues duhet të marrë një vetëvërtetim, që mund të jetë pjesë e dokumentacionit për hapjen e llogarisë, i cili e lejon Institucionin Financiar Raportues të përcaktojë rezidencat e Mbajtësit të Llogarisë për qëllime tatimore dhe të konfirmojë arsyeshmërinë e këtij vetëvërtetimi bazuar në informacionin e marrë nga Institucioni Financiar Raportues lidhur me hapjen e llogarisë, duke përfshirë çdo dokumentacion të mbledhur sipas procedurave për AML/KYC.
- B. Nëse vetëvërtetimi përcakton se Mbajtësi i Llogarisë është rezident për qëllime tatimore në një Juridiksion të Raportueshëm, Institucioni Financiar Raportues duhet ta trajtojë llogarinë si një Llogari të Raportueshme dhe vetëvërtetimi duhet të përfshijë edhe NIPT-in e Mbajtësit të Llogarisë lidhur me këtë Juridiksion të Raportueshëm (sipas paragrafit D të Seksionit I) dhe datën e lindjes.
- C. Nëse ka ndryshime të rrethanave lidhur me një Llogari të Re Individuale që e vë Institucionin Financiar Raportues në dijeni të, ose ka arsye të jetë në dijeni të faktit që vetëvërtetimi fillestar është i pasaktë ose i pabesueshëm, Institucioni Financiar Raportues nuk mund të mbështetet në vetëvërtetimin fillestar dhe duhet të marrë një vetëvërtetim të vlefshëm që përcakton rezidencat për qëllime tatimore të Mbajtësit të Llogarisë.

## Seksioni V: Verifikimi i duhur për Llogaritë Paraekzistuese të Njësive Ekonomike

Për qëllime të identifikimit të Llogarive të Raportueshme ndërmjet Llogarive Paraekzistuese të Njësive Ekonomike do të zbatohen procedurat e mëposhtme.

- A. **Llogaritë e Njësive Ekonomike që nuk kërkohet të shqyrtohen, identifikohen ose raportohen.** Përveçse nëse Institucioni Financiar Raportues zgjedh të veprojë ndryshe, qoftë lidhur me të gjitha Llogaritë Paraekzistuese të Njësive Ekonomike ose, veçmas, lidhur me çdo grup të identifikuar qartë të këtyre llogarive, Llogaria Paraekzistuese e Njesisë Ekonomike me një bilanc total llogarie ose vlerë që nuk e kalon 250 000 USD duke filluar nga data 31 dhjetor [xxxx], nuk kërkohet të shqyrtohet, identifikohet ose raportohet si një Llogari e Raportueshme deri në momentin që bilanci ose vlera totale e llogarisë kalon nivelin 250 000 USD duke filluar nga dita e fundit e çdo viti pasues **kalendarik**.
- B. **Llogaritë e Njësive Ekonomike objekt i shqyrtimit.** Një Llogari Paraekzistuese e Njesisë Ekonomike që ka një bilanc ose vlerë totale të llogarisë që e kalon nivelin 250 000 USD duke filluar nga data 31 dhjetor [xxxx], dhe Llogaria Paraekzistuese e Njesisë Ekonomike që nuk e kalon nivelin 250 000 USD duke filluar nga data 31 dhjetor [xxxx], por që bilanci ose vlera e llogarisë të së cilës e kalon nivelin 250 000 USD duke filluar nga dita e fundit e çdo viti pasues kalendarik, duhet të shqyrtohet në përputhje me procedurat e parashtruara në paragrafin D.
- C. **Llogaritë e Njësive Ekonomike për të cilat kërkohet raportim.** Lidhur me Llogaritë Paraekzistuese të Njësive Ekonomike të përshkruara në paragrafin B, vetëm ato Llogari të cilat mbahen nga një ose më shumë Njësi Ekonomike që janë Persona të Raportueshëm, ose nga NFE Pasive me një ose më shumë Persona Kontrollues që janë Persona të Raportueshëm, do të trajtohen si Llogari të Raportueshme.
- D. **Procedurat e shqyrtimit për identifikimin e Llogarive të Njësive Ekonomike për të cilat kërkohet raportim.** Për Llogaritë Paraekzistuese të Njësive Ekonomike të përshkruara në paragrafin B, Institucioni Financiar Raportues duhet të zbatojë procedurat vijuese të shqyrtimit për të përcaktuar nëse llogaria mbahet nga një ose më shumë Persona të Raportueshëm, ose nga NFE Pasive me një ose më shumë Persona Kontrollues të cilët janë Persona të Raportueshëm:



**1. Të përcaktohet nëse Njësia Ekonomike është një Person i Raportueshëm.**

- a) Shqyrtimi i informacionit që mbahet për qëllime rregullatore ose të marrëdhënies me klientin (duke përfshirë informacionin e mbledhur sipas Procedurave për AML/KYC) për të përcaktuar nëse informacioni tregon që Mbajtësi i Llogarisë është rezident në një Juridiksion të Raportueshëm. Për këtë qëllim, informacioni që tregon se Mbajtësi i Llogarisë është rezident në një Juridiksion të Raportueshëm përfshin vendin e themelimit ose të organizimit, ose adresën në Juridiksionin e Raportueshëm.
- b) Nëse informacioni tregon se Mbajtësi i Llogarisë është rezident në një Juridiksion të Raportueshëm, Institucioni Financiar Raportues duhet ta trajtojë llogarinë si Llogari të Raportueshme përveçse nëse ai merr një vetëvërtetim nga Mbajtësi i Llogarisë, ose në mënyrë të arsyeshme përcakton bazuar në informacionin që ka në dispozicion apo që është i disponueshëm publikisht, se Mbajtësi i Llogarisë nuk është një Person i Raportueshëm.

**2. Të përcaktohet nëse Njësia Ekonomike është një NFE Pasive me një ose më shumë Persona Kontrollues të cilët janë Persona të Raportueshëm.** Lidhur me Mbajtësin e Llogarisë të një Llogarie Paraekzistuese të Njesisë Ekonomike (duke përfshirë Njësine Ekonomike që është Person i Raportueshëm), Institucioni Financiar Raportues duhet të përcaktojë nëse Mbajtësi i Llogarisë është një NFE Pasive me një ose më shumë Persona Kontrollues që janë Persona të Raportueshëm. Nëse ndonjë prej Personave Kontrollues të NFE-së Pasive është Person i Raportueshëm, atëherë llogaria duhet të trajtohet si Llogari e Raportueshme. Kur bën këto përcaktime, Institucioni Financiar Raportues duhet të ndjekë udhëzimet në nënparagrafët D(2)(a) deri në (c) sipas rendit më të përshtatshëm në varësi të rrethanave.

- a) **Përcaktimi nëse Mbajtësi i Llogarisë është një NFE Pasive.** Për qëllime të përcaktimit nëse Mbajtësi i Llogarisë është një NFE Pasive, Institucioni Financiar Raportues duhet të marrë një vetëvërtetim nga Mbajtësi i Llogarisë për të përcaktuar statusin e tij, përveçse nëse disponon informacion ose ka informacion të disponueshëm publikisht, bazuar në të cilin ai mund të përcaktojë në mënyrë të arsyeshme që Mbajtësi i Llogarisë është një NFE Aktive ose një Institucion Financiar i ndryshëm nga Njësia Ekonomike e Investimeve e përsëhruar në nënparagrafin A(6)(b) të seksionit VIII që nuk është Institucion Financiar i Juridiksionit Pjesëmarrës.
- b) **Përcaktimi i Personave Kontrollues të një Mbajtësi Llogarie.** Për qëllime të përcaktimit të Personave Kontrollues të një Mbajtësi Llogarie, Institucioni Financiar Raportues mund të mbështetet në informacionin e mbledhur dhe mbajtur në pajtim me procedurat për AML/KYC.
- c) **Përcaktimi nëse Personi Kontrollues i një NFE-je Pasive është një Person i Raportueshëm.** Për qëllime të përcaktimit nëse një Person Kontrollues i një NFE-je Pasive është një Person i Raportueshëm, Institucioni Financiar Raportues duhet të mbështetet mbi:
  - i) informacionin e mbledhur dhe të mbajtur në pajtim me Procedurat për AML/KYC në rastin e një Llogarie Paraekzistuese të Njesisë Ekonomike të mbajtur nga një ose më shumë NFE me një bilanc ose vlerë totale të llogarisë që nuk e kalon nivelin 1 000 000 USD; ose
  - ii) vetëvërtetimin nga Mbajtësi i Llogarisë ose Personi Kontrollues i tij i juridiksioneve në të cilat Personi Kontrollues është rezident për qëllime tatimore.

**E. Afatet kohore të shqyrtimit dhe procedurat shtesë që zbatohen për Llogaritë Paraekzistuese të Njesisë Ekonomike.**

1. Shqyrtimi i Llogarive Paraekzistuese të Njësive Ekonomike me një bilanc ose vlerë totale të llogarisë që e kalon nivelin 250 000 USD duke filluar nga data 31 dhjetor [xxxx] duhet të përfundojë brenda datës 31 dhjetor [xxxx].
2. Shqyrtimi i Llogarive Paraekzistuese të Njësive Ekonomike me një bilanc ose vlerë totale të llogarisë që nuk e kalon nivelin 250 000 USD duke filluar nga data 31 dhjetor [xxxx], por që e kalon nivelin 250 000 USD duke filluar nga data 31 dhjetor e vitit pasues, duhet të përfundojë brenda vitit kalendarik që vjen pas vitit në të cilin bilanci ose vlera totale e llogarisë e kalon nivelin 250 000 USD.
3. Nëse ka ndryshime të rrethanave lidhur me një Llogari Paraekzistuese të Njesisë Ekonomike që e vë Institucionin Financiar Raportues në dijeni të, ose ka arsye të jetë në dijeni të faktit që vetëvërtetimi ose dokumentacioni tjetër i lidhur me llogarinë është i pasaktë ose i pabesueshëm, Institucioni Financiar Raportues duhet të ripërcaktojë statusin e llogarisë në përputhje me procedurat e parashtruara në paragrafin D.

## Seksioni VI: Verifikimi i duhur për Llogaritë e Reja të Njësive Ekonomike

Për qëllime të identifikimit të Llogarive të Raportueshme ndërmjet Llogarive të Reja të Njësive Ekonomike do të zbatohen procedurat e mëposhtme.

**A. Procedurat e shqyrtimit për identifikimin e Llogarive të Njësive Ekonomike për të cilat kërkohet raportim.** Për Llogaritë e Reja të Njësive Ekonomike, Institucioni Financiar Raportues duhet të zbatojë procedurat vijuese të shqyrtimit për të përcaktuar nëse llogaria mbahet nga një ose më shumë Persona të Raportueshëm, ose nga NFE Pasive me një ose më shumë Persona Kontrollues të cilët janë Persona të Raportueshëm:

1. **Të përcaktohet nëse Njësia Ekonomike është një Person i Raportueshëm.**
  - a) Marrja e një vetëvërtetimi, i cili mund të jetë pjesë e dokumentacionit për hapjen e llogarisë, që e lejon Institucionin Financiar Raportues të përcaktojë rezidencat e Mbajtësit të Llogarisë për qëllime tatimore dhe të konfirmojë arsyeshmërinë e këtij vetëvërtetimi bazuar në informacionin e marrë nga Institucioni Financiar Raportues lidhur me hapjen e llogarisë, duke përfshirë çdo dokumentacion të mbledhur në pajtim me Procedurat për AML/KYC. Nëse Njësia Ekonomike vërteton se nuk ka rezidencë për qëllime tatimore, Institucioni Financiar Raportues mund të mbështetet në adresën e selisë kryesore të Njesisë Ekonomike për të përcaktuar rezidencën e Mbajtësit të Llogarisë.
  - b) Nëse vetëvërtetimi tregon se Mbajtësi i Llogarisë është rezident në një Juridiksion të Raportueshëm, Institucioni Financiar Raportues duhet ta trajtojë llogarinë si një Llogari të Raportueshme përveçse nëse ai përcakton në mënyrë të arsyeshme bazuar në informacionin që posedon ose që është publikisht i disponueshëm, se Mbajtësi i Llogarisë nuk është një Person i Raportueshëm lidhur me këtë Juridiksion të Raportueshëm.
2. **Të përcaktohet nëse Njësia Ekonomike është një NFE Pasive me një ose më shumë Persona Kontrollues të cilët janë Persona të Raportueshëm.** Lidhur me Mbajtësin e Llogarisë të një Llogarie të Re të Njesisë Ekonomike (duke përfshirë Njësine Ekonomike që është Person i Raportueshëm), Institucioni Financiar Raportues duhet të përcaktojë nëse Mbajtësi i Llogarisë është një NFE Pasive me një ose më shumë Persona Kontrollues që janë Persona të Raportueshëm. Nëse ndonjë prej Personave Kontrollues të NFE-së Pasive është Person i Raportueshëm, atëherë llogaria duhet të trajtohet si Llogari e Raportueshme.

Kur bën këto përcaktime, Institucioni Financiar Raportues duhet të ndjekë udhëzimet në nënparagrafët A(2)(a) deri në (c) sipas rendit më të përshtatshëm në varësi të rrethanave.

- a) **Përcaktimi nëse Mbajtësi i Llogarisë është një NFE Pasive.** Për qëllime të përcaktimit nëse Mbajtësi i Llogarisë është një NFE Pasive, Institucioni Financiar Raportues duhet të marrë një vetëvërtetim nga Mbajtësi i Llogarisë për të përcaktuar statusin e tij, përveçse nëse disponon informacion ose ka informacion të disponueshëm publikisht, bazuar në të cilin ai mund të përcaktojë në mënyrë të arsyeshme që Mbajtësi i Llogarisë është një NFE Aktive ose një Institucion Financiar i ndryshëm nga Njësia Ekonomike e Investimeve e përshkruar në nënparagrafin A(6)(b) të seksionit VIII që nuk është Institucion Financiar i Juridiksionit Pjesëmarrës.
- b) **Përcaktimi i Personave Kontrollues të një Mbajtësi Llogarie.** Për qëllime të përcaktimit të Personave Kontrollues të një Mbajtësi Llogarie, Institucioni Financiar Raportues mund të mbështetet në informacionin e mbledhur dhe mbajtur në pajtim me procedurat për AML/KYC.
- c) **Përcaktimi nëse Personi Kontrollues i një NFE-je Pasive është një Person i Raportueshëm.** Për qëllime të përcaktimit nëse një Person Kontrollues i një NFE-je Pasive është një Person i Raportueshëm, Institucioni Financiar Raportues mund të mbështetet mbi vetëvërtetimin nga Mbajtësi i Llogarisë ose e këtij Personi Kontrollues.

## Seksioni VII: Rregullat e veçanta të verifikimit të duhur

Në implementimin e procedurave të verifikimit të duhur përshkruar më lart do të zbatohen rregullat shtesë të mëposhtme:

- A. **Mbështetja te vetëvërtetimet ose evidencat shkresore.** Institucioni Financiar Raportues mund të mos mbështetet te vetëvërtetimi ose evidencat shkresore nëse Institucioni Financiar Raportues ka dijeni ose ka arsye të ketë dijeni që vetëvërtetimi ose evidencat shkresore janë të pasakta ose të pabesueshme.
- B. **Procedurat alternative për llogaritë financiare që mbahen nga përfituesit individualë të Kontratave të Sigurimeve në Vlerë në Para të Gatshme ose të Kontratave të Pensionit Vjetor.** Institucioni Financiar Raportues mund të prezumojë se përfituesi individual (i ndryshëm nga pronari) i Kontratës së Sigurimeve në Vlerë në Para të Gatshme ose i Kontratës së Pensionit Vjetor që merr pension familjar nuk është një Person i Raportueshëm dhe mund ta trajtojë këtë Llogari Financiare ndryshe nga Llogaria e Raportueshme përveçse nëse Institucioni Financiar Raportues ka njohuri reale ose ka arsye të dijë se përfituesi është një Person i Raportueshëm. Institucioni Financiar Raportues ka arsye të dijë se përfituesi i Kontratës së Sigurimeve në Vlerë në Para të Gatshme ose i Kontratës së Pensionit Vjetor është një Person i Raportueshëm nëse informacioni i mbledhur nga Institucioni Financiar Raportues dhe që lidhet me përfituesin përmban indiciet e përshkruara në paragrafin B të seksionit III. Nëse Institucioni Financiar Raportues ka njohuri reale ose arsye të ketë dijeni që përfituesi është Person i Raportueshëm, Institucioni Financiar Raportues duhet të ndjekë procedurat në paragrafin B të seksionit III.
- C. **Totalizimi (agregimi) i bilancit të llogarisë dhe rregullat e monedhës.**
  - 1. **Totalizimi i Llogarive Individuale.** Për qëllime të përcaktimit të bilancit ose vlerës totale të Llogarive Financiare që mbahen nga një individ, Institucionit Financiar Raportues i kërkohet të totalizojë të gjitha Llogaritë Financiare që mbahen nga Institucioni Financiar Raportues, ose nga një Njësi Ekonomike e lidhur me të, por vetëm deri në masën që sistemet e kompjuterizuara të Institucionit Financiar



Raportues i lidhin Llogaritë Financiare duke iu referuar një elementi të të dhënave si numri i klientit ose NIPT-i, dhe lejojnë totalizimin e balanceve ose vlerave të llogarive. Secilit mbajtës të një Llogarie Financiare të mbajtur bashkërisht do t'i atribuohet i gjithë bilanci ose e gjithë vlera e Llogarisë Financiare të mbajtur bashkërisht për qëllime të zbatimit të kriterëve të totalizimit të përshkruara në këtë nënparagraf.

2. **Totalizimi i Llogarive të Njësive Ekonomike.** Për qëllime të përcaktimit të bilancit ose vlerës totale të Llogarive Financiare që mbahen nga një Njësi Ekonomike, Institucionit Financiar Raportues i kërkohet të marrë në konsideratë të gjitha Llogaritë Financiare që mbahen nga Institucioni Financiar Raportues, ose nga një Njësi Ekonomike e lidhur me të, por vetëm deri në masën që sistemet e kompjuterizuara të Institucionit Financiar Raportues i lidhin Llogaritë Financiare duke iu referuar një elementi të të dhënave si numri i klientit ose NIPT-i, dhe lejojnë totalizimin e balanceve ose vlerave të llogarive. Secilit mbajtës të një Llogarie Financiare të mbajtur bashkërisht do t'i atribuohet i gjithë bilanci ose e gjithë vlera e Llogarisë Financiare të mbajtur bashkërisht për qëllime të zbatimit të kriterëve të totalizimit të përshkruara në këtë nënparagraf.
3. **Rregulli i veçantë i totalizimit që zbatohet për Menaxherët e Marrëdhënieve.** Për qëllime të përcaktimit të bilancit ose vlerës totale të Llogarive Financiare që mbahen nga një person për të përcaktuar nëse një Llogari Financiare është një Llogari e Vlerës së Lartë, Institucionit Financiar Raportues gjithashtu i kërkohet që t'i totalizojë të gjitha këto llogari, në rastin e çdo Llogarie Financiare që menaxheri i marrëdhënieve e di, ose ka arsye të dijë, që janë direkt ose indirekt të zotëruara, kontrolluara ose krijuara (të ndryshme nga ato të mbajtura në besueshmëri) nga i njëjti person.
4. **Shumat e lexuara për të përfshirë ekuivalenten në monedha të tjera.** Të gjitha shumat në dollarë janë në dollarë amerikanë dhe do të lexohen për të përfshirë shumat ekuivalente në monedha të tjera, siç përcaktohet nga legjislacioni i brendshëm.

## Seksioni VIII: Termat e përkufizuara

Termat vijuese kanë kuptimet e parashtruara më poshtë:

### A. Institucion Financiar Raportues

1. Termi **“Institucion Financiar Raportues”** është çdo Institucion Financiar i Juridiksionit Pjesëmarrës që nuk është Institucion Financiar Joraportues.
2. Termi **“Institucion Financiar i Juridiksionit Pjesëmarrës”** është (i) çdo Institucion Financiar që është rezident në Juridiksionin Pjesëmarrës, por përjashton çdo degë të atij Institucioni Financiar që ndodhet jashtë këtij Juridiksioni Pjesëmarrës, dhe (ii) çdo degë e një Institucioni Financiar që nuk është rezident në Juridiksionin Pjesëmarrës, nëse kjo degë është e vendosur në Juridiksionin Pjesëmarrës në fjalë.
3. Termi **“Institucion Financiar”** është një Institucion Kujdestarie, një Institucion Depozite, një Njësi Ekonomike Investimesh ose një Shoqëri Sigurimesh Specifike.
4. Termi **“Institucion Kujdestarie”** është një Njësi Ekonomike që mban, si pjesë të konsiderueshme të biznesit të saj, aktive financiare për llogari të të tjerëve. Njësia Ekonomike mban aktive financiare për llogari të të tjerëve si pjesë të konsiderueshme të biznesit të saj nëse të ardhurat bruto të Njesisë Ekonomike që i atribuohen mbajtjes së aktiveve financiare dhe shërbimeve financiare të lidhura me to janë të barabarta me ose i tejkalojnë 20% të të ardhurave bruto të Njesisë Ekonomike në më pak se: (i) periudha tre vjeçare që përfundon më

31 dhjetor (ose dita e fundit e periudhës kontabël të vitit jokalendarik) përpara vitit në të cilin bëhet përcaktimi; ose (ii) periudha gjatë së cilës Njësia Ekonomike ka ekzistuar.

5. Termi **“Institucion Depozite”** është çdo Njësi Ekonomike që pranon depozita sipas mënyrës së zakonshme të një banke ose biznesi të ngjashëm.
6. Termi **“Njësi Ekonomike Investimi”** është çdo Njësi Ekonomike:
  - a) që kryesisht drejton si biznes një ose më shumë prej veprimtarive ose operacioneve vijuese për llogari ose në emër të një klienti:
    - i) tregti në instrumentet e tregut të parasë (çeqe, kambiale, certifikata depozite, derivativë, etj); këmbim valutor; këmbim, normë interesi dhe instrumente indeksi; letra me vlerë të transferueshme; ose transaksione me kontratat e së ardhmes (future) për mallrat;
    - ii) menaxhim të portofoleve individuale dhe kolektive; ose
    - iii) gjithashtu investon, administron ose menaxhon aktivet financiare ose paratë për llogari të personave të tjerë; ose
  - b) të ardhurat bruto të së cilës i atribuohen kryesisht investimeve, riinvestimeve ose tregtisë në aktive financiare, nëse Njësia Ekonomike menaxhohet nga një tjetër Njësi Ekonomike që është një Institucion Depozite, Institucion Kujdestarie, Shoqëri Sigurimesh e Specifikuar, ose një Njësi Ekonomike Investimesh e përshkruar në nënparagrafin A(6)(a).

Njësia Ekonomike trajtohet se po kryhen kryesisht si biznes një ose më shumë prej veprimtarive të përshkruara në nënparagrafin A(6)(a), ose të ardhurat bruto të Njesisë Ekonomike i atribuohen kryesisht investimeve, riinvestimeve ose tregtisë në aktive financiare për qëllime të nënparagrafit A(6)(b), nëse të ardhurat bruto të Njesisë Ekonomike që i atribuohen veprimtarive përkatëse janë të barabarta ose i tejkalojnë 50% të të ardhurave bruto të Njesisë Ekonomike në më pak se: (i) periudha tre vjeçare që përfundon më 31 dhjetor të vitit që vjen përpara vitit në të cilin është bërë përcaktimi; ose (ii) periudha gjatë së cilës Njësia Ekonomike ka ekzistuar. Termi “Njësi Ekonomike Investimi” nuk përfshin Njësine Ekonomike që është një NFE Aktive sepse ajo përmbush të gjitha kriteret në nënparagrafët D(9)(d) deri në (g).

Ky paragraf do të interpretohet në një mënyrë të pajtueshme me gjuhën e ngjashme të parashtruar në përkufizimin e “institucionit financiar” në Rekomandimet e Task Forcës për Aksionin Financiar.

7. Termi **“Aktiv Financiar”** përfshin një letër me vlerë (për shembull, një përqindje aksionesh në një korporatë; partneritet ose interes përfitimi nga pronësia në një trust ose shoqëri tregtare me shumë aksionerë ose të kuotuar në bursë; dëftesë, bono, instrumente borxhi, ose evidenca të tjera borxhi), interesin e partnerit në partneritet, mallra, marrëveshje shkëmbimi (swap) (për shembull, normë interesi swap, swap në valutë, swap bazë, kufijtë maksimalë të normës së interesit, kufijtë minimalë të normës së interesit, swaps-et e mallrave, swaps-et e kapitalit, swaps-et e indeksit të kapitalit dhe marrëveshje të ngjashme), Kontratat e Sigurimeve ose Kontratat e Pensionit Vjetor, ose çdo interes (duke përfshirë kontratat future ose forward ose opsionet) në letra me vlerë, interes partneriteti, mallra, swap, Kontratë Sigurimesh ose Kontratë Pensioni Vjetor. Termi “aktiv financiar” nuk përfshin një interes të drejtpërdrejtë jodebitor në pasuri të paluajtshme.
8. Termi **“Shoqëri Sigurimesh e Specifikuar”** është çdo Njësi Ekonomike që është një shoqëri sigurimesh (ose shoqëria kontrolluese (holding) e shoqërisë së sigurimeve) që lëshon ose është e detyruar të kryejë pagesa lidhur me Kontratat e Sigurimit në Vlerë në Para të Gatshme ose Kontratat e Pensionit Vjetor.

**B. Institucion Financiar Joraportues**

1. Termi “**Institucion Financiar Joraportues**” është çdo Institucion Financiar që:

- a) është një Organ Qeveritar, Organizatë Ndërkombëtare ose Bankë Qendrore, përveçse lidhur me pagesa të cilat rrjedhin nga detyrimet e mbajtura në lidhje me një veprimtari financiare tregtare të llojit të atyre të realizuara nga një Shoqëri Sigurimesh e Specifikuar, një Institucion Kujdestarie ose një Institucion Depozite;
- b) është një Fond Pensioni me Pjesëmarrje të Gjerë; një Fond Pensioni me Pjesëmarrje të Kufizuar; një Fond Pensioni i një Organi Qeveritar, Organizatë Ndërkombëtare ose Banke Qendrore; ose një Emetues i Kualifikuar i Kartave të Kreditit;
- c) çdo Njësi tjetër Ekonomike që paraqet rrezik të ulët për t’u përdorur për shmangie tatimore, ka shumë karakteristika të ngjashme me secilën prej njësive të përshkruara në nënparagrafët B(1)(a) dhe (b), dhe është përcaktuar në legjislacionin e brendshëm si një Institucion Financiar Joraportues, me kusht që statusi i kësaj njësie si Institucion Financiar Joraportues nuk cenon qëllimet e Standardit të Përbashkët të Raportimit;
- d) është një Instrument Investimesh Kolektive i Përgjashtuar; ose
- e) është një trust deri në masën që administratori i besuar i trustit është një Institucion Financiar Raportues dhe e raporton të gjithë informacionin që duhet raportuar në pajtim me seksionin I lidhur me të gjitha Llogaritë e Raportueshme të trustit.

2. Termi “**Organ Qeveritar**” është qeveria e një juridiksioni, çdo nënndarje politike e një juridiksioni (që për të shmangur dyshimet përfshin shtetin, provincën, kontenë ose bashkinë), ose çdo agjenci ose organizëm që i përket plotësisht juridiksionit ose ndonjë apo më shumë prej të lartpërmendurave (ku secila prej tyre përbën një “Organ Qeveritar”). Kjo kategori përbëhet nga pjesët integrale, njësitë e kontrolluara dhe nënndarjet politike të një juridiksioni.

- a) “Pjesë integrale” e një juridiksioni është çdo person, organizatë, agjenci, byro, fond, organizëm ose organ tjetër, pavarësisht emërimit, që përbën një autoritet qeverisës së një juridiksioni. Fitimet neto të autoritetit qeverisës duhet të kreditohen në llogarinë e tij ose në llogari të tjera të juridiksionit, ku asnjë pjesë e tyre nuk do të shkojë në përfitim të asnjë personi privat. Pjesa integrale nuk përfshin asnjë individ që mund të jetë sovran, zyrtar ose administrator që vepron në cilësinë private ose personale.
- b) Një njësi e kontrolluar është Njësia që është e ndarë në formë nga juridiksioni apo që ndryshe përbën një njësi juridike të veçantë, me kusht që:
  - i) Njësia të jetë plotësisht e zotëruar ose e kontrolluar nga një ose më shumë Organe Qeveritare në mënyrë direkte ose nëpërmjet një apo më shumë njësive të kontrolluara;
  - ii) fitimet neto të Njesisë kreditohen në llogarinë e saj ose në llogaritë e një ose më shumë Organeve Qeveritare, ku asnjë pjesë e tyre nuk do të shkojë në përfitim të asnjë personi privat; dhe
  - iii) në momentin e shpërbërjes, aktivet e Njesisë i atribuohen një ose më shumë Organeve Qeveritare.
- c) Të ardhurat nuk shkojnë në përfitim të personave privatë nëse këta persona janë përfituesit e synuar të një programi qeveritar dhe veprimtaritë e programit kryhen për publikun e gjerë për mirëqenien e përbashkët ose lidhen me

administrimin e disa fazave të qeverisë. Megjithatë, pavarësisht nga sa më lart, të ardhurat shkojnë në përfitim të personave privatë nëse të ardhurat vijnë si rezultat i përdorimit të një organi qeveritar për të kryer një aktivitet tregtar, si aktiviteti bankar tregtar që u ofron shërbime financiare personave privatë.

3. Termi **“Organizatë Ndërkombëtare”** është çdo organizatë ndërkombëtare ose agjenci apo organizëm i zotëruar plotësisht prej tyre. Kjo kategori përfshin çdo organizatë ndërqeveritare (duke përfshirë organizatat supranacionale) (1) që përbëhet kryesisht nga qeveritë; (2) që ka në fuqi një marrëveshje për selinë ose një marrëveshje të ngjashme në thelb me juridiksionin; dhe (3) të ardhurat e së cilës nuk shkojnë në përfitim të personave privatë.
4. Termi **“Bankë Qendrore”** është një institucion që me ligj ose akt shtetëror është autoriteti kryesor që, përveç qeverisë së vetë juridiksionit, emeton instrumente që kanë për qëllim të qarkullohen si monedhë. Ky institucion mund të përfshijë një organizëm që është i ndarë nga qeveria e juridiksionit, pavarësisht nëse zotërohet apo jo plotësisht ose pjesërisht nga juridiksioni.
5. Termi **“Fond Pensioni me Pjesëmarrje të Gjerë”** është fondi i krijuar për të dhënë pension pleqërie, invaliditeti ose familjar, apo një kombinim të tyre, për përfituesit që janë punëmarrës aktualë ose të mëparshëm (ose persona të zgjedhur nga këta punëmarrës) të një ose më shumë punëdhënësve për shërbimet e kryera, me kusht që fondi:
  - a) të mos ketë asnjë përfitues të vetëm me të drejtë në më shumë se pesë për qind të aktiveve të fondit;
  - b) të jetë objekt i rregulloreve të qeverisë dhe të raportoje informacione pranë autoriteteve tatimore; dhe
  - c) të përmbushë të paktën një prej kriterëve të mëposhtme:
    - i) fondi është përgjithësisht i përjashtuar nga tatimi mbi të ardhurat nga investimet, ose tatimi i këtyre të ardhurave shtyhet ose tatohet me një normë të reduktuar për shkak të statusit të tij si fond pensioni pleqërie ose fond pensioni;
    - ii) fondi merr të paktën 50% të kontributeve të tij totale (të ndryshme nga transfertat e aktiveve nga planet e tjera të përshkruara në nënparagrafët B(5) deri në (7) ose nga llogaritë e pensionit të pleqërisë ose pensionit të përshkruara në nënparagrafin C(17)(a)) nga punëdhënësit sponsorizues;
    - iii) shpërndarjet ose tërheqjet nga fondi lejohen vetëm nëse ndodhin ngjarje të specifikuar lidhur me pensionin, invaliditetin ose vdekjen (me përjashtim të shpërndarjeve të cilat riinvestohen në fonde të tjera pensioni të përshkruara në nënparagrafët B(5) deri në (7) ose në llogaritë e pensionit të pleqërisë ose pensionit të përshkruara në nënparagrafin C(17)(a)), ose në rast të shpërndarjeve ose tërheqjeve të bëra përpara këtyre ngjarjeve të specifikuar do të zbatohen penalitete; ose
    - iv) kontributet (me përjashtim të disa kontributeve kompensuese të autorizuar) nga punëmarrësit në fond janë të kufizuara në funksion të të ardhurave të punëmarrësit ose, në zbatim të rregullave të parashtruara në paragrafin C të seksionit VII për totalizimin e llogarisë dhe përkthimin në monedhën vendase, nuk mund t'i kalojnë 50 000 USD në vit.
6. Termi **“Fond Pensioni me Pjesëmarrje të Kufizuar”** është fondi i krijuar për të dhënë pension pleqërie, invaliditeti ose familjar, për përfituesit që janë punëmarrës aktualë ose të mëparshëm (ose persona të zgjedhur nga këta punëmarrës) të një ose më shumë punëdhënësve për shërbimet e kryera, me kusht që:
  - a) fondi të ketë më pak se 50 pjesëmarrës;

- b) fondi të sponsorizohet nga një ose më shumë punëdhënës të cilët nuk janë Njësi Ekonomike Investimi ose NFE Pasive;
  - c) kontributet e punëmarrësit dhe punëdhënësit në fond (me përjashtim të transfertave të aktiveve nga llogaritë e pensionit të pleqërisë dhe pensionit të përshkruara në nënparagrafin C(17)(a) të jenë përkatësisht të kufizuara në funksion të të ardhurave të fituara dhe kompensimit të punëmarrësit;
  - d) pjesëmarrësit që nuk janë rezidentë të juridiksionit ku është krijuar fondit të mos kenë të drejtën e më shumë se 20% të aktiveve të fondit; dhe
  - e) fondi të jetë objekt i rregulloreve qeveritare dhe të raportojë informacion pranë autoriteteve tatimore.
7. Termi **“Fond Pensioni i një Organi Qeveritar, Organizate Ndërkombëtare ose Banka Qendrore”** është fondi i krijuar nga Organi Qeveritar, Organizata Ndërkombëtare ose Banka Qendrore për të dhënë pensione pleqërie, invaliditeti ose familjar për përfituesit ose pjesëmarrësit që janë punëmarrës aktualë ose të mëparshëm (ose persona të caktuar nga këta punëmarrës), ose që nuk janë punëmarrës aktualë ose të mëparshëm, nëse pensionet që u jepen këtyre përfituesve ose pjesëmarrësve janë në pajtim me shërbimet personale të realizuara për Organin Qeveritar, Organizatën Ndërkombëtare ose Bankën Qendrore.
8. Termi **“Emetues i Kualifikuar i Kartave të Kreditit”** është Institucioni Financiar që përmbush kriteret e mëposhtme:
- a) Institucioni Financiar është një Institucion Financiar vetëm sepse është emetues i kartave të kreditit që pranon depozita vetëm kur klienti kryen pagesa që tejkalojnë bilancin e përcaktuar për kartën dhe kjo mbipagesë nuk i rimburohet menjëherë klientit; dhe
  - b) duke filluar më ose përpara datës [xx/xx/xxxx], Institucioni Financiar zbaton politika dhe procedura qoftë për ta ndaluar klientin që të kryejë mbipagesa që i tejkalojnë 50 000 USD, ose për të garantuar se çdo mbipagesë e klientit që e tejkalon vlerën 50 000 USD t’i rimburohet klientit brenda 60 ditëve, në çdo rast duke zbatuar rregullat e parashtruara në paragrafin C të seksionit VII për totalizimin e llogarisë dhe përkthimin e monedhës. Për këtë arsye, mbipagesa e klientit nuk i referohet balanceve të kreditit që përfshijnë tarifa të kundërshtuara por përfshijnë bilancet e kreditit që vijnë si rezultat i kthimit të mallit.
9. Termi **“Instrument Investimesh Kolektive i Përjashtuar”** është një Njësi Ekonomike Investimesh që rregullohet si një instrument investimesh kolektive, me kusht që të gjitha interesat në instrumentin e investimeve kolektive të mbahen nga ose nëpërmjet individëve ose Njësive Ekonomike që nuk janë Persona të Raportueshëm, përveç NFE-së Pasive me Persona Kontrollues të cilët janë Persona të Raportueshëm.
- Njësia Ekonomike e Investimeve që rregullohet si një instrument investimesh kolektive nuk dështon të kualifikohet sipas nënparagrafit B(9) si një Instrument i Investimeve Kolektive i Përjashtuar vetëm sepse Instrumenti i Investimeve Kolektive i ka emetuar bartësit aksione fizike, me kusht që:
- a) instrumenti i investimeve kolektive nuk ka emetuar dhe nuk emeton asnjë aksion fizik për bartësin pas datës [xx/xx/xxxx];
  - b) instrumenti i investimeve kolektive i tërheq të gjitha këto aksione menjëherë pas heqjes dorë;
  - c) instrumenti i investimeve kolektive kryen procedurat e verifikimit të duhur të parashtruara në seksionet II deri në VII dhe raporton çdo informacion që kërkohet të raportohet lidhur me këto aksione kur këto aksione paraqiten për riblerje ose për pagesa të tjera; dhe



- d) instrumenti i investimeve kolektive disponon politika dhe procedura për të garantuar se këto aksione riblihen ose mbahen rezervë sa më shpejt të jetë e mundur, dhe në çdo rast përpara datës [xx/xx/xxxx].

### C. Llogaria Financiare

1. Termi **“Llogari Financiare”** është llogaria që mbahet nga një Institucion Financiar dhe përfshin Llogarinë e Depozitës, Llogarinë e Kujdestarisë dhe:

- a) në rastin e një Njësie Ekonomike Investimesh, çdo interes në kapital ose borxh në Institucionin Financiar. Pavarësisht nga sa më lart, termi “Llogari Financiare” nuk përfshin asnjë interes në kapital ose borxh në një Njësi Ekonomike që është Njësi Ekonomike Investimesh vetëm sepse ajo (i) jep këshilla investimi dhe vepron për llogari të, ose (ii) menaxhon portofolin e dhe vepron për llogari të klientit për qëllime të investimit, menaxhimit ose administrimit të aktiveve financiare të depozituara në emrin e klientit te një Institucion Financiar i ndryshëm nga kjo Njësi Ekonomike;
- b) në rastin e një Institucioni Financiar që nuk është përshkruar në nënparagrafin C(1)(a), çdo interes në kapital ose borxh në Institucionin Financiar, nëse lloji i interesit është përcaktuar me qëllim shmangien e raportimit në pajtim me seksionin I; dhe
- c) çdo Kontratë Sigurimi në Vlerë në Para të Gatshme dhe çdo Kontratë Pensioni Vjetor që lëshohet ose mbahet nga Institucioni Financiar, e ndryshme nga pagesat vjetore për sigurimin e jetës që nuk janë të lidhura me investimet, nuk janë të transferueshme dhe të menjëhershme të cilat i jepen një individ, dhe që i jep vlerë monetare pensionit ose pensionit të invaliditetit i cili jepet në një llogari që është Llogari e Përrjashtuar.

Termi “Llogari Financiare” nuk përfshin asnjë llogari e cila është një Llogari e Përrjashtuar.

2. Termi **“Llogari Depozite”** përfshin çdo llogari tregtare, llogari rrjedhëse, llogari kursimesh, llogari me afat, ose llogari që identifikohet përmes një certifikate depozite, certifikate kursimesh, certifikate investimesh, certifikate borxhi, ose instrumente të tjera të ngjashme që mbahen nga Institucioni Financiar në punën e zakonshme të aktivitetit bankar ose të ngjashëm me të. Llogaria e Depozitës përfshin gjithashtu shumën e mbajtur nga shoqëria e sigurimeve sipas kontratës së investimeve të garantuara ose marrëveshjes së ngjashme me të për të paguar ose kredituar interesat përkatës.
3. Termi **“Llogari Kujdestarie”** është një llogari (e ndryshme nga Kontratat e Sigurimeve ose Kontratat e Pensionit Vjetor) që mban një ose më shumë aktive financiare në përfitim të një personi tjetër.
4. Termi **“Interes në Kapital”**, në rastin e një partneriteti që është Institucion Financiar, është goftë interesi në kapital ose interesi në përfitime nga partneriteti. Në rastin e një trusti që është Institucion Financiar, Interesi në Kapital konsiderohet se mbahet nga çdo person që trajtohet si krijuesi i trustit ose përfituesi i të gjithë ose i një pjese të trustit, ose çdo person tjetër fizik që ushtron kontroll efektiv themelor mbi trustin. Personi i Raportueshëm do të trajtohet si përfitues i një trusti nëse ky Person i Raportueshëm ka të drejtën të marrë direkt ose indirekt (për shembull, përmes një përfaqësuesi të caktuar) një shpërndarje të detyrueshme ose mund të marrë, direkt ose indirekt, një shpërndarje diskrete nga trusti.
5. Termi **“Kontratë Sigurimi”** është një kontratë (e ndryshme nga Kontrata e Pensionit Vjetor) sipas së cilës emetuesi bie dakord të paguajë një shumë të caktuar menjëherë pas ndodhisë së një kontigjence specifike që përfshin vdekjen, sëmundshmërinë, aksidentin, detyrimin ose riskun e pronës.



6. Termi **“Kontratë Pensioni Vjetor”** është kontrata sipas së cilës emetuesi bie dakord të kryejë pagesa për një periudhë kohore të përcaktuar plotësisht ose pjesërisht duke iu referuar jetëgjatësisë së një ose më shumë individëve. Termi gjithashtu përfshin kontratën që konsiderohet të jetë një Kontratë Pensioni Vjetor në përputhje me ligjet, rregulloret ose praktikat e juridiksionit në të cilin është lëshuar kontrata, dhe sipas së cilës emetuesi bie dakord të kryejë pagesa për një numër të caktuar vitesh.
7. Termi **“Kontratë e Sigurimit në Vlerë në Para të Gatshme”** është Kontrata e Sigurimeve (e ndryshme nga kontrata e risigurimit ndërmjet dy shoqërive të sigurimeve) që ka një Vlerë në Para të Gatshme.
8. Termi **“Vlerë në Para të Gatshme”** është sasia më e madhe e shumave vijuese (i) shuma që mbajtësi i policës ka të drejtë të marrë menjëherë pas mbylljes vullnetare ose zgjidhjes së kontratës (e përcaktuar pa llogaritur zbritjen e mundshme në formë penalizimi për çdo mbyllje vullnetare ose hua mbi policën), dhe (ii) shuma që mbajtësi i policës mund të marrë hua sipas kontratës ose lidhur me të. Pavarësisht nga sa më sipër, termi **“Vlerë në Para të Gatshme”** nuk përfshin shumën që paguhet sipas Kontratës së Sigurimit:
  - a) vetëm për shkak të vdekjes së individit të siguruar sipas kontratës së sigurimit të jetës;
  - b) në formën e përfitimit personal nga lëndimi ose sëmundja ose të përfitimeve të tjera që zhdëmtojnë humbjen ekonomike të pësuar për shkak të ndodhisë së një ngjarjeje ndaj të cilës është siguruar;
  - c) në formën e një rimbursimi të një primi të paguar më parë (minus kostot e shpenzimeve të sigurimeve pavarësisht nëse vendosen apo jo) sipas Kontratës së Sigurimit (e ndryshme nga kontrata e sigurimit të jetës lidhur me një investim ose kontrata e pensionit vjetor) për shkak të anulimit ose zgjidhjes së kontratës, uljes së rrezikut të ekspozimit gjatë periudhës së veprimit të kontratës, ose si rezultat i korrigjimit të njoftimit apo gabimit të ngjashëm lidhur me primin e kontratës;
  - d) në formën e dividendit të mbajtësit të policës (i ndryshëm nga dividendi në zgjidhjen e kontratës) me kusht që dividendi të lidhet me një Kontratë Sigurimi sipas së cilës të vetmet përfitime të pagueshme janë të përshkruara në nënpragrafin C(8)(b); ose
  - e) në formën e kthimit të primit të parapaguar ose të depozitës së primit për Kontratën e Sigurimit për të cilën primi paguhet të paktën çdo vit nëse shuma e primit të parapaguar ose e depozitës së primit nuk e kalon primin vijues vjetor që do të paguhet sipas kontratës.
9. Termi **“Llogari Paraekzistuese”** është Llogaria Financiare që mbahet nga Institucioni Financiar Raportues duke filluar nga data [xx/xx/ xxxx].
10. Termi **“Llogari e Re”** është Llogaria Financiare që mbahet nga Institucioni Financiar Raportues e hapur më ose pas datës [xx/xx/ xxxx].
11. Termi **“Llogari Paraekzistuese Individuale”** është Llogaria Paraekzistuese që mbahet nga një ose më shumë individë.
12. Termi **“Llogari e Re Individuale”** është Llogaria e Re që mbahet nga një ose më shumë individë.
13. Termi **“Llogari Paraekzistuese e Njësisë Ekonomike”** është Llogaria Paraekzistuese që mbahet nga një ose më shumë Njësi Ekonomike.
14. Termi **“Llogari e Vlerës së Ulët”** është Llogaria Paraekzistuese Individuale me një bilanc ose vlerë të totalizuar duke filluar nga data 31 dhjetor [xxxx] që nuk e kalon nivelin 1 000 000 USD.

15. Termi **“Llogari e Vlerës së Lartë”** është Llogaria Paraekzistuese Individuale me një bilanc ose vlerë të totalizuar që e kalon nivelin 1 000 000 USD duke filluar nga data 31 dhjetor [xxxx] ose data 31 dhjetor e çdo viti pasues.
16. Termi **“Llogari e Re e Njesisë Ekonomike”** është Llogaria e Re që mbahet nga një ose më shumë Njësi Ekonomike.
17. Termi **“Llogari e Përfshirë”** është secila prej llogarive të mëposhtme:

a) llogaria e pensionit të pleqërisë ose e pensionit që përmbush kriteret vijuese:

- i) llogaria është objekt i rregulloreve si llogari personale pensioni ose është pjesë e një plani të regjistruar ose të rregulluar pensioni pleqërie ose pensioni për dhënien e pensionit të pleqërisë ose të pensionit (duke përfshirë pensionin për invaliditetin ose pensionin familjar);
- ii) llogaria është e favorizuar nga pikëpamja tatimore (d.m.th. kontributet në llogari që në një tjetër kontekst do të ishin objekt i tatimit zhvishen ose përjashtohen nga të ardhurat bruto të mbajtësit të llogarisë ose tatohen në nivele të reduktuara, ose tatimi mbi të ardhurat nga investimi nga llogaria shtyhet ose tatohet në nivele të reduktuara);
- iii) lidhur me llogarinë kërkohet raportim i informacionit pranë autoriteteve tatimore;
- iv) tërheqjet kushtëzohen me arritjen e moshës së specifikuar të pensionit të pleqërisë, invaliditetin ose vdekjen, ose në të kundërt do të zbatohen penalitete mbi tërheqjet e kryera përpara këtyre ngjarjeve të specifikuara; dhe
- v) (i) kontributet vjetore nuk duhet t'i kalojnë 50 000 USD, ose (ii) limiti maksimal i kontributeve në llogari gjatë të gjithë jetës nuk duhet t'i kalojë 1 000 000 USD, dhe në çdo rast do të zbatohen rregullat e parashtruara në paragrafin C të seksionit VII për totalizimin e llogarisë dhe përkthimin e monedhës.

Llogaria Financiare që për më tepër përmbush kërkesat e nënparagrafit C(17)(a)(v) nuk do të dështojë në përmbushjen e kësaj kërkeje vetëm sepse kjo Llogari Financiare mund të marrë aktive ose fonde të transferuara nga një ose më shumë Llogari Financiare që përmbushin kërkesat e nënparagrafit C(17)(a) ose (b) apo nga një ose më shumë fonde pensioni pleqërie ose pensioni që përmbushin kërkesat e secilit prej nënparagrafëve nga B(5) deri në (7).

b) llogaria që përmbush kërkesat e mëposhtme:

- i) llogaria është objekt i rregulloreve si një instrument investimesh për qëllime të ndryshme nga pensioni dhe tregtohet rregullisht në një treg të konsoliduar letrash me vlerë, ose llogaria është objekt i rregulloreve si instrument kursimesh për qëllime të ndryshme nga pensioni;
- ii) llogaria është e favorizuar nga pikëpamja tatimore (d.m.th. kontributet në llogari që në një tjetër kontekst do të ishin objekt i tatimit zhvishen ose përjashtohen nga të ardhurat bruto të mbajtësit të llogarisë ose tatohen në nivele të reduktuara, ose tatimi mbi të ardhurat nga investimi nga llogaria shtyhet ose tatohet në nivele të reduktuara);
- iii) tërheqjet kushtëzohen nga përmbushja e kriterëve specifike të lidhura me qëllimin e llogarisë së investimeve ose të kursimeve (për shembull, dhënia e përfitimeve shëndetësore ose arsimore), ose do të zbatohen penaliteteve për tërheqjet e kryera përpara përmbushjes së këtyre kriterëve; dhe

- iv) kontributet vjetore nuk e kalojnë limitin prej 50 000 USD, duke zbatuar rregullat e parashtruara në paragrafin C të seksionit VII për totalizimin e llogarisë dhe përkthimin e monedhës.

Llogaria Financiare që për më tepër përmbush kërkesat e nënparagrafit C(17)(b)(iv) nuk do të dështojë në përmbushjen e kësaj kërkeje vetëm sepse kjo Llogari Financiare mund të marrë aktive ose fonde të transferuara nga një ose më shumë Llogari Financiare që përmbushin kërkesat e nënparagrafit C(17)(a) ose (b) apo nga një ose më shumë fonde pensioni pleqërie ose pensioni që përmbushin kërkesat e secilit prej nënparagrafëve nga B(5) deri në (7).

- c) kontrata e sigurimit të jetës me një periudhë mbulimi që do të mbarojë përpara se individi i siguruar të arrijë moshën 90 vjeç, me kusht që kontrata të përmbushë kërkesat e mëposhtme:

- i) primet periodike, që nuk ulen me kalimin e kohës, paguhet në paktën çdo vit gjatë periudhës që kontrata është ekzistuese ose deri kur i siguruari të arrijë moshën 90 vjeç, cilado periudhë që është më e shkurtër;

- ii) kontrata nuk ka një vlerë kontrate tek e cila çdo person mund të ketë akses (përmes tërheqjes, huasë ose ndryshe) pa e zgjidhur kontratën;

- iii) shuma (e ndryshme nga pensioni familjar) që paguhet pas anulimit ose zgjidhjes së kontratës nuk mund të tejkalojë primet e totalizuara që janë paguar për kontratën, minus shumën e shpenzimeve në rast vdekjeje, sëmundjeje, dhe tarifat e shpenzimeve (pavarësisht nëse janë vendosur realisht ose jo) për periudhën ose periudhat e ekzistencës së kontratës dhe çdo shumë të paguar përpara anulimit ose zgjidhjes së kontratës; dhe

- iv) kontrata nuk mbahet nga personi tek i cili transferohet për vlerën e saj.

- d) llogaria e cila mbahet vetëm nga një titull pronësie nëse dokumentacioni për këtë llogari përfshin një kopje të testamentit të personit të vdekur ose certifikatën e vdekjes.

- e) llogaria e krijuar lidhur me secilën nga pikat vijuese:

- i) një urdhër ose vendim gjykatë.

- ii) një shitje, shkëmbim ose qiradhënie/marrje të pasurisë së paluajtshme ose personale me kusht që llogaria të përmbushë kërkesat e mëposhtme:

- i) llogaria financohet vetëm nga depozitimi i një page në llogari, si garanci ekzekutimi, në sasinë e mjaftueshme për të garantuar detyrimin e lidhur direkt me transaksionin, ose nga pagesa të ngjashme, ose financohet nga aktivet financiare të depozituara në llogari lidhur me shitjen, shkëmbimin ose qiramarrjen/dhënie të pasurisë;

- ii) llogaria krijohet dhe përdoret vetëm për të garantuar detyrimin e blerësit për të paguar çmimin e blerjes, të shitësit për të paguar çdo detyrim kontigjencë, ose të qiramarrësit apo qiradhënësit për të paguar për çdo dëm lidhur me pasurinë e marrë/dhënë me qira siç është rënë dakord në kontratë;

- iii) aktivet e llogarisë, duke përfshirë edhe të ardhurat e fituara prej saj, do të paguhet ose shpërndahet në përfitim të blerësit, shitësit, qiramarrësit ose qiradhënësit (duke përfshirë edhe përmbushjen e detyrimit të këtij personi) në momentin kur pasuria shitet, shkëmbehet ose hiqet dorë prej saj apo kur zgjidhet kontrata e qirasë;

- iv) llogaria nuk është një llogari marzh apo e ngjashme me të e krijuar për shitjen ose shkëmbimin e aktivitetit financiar; dhe
- v) llogaria nuk lidhet me ndonjë llogari të përshkruar në nënparagrafin C(17)(f).
  - iii) detyrimi i Institucionit Financiar që jep huanë e garantuar nga pasuria e paluajtshme për të hequr mënjatë një pjesë të pagesës vetëm për shlyerjen e tatimeve ose të siguracioneve të lidhura me pasurinë e paluajtshme në një moment tjetër.
  - iv) detyrimi i Institucionit Financiar vetëm për të lehtësuar shlyerjen e tatimeve në një moment tjetër.
- f) Llogaria e Depozitës që përmbush kërkesat e mëposhtme:
  - i) llogaria ekziston vetëm sepse klienti kryen një pagesë përtej bilancit të caktuar lidhur me një kartë krediti ose instrumente të tjera kredie të rinovueshme dhe mbipagesa nuk i kthehet menjëherë klientit; dhe
  - ii) duke filluar më datë ose përpara datës [xx/xx/xxxx], Institucioni Financiar zbaton politika dhe procedura qoftë për ta penguar klientin që të kryejë mbipagesa të cilat i tejkalojnë 50 000 USD, ose për të garantuar që çdo mbipagesë e klientit që e tejkalon vlerën 50 000 USD i rimbursohet klientit brenda 60 ditëve, në secilin rast zbatohen rregullat e parashtruara në paragrafin C të seksionit VII për përkthimin e monedhës. Për këtë arsye, mbipagesa e klientit nuk i referohet bilanceve të kreditit që përfshijnë tarifa të kundërshtuara por përfshijnë bilancet e kreditit që vijnë si rezultat i kthimit të mallit.
- g) çdo llogari tjetër që paraqet pak rrezik për t'u përdorur për shmangie tatimore, ka në thelb karakteristika të ngjashme me secilën prej llogarive të përshkruara në nënparagrafët C(17)(a) deri në (f), dhe në legjislacionin e brendshëm përkufizohet si Llogari e Përrjashtuar, me kusht që statusi i kësaj llogarie si Llogari e Përrjashtuar nuk cenon qëllimet e Standardit të Përbashkët të Raportimit.

#### D. Llogaria e Raportueshme

1. Termi **“Llogari e Raportueshme”** është llogaria që mbahet nga një ose më shumë Persona të Raportueshëm ose nga një NFE Pasive me një ose më shumë Persona Kontrollues që është Person i Raportueshëm, me kusht që të jetë identifikuar si e tillë në bazë të procedurave të verifikimit të duhur të përshkruara në seksionet II deri në VII.
2. Termi **“Person i Raportueshëm”** është Personi i Juridiksionit të Raportueshëm i ndryshëm nga: (i) korporata, aksionet e së cilës tregtohen rregullisht në një ose më shumë tregje të konsoliduara të letrave me vlerë; (ii) çdo korporatë që është Njësi Ekonomike e lidhur me korporatën e përshkruar në klauzolën (i); (iii) Organi Qeveritar; (iv) Organizata Ndërkombëtare; (v) Banka Qendrore; ose (vi) Institucioni Financiar.
3. Termi **“Person i Juridiksionit të Raportueshëm”** është individ i ose Njësia Ekonomike që është rezident në një Juridiksion të Raportueshëm në bazë të legjislacionit tatimor të këtij juridiksioni, ose pasuria e trashëgimlënësit që ka qenë rezident i një Juridiksioni të Raportueshëm. Për këtë qëllim, Njësia Ekonomike e tillë si partneriteti, partneriteti me përgjegjësi të kufizuara ose strukturat ligjore të ngjashme që nuk kanë rezidencë për qëllime tatimore, do të trajtohen si rezidentë në juridiksionin në të cilin ndodhet vendi ose menaxhimi aktiv.

4. Termi **“Juridiksion i Raportueshëm”** është juridiksioni (i) me të cilin ekziston një marrëveshje në bazë të së cilës ka një detyrim për të dhënë informacionin e specifikuar në seksionin I, dhe (ii) i cili është i identifikuar në listën e publikuar.
5. Termi **“Juridiksion Pjesëmarrës”** është juridiksioni (i) me të cilin ekziston një marrëveshje në bazë të së cilës ka një detyrim për të dhënë informacionin e specifikuar në seksionin I, dhe (ii) i cili është i identifikuar në listën e publikuar.
6. Termi **“Persona Kontrollues”** janë personat fizikë që ushtrojnë kontroll mbi Njësinë Ekonomike. Në rastin e një trusti, ky term nënkupton krijuesin e trustit, administratorin e trustit, ruajtësin (nëse ka), përfituesin ose kategoritë e përfituesve, dhe çdo person tjetër fizik që ushtron kontroll efektiv themelor mbi trustin, dhe në rastin e një strukture ligjore të ndryshme nga trusti, ky term nënkupton personat në pozicione ekuivalente ose të ngjashme. Termi **“Persona Kontrollues”** duhet të interpretohet në mënyrë të pajtueshme me Rekomandimet e Task Forcës për Aksionin Financiar.
7. Termi **“NFE”** është çdo Njësi Ekonomike që nuk është një Institucion Financiar.
8. Termi **“NFE Pasive”** është çdo: (i) NFE që nuk është NFE Aktive; ose (ii) Njësi Ekonomike e përshkruar në nënparagrafin A(6)(b) që nuk është një Institucion Financiar i Juridiksionit Pjesëmarrës.
9. Termi **“NFE Aktive”** është çdo NFE që përmbush secilin prej kritereve të mëposhtme:
  - a) më pak se 50% e të ardhurave bruto të NFE-së për vitin kalendarik paraardhës ose një periudhë tjetër të përshtatshme raportimi janë të ardhura Pasive dhe më pak se 50% e aktiveve të mbajtura nga NFE-ja gjatë vitit kalendarik paraardhës ose një periudhë tjetër të përshtatshme raportimi janë aktive që prodhojnë ose mbahen për prodhimin e të ardhurave Pasive;
  - b) aksionet e NFE-së tregtohen rregullisht në një treg të konsoliduar letrash me vlerë ose NFE-ja është Njësi e Lidhur me një Njësi Ekonomike aksionet e së cilës tregtohen rregullisht në një treg të konsoliduar letrash me vlerë;
  - c) NFE-ja është një Organ Qeveritar, një Organizatë Ndërkombëtare, një Bankë Qendrore ose një Njësi Ekonomike e zotëruar plotësisht nga një ose më shumë prej të lartpërmendurave;
  - d) në thelb të gjitha aktivitetet e NFE-së konsistojnë në mbajtjen (plotësisht ose pjesërisht) të aksioneve të qarkullueshme të, ose në ofrimin e financimit dhe shërbimeve për, një ose më shumë filiale që angazhohen në tregti ose biznese të ndryshme nga biznesi i Institucionit Financiar, por Njësia Ekonomike nuk kualifikohet për këtë status nëse Njësia Ekonomike funksionon (ose pretendon se funksionon) si një fond investimi, i tillë si fond privat me kapital neto, fond me sipërmarrje kapitali, fond blerjeje me financim nga të tretë, ose çdo instrument investimi qëllimi i të cilit është blerja ose financimi i shoqërive dhe më pas mbajtja e interesave në ato shoqëri si aktive kapitali për qëllime investimi;
  - e) NFE ende nuk po operon një biznes dhe nuk ka asnjë historik të mëparshëm operimi, por po investon kapital në aktive me synimin për të operuar një biznes të ndryshëm nga ai i Institucionit Financiar, me kusht që NFE-ja nuk kualifikohet për këtë përjashtim pas datës e cila është 24 muaj pas datës së organizimit fillestar të NFE-së;
  - f) NFE-ja nuk ka qenë një Institucion Financiar në pesë vitet e fundit, dhe është në procesin e likuidimit të aktiveve të saj ose po riorganizohet me qëllim vijimin



ose rifillimin e operacioneve në një biznes të ndryshëm nga ai i Institucionit Financiar;

- g) NFE-ja angazhohet kryesisht në financimin dhe mbrojtjen e transaksioneve me, ose për, Njësitë Ekonomike të Lidhura që nuk janë Institucione Financiare, dhe nuk i ofron shërbime financimi ose mbrojtjeje asnjë Njësie Ekonomike që nuk është Njësi Ekonomike e Lidhur, me kusht që grupi i çdo Njësie të tillë Ekonomike të Lidhur është kryesisht i angazhuar në një biznes të ndryshëm nga ai i Institucionit Financiar; ose
- h) NFE-ja përmbush të gjitha kërkesat e mëposhtme:
  - i) ajo është themeluar dhe funksionon në juridiksionin e saj të rezidencës vetëm për qëllime fetare, bamirësie, shkencore, artistike, kulturore, atletike ose arsimore; ose është themeluar dhe funksionon në juridiksionin e saj të rezidencës dhe është një organizatë profesionale, ligë biznesi, dhomë tregtie, organizatë pune, organizatë bujqësore ose e hortikulturës, ligë civile ose një organizatë e cila funksionon ekskluzivisht për promovimin e mirëqenies sociale;
  - ii) ajo është e përjashtuar nga tatimi mbi të ardhurat në juridiksionin e saj të rezidencës;
  - iii) ajo nuk ka aksionarë ose anëtarë të cilët kanë një interes pronësor ose përfitimi në të ardhurat ose aktivet e saj;
  - iv) ligjet në fuqi të juridiksionit të rezidencës së NFE-së ose dokumentet e krijimit të NFE-së nuk e lejojnë shpërndarjen ose kalimin e të ardhurave apo aktiveve në përfitim të personave privatë ose një Njësie jobamirëse përveçse në pajtim me kryerjen e aktiviteteve të bamirësisë të NFE-së, ose si pagesë e një kompensimi të arsyeshëm për shërbimet e ofruara, ose si pagesë që përfaqëson vlerën e drejtë në treg të pasurisë që ka blerë NFE; dhe
  - v) ligjet në fuqi të juridiksionit të rezidencës së NFE-së ose dokumentet e krijimit të NFE-së kërkojnë që, pas likuidimit ose shpërbërjes së NFE-së, të gjitha aktivet e saj t'i shpërndahen një Organi Qeveritar ose organizate tjetër jofitimprurëse, ose t'i rikthehen qeverisë së juridiksionit të rezidencës së NFE-së apo çdo nënndarjeje politike të saj.

#### E. Të ndryshme

1. Termi **“Mbajtës i Llogarisë”** është personi i listuar ose identifikuar si mbajtësi i Llogarisë Financiare nga Institucioni Financiar që mban llogarinë. Personi, i ndryshëm nga Institucioni Financiar, që mban një Llogari Financiare në përfitim të ose për llogari të një personi tjetër si agjent, kujdestar, i emëruar, nënshkrues, këshilltar investimesh ose ndërmjetës, nuk trajtohet si person që e mban llogarinë për qëllime të Standardit të Përbashkët të Raportimit, dhe personi tjetër trajtohet si personi që mban llogarinë. Në rastin e një Kontrate Sigurimi në Vlerë në Para të Gatshme ose Kontrate Pensioni Vjetor, Mbajtësi i Llogarisë është çdo person i cili ka të drejtë të ketë akses në Vlerën në Para të Gatshme ose të ndryshojë përfituesin e kontratës. Nëse asnjë person nuk mund të ketë akses në Vlerën në Para të Gatshme ose të ndryshojë përfituesin, Mbajtësi i Llogarisë është çdo person i emëruar si pronar në kontratë dhe çdo person mbi të cilin bie e drejta e pagesës sipas kushteve të kontratës. Menjëherë pas maturimit të Kontratës së Sigurimit në Vlerë në Para të Gatshme ose Kontratës së Pensionit Vjetor, çdo person që ka të drejtë të marrë pagesë sipas kontratës do të trajtohet si Mbajtës Llogarie.
2. Termi **“Procedurat për AML/KYC”** janë procedurat e verifikimit të duhur për klientin e Institucionit Financiar Raportues në bazë të kërkesave kundër pastrimit të parave ose të ngjashme me to kundrejt të cilave ky Institucion Financiar Raportues është objekt.
3. Termi **“Njësi Ekonomike”** është personi juridik ose struktura juridike si korporata, partneriteti, trusti ose fondacioni.



4. Njësia Ekonomike është një **“Njësi Ekonomike e Lidhur”** e një Njësie tjetër nëse secila prej Njësive kontrollon tjetrën, ose nëse të dyja Njësitë Ekonomike janë nën kontroll të përbashkët. Për këtë qëllim, kontrolli përfshin pronësinë direkte ose indirekte të më shumë se 50% të votave ose vlerave në një Njësi Ekonomike.
5. Termi **“NIPT”** është numri i identifikimit të tatimpaguesit (ose ekuivalenti funksional në mungesë të një numri identifikimi të tatimpaguesit).
6. Termi **“Evidenca Shkresore”** përfshin pikat e mëposhtme:
  - a) certifikatën e rezidencës të lëshuar nga një organ qeveritar i autorizuar (për shembull, qeveria ose agjenci e saj, ose bashkia) i juridiksionit në të cilin paguesi pretendon se është rezident.
  - b) lidhur me individin, çdo identifikim të vlefshëm të lëshuar nga një organ qeveritar i autorizuar (për shembull, qeveria ose agjenci e saj, ose bashkia), që përfshin emrin e individit dhe zakonisht përdoret për qëllime identifikimi.
  - c) lidhur me Njësinë Ekonomike, çdo dokument zyrtar të lëshuar nga një organ qeveritar i autorizuar (për shembull, qeveria ose agjenci e saj, ose bashkia) që përfshin emrin e Njësisë Ekonomike si dhe adresën e selisë së saj qendrore në juridiksionin në të cilin pretendon se është rezidente ose juridiksionin në të cilin Njësia Ekonomike ishte themeluar ose organizuar.
  - d) çdo pasqyrë financiare të audituar, raport kredie të palëve të treta, aplikim për faliment ose raport të rregullatorit të letrave me vlerë.

## Seksioni IX: Zbatimi efikas

- A. Juridiksioni duhet të ketë rregulla dhe procedura administrative për të garantuar zbatimin efikas dhe pajtueshmërinë me procedurat e raportimit dhe të verifikimit të duhur të parashtruara më lart duke përfshirë:
  1. rregullat për të parandaluar çdo Institucion Financiar, person ose ndërmjetës që të aprovojë praktika të cilat kanë për synim shmangien e procedurave të raportimit dhe verifikimit të duhur;
  2. rregullat të cilat u kërkojnë Institucioneve Financiare Raportuese që të regjistrojnë hapat e ndërmarra dhe çdo evidencë të përdorur për realizimin e procedurave të mësipërme dhe masa të përshtatshme për regjistrimin e këtyre të dhënave;
  3. procedurat administrative për të verifikuar pajtueshmërinë e Institucioneve Financiare Raportuese me procedurat e raportimit dhe të verifikimit të duhur; procedurat administrative për ta ndjekur çështjen me Institucionin Financiar Raportues kur ka raste të llogarive të padokumentuara;
  4. procedurat administrative për të garantuar se Njësitë Ekonomike dhe llogaritë e përcaktuara në legjislacionin e brendshëm si Institucione Financiare Joraportuese dhe Llogari të Përrjashtuara vijnë të paraqesin rrezik të ulët për t'u përdorur për shmangie tatimore; dhe
  5. dispozita efikase të zbatimit të ligjit për të adresuar papajtueshmërinë.

### **III. Komentet për Marrëveshjen Model Shumëpalëshe të Autoritetit Kompetent dhe Standardin e Përbashkët të Raportimit**

#### **A. Komentet për Marrëveshjen Model Shumëpalëshe të Autoritetit Kompetent**

##### **Hyrje**

1. CAA Model lidh CRS-në dhe bazën ligjore për shkëmbimin (si Konventa Shumëpalëshe për Ndihmën e Ndërsjellë Administrative në Çështjet Tatimore ose traktati dypalësh për tatimin). CAA Model përbëhet nga preambula dhe shtatë seksione, dhe parashikon modalitetet e shkëmbimit për të garantuar fluksin e duhur të informacionit. Preambula përmban aspekte lidhur me raportimin e brendshëm dhe rregullat e verifikimit të duhur që qëndrojnë në themel të shkëmbimit të informacionit sipas CAA-së Model. Gjithashtu përmban aspekte lidhur me konfidencialitetin, masat mbrojtëse dhe ekzistencën e infrastrukturës së nevojshme për një marrëdhënie efikase shkëmbimi.
2. CAA Model përmban një seksion për përkufizimet (seksioni 1), mbulon llojin e informacionit që do të shkëmbehet (seksioni 2), kohën dhe mënyrën e shkëmbimit (seksioni 3), bashkëpunimin për pajtueshmërinë dhe zbatimin (seksioni 4) dhe konfidencialitetin dhe ruajtjen e të dhënave që duhen respektuar (seksioni 5). Konsultimet ndërmjet autoriteteve kompetente, bashkëpunimi për pajtueshmërinë dhe zbatimin, ndryshimet në marrëveshje dhe afati i marrëveshjes, duke përfshirë pezullimin dhe zgjidhjen, trajtohen në seksionet 4, 6 dhe 7.
3. CAA Model është hartuar si një marrëveshje dypalëshe reciproke mbështetur në parimin se shkëmbimi automatik është reciprok dhe se shkëmbimi do të bëhet në baza dypalëshe. Për të reduktuar kostot që lidhen me nënshkrimin e disa marrëveshjeve me autoritetin kompetent, shkëmbimi i informacionit mund të zbatohet mbi bazën e një marrëveshjeje shumëpalëshe të autoritetit kompetent. Versioni shumëpalësh i CAA Model gjendet në shtojcën 1. Pavarësisht se marrëveshja do të jetë shumëpalëshe, shkëmbimi i informacionit në vetvete do të jetë mbi baza dypalëshe. Më pas, mund të ketë raste kur juridiksionet do të dëshirojnë të hyjnë në marrëveshje dypalëshe joreciproke (p.sh. në rastin kur një juridiksion nuk ka tatimin mbi të ardhurat). Një version joreciprok i CAA-së Model gjendet në shtojcën 2. Është pranuar nga G20 dhe të tjerët se vendet në zhvillim mund të përballen me disa probleme kapaciteti sa i përket shkëmbimit automatik të informacionit dhe kjo është një çështje e rëndësishme e cila duhet trajtuar, dhe në korrik të vitit 2013, G20 i bëri thirrje Forumit Global për Transparencën dhe Shkëmbimin e Informacionit për Qëllime Tatimore që të punojë me Task Forcën e OECD-së për Tatimet dhe Zhvillimin, Bankën Botërore dhe të tjerë për t'i ndihmuar vendet në zhvillim të identifikojnë nevojat e tyre për asistencë teknike dhe ngritje kapacitetesh.

4. Juridiksionet gjithashtu mund të hyjnë në një marrëveshje shumëpalëshe ndërqeveritare ose disa marrëveshje shumëpalëshe ndërqeveritare që mund të jenë traktatet ndërkombëtare në të drejtë të tyre ose legjislacioni rajonal që mbulon si detyrimet e raportimit edhe procedurat e verifikimit të duhur shoqëruar me një marrëveshje më të kufizuar të autoritetit kompetent

## Koment për preambulën

1. Preambula (“klauzolat meqë”) ofron kontekst relevant dhe aspekte përshkruese duke përfshirë fjalinë që i referohet bazës ligjore themelore që lejon shkëmbimin automatik të informacionit.
2. Klauzola e parë shërben si hyrje dhe mund të ndryshojë në varësi të rrethanave të caktuara të juridiksioneve që hyjnë marrëveshje.
3. Klauzola e dytë parashtron aspektet përshkruese nga Autoritetet Kompetente që ligjet e juridiksioneve të tyre përkatëse kërkojnë ose pritet që të kërkojnë nga institucionet financiare për të raportuar informacion lidhur me llogari të caktuara, në pajtim me qëllimin e shkëmbimit të parashikuar në seksionin 2 të kësaj Marrëveshjeje.
4. Gjuha alternative e përdorur në këtë klauzolë i lejon juridiksionet, të cilët dëshirojnë, që ta nënshkruajnë marrëveshjen me autoritetin kompetent edhe përpara se njëri apo të dy juridiksionet të kenë vendosur rregullat përkatëse për raportimin dhe verifikimin e duhur. Shih edhe paragrafin 3 të seksionit 3 (paragrafi 3 i Komentit për seksionin 3) dhe seksionin 7 (paragrafi 1 i Komentit për seksionin 7).
5. Klauzola e tretë parashtron bazën ligjore që autorizon shkëmbimin automatik të informacionit për llogarinë financiare dhe i lejon Autoritetet Kompetente që të bien dakord për qëllimin dhe modalitetet e këtyre shkëmbimeve automatike. Qëllimi i rënë dakord duhet të jetë në përputhje me qëllimin e shkëmbimit të parashikuar nga seksioni 2 i kësaj marrëveshjeje. Instrumente të tjera ligjore (d.m.th. instrumentet e ndryshme nga konventat për tatimin mbi të ardhurat ose Konventa për Ndihmën e Ndërsjellë Administrative në Çështjet Tatimore) që lejojnë shkëmbimin automatik të informacionit për qëllime tatimore përfshijnë disa marrëveshje për shkëmbimin e informacionit tatimor, ose marrëveshjet rajonale të bashkëpunimit në fushën tatimore. Në nivel rajonal shkëmbimi automatik i informacionit mund të zbatohet edhe mbi bazën e, për shembull, legjislacionit të BE-së ose legjislacionit të komunitetit të Andeve që mbulon elementet e CAA-së Model dhe të CRS-së.
6. Klauzola e katërt parashtron ato aspekte të Autoriteteve Kompetente që ato disponojnë (i) masat e duhura mbrojtëse për të garantuar konfidencialitetin e informacionit të marrë dhe (ii) infrastrukturën që lejon marrëdhënien për një shkëmbim efikas. Komenti për seksionin 5 të CAA-së Model jep më tepër informacione.

## Koment për seksionin 1 lidhur me përkufizimet

### Paragrafi 1 – Përkufizimet

1. Paragrafi 1 përmban përkufizimet e termave që janë specifike për Marrëveshjen. Përkufizimet e të gjitha termave të përdorura në Marrëveshje janë në seksionin VIII të Standardit të Përbashkët të Raportimit.
2. Nënparagrafët 1(a) dhe (b) i janë dedikuar përshkrimit të juridiksioneve që nënshkruajnë Marrëveshjen. Autoritetet Kompetente janë të lira për të rënë dakord mbi përkufizimet e termave “[Juridiksioni A]” dhe “[Juridiksioni B]”; megjithatë këto përkufizime duhet të jenë në pajtim me përkufizimet që ndodhen në instrumentin ligjor në themel të marrëveshjes. Për më tepër, Autoritetet Kompetente janë të lira të përfshijnë një përshkrim gjeografik (duke përfshirë referencat ndaj platformave kontinentale); megjithatë, mjafton vetëm një përkufizim politik. Një shembull i përkufizimit politik është “Meksika është Shtetet e Bashkuara të Meksikës”.
3. Përkufizimi i termit “Autoritet Kompetent” që ndodhet në nënparagrafin 1(c) përfshin përshkrimin e autoriteteve kompetente për qëllime të Marrëveshjes. Ky përkufizim u jep mundësinë secilit juridiksion që të caktojë një ose më shumë autoritete si kompetente. Sidoqoftë, ky përkufizim duhet të jetë në pajtim me përkufizimin që ndodhet në instrumentin ligjor në themel të Marrëveshjes.
4. Termat që ndodhen në nënparagrafët 1(d) deri në (k) e bashkërendojnë qëllimin e shkëmbimit të informacionit ndërmjet juridiksioneve që nënshkruajnë Marrëveshjen me qëllimin e Standardit të Përbashkët të Raportimit. Këto terma i referohen:
  - institucioneve financiare që u kërkohet të raportojnë: “Institucion Financiar i [Juridiksionit A]”, “Institucion Financiar i [Juridiksionit B]”, dhe “Institucion Financiar Raportues”, që janë në përputhje me termat “Institucion Financiar Raportues” dhe “Institucion Financiar i Juridiksionit Pjesëmarrës” që ndodhen në nënparagrafët A(1) dhe (2) të seksionit VIII të Standardit të Përbashkët të Raportimit (shih paragrafët 2-6 të Komentit për seksionin VIII);
  - llogarive financiare të raportuara: “Llogari e Raportueshme”, “Llogari e Raportueshme e [Juridiksionit A]”, dhe “Llogari e Raportueshme e [Juridiksionit B]”, që janë në pajtim me termin “Llogari e Raportueshme” që ndodhet në nënparagrafin D(1) të seksionit VIII të Standardit të Përbashkët të Raportimit (shih paragrafin 105 të Komentit për seksionin VIII); dhe
  - mbajtësve të llogarive që janë objekt i raportimit: “Person i [Juridiksionit A]” dhe “Person i [Juridiksionit B]”, që janë në pajtim me termat “Person i Raportueshëm” dhe “Person i Juridiksionit të Raportueshëm” që ndodhen në nënparagrafët D(2) dhe (3) të seksionit VIII të Standardit të Përbashkët të Raportimit (shih paragrafin 106-116 të Komentit për seksionin VIII).
5. Nënparagrafi 1(1) përmban përkufizimin e termit “NIPT”, i cili është gjithashtu një term i përkufizuar në nënparagrafin E(5) të seksionit VIII të Standardit të Përbashkët të Raportimit. Ndërkohë që e dyta ka për qëllim ta përshkruajë NIPT-in si Numri i Identifikimit të Tatimpaguesit ose ekuivalentin funksional në mungesë të një Numri Identifikimi të Tatimpaguesit (shih paragrafët 146-149 të Komentit për seksionin VIII), qëllimi i të parës është identifikimi i NIPT-ve të juridiksioneve që nënshkruajnë Marrëveshjen. Termat NIPT i “[Juridiksionit A]” dhe “NIPT i [Juridiksionit B]” që ndodhen në nënparagrafët 1(m) dhe (n) i shërbejnë gjithashtu këtij qëllimi.
6. Termi “Standard i Përbashkët Raportimi” nuk është i përkufizuar në Marrëveshjen Model të Autoritetit Kompetent, por është i përkufizuar në versionin shumëpalësh të Marrëveshjes Model të Autoritetit Kompetent. Ka gjasa që Standardi i Përbashkët i Raportimit, duke përfshirë modalitetet e teknologjisë së informacionit, do të përditësohen herë pas here duke qenë se

gjithmonë e më tepër juridiksione zbatojnë, dhe marrin përvojë me, Standardin e Përbashkët të Raportimit. Në kontekstin e marrëveshjes shumëpalëshe, autoritetet kompetente mund të nënshkruajnë në data të ndryshme dhe për shkak të datave të ndryshme në nënshkrim, Standardi i Përbashkët i Raportimit mund të jetë përditësuar ndërkohë. Për ta trajtuar këtë situatë, versioni shumëpalësh e përkufizon Standardin e Përbashkët të Raportimit si “standardi për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarisë financiare zhvilluar nga OECD, me vendet e G20-ës, paraqitur në G20 në vitin 2014 dhe publikuar në faqen e internetit të OECD-së”. Gjithashtu, për të garantuar se ka një mirëkuptim që të gjitha juridiksionet priten që të zbatojnë versionin më të fundit të Standardit, parashtrimi (recitali) i tretë thotë se “pritet që Juridiksionet të ndryshojnë ligjet e tyre herë pas here për të pasqyruar përditësimet në Standardin e Përbashkët të Raportimit dhe pasi të jenë miratuar këto ndryshime nga Juridiksioni, përkufizimi i “Standardit të Përbashkët të Raportimit” do të vlerësohet se i referohet versionit të përditësuar lidhur me atë Juridiksion”. Në marrëveshjen dypalëshe nuk ndodh e njëjta gjë, pasi autoritetet kompetente në përgjithësi do të nënshkruajnë në të njëjtën datë. Megjithatë, edhe në marrëveshjen dypalëshe, autoritetet kompetente mund të dëshirojnë që të parashikojnë në mënyrë eksplicite përditësimet në Standardin e Përbashkët të Raportimit në të njëjtën mënyrë siç parashtrohet në versionin shumëpalësh (d.m.th. të përkufizohet termi “Standard i Përbashkët Raportimi” dhe të shtohet një parashtrim i cili specifikon pritshmërinë se juridiksionet do t’i ndryshojnë ligjet e tyre për të pasqyruar përditësimet në Standardin e Përbashkët të Raportimit).

## **Paragrafi 2 – Rregulli i përgjithshëm i interpretimit**

7. Paragrafi 2 parashtron rregullin e përgjithshëm të interpretimit. Fjalja e parë e paragrafit 2 e bën të qartë se çdo term i kapitalizuar në CAA-në Model, por që nuk është i përkufizuar aty, do të interpretohet në përputhje me kuptimin që i është dhënë në Standardin e Përbashkët të Raportimit. Kjo pasqyron edhe nocionin, i cili është shprehur dhe në preambulë, se juridiksionet i kanë vendosur procedurat e raportimit dhe të verifikimit të duhur (duke përfshirë përkufizimet e lidhura me to) në pajtim me Standardin e Përbashkët të Raportimit.

8. Fjalja e dytë e paragrafit 2 parashikon se, përveçse kur kërkohet ndryshe nga konteksti ose kur Autoritetet Kompetente bien dakord për një kuptim të përbashkët, çdo term që nuk është përkufizuar në këtë Marrëveshje ose në Standardin e Përbashkët të Raportimit, do të ketë kuptimin që ka në atë moment në legjislacionin e juridiksionit që zbaton Marrëveshjen. Në këtë aspekt, çdo kuptim sipas legjislacionit tatumor në fuqi të atij juridiksioni do të do të ketë përparësi mbi çdo kuptim që i është dhënë atij termi në legjislacionet e tjera të atij juridiksioni. Më pas, kur vërejmë kontekstin, Autoritetet Kompetente duhet të marrin në konsideratë Komentin për Standardin e Përbashkët të Raportimit dhe çdo term të përkufizuar aty.

## **Koment për seksionin 2 lidhur me shkëmbimin e informacionit për Llogaritë e Raportueshme**

1. Ky seksion parashikon se informacioni që duhet shkëmbyer është informacioni i cili kërkohet të raportohet sipas rregullave të raportimit dhe verifikimit të duhur të Standardit të Përbashkët të Raportimit. Shih seksionin I (Kërkesat e Përgjithshme të Raportimit) të CRS-së dhe Komentit që lidhet me të.
2. Paragrafi i parë i referohet bazës ligjore për shkëmbimin dhe parashikon se informacioni do të shkëmbehet mbi baza vjetore. Informacioni mund të shkëmbehet edhe më shpesh se një herë në vit; për shembull, kur Autoriteti Kompetent merr të dhëna të korrigjuara nga një Institucion Financiar Raportues, ai informacioni përgjithësisht do t'i dërgohet Autoritetit tjetër Kompetent sa më shpejt të jetë e mundur pasi të jetë marrë. Informacioni që do të shkëmbehet është informacioni i marrë sipas CRS-së dhe specifikohet më tej në paragrafin 2.
3. Paragrafi 1 e bën të qartë se shkëmbimi i informacionit është objekt i rregullave të zbatueshme të raportimit dhe verifikimit të duhur të CRS-së. Pra, në rastin kur ato rregulla nuk kërkojnë raportim, për shembull, të një NIPT-i për një Llogari të caktuar të Raportueshme, gjithashtu nuk ka detyrim për ta shkëmbyer këtë informacion. Shih përjashtimet në paragrafët C deri në F të seksionit I të CRS-së dhe paragrafët 25-35 të Komentit për seksionin I.
4. Nënparagrafi 2(d) i seksionit 2 parashikon se juridiksionit i kërkohet të shkëmbejë informacion për bilancin ose vlerën e llogarisë duke filluar nga fundi i vitit kalendarik ose një periudhe tjetër të përshtatshme raportimi. Sidoqoftë, paragrafi 11 i Komentit për seksionin I të CRS-së parashikon se juridiksionet, si alternativë, mund t'u kërkojnë institucioneve financiare që të raportojnë bilancin ose vlerën mesatare të llogarisë gjatë vitit kalendarik përkatës ose një periudhe tjetër raportimi. Në rastin kur juridiksioni kërkon raportim të bilancit ose vlerës mesatare të llogarisë në vend të bilancit të fundit të vitit financiar, kjo duhet të përcaktohet në Marrëveshje, duke përfshirë rregullat e zbatueshme për të përcaktuar bilancin ose vlerën mesatare të llogarisë, me qëllim që të jetë e qartë se çfarë do të shkëmbehet.



# Koment për seksionin 3 lidhur me kohën dhe mënyrën e shkëmbimit të informacionit

## Paragrafët 1 dhe 2 – Shuma, karakterizimi dhe monedha e pagesës

1. Paragrafi 1 parashikon se për qëllime të shkëmbimit të informacionit në seksionin 2, shuma dhe karakterizimi i pagesave të bëra lidhur me një Llogari të Raportueshme mund të përcaktohet në përputhje me parimet e legjislacionit tatimor të juridiksionit që dërgon informacionin. Paragrafi 2 parashikon se informacioni i shkëmbyer do të identifikojë monedhën në të cilën secila shumë do të shprehet.

## Paragrafët 3 dhe 4 – Koha e shkëmbimit të informacionit

2. Paragrafi 3 parashikon që informacioni duhet të shkëmbehet brenda nëntë muajve pas vitit kalendarik me të cilin lidhet informacioni. Viti i parë lidhur me të cilin shkëmbehet informacioni lihet i paplotësuar dhe i takon juridiksioneve që të bëjnë plotësimet. Afati kohor prej nëntë muajsh në paragrafin 3 është standardi minimal dhe juridiksionet janë të lira që të bien dakord për afate kohore më të shkurtra. Për shembull, shtetet anëtare të Bashkimit Evropian janë objekt i afatit kohor gjashtë mujor sipas Direktivës “Për kursimet”.

3. Paragrafi 3 gjithashtu parashikon se pavarësisht vitit që Autoritetet Kompetente kanë zgjedhur si vitin lidhur me të cilin do të bëhet shkëmbimi i parë, kërkohet që të shkëmbehet informacioni lidhur me vitin kalendarik nëse të dyja juridiksionet kanë në fuqi legjislacionin që kërkon raportim për këtë vit kalendarik që është në përputhje me qëllimin e shkëmbimit të parashikuar në seksionin 2 dhe në Standardin e Përbashkët të Raportimit. Kjo fjali nuk do të jetë funksionale nëse në kohën e nënshkrimit të Marrëveshjes të dyja juridiksionet kanë në fuqi legjislacion të brendshëm në përputhje me Standardin e Përbashkët të Raportimit. Nëse njëri ose të dy juridiksionet nuk e kanë një legjislacion të tillë në fuqi në momentin e nënshkrimit, fjalia do të jetë funksionale për të garantuar që pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes, por Standardi i Përbashkët i Raportimit ka ekzistuar për shumë kohë në njërin prej juridiksioneve, i vetmi informacion që duhet të shkëmbehet është ai lidhur me vitet kur të dyja juridiksionet kanë detyrimet përkatëse të raportimit. Sidoqoftë, një Juridiksion mund të zgjedhë, në bazë të legjislacionit të tij të brendshëm, që të shkëmbejë informacion për vitet e mëparshme, rast në të cilin kjo është gjithashtu në pajtim me CRS-në dhe CAA-në Model.

4. Shembulli vijues ilustron funksionimin e paragrafit 3 kur një juridiksion nuk ka në fuqi legjislacion që kërkon raportim për vitin kalendarik në të cilin është rënë dakord në fjalinë e parë të paragrafit 3. Juridiksionet A dhe B nënshkruajnë CAA-në Model më 30 prill 2015 dhe bien dakord se do të shkëmbehet informacion për vitin 2016 dhe vitet në vijim. Juridiksioni A njofton më datë 7 qershor 2015 se ka në fuqi legjislacionin që kërkon raportim për vitin 2016. Juridiksioni B njofton më 1 nëntor 2015 se ka në fuqi legjislacionin për të raportuar për vitin 2017. Në këtë rast do të hyjë në veprim fjalia e fundit e paragrafit 3 me qëllim që Juridiksioni A të mos ketë detyrimin për të shkëmbyer informacion për vitin 2016. Të dyja juridiksionet A dhe B do të kenë detyrimin për të shkëmbyer informacion për vitin 2017. Sidoqoftë, në bazë të legjislacionit të tij të brendshëm, Juridiksioni A mund të zgjedhë t'i dërgojë informacion Juridiksionit B për vitin 2016 edhe pse Juridiksioni A nuk do të marrë informacion për vitin 2016.

5. Paragrafi 4 përmban një përjashtim për vitin për të cilin duhet të raportohen të ardhurat bruto. Mund të jetë më e vështirë për Institucionet Financiare Raportuese që të zbatojnë procedurat për marrjen e të ardhurave totale bruto nga shitja ose shlyerja e një pasurie. Prandaj, kur zbatohet Standardi i Përbashkët i Raportimit, juridiksionet mund të zgjedhin që të fusin gradualisht raportimin e këtyre të ardhurave bruto. Nëse nuk parashikohet kalim,

paragrafi 4 do të jetë i panevojshëm. Nëse parashikohet kalim nga njëri prej juridiksioneve, paragrafi 4 duhet të përfshihet i cili parashikon se pavarësisht paragrafit 3, informacioni që duhet të shkëmbehet për vitin e identifikuar në paragrafin 3 është informacioni i përshkruar në paragrafin 2 të seksionit 2, me përjashtim të informacionit për të ardhurat bruto që përshkruhen në nënparagrafin 2(e)(2) të seksionit 2. Në këtë rast, juridiksionet duhet të specifikojnë vitin për të cilin do të raportohen të ardhurat bruto.

6. Asgjë në këtë Marrëveshje nuk e pengon zbatimin e dispozitave të seksioneve 2 dhe 3 lidhur me informacionin e marrë përpara datës së hyrjes në fuqi të Marrëveshjes, për sa kohë që ky informacion jepet pasi Marrëveshja ka hyrë në fuqi dhe dispozitat e seksioneve 2 dhe 3 kanë hyrë në fuqi. Autoritetet Kompetente, sidoqoftë, mund ta shohin të dobishme qartësimin e shkallës se deri ku dispozitat e seksioneve 2 dhe 3 janë të zbatueshme për këtë informacion.

## **Paragrafët 5 dhe 6 – Modalitetet e teknologjisë së informacionit**

### *Skema e CRS-së dhe udhëzuesi i përdorimit*

7. Paragrafi 5 parashikon se Autoritetet Kompetente do ta shkëmbejnë automatikisht informacionin e përshkruar në seksionin 2 sipas një skeme të standardit të përbashkët të raportimit në gjuhën e zgjeruar të caktuar (XML). Udhëzimet për skemën përkatëse dhe përdorimin e saj janë në udhëzuesin e përdorimit të CRS-së, i cili gjendet në shtojcën 3.

### *Transmetimi i të dhënave duke përfshirë kodimin*

8. Paragrafi 6 parashikon që Autoritetet Kompetente do të bien dakord për një ose më shumë metoda për transmetimin e të dhënave, duke përfshirë standardet e kodimit.

### **Standardet minimale të përshtatshme**

9. Çdo metodë transmetimi duhet të përmbushë standardet minimale të përshtatshme për të garantuar konfidencialitetin dhe integritetin e të dhënave përgjatë transmetimit. Konfidencialiteti do të thotë që të dhënat ose informacioni nuk i jepet ose i vihet në dispozicion personave të paautorizuar. Integriteti do të thotë që të dhënat ose informacioni nuk janë modifikuar ose ndryshuar në mënyrë të paautorizuar. Këto standarde duhet të jenë të ndjeshme ndaj kapaciteteve teknologjike në ndryshim me kalimin e kohës. Kjo përfshin përdorimin e protokolleve dhe kanaleve të sigurt të transmetimit që garantojnë konfidencialitetin dhe integritetin e të dhënave përmes kodimit ose masave fizike ose kombinimit të të dyjave.

10. CAA Model nuk mandaton një zgjidhje të vetme për transmetimin e të dhënave ose kodimin, sepse kjo mund të kufizojë aftësinë e Autoriteteve Kompetente për të rënë dakord për sisteme dhe praktika që janë duke u përdorur me sukses ose që mund të jenë të përshtatshme në rrethana të caktuara. Duke qenë se përgjegjësia për të dhënat mbetet e juridiksionit dërgues deri në momentin që të dhënat të mbërrijnë te juridiksioni marrës, është gjithashtu e mundur që, në varësi të kërkesave të brendshme, mund të bihet dakord për procese të ndryshme për të dyja palët e një shkëmbimi dypalësh (d.m.th. dërgues dhe marrës). Për shembull, juridiksioni A mund të përdorë transmetimin me bazë shfletimi (browseri) dhe juridiksioni B një server të lidhur me një rrjet të sigurt për shkëmbimin e të dhënave. Megjithatë, duke qenë se juridiksionet do të hyjnë në marrëdhënie shkëmbimi automatik bazuar në CRS me një sërë juridiksionesh, do të mendohet për projektimin e një arkitekture transmetimi të qëndrueshme në nivel ndërkombëtar e cila zbut nevojën që secili juridiksion me shumë gjasa duhet të miratojë dhe të mirëmbajë disa metoda të transmetimit dhe/ose kodimit.

## Kodimi

11. Kodimi është projektuar për të mbrojtur konfidencialitetin dhe integritetin e të dhënave. Ai garanton që të dhënat transformohen siç duhen për t'i bërë ato të palexueshme nga dikush tjetër që nuk e ka kodin e çkodimit. Të gjithë skedarët me të dhëna duhet të kodohen me një standard minimal sigurie, dhe rruga e transmetimit duhet të kodohet ose të sigurohet fizikisht me kontrolle auditi për të monitoruar aksesin dhe kopjimet e skedarëve. Metoda e kodimit e cila përdoret gjerësisht për shkëmbimin e informacionit përdor kod publik dhe privat. Kriptografia me kod publik (asimetrike) është përdorur për disa dekada dhe i lejon palët që të shkëmbejnë të dhëna të koduara pa qenë nevoja të komunikojnë paraprakisht kodin e përbashkët sekret. Pala dërguese e kodon skedarin e të dhënave me një kod publik dhe vetëm pala marrëse mban kodin privat të sigurisë që lejon çkodimin e të dhënave. Ekzistojnë standarde për gjatësinë e kodeve të kodimit që janë në përdorim në botë të cilat janë pranuar se sigurojnë nivelin e duhur të sigurisë për të dhënat financiare personale, si tani edhe për të ardhmen e parashikuar, si standardi i avancuar i kodimit (AES) 256.

## Metodat e transmetimit elektronik

12. Ndërsa dikur ka qenë e zakonshme të dërgoheshin skedarë të koduar të dhënash në disketa, USB dhe disqe përmes dorëzimit dorazi ose me postë rekomande ndërmjet Autoriteteve Kompetente, ka disa rreze shtesë dhe administrative për transferimin e të dhënave të lëvizshme (edhe kur integriteti dhe konfidencialiteti garantohen me kodim). Tashmë është e mundur teknologjikisht që të transferohen të dhëna përmes një browser-i në internet i cili mund të sigurojë edhe kodimin pa kosto të mëdha, kapacitete jorevokuese dhe jorefuzuese, kështu që mediat e lëvizshme nuk do të konsiderohen më praktika më e mirë. Metoda e transmetimit që lejon procesin e integruar të transferimit nga përdoruesi në përdorues të autorizuar për transmetimin e skedarëve elektronikë është praktika më e mirë e rekomanduar, qoftë nga serveri në server ose me bazë browser-i<sup>5</sup>. Në mënyrë alternative mund të përdoret dhe emaili i siguruar sipas standardeve dhe specifikimeve minimale, por mund të ketë kosto më të larta instalimi ose vështirësi funksionimi në menaxhimin e aksesit të përdoruesit dhe sigurisë së të dhënave, duke përfshirë kufizimet në madhësinë e skedarëve dhe çështje të mureve të sigurisë. Duhet pranuar rëndësia e vlerësimit të rrezikut dhe rivlerësimi i vazhdueshëm i rrezikut.

## Zbatimi i sigurisë operationale

13. Konfidencialiteti dhe siguria e të dhënave të transmetuara varet edhe nga procedurat e mira menaxhuese, organizative dhe operationale, si edhe nga masat teknike të tilla si instrumentet harduer dhe softuer. Edhe pse nuk është mandatuar pajtueshmëria me ndonjë standard të caktuar, në mënyrë ideale siguria duhet të menaxhohet në mënyrë të pajtueshme me standardet e praktikave më të mira si standardet e sigurisë së informacionit të serive ISO 27000 të ndryshuara kohë pas kohe. Më konkretisht, të dhënat duhet të aksesohen vetëm nga palët e autorizuar në procesin e transmetimit dhe aksesit në çdo kod kodimi, veçanërisht kodi privat, duhet të kontrollohet rreptësisht. Duhet të ketë një evidencë auditi që të regjistrojë të gjitha akseset e autorizuar në të dhëna ose kode. Informacione të mëtejshme për standardet e mbrojtjes dhe konfidencialitetit të të dhënave jepen në Komentin për seksionin 5.

---

<sup>5</sup> UEB SHËRBIMET me siguri të shërbimeve në ueb janë një tjetër standard i përballeshëm që po përdoret gjithmonë e më tepër në mjedise të sigurta, që përbëhen nga një tërësi shërbimesh që përdorin protokolle HTTP përmes metodave standarde si GET dhe POST. Shembuj të protokolleve të transmetimit që janë rënë dakord në nivel ndërkombëtar se përmbushin kriterin e garantimit të konfidencialitetit dhe integritetit të të dhënave për kanalet dhe protokollin e transmetimit të sigurt përfshijnë sigurinë e shtresës së transportit (TLS) v. 1.1 për shkëmbime të sigurta me bazë browser-i dhe protokollin e transferimit të sigurt të skedarit (SFTP) për transferimin e parashikuar në grup, por këto nuk janë protokollin e vetme që mund të ofrojnë zgjidhje të përshtatshme.

## Koment për seksionin 4 lidhur me bashkëpunimin për pajtueshmërinë dhe zbatimin

1. Ky seksion trajton bashkëpunimin ndërmjet Autoriteteve Kompetente për pajtueshmërinë dhe zbatimin. Ai parashikon se nëse një Autoritet Kompetent ka arsye të besojë se një gabim mund të ketë çuar në raportim të pasaktë ose jo të plotë të informacionit ose ka papajtueshmëri nga Institucioni Financiar Raportues, ai Autoritet Kompetent duhet të njoftojë Autoritetin tjetër Kompetent. Autoriteti Kompetent i njoftuar do të marrë të gjitha masat e duhura të disponueshme në legjislacionin e tij të brendshëm për të adresuar gabimet ose papajtueshmërinë e përshkruar në njoftim. Shih Komentin për seksionin IX të Standardit të Përbashkët të Raportimit lidhur me rregullat dhe procedurat administrative që duhet të kenë juridiksionet për të garantuar që CRS zbatohet me efikasitet.

2. Njoftimi sipas këtij seksioni duhet të jetë me shkrim dhe duhet të parashtrojë qartë gabimin dhe papajtueshmërinë si dhe arsyet për të cilat besohet se ka ndodhur ky gabim ose kjo papajtueshmëri. Autoriteti Kompetent i njoftuar duhet të japë një përgjigje ose përditësim sa më shpejt të jetë e mundur dhe jo më vonë se 90 ditë kalendarike pasi ka marrë njoftimin nga Autoriteti tjetër Kompetent. Nëse nuk është zgjidhur çështja, Autoriteti Kompetent duhet t'i japë Autoritetit tjetër Kompetent përditësime çdo 90 ditë. Sidoqoftë, nëse pas marrjes dhe shqyrtimit të njoftimit në mirëbesim, Autoriteti Kompetent i Njoftuar nuk bie dakord se ka apo ka pasur një gabim ose papajtueshmëri siç përshkruhet në njoftim, ai duhet që ta përcjellë sa më shpejt të jetë e mundur këtë vendim tek Autoriteti tjetër Kompetent dhe të shpjegojë arsyet për këtë vendim.

3. Seksioni 4 nuk merr direkt në shqyrtim kontaktin ndërmjet Autoritetit Kompetent nga një juridiksion me Institucionin Financiar Raportues në juridiksionin tjetër. Si alternativë, dy autoritetet kompetente mund të dëshirojnë të lejojnë kontaktin direkt ndërmjet një autoriteti kompetent në një juridiksion dhe Institucionit Financiar Raportues në një tjetër juridiksion në rast gabimesh administrative ose të tjera të vogla. Vendimi për të përfshirë këtë opsion do të varet nga legjislacioni i brendshëm në juridiksionet përkatëse dhe gjithashtu mund të ndikohet nga volumi i kërkesave që një Autoritet Kompetent pret të marrë. Nëse autoritetet kompetente bien dakord për këtë qasje, teksti vijues do të zëvendësojë tekstin aktual në seksionin 4:

*1. Autoriteti Kompetent mund t'i bëjë një kërkesë direkte Institucionit Financiar Raportues në juridiksionin tjetër ku ka arsye të besojë se gabimet administrative ose gabimet e tjera të vogla mund të kenë çuar në raportim të pasaktë ose të paplotë të informacionit. Autoriteti Kompetent do të njoftojë Autoritetin tjetër Kompetent kur Autoriteti Kompetent i përmendur i pari e bën këtë kërkesë të Institucionit Financiar Raportues në juridiksionin tjetër.*

*2. Autoriteti Kompetent do ta njoftojë Autoritetin tjetër Kompetent kur Autoriteti Kompetent i përmendur i pari ka arsye të besojë se ka papajtueshmëri nga Institucioni Financiar Raportues me kërkesat e zbatueshme të raportimit dhe procedurat e verifikimit të duhur në përputhje me Standardin e Përbashkët të Raportimit. Autoriteti Kompetent i njoftuar do të marrë të gjitha masat e duhura në dispozicion sipas legjislacionit të brendshëm për të adresuar papajtueshmërinë e përshkruar më lart.*

4. Në rastin e një kontakti të tillë direkt do të zbatohet legjislacioni i brendshëm i juridiksionit të Institucionit Financiar Raportues, duke përfshirë mbrojtjen e të dhënave personale.

## Koment për seksionin 5 lidhur me konfidencialitetin dhe ruajtjen e të dhënave

1. Konfidencialiteti i informacionit të tatimpaguesit ka qenë gjithmonë një gur themeli thelbësor i sistemeve tatimore. Si tatimpaguesit dhe administratat tatimore kanë të drejtën ligjore të presin që informacioni i shkëmbyer të mbesë konfidencial. Me qëllim që të kenë besim në sistemet e tyre tatimore dhe të përmbushin detyrimet e tyre sipas ligjit, tatimpaguesit duhet të dinë se informacioni financiar, shpesh sensitiv, nuk i jepet palëve të tjera në mënyrë të papërshtatshme, qoftë me qëllim ose aksidentalisht. Qytetarët dhe qeveritë do të kenë besim te shkëmbimi ndërkombëtar vetëm nëse informacioni i shkëmbyer përdoret dhe jepet në përputhje me instrumentin mbi bazën e të cilit është shkëmbyer. Kjo është çështje e kuadrit ligjor por edhe e pasjes së sistemeve dhe procedurave për të garantuar se kuadri ligjor respektohet në praktikë dhe se nuk ka publikim të paautorizuar të informacionit. Aftësia për të mbrojtur konfidencialitetin e informacionit tatimor është gjithashtu rezultat i “kulturës së kujdesit” brenda një administrate tatimore e cila përfshin të gjithë spektrin e sistemeve, procedurave dhe proceseve për të garantuar se kuadri ligjor zbatohet në praktikë dhe se siguria dhe integriteti i informacionit respektohet gjatë trajtimit të informacionit. Me rritjen e sofistikimit të administratës tatimore, proceset dhe praktikat e konfidencialitetit duhet të mbajnë ritmin për të garantuar se informacioni i shkëmbyer mbetet konfidencial<sup>6</sup>. Juridiksione të ndryshme kanë rregulla specifike për mbrojtjen e të dhënave personale që vlejné dhe zbatohen edhe për informacionin e tatimpaguesit.

2. Seksioni 5 së bashku me seksionin 7 dhe aspektet prezantuese në klauzolën e katërt të preambulës pranojnë hapur rëndësinë e konfidencialitetit dhe të ruajtjes së të dhënave lidhur me shkëmbimin automatik të informacionit të llogarisë financiare. Pjesa tjetër e këtij Komenti diskuton shkurtimisht paragrafët 1 dhe 2 të ndjekur nga një diskutim gjithëpërfshirës të konfidencialitetit dhe ruajtjes së të dhënave lidhur me Standardin e Përbashkët të Raportimit.

### Paragrafi 1 – Konfidencialiteti duke përfshirë mbrojtjen e të dhënave personale

3. I gjithë informacioni i shkëmbyer është objekt i rregullave të konfidencialitetit dhe masave të tjera mbrojtëse të parashikuara në instrumentin ligjor që qëndron në themel të marrëveshjes. Këtu përfshihen qëllimet për të cilat mund të përdoret informacioni dhe kufizimet për personat të cilëve mund t’u jepet informacioni.

4. Shumë juridiksione kanë rregulla specifike për mbrojtjen e të dhënave personale të cilat zbatohen për informacionin e tatimpaguesit. Për shembull, për shkëmbimin e informacionit nga shtetet anëtare të BE-së zbatohen rregulla të veçanta për mbrojtjen e të dhënave (pavarësisht nëse shkëmbimi bëhet në një tjetër shtet anëtar të BE-së ose në një juridiksion të tretë). Ndër të tjera, këto rregulla përfshijnë të drejtën e subjektit të të dhënave për informacion, akses, korrigjim, ndryshim, dhe ekzistencën e një mekanizmi mbikëqyrës për të mbrojtur të drejtat e subjektit të të dhënave. Paragrafi 1 i seksionit 5 parashikon se Autoriteti Kompetent që jep informacionin mundet që, deri në masën e nevojshme për të siguruar nivelin e nevojshëm të mbrojtjes së të dhënave personale, të specifikojë në Marrëveshjen e Autoritetit Kompetent masat e veçanta mbrojtëse që duhet të respektohen, siç kërkohet në legjislacionin e tij të brendshëm. Autoriteti Kompetent që merr informacionin duhet të garantojë zbatimin praktik dhe respektimin e çdo mase të specifikuar mbrojtëse. Autoriteti Kompetent që merr informacionin duhet ta trajtojë informacionin në pajtim jo vetëm me legjislacionin e tij të

<sup>6</sup> OECD (2012), *Garantimi i sigurisë: Udhëzuesi i OECD-së për mbrojtjen e konfidencialitetit të informacionit të shkëmbyer për qëllime tatimore*, OECD, PARIS, disponohet në [www.oecd.org/ctp/exchange-of-tax-information/keeping-it-safe-report.pdf](http://www.oecd.org/ctp/exchange-of-tax-information/keeping-it-safe-report.pdf)



brendshëm, por edhe me masat shtesë mbrojtëse që mund të kërkojnë për të garantuar mbrojtjen e të dhënave sipas legjislacionit të brendshëm të Autoritetit Kompetent që jep informacionin. Këto masa shtesë mbrojtëse, siç specifikohen nga Autoriteti Kompetent që jep informacionin, mund të lidhen për shembull me aksesin e individit tek të dhënat. Specifikimi i masave mbrojtëse mund të mos jetë i nevojshëm nëse Autoriteti Kompetent që jep informacionin është i kënaqur me faktin se Autoriteti Kompetent marrës garanton nivelin e nevojshëm të mbrojtjes së të dhënave lidhur me të dhënat që jepen. Në çdo rast, këto masa mbrojtëse duhet të kufizohen me ato që nevojiten për të garantuar mbrojtjen e të dhënave personale pa ndaluar ose vonuar me pa të drejtë shkëmbimin efikas të informacionit.

5. Instrumentet e shkëmbimit të informacionit në përgjithësi parashikojnë se informacioni nuk duhet t'i jepet një juridiksioni tjetër nëse dhënia e informacionit do të ishte në kundërshtim me *ordre public* (politikën publike) të juridiksionit që jep informacionin.<sup>7</sup> Ndërsa kjo zbatohet rrallë në kontekstin e shkëmbimit të informacionit ndërmjet Autoriteteve Kompetente, disa juridiksione mund t'i kërkojnë Autoriteteve Kompetente që të specifikojnë se informacioni që japin mund të mos përdoret ose bëhet i ditur në procese që mund të rezultojnë në dhënien ose ekzekutimin e dënimit me vdekje ose torturës apo të dhunimeve të tjera të rënda të të drejtave të njeriut (si për shembull kur hetimet tatimore motivohen nga persekutimi politik, racor ose fetar) sepse kjo mund të jetë në kundërshtim me politikën publike të juridiksionit që jep informacionin. Në këtë rast, në Marrëveshjen e Autoritetit Kompetent mund të përfshihet një dispozitë me këtë efekt.

## Paragrafi 2 – Shkelja e konfidencialitetit

6. Garantimi i konfidencialitetit të informacionit të marrë sipas instrumentit ligjor të zbatueshëm është kritik. Paragrafi 2 i seksionit 5 parashikon se në rast shkeljeje të konfidencialitetit ose dështimit të masave mbrojtëse (duke përfshirë masat mbrojtëse shtesë (nëse ka) të specifikuara nga Autoriteti Kompetent që jep informacionin), Autoriteti Kompetent duhet të njoftojë menjëherë Autoritetin tjetër Kompetent për këtë shkelje ose dështim duke përfshirë çdo sanksion ose masë për zgjidhje që është vendosur si pasojë e kësaj. Përmbajtja e këtij njoftimi duhet në vetvete të respektojë rregullat e konfidencialitetit dhe duhet të jetë në pajtim me legjislacionin e brendshëm të juridiksionit ku ka ndodhur shkelja ose dështimi. Më tej, seksioni 7 parashikon hapur se papajtueshmëria me dispozitat e konfidencialitetit dhe të masave mbrojtëse (duke përfshirë masat mbrojtëse shtesë (nëse ka) të specifikuara nga Autoriteti Kompetent që jep informacionin), do të konsiderohet papajtueshmëri e konsiderueshme dhe një justifikim për pezullim të menjëhershëm të Marrëveshjes së Autoritetit Kompetent.

### *Konfidencialiteti dhe ruajtja e të dhënave sipas Standardit të Përbashkët të Raportimit*

7. Janë tre shtylla kryesore thelbësore për të garantuar se ekzistojnë masat e duhura mbrojtëse për mbrojtjen e informacionit të shkëmbyer automatikisht: (i) kuadri ligjor, (ii) menaxhimi i sigurisë së informacionit: praktikat dhe procedurat, dhe (iii) monitorimi i pajtueshmërisë dhe sanksioneve për të adresuar shkeljen e konfidencialitetit. Secili prej këtyre aspekteve diskutohet më në detaje në vijim. Shtojca 4 është një pyetësor<sup>8</sup> që e përkthen diskutimin në një sërë pyetjesh dhe që juridiksionet mund ta shohin si instrument të dobishëm për të vlerësuar nëse përmbushen masat e kërkuara mbrojtëse dhe konfidencialiteti. Juridiksionet mund të zgjedhin të hartojnë pyetësorin e tyre të vet për të përkthyer parimet e aspekteve të

<sup>7</sup> Shih për shembull nënparagrafin 3(c) të nenit 26 të Konventës Tatimore mbi të Ardhurat dhe Kapitalin të OECD-së dhe nënparagrafin 2(d) të nenit 21 të Konventës Shumëpalëshe për Ndihmën e Ndërsjellë Administrative në Çështjet Tatimore.

<sup>8</sup> Pyetësori shembull në shtojcën 4 është pyetësori që përdoret nga Shtetet e Bashkuara për qëllime të FATCA-s duke filluar nga data 20 mars 2014 ku janë hequr specifikat e Shteteve të Bashkuara.



konfidencialitetit dhe masave mbrojtëse të të dhënave të CRS-së. Juridiksione të tjera mund të zgjedhin që të mos përdorin një pyetësor duke qenë se tashmë e kanë një marrëdhënie të vazhdueshme të shkëmbimit automatik të informacionit me një juridiksion tjetër dhe e kanë vërtetuar më parë që juridiksioni partner ka masat e duhura mbrojtëse për të mbrojtur informacionin e shkëmbyer automatikisht.

## 1. Kuadri ligjor

8. Kuadri ligjor duhet të sigurojë konfidencialitetin e informacionit tatimor të shkëmbyer dhe ta kufizojë përdorimin e tij sipas qëllimeve të duhura në pajtim me termat e instrumentit të shkëmbimit. Dy komponentët bazë të këtij kuadri janë termat e instrumentit të zbatueshëm dhe legjislacioni i brendshëm i juridiksionit.

9. Të gjitha konventat tatimore dypalëshe dhe shumëpalëshe si dhe instrumentet e tjera ligjore në bazë të të cilave shkëmbehet informacioni tatimor duhet të përmbajnë dispozita që kërkojnë që të ruhet konfidencialiteti i informacionit të shkëmbyer dhe përdorimi i tij të kufizohet për qëllime të caktuara. Një shembull i tillë është Konventa Model Tatimore e OECD-së. Paragrafi 2 i nenit 26 të Konventës Model Tatimore kërkon që informacioni i tatimpaguesit i marrë nga Autoriteti Kompetent të trajtohet si sekret në të njëjtën mënyrë si informacioni i tatimpaguesit i marrë në bazë të legjislacionit të brendshëm të juridiksionit.

Dhënia e këtij informacioni kufizohet te “personat ose autoritetet (duke përfshirë gjykatat dhe organet administrative)” të përfshira në vlerësimin, mbledhjen, administrimin ose zbatimin e tatimeve të mbuluara, ose në ndjekjen penale, ankimimet apo mbikëqyrjet e lidhura me to. Gjithashtu lejon përdorimin për një tjetër qëllim nëse autorizohet nga të dyja autoritetet kompetente dhe nëse ligjet e të dyja shteteve e lejojnë këtë përdorim. Po kështu, neni 22 i Konventës Shumëpalëshe për Ndihmën e Ndërsjellë Administrative në Çështjet Tatimore kërkon që informacioni të trajtohet si sekret dhe të mbrohet në të njëjtën mënyrë si informacioni i marrë në bazë të legjislacionit të brendshëm të palës dhe vendos kufizime mbi përdorimin dhe publikimin e informacionit.

10. Legjislacioni i brendshëm duhet të përfshijë dispozita të mjaftueshme për të mbrojtur konfidencialitetin e informacionit të tatimpaguesit dhe të parashikojë rrethanat specifike dhe të kufizuara në bazë të cilave do të jepet dhe përdoret ky informacion. Legjislacioni i brendshëm duhet të vendosë edhe penalitete ose sanksione për publikimin ose përdorimin e papërshtatshëm të informacionit të tatimpaguesit. Me tej, legjislacioni i brendshëm duhet të sigurojë që instrumentet ndërkombëtare të shkëmbimit të juridiksionit janë të detyrueshme nga pikëpamja ligjore, në mënyrë të atillë që edhe detyrimet e konfidencialitetit në këto instrumente janë të detyrueshme me ligj. Gjithashtu, legjislacioni i brendshëm i tatimpaguesit për ruajtjen e të dhënave të tatimpaguesit duhet të zbatohet për informacionin e tatimpaguesit të marrë nga një tjetër qeveri në bazë të një instrumenti shkëmbimi.

## 2. Menaxhimi i sigurisë së informacionit: Praktikrat dhe procedurat

11. Me qëllim që mbrojtjet ligjore të dhëna në kuadër të instrumentit të shkëmbimit dhe legjislacionit të brendshëm të jenë kuptimplota, duhet të ekzistojnë praktika dhe procedura për të garantuar se informacioni i shkëmbyer i tatimpaguesit mund të përdoret vetëm për qëllime tatimore (ose qëllime të tjera të specifikuara) dhe për të parandaluar publikimin e informacionit të tatimpaguesit te persona ose autoritete qeveritare që nuk janë të përfshira në vlerësimin, mbledhjen, administrimin ose zbatimin e tatimeve të mbuluara, ose në ndjekje penale, ankimime apo mbikëqyrje të lidhura me to.

12. Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit është një tërësi politikash, praktikash dhe procedurash për menaxhimin e sigurisë së informacionit, duke përfshirë rreziqet që lidhen me teknologjinë e informacionit. Siç diskutohet në detaje të mëtejshme më poshtë, praktikrat dhe procedurat e vëna në zbatim nga administratat tatimore duhet të mbulojnë të gjitha aspektet të cilat i përkasin mbrojtjes së konfidencialitetit duke përfshirë procesin e

vlerësimit për punonjësit që përdorin informacionin, kufizimet se kush do të mund të ketë akses në informacion dhe sistemet për të zbuluar dhe gjurmuar publikimin e paautorizuar të informacionit. Praktikë dhe procedurat për menaxhimin e sigurisë së informacionit që përdor çdo administratë tatimore e juridiksionit duhet të respektojnë standardet e njohura ndërkombëtarisht ose praktikë më të mira që garantojnë mbrojtjen e të dhënave konfidenciale të tatimpaguesit.<sup>9</sup> Më konkretisht kjo do të përfshinte kontrollet vijuese bazë:

### *2.1. Punëmarrësit (kontrolle të historikut, kontratat e punës, trajnimi)*

13. Administratat tatimore duhet të sigurohen se individët që kanë pozicione autoriteti dhe akses janë të besueshëm dhe përmbushin kriteret e sigurisë, dhe se privilegjet e tyre të aksesit menaxhohen dhe monitorohen në mënyrën e duhur. Punëmarrësit, konsulentët dhe të tjerë me akses në informacionin konfidencial duhet të vlerësohen për rreziqe të mundshme rreziku. Konsulentët me akses në informacionin e tatimpaguesit duhet të kenë të njëjtat detyrime kontraktore si punëmarrësit për të mbajtur konfidencial informacionin e tatimpaguesit.

14. Administratat tatimore duhet që gjithashtu të garantojnë se punëmarrësit me akses në të dhëna janë të ndërgjegjshëm për kërkesat e konfidencialitetit të pozicioneve të tyre, rreziqet e sigurisë që lidhen me aktivitetet e tyre dhe ligjet e zbatueshme, politikat dhe procedurat që lidhen me sigurinë/konfidencialitetin. Për sa kohë punëmarrësit vijnë në të kenë akses tek të dhënat, duhet të vazhdojnë trajnimi vjetor ose më i shpeshtë.

15. Gjithashtu, duhet të ekzistojnë procedura për t'i dhënë menjëherë dhe shpejt fund aksesit në informacionin konfidencial për punëmarrësit që u është zgjidhur kontrata, të transferuar apo të dalë në pension të cilët nuk kanë më nevojë për këtë akses. Për më tepër, detyrimet për ruajtjen e konfidencialitetit duhet të vazhdojnë edhe pasi të ketë mbaruar aksesit.

### *2.2. Akses në ambiente dhe arkivin e dokumenteve fizike*

16. Administratat tatimore duhet të kenë masa sigurie për të kufizuar hyrjen në ambientet e tyre. Këto masa shpesh përfshijnë praninë e rojeve të sigurisë, politika kundër vizitorëve të pashoqëruar, kartë sigurie për të hyrë në ambiente ose sisteme hyrjeje të koduara për punëmarrësit dhe kufizime për aksesin e punëmarrësve në zonat ku ndodhet informacioni sensitiv.

17. Administratat tatimore gjithashtu duhet të ofrojnë arkivim të sigurt për dokumentet konfidenciale. Informacioni mund të sigurohet në njësi ose dhoma arkivimi të kyçura, të tilla si dollapë (të kyçura me kod ose me çelës), kasaforta dhe dhoma të blinduara. Aksesit të kodet dhe çelësat duhet të jetë i kufizuar. Siguria e dollapëve të arkivimit fizik duhet të variojë në varësi të klasifikimit të përmbajtjeve të tyre, dhe të dhënat tatimore në grup të shkëmbyera automatikisht duhet të kenë një klasifikim të duhur sigurie. Administratat tatimore gjithashtu duhet të garantojnë se kjo siguri nuk ndërpritet edhe kur të dhënat merren dhe dërgohen në vende të tjera pune.

### *2.3. Planifikimi*

18. Administratat tatimore duhet të kenë një plan për të zhvilluar, dokumentuar, përditësuar dhe zbatuar sigurinë për sistemet e informacionit.

<sup>9</sup> Standardet e pranura ndërkombëtarisht për sigurinë e informacionit njihen si "seritë ISO/IEC 27000", të cilat publikohen bashkërisht nga Organizata Ndërkombëtare për Standardizimin (ISO) dhe Komisioni Ndërkombëtar Elektroteknik (IEC). Seritë ofrojnë praktikë më të mira për menaxhimin e sigurisë së informacionit, rreziqet dhe kontrollet brenda kontekstit të një sistemi të përgjithshëm për menaxhimin e sigurisë së informacionit. Administrata tatimore duhet të jetë e aftë të dokumentojë menjëherë se është në pajtim me standardet e serive ISO/IEC 27000 apo që ka një kuadër ekuivalent të sigurisë së informacionit dhe se informacioni i tatimpaguesit i marrë në kuadrin e një instrumenti ligjor është i mbrojtur brenda atij kuadri.

#### *2.4. Menaxhimi i konfigurimit*

19. Administratat tatimore duhet të kontrollojnë dhe menaxhojnë konfigurimin e sistemeve të informacionit. Për këtë qëllim, ato duhet të zhvillojnë, dokumentojnë, shpërndajnë dhe përditësojnë kontrollet përkatëse të sigurisë.

#### *2.5. Kontrolli i aksesit*

20. Administratat tatimore duhet ta kufizojnë aksesin në sistem për përdoruesit dhe pajisjet e autorizuar (duke përfshirë sistemet e tjera të informacionit). Përdoruesit e autorizuar duhet të kenë kufizime në aksesimin e transaksioneve dhe funksioneve që u lejohet të ndërmarrin.

#### *2.6. Identifikimi dhe autentikimi*

21. Sistemet e informacionit duhet të kenë mjetet për të ruajtur dhe autentikuar identitetet e përdoruesve dhe pajisjeve që kërkojnë akses në sistemet e informacionit. Sistemet e informacionit gjithashtu duhet të jenë të afta ta identifikojnë përdoruesin e paautorizuar dhe ta pengojnë atë të hyjë në informacionin konfidencial.

#### *2.7. Auditimi dhe llogaridhënia*

22. Përdoruesit e paautorizuar mund të mbajnë përgjegjësi vetëm nëse veprimet e tyre janë të gjurmueshme. Prandaj, është shumë e rëndësishme që administratat tatimore të krijojnë dhe të mbajnë regjistra auditimi të sistemit të informacionit për monitorimin, analizimin, investigimin dhe raportimin e aktivitetit të jashtëligjshëm, të paautorizuar ose të papërshtatshëm të sistemit të informacionit.

#### *2.8. Mirëmbajtja*

23. Administratat tatimore duhet të kryejnë mirëmbajtje periodike dhe në kohë të sistemeve, si dhe të ofrojnë kontrolle efikase për instrumentet, teknikat dhe mekanizmat për mirëmbajtjen e sistemit dhe personelin që i përdor ato.

#### *2.9. Mbrojtja e komunikimeve dhe sistemit*

24. Administratat tatimore duhet të monitorojnë, kontrollojnë dhe mbrojnë komunikimet në kufijtë e jashtëm dhe të brendshëm të sistemeve të informacionit. Këto kontrolle duhet të përfshijnë procedurat për të hequr të dhënat e mbetura, të ofrojnë konfidencialitet në transmetim dhe të validojnë kriptografinë.

#### *2.10. Integriteti i informacionit dhe sistemit*

25. Administratat tatimore duhet të identifikojnë, raportojnë dhe korrigjojnë (ose të marrin masa korrigjuese për) incidentet me sigurinë e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në kohën e duhur, duke ofruar mbrojtje nga kodet e dëmshme (malware) dhe duke monitoruar këshillat dhe alarmet e sigurisë të sistemit.

#### *2.11. Vlerësimet e sigurisë*

26. Administrata tatimore duhet të zhvillojë dhe përditësojë rregullisht politikën për shqyrtimin e proceseve që përdoren për të testuar, validuar dhe autorizuar kontrollet e sigurisë për mbrojtjen e të dhënave, korrigjimin e mangësive dhe reduktimin e cenueshmërive. Shpeshtësia e këtyre përditësimeve do të bazohet mbi rrezik, por duhet të bëhet në intervale të përshtatshme në përputhje me standardet ose praktikatat më të mira të njohura ndërkombëtarisht. Ajo gjithashtu duhet të ketë një politikë për të shqyrtuar mënyrën në të cilën autorizohen veprimet

dhe lidhjet e sistemit të informacionit, dhe procedurat për monitorimin e kontrolleve të sigurisë së sistemit.

### *2.12. Planifikimi i kontigjencave*

27. Administratat tatimore duhet të krijojnë dhe vënë në zbatim plane për reagim ndaj emergjencave, operacione mbështetëse (back-up) dhe rikuperim të sistemeve të informacionit pas fatkeqësive natyrore.

### *2.13. Vlerësimi i rrezikut*

28. Administrata tatimore duhet të vlerësojë rrezikun e mundshëm nga aksesit i paautorizuar në informacionin e tatimpaguesit, dhe rrezikun dhe magnitudën e dëmit nga përdorimi, dhënia, ndërprerja, ndryshimi ose shkatërrimi i paautorizuar i këtij informacioni ose i sistemeve të informacionit të tatimpaguesit. Ajo duhet ta përditësojë vlerësimin e saj të rrezikut në mënyrë periodike ose kurdoherë që ka ndryshime të konsiderueshme në sistemin e informacionit, strukturat ku qëndron sistemi ose në kushte të tjera që mund të ndikojnë në sigurinë ose statusin e akreditimit të sistemit.

### *2.14. Blerja e shërbimeve dhe sistemeve*

29. Administratat tatimore duhet të sigurohen që palët e treta të cilat janë ofruese të sistemeve të informacionit të cilët janë të angazhuar në përpunimin, ruajtjen dhe transmetimin e informacionit të shkëmbyer në kuadrin e instrumentit ligjor përdorin kontrolle sigurie në pajtim me kërkesat e nevojshme të sigurisë kompjuterike.

### *2.15. Mbrojtja e medias*

30. Administratat tatimore duhet të mbrojnë informacionin në formë të printuar ose në media dixhitale, të kufizojnë aksesin në informacion për përdoruesit e autorizuar dhe të pastrojnë ose shkatërrojnë median dixhitale përpara eliminimit ose ripërdorimit.

### *2.16. Identifikimi i të dhënave*

31. Të dhënat e shkëmbyera në kuadrin e instrumentit ligjor gjithmonë duhet të mbrohen nga publikimet aksidentale të informacionit. Nëse të dhënat futen në një skedar që përfshin të dhëna të tjera dhe ndarja fizike është jopraktike, duhet të ketë procedura për të garantuar që i gjithë skedari mbrohet dhe etiketohet qartësisht për të treguar përfshirjen e të dhënave të shkëmbyera në kuadrin e një instrumenti ligjor. Edhe vetë informacioni duhet të etiketohet qartësisht.

32. Duhet të ketë procedura për të garantuar që, përpara se ky skedar t'i jepet një individ ose agjencie të paautorizuar për të hyrë në të dhënat e shkëmbyera sipas një instrumenti ligjor, të gjitha këto të dhëna janë hequr. Në rast se të dhënat ruhen në një bazë të dhënash, duhet të ketë procedura që garantojnë se, përpara se t'i jepet akses në bazën e të dhënave një individ ose agjencie të paautorizuar për të hyrë në të dhënat e shkëmbyera sipas një instrumenti ligjor, të gjitha këto të dhëna janë fshirë nga baza e të dhënave (ose janë ndarë në mënyrë të sigurtë/mbrohen në mënyrë të atillë që e ndalon individin ose agjencinë e paautorizuar të hyjë tek të dhënat).

### *2.17. Politikat e eliminimit të informacionit*

33. Administratat tatimore duhet të kenë politika që kërkojnë shkatërrimin e të dhënave menjëherë pasi ato nuk nevojiten më dhe që sigurojnë eliminimin e informacionit konfidencial. Prerja e dokumenteve, kutitë e djegies ose prerja në kosha të kyçur janë të përshtatshme për

dokumentet letër, dhe dokumentet elektronike duhet të fshihen kur nuk janë më të nevojshme. Informacioni konfidencial duhet të hiqet përpara hedhjes së kompjuterëve dhe pajisjeve për ruajtjen e informacionit.

### 3. Monitorimi i pajtueshmërisë dhe sanksionet për të adresuar shkeljen e konfidencialitetit

34. Përveç mbajtjes konfidencial të informacionit të shkëmbyer sipas një instrumenti ligjor, administratat tatimore duhet të jenë të afta të garantojnë se përdorimi i tij do të jetë i kufizuar për qëllimet e përcaktuara nga marrëveshja e zbatueshme për shkëmbimin e informacionit. Prandaj, pajtueshmëria vetëm me një kuadër të pranueshëm të sigurisë së informacionit nuk mjafton për të mbrojtur të dhënat tatimore që janë shkëmbyer. Për më tepër, legjislacioni i brendshëm duhet të vendosë sanksione ose penalitete për publikimin ose përdorimin e papërshtatshëm të informacionit të tatimpaguesit. Për të garantuar zbatimin, këto ligje duhet të përforcohen me burime dhe procedura të përshtatshme administrative.

#### 3.1. Penalitetet dhe sanksionet

35. Legjislacioni i brendshëm duhet të vendosë penalitete ose sanksione për publikimin ose përdorimin e papërshtatshëm të informacionit të tatimpaguesit, dhe administratat tatimore duhet në fakt t'i vendosin këto penalitete dhe sanksione kundër personelit që shkel politikën e sigurisë dhe procedurat që shkurajojnë të tjerët që të angazhohen në shkelje të ngjashme. Për të garantuar zbatimin, këto ligje duhet të përforcohen me burime dhe procedura të përshtatshme administrative. Administratat tatimore duhet të zbatojnë një proces zyrtar sanksionesh për personelin dhe palën e tretë ofruese që nuk respektojnë politikën dhe procedurat e vendosura të sigurisë së informacionit. Politikën duhet të marrin në konsideratë si sanksionet civile dhe ato penale për inspektim ose publikim të paautorizuar të informacionit.

#### 3.2. Rregullimi i aksesit ose publikimit të paautorizuar të informacionit

36. Përveç politikave që rregullojnë aksesin në informacionin konfidencial, administratat tatimore duhet të kenë edhe procese për monitorimin e pajtueshmërisë me këto politika dhe për të zbuluar çdo akses dhe publikim të paautorizuar informacioni. Nëse ndodh diçka e tillë, duhet të ketë një hetim të ndjekur nga përgatitja e një raporti për menaxhim. Raporti duhet të përfshijë:

- rekomandimet për të minimizuar pasojat e incidentit;
- analizën për mënyrën se si duhet të shmangen incidentet e ngjashme në të ardhmen;
- rekomandimet për çdo sanksion që duhet vendosur mbi personat përgjegjës për shkeljen, duke e vënë theksin mbi faktin se duhet të përfshihen edhe autoritetet ligjzbatuese nëse dyshohet për publikim të qëllimshëm të informacionit; dhe
- arsyet për një nivel të lartë besimi që, menjëherë pas zbatimit, ndryshimet e rekomanduara në sistem dhe penalitetet do të shmangin shkelje të ngjashme në të ardhmen.

37. Gjithashtu, administratat tatimore duhet të kenë një proces për shqyrtimin dhe miratimin e rekomandimeve për ndryshimet e politikave dhe procedurave për të shmangur shkeljet e ardhshme. Autoriteti hetues i administratës tatimore ose niveli më i lartë drejtues i saj duhet të garantojnë zbatimin e rekomandimeve të miratuara.



## Koment për seksionin 6 lidhur me konsultimet dhe ndryshimet

1. Ky seksion trajton konsultimet ndërmjet Autoriteteve Kompetente dhe ndryshimet në marrëveshjen e autoritetit kompetent.

### Paragrafi 1 – Konsultimet

2. Ky paragraf parashikon se nëse linden vështirësi në zbatimin ose interpretimin e kësaj Marrëveshjeje, secili prej autoriteteve kompetente mund të kërkojë konsultime për të zhvilluar masa me qëllim garantimin e përmbushjes së kësaj Marrëveshjeje. Konsultimet gjithashtu mund të mbahen për të analizuar cilësinë e informacionit të marrë.

3. Autoritetet Kompetente mund të komunikojnë me njëri tjetrin me shkresa, përcjellje të faksimileve, telefon, takime direkte ose me çdo mënyrë tjetër të përshtatshme për qëllime të arritjes së një marrëveshjeje mbi masat e përshtatshme për të garantuar përmbushjen e kësaj marrëveshjeje.

### Paragrafi 2 – Ndryshimet

4. Ky paragraf qartëson se Marrëveshja mund të ndryshohet me marrëveshje me shkrim të Autoriteteve Kompetente. Përveçse nëse Autoritetet Kompetente bien dakord ndryshe, ky ndryshim hyn në fuqi në ditën e parë të muajit vijues që pason periudhën njëmuajore nga:

- data e fundit e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje me shkrim, ose
- data e fundit që janë shkëmbyer njoftimet për qëllime të kësaj marrëveshjeje me shkrim.

5. Siç u vu në dukje te hyrja e Komenteve për Marrëveshjen Model të Autoritetit Kompetent, juridiksionet gjithashtu mund të hyjnë në marrëveshje shumëpalëshe ndërqeveritare ose disa marrëveshje ndërqeveritare që mund të jenë traktate ndërkombëtare në të drejtë të tyre të cilat mbulojnë detyrimet e raportimit dhe procedurat e verifikimit të duhur shoqëruar me një marrëveshje më të kufizuar të autoritetit kompetent. Në këto raste mund të zbatohen rregulla të ndryshme për ndryshimet.

## Koment për seksionin 7 lidhur me afatin e marrëveshjes

### Paragrafi 1 – Hyrja në fuqi

1. Paragrafi 1 parashikon dy alternativa për datën e hyrjes në fuqi. Së pari, në rastin kur juridiksionet kanë hyrë në këtë marrëveshje pasi të dyja juridiksionet disponojnë ligjet e nevojshme për të zbatuar Standardin e Përbashkët të Raportimit, ato duhet të vendosin për datën e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes. Së dyti, nëse Autoritetet Kompetente nënshkruajnë përpara se një ose të dyja juridiksionet të kenë ligjet e nevojshme, ato me shumë gjasa do të përdorin këtë alternativë të dytë dhe marrëveshja do të hyjë në fuqi në datën e njoftimeve më të fundit që juridiksioni tashmë i disponon rregullat për zbatimin e marrëveshjes.

### Paragrafi 2 – Pezullimi

2. Paragrafi 2 parashikon detajet mbi mundësinë që një Autoritet Kompetent ta pezullojë Marrëveshjen kur përcakton se ka ose ka pasur papajtueshmëri të konsiderueshme nga Autoriteti



tjetër Kompetent me këtë Marrëveshje. Kur është e mundur Autoritetet Kompetente duhet të përpiqen që të zgjidhin çdo çështje papajtueshmërie, edhe ato të papajtueshmërisë së konsiderueshme, përpara nxjerrjes së njoftimit për pezullimin e funksionimit të Marrëveshjes.

3. Për ta pezulluar Marrëveshjen, Autoriteti Kompetent duhet ta njoftojë me shkrim Autoritetin tjetër Kompetent mbi qëllimin e tij për të pezulluar Marrëveshjen. Njoftimi duhet të japë një përshkrim të detajuar të papajtueshmërisë së konsiderueshme që ka ndodhur, ose që po ndodh, dhe kur është e mundur një përshkrim të hapave që duhen ndërmarrë për ta zgjidhur këtë çështje. Pezullimi do të ketë efekt të menjëhershëm.

4. Autoriteti Kompetent i njoftuar duhet, sa më shpejt të jetë e mundur, që të ndërmarrë hapat e nevojshme për të adresuar papajtueshmërinë e konsiderueshme. Menjëherë pasi të jetë zgjidhur papajtueshmëria, Autoriteti Kompetent i njoftuar duhet t'ia bëjë të ditur Autoritetit tjetër Kompetent. Pas zgjidhjes me sukses të çështjes, Autoriteti Kompetent që ka dërguar njoftimin për pezullim duhet t'i konfirmojë me shkrim Autoritetit Kompetent të njoftuar se Marrëveshja nuk është më e pezulluar dhe se duhet të fillojnë sa më shpejt të jetë e mundur shkëmbimet e informacionit.

5. Paragrafi 2 parashikon se papajtueshmëria e konsiderueshme përfshin, por nuk kufizohet me:

- Papajtueshmërinë me dispozitat e konfidencialitetit dhe të ruajtjes së të dhënave të kësaj Marrëveshjeje (duke përfshirë dhe masat mbrojtëse shtesë të specifikuara në Marrëveshjen e Autoritetit Kompetent), për shembull informacioni është përdorur për qëllime që nuk janë të autorizuar në instrumentin ligjor që qëndron në themel të marrëveshjes ose legjislacioni i brendshëm është ndryshuar në mënyrë të atillë që është kompromentuar konfidencialiteti i informacionit;
- paaftësinë e Autoritetit Kompetent për ta dhënë informacionin në kohë ose të përshtatshëm siç kërkohet nga kjo Marrëveshje;
- përkufizimin e statusit të Llogarive të Përgjashtuara ose të Institucioneve Financiare Raportuese në mënyrë të atillë që cenon qëllimet e Standardit të Përbashkët të Raportimit;
- paaftësinë për të pasur rregulla dhe procedura administrative për të garantuar zbatimin e efikas të procedurave të raportimit dhe verifikimit të duhur të parashtruara në Standardin e Përbashkët të Raportimit.

6. Gjatë periudhës së çdo pezullimi, i gjithë informacioni i marrë më parë në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje do të mbetet konfidencial dhe objekt i kushteve të seksionit 5 të Marrëveshjes duke përfshirë çdo ruajtje shtesë të të dhënave të specifikuara nga Autoriteti Kompetent që jep informacionin dhe instrumenti ligjor që qëndron në themel të marrëveshjes.

### **Paragrafi 3 – Zgjidhja**

7. Paragrafi 3 përmban klauzolën e zgjidhjes. Secili Autoritet Kompetent mund ta zgjidhë këtë Marrëveshje duke e njoftuar për këtë zgjidhje me shkrim Autoritetin tjetër Kompetent. Kjo zgjidhje do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit pas skadimit të periudhës prej 12 muajsh pas datës së njoftimit për zgjidhje. Për shembull, Autoriteti Kompetent mund të zgjedhë ta zgjidhë këtë Marrëveshje kur Marrëveshja është pezulluar dhe Autoriteti tjetër Kompetent nuk i ka zgjidhur çështjet e papajtueshmërisë brenda një kuadri të arsyeshëm kohor.

8. Zgjidhja e instrumentit ligjor në themel të Marrëveshjes në kuadrin e së cilit është arritur Marrëveshja e Autoritetit Kompetent do të çonte në zgjidhjen automatike të Marrëveshjes së Autoritetit Kompetent. Po kështu, në rrethana të tilla Marrëveshja e Autoritetit Kompetent nuk do të kishte nevojë të zgjidhej veçmas.

9. Paragrafi 3 qartëson se në rast zgjidhjeje, i gjithë informacioni i marrë më parë në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje do të mbetet konfidencial dhe objekt i termave të seksionit 5 të

Marrëveshjes duke përfshirë çdo ruajtje shtesë të të dhënave të specifikuara nga Autoriteti Kompetent që jep informacionin dhe instrumenti ligjor që qëndron në themel të marrëveshjes.

## B. Komentet për Standardin e Përbashkët të Raportimit

### Hyrje

CRS-ja përmban standardet e raportimit dhe të verifikimit të duhur që qëndrojnë në themel të shkëmbimit automatik të informacionit të llogarisë financiare. Juridiksioni zbatues duhet të ketë rregullat që u kërkojnë institucioneve financiare të raportojnë informacion në pajtim me qëllimin e raportimit të parashtruar në seksionin I dhe të ndjekin procedurat e verifikimit të duhur në pajtim me procedurat në seksionet II deri në VII të CRS-së.

Termat e kapitalizuara që përdoren në CRS janë të përkufizuara në seksionin VIII. Juridiksioni zbatues mund të parashikojë që shuma dhe karakterizimi i pagesave lidhur me një Llogari të Raportueshme duhet të përcaktohen në pajtim me parimet e ligjeve të tij tatimore.

Seksioni IX i CRS-së përshkruan rregullat dhe procedurat administrative që pritet të ketë një juridiksion për të garantuar zbatimin efikas të, dhe pajtueshmërinë me CRS-në.

### Koment për seksionin I lidhur me Kërkesat e Përgjithshme të Raportimit

1. Seksioni I përmban kërkesat e përgjithshme të raportimit që zbatohen për Institucionet Financiare Raportuese. Paragrafët A dhe B specifikojnë informacionin që do të raportohet si rregull i përgjithshëm, ndërsa paragrafët C deri në F parashikojnë një sërë përjashtimesh lidhur me NIPT-in, datën e lindjes, vendin e lindjes dhe të ardhurat bruto. Paragrafi 1 i seksionit 2 të Marrëveshjes Model të Autoritetit Kompetent e bën të qartë se informacioni që do të shkëmbehet është informacioni që kërkohej të raportohet sipas rregullave të raportimit dhe verifikimit të duhur të Standardit të Përbashkët të Raportimit, duke përfshirë përjashtimet që ndodhen në paragrafët C deri në F të seksionit I.

2. Institucionet Financiare Raportuese shpesh do t'i informojnë Mbajtësit e Llogarive (p.sh. përmes ndryshimit në terma dhe kushte) se informacioni lidhur me llogaritë e tyre, nëse llogaritë e tyre janë Llogari të Raportueshme, do të raportohet dhe mund të shkëmbehet me juridiksione të tjera. Në disa juridiksione, Institucioneve Financiare Raportuese mund t'u kërkohej të veprojnë kështu nën kuadrin e rregullave të privatësisë dhe publikimit të informacionit të juridiksionit të tyre. Institucionet Financiare Raportuese do të duhet të pajtohen me këto rregulla në këtë drejtim (p.sh. duke u dhënë Mbajtësve të Llogarive, me kërkesë, një kopje të informacionit të raportuar).

#### Paragrafi A – Informacioni që duhet raportuar

3. Sipas paragrafit A, secili Institucion Financiar Raportues duhet të raportojë informacionin vijues lidhur me secilën Llogari të Raportueshme të këtij Institucioni Financiar Raportues:
  - a) në rastin e një individi që është Mbajtës i Llogarisë dhe Person i Raportueshëm: emrin, adresën, juridiksionet e rezidencës, NIPT-et dhe datën e vendin e lindjes;
  - b) në rastin e çdo Njësie Ekonomike që është Mbajtës Llogarie dhe Person i Raportueshëm: emrin, adresën, juridiksionet e rezidencës dhe NIPT-et;
  - c) në rastin e çdo Njësie Ekonomike që është Mbajtës Llogarie dhe që është identifikuar se ka një ose më shumë Persona Kontrollues që janë Persona të Raportueshëm:

- (1) emrin, adresën, juridiksionet e rezidencës dhe NIPT-et e Njesisë Ekonomike; dhe
  - (2) emrin, adresën, juridiksionet e rezidencës, NIPT-et dhe datën e vendin e lindjes të secilit Person Kontrollues që është Person i Raportueshëm;
  - d) numrin e llogarisë (ose ekuivalentin funksional në mungesë të një numri llogarie);
  - e) emrin dhe numrin identifikues (nëse ka) të Institucionit Financiar Raportues; dhe
  - f) gjendjen e llogarisë ose vlerën (duke përfshirë, në rastin e Kontratës së Sigurimit në Vlerë në Para të Gatshme ose Kontratë Pensioni Vjetor, Vlerën në Para të Gatshme ose vlerën e mbylljes vullnetare) duke filluar në fund të vitit përkatës kalendarik ose në një periudhë tjetër të përshtatshme raportimi ose, nëse llogaria është mbyllur gjatë atij viti apo asaj periudhe, në mbylljen e llogarisë.
4. Gjithashtu duhet raportuar edhe informacioni vijues:
- a) në rastin e një Llogarie Kujdestarie:
    - (1) shumën totale bruto të interesit të paguar apo të kredituar në llogari (ose lidhur me llogarinë) gjatë vitit kalendarik ose një periudhe tjetër të përshtatshme raportimi;
    - (2) shumën totale bruto të dividendëve të paguar apo të kredituar në llogari (ose lidhur me llogarinë) gjatë vitit kalendarik ose një periudhe tjetër të përshtatshme raportimi;
    - (3) shumën totale bruto të të ardhurave të tjera të krijuara në lidhje me aktivet e mbajtura në llogari të paguara ose të kredituara në llogari (ose në lidhje me llogarinë) gjatë vitit kalendarik ose një periudhe tjetër të përshtatshme raportimi; dhe
    - (4) të ardhurat totale bruto nga shitja apo shlyerja e aktiveve financiare të paguara apo të kredituara në llogari gjatë vitit kalendarik ose një periudhe tjetër të përshtatshme të raportimit në lidhje me të cilën Institucioni Financiar Raportues ka vepruar, si: kujdestar, ndërmjetës, kandidat ose ndryshe si një agjent për Mbajtësin e Llogarisë.
  - b) në rastin e ndonjë Llogarie Depozite: shumën totale bruto të interesit të paguar apo të kredituar në llogari gjatë vitit kalendarik ose një periudhe tjetër të përshtatshme raportimi.
  - c) në rastin e çdo llogarie të ndryshme nga Llogaria e Kujdestarisë ose Llogaria e Depozitës: shumën totale bruto të paguar apo të kredituar për Mbajtësin e Llogarisë në lidhje me llogarinë gjatë vitit kalendarik ose një periudhe tjetër të përshtatshme raportimi në lidhje me të cilën Institucioni Financiar Raportues është institucioni që ka detyrim ose debitori, duke përfshirë edhe shumën totale të pagesave të shlyerjeve të bëra për Mbajtësin e Llogarisë gjatë vitit kalendarik ose një periudhe tjetër të përshtatshme raportimi.

### *Nënparagrafi A(1) – Adresa*

5. Adresa që duhet raportuar lidhur me një llogari është adresa e regjistruar nga Institucioni Financiar Raportues për Mbajtësin e Llogarisë, sipas procedurave të verifikimit të duhur në seksionet II deri në VII. Si rrjedhojë, në rastin e një llogarie të mbajtur nga një individ që është Person i Raportueshëm, adresa që duhet raportuar është adresa aktuale e rezidencës së një individi (shih paragrafët 8 dhe 22 të Komentit për seksionin III) përveçse nëse Institucioni Financiar Raportues nuk e ka këtë adresë në regjistrat e tij, do të duhet të raportojë adresën postare që ka në dosje. Në rastin e një llogarie të mbajtur nga një Njësi Ekonomike që është identifikuar se ka një ose më shumë Persona Kontrollues që janë

Persona të Raportueshëm, adresa që do të raportohet është adresa e Njesisë Ekonomike dhe adresa e secilit Person Kontrollues të kësaj Njësie Ekonomike që është Person i Raportueshëm.

#### *Nënparagrafi A(1) – Juridiksionet e rezidencës*

6. Juridiksioni i rezidencës që duhet raportuar lidhur me një llogari është juridiksioni i rezidencës i identifikuar nga Institucioni Financiar Raportues për Personin e Raportueshëm lidhur me vitin përkatës kalendarik ose një periudhë tjetër të përshtatshme raportimi, sipas procedurave të verifikimit të duhur në seksionet II deri në VIII. Në rastin e një Personi të Raportueshëm që identifikohet se ka më shumë se një juridiksion rezidence, juridiksionet e rezidencës që duhen raportuar janë të gjitha juridiksionet e rezidencës të identifikuara nga Institucioni Financiar Raportues lidhur me vitin kalendarik përkatës ose periudhë tjetër të përshtatshme raportimi. Juridiksionet e rezidencës që janë identifikuar si rezultat i procedurave të verifikimit të duhur në seksionet II deri në VII nuk cenojnë përcaktimin e rezidencës të bërë nga Institucioni Financiar Raportues për qëllime të tjera tatimore.

#### *Nënparagrafi A(1) – NIPT-i*

7. NIPT-i që duhet raportuar lidhur me një llogari është NIPT-i që i jepet Mbajtësit të Llogarisë nga juridiksioni i tij i rezidencës (d.m.th. jo nga juridiksioni i burimit). Në rastin e një Personi të Raportueshëm që identifikohet se ka më shumë se një juridiksion rezidence, NIPT-i që duhet raportuar është NIPT-i i Mbajtësit të Llogarisë lidhur me secilin Juridiksion të Raportueshëm (objekt i zbatimit të paragrafëve C dhe D). Siç përcaktohet në nënparagrafin E(5) të seksionit VIII, termi “NIPT” përfshin një ekuivalent funksional në mungesë të Numrit të Identifikimit të Tatimpaguesit (shih paragrafin 148 të Komentit për seksionin VIII).

#### *Nënparagrafi A(2) – Numri i llogarisë*

8. Numri i llogarisë që duhet raportuar lidhur me një llogari është numri identifikues që jepet nga Institucioni Financiar Raportues për qëllime të ndryshme nga përmbushja e kërkesave të raportimit të nënparagrafit A(1) ose, nëse llogarisë nuk i jepet një numër i tillë, ekuivalenti funksional (d.m.th numri unik i serisë ose numër tjetër që ky Institucion Financiar Raportues i jep Llogarisë Financiare që e dallon atë nga llogari të tjera që mbahen nga ky institucion). Numri i kontratës ose i policës në përgjithësi do të konsiderohen ekuivalentë funksionalë të një numri llogarie.

#### *Nënparagrafi A(3) – Numri identifikues*

9. Institucioni Financiar Raportues duhet të raportojë emrin dhe numrin e tij identifikues (nëse ka). Informacioni identifikues për Institucionin Financiar Raportues ka për qëllim t'i lejojë Juridiksionet Pjesëmarrëse që të identifikojnë me lehtësi burimin e informacionit të raportuar dhe të shkëmbyer më pas, me qëllim që, p.sh. të ndjekin gabimin që mund të ketë çuar në raportim të pasaktë ose të paplotë të informacionit. “Numri i identifikues” i një Institucioni Financiar Raportues është numri që i jepet Institucionit Financiar Raportues për qëllime identifikimi. Normalisht ky numër i jepet Institucionit Financiar Raportues nga juridiksioni i tij i rezidencës ose vendndodhjes, por gjithashtu mund të jepet në nivel global. Shembuj të numrit të identifikimit përfshijnë NIPT-in, kodin/numrin e biznesit/shoqërisë, Identifikuesin Global të Njesisë Ekonomike Juridike (LEI)<sup>10</sup>, ose Numrin e Identifikimit

<sup>10</sup> Shih faqen e internetit të Komitetin Mbikëqyrës Rregullator (ROC) të Sistemit Global të Identifikuesit të Njesisë Ekonomike Juridike (GLEIS), që gjendet në [www.lei.org/](http://www.lei.org/).

Ndërmjetës Global (GIIN)<sup>11</sup>. Juridiksionet Pjesëmarrëse priten që t'u japin Institucioneve të tyre Financiare Raportuese orientime lidhur me çdo numër identifikues që do të raportohet, më pas është e nevojshme të raportohet vetëm emri dhe adresa e Institucionit Financiar Raportues.

#### *Nënparagrafi A(4) – Vlera ose bilanci i llogarisë*

10. Institucioni Financiar Raportues duhet të raportojë bilancin ose vlerën e llogarisë duke filluar nga fundi i vitit kalendarik ose periudhe tjetër të përshtatshme raportimi ose, nëse llogaria është mbyllur gjatë këtij viti ose periudhe, në mbyllje të llogarisë (shih paragrafin 14 më poshtë). Llogaria me bilanc ose vlerë negative duhet të raportohet se ka bilanc ose vlerë llogarie të barabartë me zero. Në rastin e një llogarie që është Kontratë Sigurimi në Vlerë në Para të Gatshme ose Kontrate Pensioni, Institucioni Financiar Raportues duhet të raportojë Vlerën në Para të Gatshme ose vlerën për mbylljen vullnetare të llogarisë.

11. Megjithatë, disa juridiksione, tashmë u kërkojnë institucioneve financiare që të raportojnë bilancin ose vlerën mesatare të llogarisë gjatë vitit kalendarik ose periudhe tjetër të përshtatshme raportimi. Këto juridiksione janë të lira të mbajnë raportimin e atij informacioni në vend që të kërkojnë raportim të bilancit ose vlerës së llogarisë duke filluar nga fundi i vitit kalendarik ose një periudhe tjetër të përshtatshme raportimi, e cila mund të realizohet duke zëvendësuar nënparagrafin A(4) me dispozitën e mëposhtme:

*4. vlerën ose bilancin [mujor] mesatar [më të lartë] (duke përfshirë, në rastin e një Kontrate Sigurimi në Vlerë në Para të Gatshme ose Kontrate Pensioni Vjetor, Vlerën në Para të Gatshme ose vlerën e mbylljes vullnetare) gjatë vitit përkatës kalendarik ose periudhe tjetër të përshtatshme raportimi ose, nëse llogaria është mbyllur gjatë këtij viti ose periudhe, në mbyllje të llogarisë;*

Në këtë rast, nënparagrafi 2(d) i seksionit 2 të Marrëveshjes Model të Autoritetit Kompetent duhet të modifikohet përkatësisht (shih paragrafin 4 të Komentit për seksionin 2 të Marrëveshjes Model të Autoritetit Kompetent).

12. Në përgjithësi, bilanci ose vlera e Llogarisë Financiare është bilanci ose vlera e përlllogaritur nga Institucioni Financiar për qëllime raportimi të Mbajtësi i Llogarisë. Në rast interesi në kapital neto ose borxhi në një Institucion Financiar, bilanci ose vlera e interesit në kapital neto është vlera që përlllogaritet nga Institucioni Financiar për qëllime se kërkon përcaktimin më të shpeshtë të vlerës, dhe bilanci ose vlera e interesit në borxh është shuma e principalit të saj. Bilanci ose vlera e një Kontrate Sigurimi ose Pensioni Vjetor është bilanci ose vlera duke filluar nga fundi i vitit kalendarik ose një periudhe tjetër të përshtatshme raportimi (shih paragrafin 15 më poshtë). Bilanci ose vlera e llogarisë nuk do të ulet nga asnjë pasiv ose detyrim të pësuar nga mbajtësi i llogarisë lidhur me llogarinë ose ndonjë prej aktiveve të mbajtura në llogari.

13. Secilit mbajtës të një llogarie të mbajtur bashkërisht i atribuohet i gjithë bilanci ose vlera e llogarisë së përbashkët, si edhe të gjitha shumat të paguara ose kredituara në llogarinë e përbashkët (ose lidhur me llogarinë e përbashkët). E njëjta gjë vlen për:

- llogarinë që mbahet nga një NFE Pasive me më shumë se një Person Kontrollues që është Person i Raportueshëm, ku secilit Person Kontrollues i atribuohet i gjithë

<sup>11</sup> Numri i Identifikimit Ndërmjetës Global (GIIN) është numri i identifikimit që i jepet disa institucioneve financiare raportuese nga Shërbimi Kombëtar i të Ardhurave (IRS) i Shteteve të Bashkuara.



bilanci ose vlera e llogarisë të mbajtur nga NFE-ja Pasive, si edhe të gjitha shumat e paguara ose të kredituara në llogari;

- llogarinë që mbahet nga një Mbajtës Llogarie që është Person i Raportueshëm dhe që është identifikuar se ka më shumë se një juridiksion rezidence, ku i gjithë bilanci ose vlera e llogarisë, si edhe e gjithë shuma e paguar ose e kredituar në llogari, duhet të raportohet lidhur me secilin juridiksion rezidence të Mbajtësit të Llogarisë;
- llogarinë që mbahet nga një NFE Pasive me një Person Kontrollues që është Person i Raportueshëm dhe që është identifikuar se ka më shumë se një juridiksion rezidence, ku i gjithë bilanci ose vlera e llogarisë të mbajtur nga NFE-ja Pasive, si edhe e gjitha shuma e paguar ose kredituar në llogari, duhet të raportohet lidhur me secilin juridiksion të rezidencës të Personit Kontrollues; ose
- llogarinë që mbahet nga një NFE Pasive e cila është një Person i Raportueshëm me një Person Kontrollues i cili është Person i Raportueshëm, ku i gjithë bilanci ose vlera e llogarisë të mbajtur nga NFE-ja Pasive, si edhe e gjithë shuma e paguar ose kredituar në llogari duhet të raportohet lidhur si me NFE-në Pasive dhe me Personin Kontrollues.

14. Në rastin e mbylljes së llogarisë, Institucioni Financiar Raportues nuk ka detyrimin të raportojë bilancin e llogarisë ose vlerën e saj përpara ose në momentin e mbylljes, por duhet të raportojë që llogaria është mbyllur. Për të përcaktuar se kur “mbyllet” një llogari, duhet marrë për bazë legjislacioni i zbatueshëm i juridiksionit të caktuar. Nëse legjislacioni në fuqi nuk i adreson mbylljet e llogarive, llogaria do të konsiderohet si e mbyllur në bazë të procedurave të funksionimit normal të Institucionit Financiar Raportues të cilat zbatohen vazhdimisht për të gjitha llogaritë që mbahen nga ky institucion. Për shembull, interesi në kapitalin neto ose borxh në një Institucion Financiar përgjithësisht do të konsiderohet i mbyllur menjëherë pas zgjidhjes, transferimit, mbylljes vullnetare, shlyerjes, anulimit ose likuidimit. Llogaria me bilanc ose vlerë të barabartë me zero ose që është negative nuk do të jetë një llogari e mbyllur vetëm për arsye të këtij bilanci ose kësaj vlere.

#### *Nënparagrafët A(4) deri në (7) – Periudha e përshtatshme e raportimit*

15. Informacioni që duhet raportuar duhet të jetë ai duke filluar nga fundi i vitit përkatës kalendarik ose një periudhe të përshtatshme raportimi. Për të përcaktuar se çfarë nënkuptohet me “periudhë të përshtatshme raportimi”, duhet të merret për bazë kuptimi që ka termi në atë kohë sipas rregullave të raportimit të secilit juridiksion, që mund të zbatohet vazhdimisht për një numër të arsyeshëm vitesh. Periudha ndërmjet datës më të fundit të përvjetorit të kontratës dhe datës së mëparshme të përvjetorit të kontratës (p.sh. në rastin e një Kontrate Sigurimi në Vlerë në Para të Gatshme), dhe viti fiskal i ndryshëm nga viti kalendarik, përgjithësisht do të konsiderohen periudha të përshtatshme raportimi.

#### *Nënparagrafi A(5)(a) – Të ardhura të tjera*

16. Informacioni që duhet të raportohet, në rastin e një Llogarie Kujdestarie, përfshin shumën totale bruto të të ardhurave të tjera të gjeneruara lidhur me aktivet e mbajtura në llogari, të paguara ose të kredituara në llogari (ose lidhur me llogarinë) gjatë vitit kalendarik ose një periudhe tjetër të përshtatshme raportimi. Termi “të ardhura të tjera” është çdo shumë që konsiderohet e ardhur në bazë të ligjeve të juridiksionit ku mbahet llogaria, e ndryshme nga çdo shumë që konsiderohet interes, dividend ose të ardhura bruto apo fitime neto kapitali nga shitja ose shlyerja e Aktiveve Financiare.

#### *Nënparagrafi A(5)(b) – Të ardhurat bruto*

17. Në rastin e një Llogarie Kujdestarie, informacioni që duhet të raportohet përfshin të ardhurat totale bruto nga shitja ose shlyerja e Aktiveve Financiare të paguara ose të kredituara në llogari gjatë

vitit kalendarik ose një periudhe tjetër të përshtatshme raportimi për të cilën Institucioni Financiar Raportues ka vepruar si kujdestar, broker, përfaqësues ose si agjent për Mbajtësin e Llogarisë. Termi “shitje ose shlyerje” është çdo shitje ose shlyerje e Aktiveve Financiare, e përcaktuar pa iu referuar faktit nëse pronari i këtyre Aktiveve Financiare është objekt i tatimeve lidhur me këtë shitje ose shlyerje.

18. Organizata e kliringut ose shlyerjes që mban Llogari të Raportueshme dhe shlyen/likuidon shitjet dhe blerjet e letrave me vlerë ndërmjet anëtarëve të kësaj organizate mbi baza neto mund të mos i dijë të ardhurat bruto nga shitjet ose likuidimet. Në rastin kur organizata e kliringut ose shlyerjes nuk i di të ardhurat bruto, këto të ardhura kufizohen në shumën neto të paguar ose kredituar në llogarinë e një anëtarë që lidhet me shitjet ose likuidime të tjera të Aktiveve Financiare nga ky anëtar duke filluar nga koha kur këto transaksione likuidohen sipas procedurave të likuidimit të kësaj organizate. Termi “organizatë kliringu ose shlyerjeje” është njësi ekonomike që ushtron aktivitetin e kliringut në tregtinë e letrave me vlerë për organizatat e saj anëtare dhe të transferimit, ose udhëzimit për transferimin e, letrave me vlerë përmes kreditit ose debitit në llogarinë e një anëtarë pa qenë e nevojshme që letrat me vlerë të dorëzohen fizikisht.

19. Lidhur me shitjen që kryhet nga brokeri e cila rezulton në pagesën e të ardhurave bruto, data në të cilën të ardhurat bruto konsiderohen të paguara është data kur të ardhurat nga kjo shitje kreditohen në llogarinë e, ose në të kundërt i vihen në dispozicion, personit që ka të drejtën të marrë pagesën.

20. Të ardhurat totale bruto nga shitja ose shlyerja e aktiveve është shuma totale e kryer si rezultat i shitjes ose shlyerjes së Aktiveve Financiare. Në rastin e shitjes së kryer nga brokeri, të ardhurat totale bruto nga shitja ose shlyerja është shuma totale e paguar ose e kredituar në llogarinë e personit që ka të drejtën e marrjes së pagesës e cila rritet nga çdo pagesë që nuk është paguar si e tillë për arsye të ripagimit të huave për investime; brokeri mund (por nuk i kërkohet që) të marrë komisione lidhur me shitjen në fjalë për të përcaktuar të ardhurat totale bruto. Në rastin e shitjes së interesit që mbart detyrim borxhi, të ardhurat bruto përfshijnë çdo interes të konstatuar ndërmjet datave për shlyerjen e interesit.

### *Nënparagrafi A(7) – Shumat bruto*

21. Informacioni që duhet të raportohet, në rastin e çdo llogarie të ndryshme nga Llogaria e Kujdestarisë ose Llogaria e Depozitës, përfshin shumë totale bruto të paguar ose kredituar të Mbajtësi i Llogarisë lidhur me llogarinë gjatë vitit kalendarik ose një periudhe tjetër të përshtatshme raportimi për të cilën Institucioni Financiar Raportues është kreditor ose debitor. Kjo “shumë bruto” përfshin, për shembull, shumën e totalizuar të:

- çdo shume shlyerjeje të kryer (plotësisht ose pjesërisht) të Mbajtësi i Llogarisë gjatë vitit kalendarik ose një periudhe tjetër të përshtatshme raportimi; dhe
- çdo shume të kryer të Mbajtësi i Llogarisë në bazë të Kontratës së Sigurimit në Vlerë në Para të Gatshme ose Kontratës së Pensionit Vjetor gjatë vitit kalendarik ose një periudhe tjetër të përshtatshme raportimi, pavarësisht se këto pagesa nuk konsiderohen Vlerë në Para të Gatshme në pajtim me nënparagrafin C(8) të seksionit VIII.

### *Skema e CRS-së dhe udhëzuesi i përdorimit*

22. Siç parashikohet në Marrëveshjen Model të Autoritetit Kompetent, Autoritetet Kompetente do të përdorin skemën e Standardit të Përbashkët të Raportimit për qëllime të shkëmbimit të informacionit që duhet raportuar. Skema mund të përdoret edhe nga Institucionet Financiare Raportuese për qëllime të raportimit të informacionit (në bazë të legjislacionit të brendshëm). Si paraqitja në formë diagrami e skemës dhe udhëzuesi i saj i përdorimit mund të gjenden në shtojcën 3. Udhëzuesi i përdorimit mund të jetë veçanërisht i dobishëm për Institucionet Financiare të Raportimit duke qenë se përmban më shumë informacion të detajuar për çdo element të dhënash dhe për çdo atribut që vlen për këto elemente të dhënash. Për shembull, udhëzuesi i përdorimit

përshkruan tre elementët e të dhënave që vlejné veçanërisht për vendin e lindjes (d.m.th. CountryInfo, City dhe CitySubentity) dhe qartëson se, kur kërkohet të raportohet vendi i lindjes, elementët e të dhënave CountryInfo (identifikuar përmes kodit ose emrit të shtetit) dhe City duhet të raportohen të dyja dhe elementi i të dhënave CitySubentity është fakultativ.

## **Paragrafi B – Monedha**

23. Informacioni duhet të raportohet në monedhën në të cilën është shprehur llogaria dhe informacioni i raportuar duhet të identifikojë monedhën në të cilën është shprehur çdo shumë. Në rastin e një llogarie të shprehur në më shumë se një monedhë, Institucioni Financiar Raportues mund të zgjedhë ta raportojë informacionin në monedhën në të cilën është shprehur llogaria dhe i kërkohet të identifikojë monedhën në të cilën është raportuar llogaria.

24. Nëse bilanci ose vlera e llogarisë financiare ose shuma të tjera janë shprehur në një monedhë të ndryshme nga monedha e përdorur nga Juridiksioni Pjesëmarrës kur zbaton Standardin e Përbashkët të Raportimit (për qëllime të pragut ose limitit), Institucioni Financiar Raportues duhet ta përlllogarisë bilancin ose vlerën duke aplikuar një kurs këmbimi të çastit (spot) për ta përkthyer këtë bilanc ose vlerë në monedhën ekuivalente. Për qëllime të raportimit të llogarisë nga Institucioni Financiar Raportues, kursi i këmbimit i çastit duhet të përcaktohet duke nisur nga dita e fundit e vitit kalendarik ose një periudhe tjetër të përshtatshme raportimi për të cilën po raportohet llogaria.

## **Paragrafët C deri në F – Përgjashtimet**

### *NIPT-i dhe data e lindjes*

25. Paragrafi C përmban një përjashtim që zbatohet për Llogaritë Paraekzistuese: NIPT-i ose data e lindjes nuk kërkohet të raportohet nëse (i) ky NIPT ose data e lindjes nuk është në regjistrat e Institucionit Financiar Raportues, dhe (ii) në bazë të legjislacionit të brendshëm nuk kërkohet që NIPT-i ose data e lindjes të mblidhet nga Institucioni Financiar Raportues. Pra, NIPT-i ose data e lindjes kërkohet të raportohet nëse:

- NIPT-i ose data e lindjes është në regjistrat e Institucionit Financiar Raportues (pavarësisht nëse ka apo jo një detyrim për ta pasur në regjistra); ose
- NIPT-i ose data e lindjes nuk është në regjistrat e Institucionit Financiar Raportues, por kërkohet që të mblidhet nga Institucioni Financiar Raportues në bazë të legjislacionit të brendshëm (p.sh. Procedurat për AML/KYC).

26. “Regjistrat” e Institucionit Financiar Raportues përfshijnë dosjen kryesore të klientit dhe informacionin e kërkueshëm në formë elektronike (shih paragrafin 34 më poshtë). “Dosja kryesore e klientit” përfshin skedarët parësorë të Institucionit Financiar Raportues për mbajtjen e informacionit për mbajtësin e llogarisë, si informacioni që përdoret për të kontaktuar mbajtësit e llogarisë dhe për të përmbushur Procedurat për AML/KYC. Përgjithësisht Institucionet Financiare Raportuese do të kenë një periudhë dy vjeçare për të përfunduar shqyrtimin e procedurave për identifikimin e Llogarive të Raportueshme ndërmjet Llogarive të Vlerës së Ulët (shih paragrafin 51 të Komentit për seksionin III) dhe, si rrjedhojë, fillimisht mund të shqyrtojnë regjistrat e tyre elektronike (ose të marrin NIPT-in apo datën e lindjes nga Mbajtësi i Llogarisë) dhe më pas të shqyrtojnë regjistrat manuale.

27. Gjithashtu, edhe kur Institucioni Financiar Raportues nuk e ka NIPT-in ose datën e lindjes për një Llogari Paraekzistuese në regjistrat e tij dhe nuk i kërkohet që ta mbledhë këtë informacion në bazë të legjislacionit të brendshëm, Institucioni Financiar Raportues i kërkohet të bëjë përpjekje të arsyeshme për të marrë NIPT-in dhe datën e lindjes lidhur me Llogaritë Paraekzistuese deri në fund të vitit të dytë kalendarik pas vitit në të cilin këto Llogari janë identifikuar si Llogari të Raportueshme, përveçse nëse ndonjëra prej përjashtimeve në paragrafin D zbatohet lidhur me NIPT-in dhe nuk kërkohet të raportohet.

28. “Përpyqje të arsyeshme” janë përpyqjet konkrete për të marrë NIPT-in dhe datën e lindjes së Mbajtësit të Llogarisë të një Llogarie të Raportueshme. Këto përpyqje duhet të bëhen, të paktën një herë në vit, gjatë periudhës ndërmjet identifikimi të Llogarisë Paraekzistuese si Llogari e Raportueshme dhe mbarimit të vitit të dytë kalendarik pas vitit të këtij identifikimi. Shembuj të përpyqjeve të arsyeshme përfshijnë kontaktimin e Mbajtësit të Llogarisë (p.sh. me postë, personalisht ose me telefon), duke përfshirë kërkesën të bërë si pjesë e dokumentacionit tjetër ose elektronikisht (p.sh. me faksimile ose email); dhe shqyrtimin e informacionit të kërkueshëm në formë elektronike që mbahet nga një Njësi Ekonomike e Lidhur e Institucionit Financiar Raportues, në pajtim me parimet e totalizimit të parashtruara në paragrafin C të seksionit VII. Sidoqoftë, përpyqjet e arsyeshme jo domosdoshmërisht kërkojnë mbylljen, bllokimin ose transferimin e llogarisë, dhe as kushtëzimin ose kufizimin e përdorimit të saj. Pavarësisht nga sa më lart, përpyqjet e arsyeshme mund të vijojnë të bëhen edhe pas periudhës së lartpërmendur.

29. Paragrafi D përmban një përjashtim që zbatohet si për Llogaritë Paraekzistuese dhe ato të Reja. NIPT-i nuk kërkohe të raportohet nëse:

- a) NIPT-i nuk lëshohet nga Juridiksioni përkatës Raportues; ose
- b) legjislacioni i brendshëm i Juridiksionit përkatës Raportues nuk kërkon mbledhjen e NIPT-it të lëshuar nga ky Juridiksion i Raportueshëm.

30. NIPT-i nuk konsiderohet se është lëshuar nga Juridiksioni Raportues (i) në rastin kur juridiksioni nuk lëshon një Numër të Identifikimit të Tatimpaguesit dhe as një ekuivalent funksional në mungesë të Numrit të Identifikimit të Tatimpaguesit (shih paragrafin 148 të Komentit për seksionin VIII), ose (ii) në rastin kur juridiksioni nuk ka lëshuar NIPT për një individ apo Njësi të caktuar Ekonomike. Si pasojë, NIPT-i nuk kërkohe të raportohet lidhur me një Llogari të Raportueshme që mbahet nga një Person i Raportueshëm i cili është rezident në këtë Juridiksion të Raportueshëm, ose lidhur me personin të cilit nuk i është lëshuar NIPT. Sidoqoftë, nëse dhe në momentin që Juridiksioni i Raportueshëm fillon të lëshojë NIPT-e dhe lëshon një NIPT për një Person të caktuar të Raportueshëm, nuk zbatohet më përjashtimi që ndodhet në paragrafin D dhe NIPT-i i Personit të Raportueshëm do të kërkohe të raportohet nëse Institucioni Financiar Raportues merr një vetëvërtetim që e përmban këtë NIPT, ose në të kundërt e merr këtë NIPT.

31. Përjashtimi i përshkruar në klauzolën (ii) të paragrafit D fokusohet në legjislacionin e brendshëm të juridiksionit të Mbajtësit të Llogarisë. Në rastin kur Juridiksioni i Raportueshëm ka lëshuar një NIPT për një Person të Raportueshëm që mban një Llogari të Raportueshme dhe mbledhja e këtij NIPT-i nuk mund të kërkohe sipas legjislacionit të brendshëm të këtij juridiksioni (p.sh. sepse sipas këtij legjislacioni dhënia e NIPT-it nga tatimpaguesi është mbi baza vullnetare), Institucionit Financiar Raportues që mban këtë llogari nuk i kërkohe ta marrë dhe raportojë NIPT-in. Sidoqoftë, Institucioni Financiar Raportues nuk e ka të ndaluar që të kërkojë dhe mbledhë NIPT-in e Mbajtësit të Llogarisë për qëllime raportimi nëse Mbajtësi i Llogarisë zgjedh që ta japë atë. Në këtë rast, Institucioni Financiar Raportues duhet ta raportojë NIPT-in. Në praktikë mund të ketë vetëm disa juridiksione ku ndodh kështu (p.sh. Australia).

32. Juridiksionet Pjesëmarrëse priten që t’u japin Institucioneve Financiare Raportuese informacion lidhur me lëshimin, mbledhjen dhe, për aq sa është e mundur dhe praktike, strukturën dhe specifikime të tjera të numrave të identifikimit të tatimpaguesit. OECD do të bëjë përpyqjet e saj për të lehtësuar shpërndarjen e tij.

### *Vendi i lindjes*

33. Paragrafi E përmban një përjashtim si për Llogaritë Paraekzistuese dhe ato të Reja: vendi i lindjes nuk kërkohe të raportohet përveçse nëse Institucionit Financiar Raportues i kërkohe ta marrë dhe raportojë atë në bazë të legjislacionit të brendshëm dhe ai është i disponueshëm në të dhënat e kërkueshme në formë elektronike që mbahen nga Institucioni Financiar Raportues. Kështu, vendi i lindjes kërkohe të raportohet nëse, lidhur me Mbajtësin përkatës të Llogarisë:

- institucionit Financiar Raportues i kërkohet ta marrë vendin e lindjes dhe raportojë atë në bazë të legjislacionit të brendshëm; dhe
- vendi i lindjes është i disponueshëm në informacionin e kërkueshëm në formë elektronike që mbahet nga Institucioni Financiar Raportues.

34. Termi “të dhëna/informacion i kërkueshëm në formë elektronike” është informacioni që Institucioni Financiar Raportues e mban në dosjet e tij të raportimit tatimor, dosjet kryesore të klientit ose dosje të ngjashme, dhe që ruhet në formën e një baze të dhënash elektronike ku mund të përdoren kërkime standarde në gjuhët e programimit si Gjuha e Strukturuar e Kërkimit. Informacioni, të dhënat ose dosjet nuk kërkohen në formë elektronike vetëm sepse ruhen në një sistem me tërheqje imazhi (si formati portativ i dokumentit (.pdf) ose dokumente të skanuara). “Raportimi” për këtë qëllim nuk përfshin informacionin që jepet vetëm me kërkesë.

### *Të ardhurat bruto*

35. Paragrafi F përmban një përjashtim lidhur me vitin që duhet raportuar informacioni. Mund të jetë më e vështirë për Institucionet Financiare Raportuese që të zbatojnë procedurat për të marrë të ardhurat totale bruto nga shitja ose shlyerja e Aktiveve Financiare. Prandaj, kur zbatojnë Standardin e Përbashkët të Raportimit, juridiksionet mund të marrin në konsideratë (nëse është e nevojshme) që të fusin në mënyrë graduale raportimin e këtyre të ardhurave bruto. Në atë rast, dispozita kalimtare do të hartohet si paragrafi F.



## Koment për seksionin II lidhur me kërkesat e përgjithshme të verifikimit të duhur

1. Ky seksion përmban rregullat e përgjithshme të verifikimit të duhur. Ai gjithashtu trajton mbështetjen tek ofruesit e shërbimeve dhe procedurat alternative të verifikimit të duhur për Llogaritë Paraekzistuese.

### Paragrafët A deri në C – Kërkesat e përgjithshme të verifikimit të duhur

2. Llogaria trajtohet si Llogari e Raportueshme, sipas paragrafit A, duke filluar në datën që identifikohet si e tillë sipas procedurave të verifikimit të duhur në seksionet II deri në VII. Pasi llogaria të jetë Llogari e Raportueshme, ajo e mban këtë status deri në datën në të cilën pushon së qeni një Llogari e Raportueshme (p.sh. për shkak se Mbajtësi i Llogarisë pushon së qeni një Person i Raportueshëm ose llogaria bëhet një Llogari e Përrjashtuar, mbyllet ose transferohet në tërësinë e saj), edhe nëse bilanci ose vlera e llogarisë është e barabartë me zero ose negative, ose nëse nuk ka pasur asnjë shumë të paguar ose kredituar në llogari (ose lidhur me llogarinë). Në rastin kur llogaria identifikohet si Llogari e Raportueshme bazuar në statusin e saj në fund të vitit kalendarik ose periudhës së raportimit, informacioni për atë llogari duhet të raportohet sikur të ishte Llogari e Raportueshme përgjatë të gjithë vitit kalendarik ose periudhës së raportimit në të cilën është identifikuar si e tillë. Në rastin kur Llogaria e Raportueshme mbyllet, informacioni për këtë llogari duhet të raportohet deri në datën e mbylljes. Përveçse nëse parashikohet ndryshe, informacioni për Llogarinë e Raportueshme duhet të raportohet çdo vit në vitin kalendarik pas vitit me të cilin lidhet informacioni.

3. Shembujt vijues ilustrojnë në terma të përgjithshëm zbatimin e paragrafit A:

- Shembulli 1 (Llogaria që bëhet Llogari e Raportueshme): Llogaria hapet më 28 maj 00 dhe identifikohet si Llogari e Raportueshme më 3 dhjetor 01. Duke qenë se llogaria u identifikua si Llogari e Raportueshme në vitin kalendarik 01, informacioni për atë Llogari të Raportueshme duhet të raportohet në vitin kalendarik 02 për vitin e plotë kalendarik 01 dhe çdo vit pas atij viti.
- Shembulli 2 (Llogaria që pushon së qeni Llogari e Raportueshme): Faktet janë njësoj si në shembullin 1. Megjithatë, më 24 mars 02, Mbajtësi i Llogarisë pushon se qeni një Person i Raportueshëm dhe, si rrjedhojë, llogaria pushon së qeni një Llogari e Raportueshme. Për shkak se llogaria pushon se qeni Llogari e Raportueshme më 24 mars 02, informacioni për këtë llogari nuk kërkohet të raportohet në vitin kalendarik 03 dhe as më pas, përveçse nëse llogaria bëhet sërish Llogari e Raportueshme në vitin kalendarik 03 ose në ndonjë vit kalendarik pasues.
- Shembulli 3 (Llogaria që mbyllet): Llogaria hapet më 9 shtator 04 dhe bëhet Llogari e Raportueshme më 8 shkurt 05. Sidoqoftë, më 27 shtator 05, Mbajtësi i Llogarisë e mbyll llogarinë. Për shkak se llogaria ishte Llogari e Raportueshme ndërmjet datës 8 shkurt dhe 27 shtator 05 dhe u mbyll në vitin kalendarik 05, informacioni lidhur me këtë llogari (duke përfshirë edhe mbylljen e llogarisë) duhet të raportohet në vitin kalendarik 06 për pjesën e vitit kalendarik 05 ndërmjet datës 1 janar dhe 27 shtator.
- Shembulli 4 (Llogaria që pushon së qeni një Llogari e Raportueshme dhe mbyllet): Faktet janë njësoj si një shembullin 2, me përjashtim të faktit se më 4 korrik 02 Mbajtësi i Llogarisë e mbyll llogarinë. Për shkak se llogaria pushoi së qeni Llogari e Raportueshme më 24 mars 02, informacioni lidhur me atë llogari nuk kërkohet të raportohet në vitin kalendarik 03.



4. Ndërsa bilanci ose vlera e një llogarie është pjesë e informacionit që duhet të raportohet, ajo gjithashtu është e rëndësishme për qëllime të tjera, si procedurat e verifikimit të duhur për Llogaritë Paraekzistuese të Njësive Ekonomike (shih paragrafët A dhe B, dhe nënparagrafin E(1) dhe (2) të seksionit V) dhe rregullat për totalizimin e bilancit të llogarisë (shih nënparagrafët C(1) dhe (2) të seksionit VII). Sipas paragrafit B, bilanci ose vlera e llogarisë duhet të përcaktohet duke filluar nga data e fundit e vitit kalendarik ose një periudhe tjetër të përshtatshme raportimi.

5. Ndërsa pragu i bilancit ose vlerës do të përcaktohet duke filluar nga data e fundit e vitit kalendarik (shih, p.sh. nënparagrafin C(6) të seksionit III, dhe paragrafët A dhe B të seksionit V), sipas paragrafit C, bilanci ose vlera përkatëse duhet të përcaktohet duke filluar nga data e fundit e periudhës së raportimit që mbaron me ose brenda vitit kalendarik. Kështu që, nëse periudha e raportimit mbaron me vitin kalendarik, atëherë bilanci ose vlera përkatëse duhet të përcaktohet duke filluar më 31 dhjetor të vitit kalendarik. Sidoqoftë, nëse periudha e raportimit mbaron brenda vitit kalendarik, atëherë bilanci ose vlera përkatëse duhet të përcaktohet duke filluar nga dita e fundit e periudhës së raportimit, por brenda vitit kalendarik.

#### **Paragrafi D – Mbështetja tek ofruesit e shërbimeve**

6. Sipas paragrafit D, çdo juridiksion mund t'i lejojë Institucionet Financiare Raportuese që të përdorin ofrues shërbimesh për të përmbushur detyrimet e raportimit dhe të verifikimit të duhur të vendosura mbi këto Institucione Financiare Raportuese (p.sh. juridiksioni mund t'i lejojë Institucionet Financiare Raportuese që të mbështeten te procedurat e verifikimit të duhur të kryera nga ofruesit e shërbimeve). Në këto raste, Institucionet Financiare Raportuese duhet të përmbushin kërkesat që përmban legjislacioni i brendshëm dhe të mbajnë përgjegjësi për detyrimet e tyre të raportimit dhe verifikimit të duhur (d.m.th. veprimet e ofruesve të shërbimeve i ngarkohen Institucionit Financiar Raportues), duke përfshirë edhe detyrimet e tyre në kuadrin e legjislacionit të brendshëm për konfidencialitetin dhe mbrojtjen e të dhënave. Kjo alternativë e lejon Institucionin Financiar Raportues që të përdorë një ofrues shërbimesh i cili është rezident në të njëjtin juridiksion apo në një juridiksion të ndryshëm si Institucioni Financiar Raportues. Gjithashtu, kjo nuk ndryshon kohën dhe mënyrën e detyrimeve të raportimit dhe verifikimit të duhur, të cilat mbeten njësoj sikur të ishin ende duke u përmbushur nga Institucioni Financiar Raportues. Për shembull, ofruesi i shërbimeve duhet ta raportojë informacionin ashtu siç do të kishte bërë Institucioni Financiar Raportues (p.sh. për të njëjtin juridiksion) dhe duhet të identifikojë Institucionin Financiar Raportues për të cilin po përmbush detyrimet e raportimit dhe verifikimit të duhur.

7. Shembulli vijues ilustron zbatimin e paragrafit D: Njësia Ekonomike e Investimeve P është një fond i përbashkët i menaxhuar nga menaxheri i Fondit M i cili është rezident në Juridiksionin Pjesëmarrës B dhe nuk kualifikohet si Instrument i Investimeve Kolektive i Përrjashtuar. Juridiksioni Pjesëmarrës B i lejon Institucionet e Raportimit Financiar që të përdorin ofrues shërbimesh për të përmbushur të gjitha detyrimet e tyre lidhur me CRS-në. Për shkak se Njësia Ekonomike e Investimeve P është një Institucion Financiar Raportues në Juridiksionin Pjesëmarrës B, Njësia Ekonomike e Investimeve P mund të përdorë menaxherin e Fondit M për të kryer procedurat e verifikimit të duhur dhe për të përmbushur detyrimet e saj të raportimit ose të tjera që lidhen me CRS-në.

#### **Paragrafi E – Procedurat alternative dhe të verifikimit të duhur për Llogaritë Paraekzistuese**

8. Sipas paragrafit E, secili juridiksion mund t'i lejojë Institucionet Financiare Raportuese që të zbatojnë (i) procedurat e verifikimit të duhur për Llogaritë e Reja deri te Llogaritë Paraekzistuese, dhe (ii) procedurat e verifikimit të duhur për Llogaritë e Vlerës së Lartë deri te Llogaritë e Vlerës së Ulët. Ai mund t'i lejojë gjithashtu Institucionet Financiare Raportuese ta bëjnë këtë zgjedhje

qoftë lidhur me të gjitha Llogaritë Paraekzistuese përkatëse ose, veçmas, lidhur me çdo grup të identifikuar qartë të këtyre llogarive (si për shembull sipas linjës së biznesit ose vendndodhjes ku mbahet llogaria).

9. Në rastin kur juridiksioni lejon përdorimin e procedurave të verifikimit të duhur për Llogaritë e Reja për ato Paraekzistuese, rregullat e zbatueshme për Llogaritë Paraekzistuese vijojnë të zbatohen. Prandaj, Institucioni Financiar Raportues mund të zbatojë procedurat e verifikimit të duhur për Llogaritë e Reja pa hequr dorë nga dispozitat lehtësuese që zbatohen për Llogaritë Paraekzistuese, si paragrafët C të seksionit I, A të seksionit III dhe A të seksionit V, të cilat vijojnë të zbatohen në këto rrethana. Gjithashtu, në pajtim me nënparagrafin B(1) të seksionit III, raportimi i një rezidence të vetme për Llogarinë Paraekzistuese Individuale mjafton për të përmbushur kërkesat e raportimit të seksionit I.

## Koment për seksionin III lidhur me Verifikimin e Duhur për Llogaritë Paraekzistuese Individuale

1. Ky seksion përmban procedurat e verifikimit të duhur për qëllime të identifikimit të Llogarive të Raportueshme ndërmjet atyre Paraekzistuese Individuale. Ai bën dallimin ndërmjet Llogarive të Vlerës së Ulët dhe Llogarive të Vlerës së Lartë.

### Paragrafi A – Llogaritë që nuk kërkohen të shqyrtohen, identifikohen ose raportohen

2. Paragrafi A përjashton nga shqyrtimi të gjitha Llogaritë Paraekzistuese Individuale që janë Kontrata Sigurimi në Vlerë në Para të Gatshme dhe Kontrata Pensioni Vjetor, me kusht që Institucioni Financiar Raportues ta ketë të ndaluar në mënyrë efikase me ligj shitjen e këtyre kontratave për rezidentët e Juridiksionit të Raportueshëm. Institucioni Financiar Raportues e “ka të ndaluar me efikasitet me ligj” shitjen e Kontratave të Sigurimit në Vlerë në Para të Gatshme ose të Kontratave të Pensionit Vjetor për rezidentët e Juridiksionit të Raportueshëm nëse:

- a) ligji i juridiksionit të Institucionit Financiar Raportues e ndalon ose në të kundërt e parandalon në mënyrë efikase shitjen e këtyre kontratave për rezidentët e një juridiksioni tjetër; ose
- b) ligji i një Juridiksioni të Raportueshëm e ndalon ose në të kundërt e parandalon në mënyrë efikase shitjen e këtyre kontratave për rezidentët e këtij Juridiksioni të Raportueshëm nga Institucioni Financiar Raportues.

3. Në rastin kur legjislacioni i zbatueshëm nuk i ndalon Institucionet Financiare Raportuese të shesin kontratat e sigurimit ose të pensionit vjetor menjëherë, por u kërkon atyre që të përmbushin disa kushte përpara se të jenë të aftë t'i shesin këto kontrata për rezidentët e Juridiksionit të Raportueshëm (si marrja e një licence dhe regjistrimi i kontratave), Institucioni Financiar Raportues që nuk i ka përmbushur kushtet e kërkuara sipas legjislacionit të zbatueshëm do të konsiderohet se është “i ndaluar me efikasitet nga ligji” të shesë këto kontrata te rezidentët e këtij Juridiksioni të Raportueshëm.

### Paragrafi B – Verifikimi i duhur për Llogaritë e Vlerës së Ulët

4. Paragrafi B përmban procedurat që zbatohen për Llogaritë e Vlerës së Ulët. Këto procedura janë testi i adresës së rezidencës dhe kërkimi elektronik i të dhënave.

5. Kur zbatojnë Standardin e Përbashkët të Raportimit, juridiksionet mund t'i lejojnë Institucionet Financiare Raportuese që të zbatojnë (i) qoftë testin e adresës së rezidencës ose kërkimit elektronik të të dhënave të parashtruar në nënparagrafët B(2) deri në (6), ose (ii) vetëm kërkimin elektronik të të dhënave. Në rastin e parë, juridiksionet mund t'i lejojnë gjithashtu Institucionet Financiare të Raportimit të bëjnë një zgjedhje që të zbatojnë testin e adresës së rezidencës si lidhur me Llogaritë e Vlerës së Ulët ose, veçmas, për çdo grup të identifikuar qartë të këtyre llogarive (si për shembull sipas linjës së biznesit ose vendndodhjes ku mbahet llogaria).

6. Në rastin kur legjislacioni i brendshëm i lejon Institucionet Financiare Raportuese që të zbatojnë testin e adresës së rezidencës dhe Institucioni Financiar Raportues zgjedh që ta zbatojë atë, Institucioni Financiar Raportues duhet ta zbatojë këtë test lidhur me çdo Llogari të Vlerës së Ulët ose grup të identifikuar qartë të këtyre llogarive (siç lejohet nga legjislacioni i brendshëm). Nëse Institucioni Financiar Raportues vendos të mos e zbatojë testin ose një apo më shumë prej kërkesave të testit nuk përmbushen, atëherë duhet të kryejë kërkimin elektronik e të dhënave për Llogarinë e Vlerës së Ulët.

*Nënparagrafi B(1) – Testi i adresës së rezidencës*

7. Nënparagrafi B(1) përmban testin e “adresës së rezidencës”. Sipas këtij testi, Institucioni Financiar Raportues duhet të ketë politika dhe procedura për të verifikuar adresën e rezidencës mbështetur në Evidencat Shkresore. Për qëllime të përcaktimit nëse një Mbajtës individual Llogarie është Person i Raportueshëm, Institucioni Financiar Raportues mund ta trajtojë këtë individ si rezident për qëllime tatimore të juridiksionit në të cilin ndodhet adresa nëse:

- a) Institucioni Financiar Raportues ka në regjistrat e tij një adresë rezidence për Mbajtësin individual të Llogarisë;
- b) kjo adresë rezidence është aktuale; dhe
- c) kjo adresë rezidence mbështetet në Evidencat Shkresore.

8. Kërkesa e parë është që Institucioni Financiar Raportues të ketë në regjistrat e tij një adresë rezidence për Mbajtësin individual të Llogarisë (shih paragrafin 26 të Komentit për seksionin I). Përgjithësisht, adresa “në vëmendje të” ose kutia postare nuk është një adresë rezidence. Sidoqoftë, kutia postare përgjithësisht do të konsiderohet adresë rezidence në rastin kur është pjesë e një adrese së bashku me, p.sh. rrugën, numrin e apartamentit ose të suitës, ose rrugën rurale, dhe kështu identifikon qartë rezidencën aktuale të Mbajtësit të Llogarisë. Po kështu, në rrethana të veçanta si rasti i personelit ushtarak, adresa “në vëmendje të” mund të përbëjë një adresë rezidence. Juridiksionet që zbatojnë Standardin e Përbashkët të Raportimit mund të përcaktojnë rrethana të tjera të veçanta kur një adresë “në vëmendje të” ose kuti postare mund të përdoren për të identifikuar qartë një adresë rezidence, me kusht që ky përcaktim nuk cenon qëllimet e Standardit të Përbashkët të Raportimit.

9. Kërkesa e dytë është që adresa e rezidencës në regjistrat e Institucionit Financiar Raportues të jetë aktuale. Adresa e rezidencës konsiderohet si “aktuale” në rastin kur është adresa më e fundit e rezidencës që është regjistruar nga Institucioni Financiar Raportues për Mbajtësin individual të Llogarisë. Sidoqoftë, adresa e rezidencës nuk konsiderohet si “aktuale” nëse është përdorur për qëllime postare dhe posta është kthyer e padorëzuar në adresën e dhënë (me përjashtim të rastit kur ka një gabim). Pavarësisht nga sa më sipër, adresa e rezidencës e lidhur me një llogari që është llogari e fjetur do të konsiderohet si “aktuale” gjatë periudhës së fjetjes. Llogaria (e ndryshme nga Kontrata e Pensionit Vjetor) konsiderohet si “llogari e fjetur” nëse (i) Mbajtësi i Llogarisë nuk ka filluar një transaksion lidhur me llogarinë ose çdo llogari tjetër të mbajtur nga Mbajtësi i Llogarisë me Institucionin Financiar Raportues në tre vitet e fundit; (ii) Mbajtësi i Llogarisë nuk ka komunikuar me Institucionin Financiar Raportues që e mban këtë llogari lidhur me llogarinë ose çdo llogari tjetër të mbajtur nga Mbajtësi i Llogarisë në Institucionin Financiar Raportues në gjashtë vitet e fundit; dhe (iii) në rastin e Kontratës së Sigurimit në Vlerë në Para të Gatshme, Institucioni Financiar Raportues nuk ka komunikuar me Mbajtësin e Llogarisë që e mban këtë llogari lidhur me llogarinë ose çdo llogari tjetër të mbajtur nga Mbajtësi i Llogarisë në Institucionin Financiar Raportues në gjashtë vitet e fundit. Po kështu, llogaria (e ndryshme nga Kontrata e Pensionit Vjetor) gjithashtu mund të konsiderohet si “llogari e fjetur” në bazë të legjislacionit të zbatueshëm ose rregulloreve apo procedurave të funksionimit normal të Institucionit Financiar Raportues që zbatohen vazhdimisht për të gjitha llogaritë që mbahen nga ky institucion në një juridiksion të caktuar, me kusht që këto ligje ose rregullore apo procedura të përmbajnë kërkesa të ngjashme në thelb me ato në fjalinë e parë. Llogaria pushon së qeni llogari e fjetur kur (i) Mbajtësi i Llogarisë ndërmerr një transaksion lidhur me llogarinë ose çdo llogari tjetër të mbajtur nga Mbajtësi i Llogarisë në Institucionin Financiar Raportues; (ii) Mbajtësi i Llogarisë komunikon me Institucionin Financiar Raportues që e mban këtë llogari lidhur me llogarinë ose çdo llogari tjetër që mbahet nga Mbajtësi i Llogarisë në Institucionin Financiar Raportues; ose (iii) llogaria pushon së qeni një llogari e fjetur në bazë të ligjeve të zbatueshme ose rregulloreve apo procedurave të funksionimit normal të Institucionit Financiar Raportues.

10. Kërkesa e tretë është që adresa aktuale e rezidencës në regjistrat e Institucionit Financiar Raportues bazohet në Evidencat Shkresore (shih paragrafët 150-162 të Komentit për

seksionin VIII). Kjo kërkesë përmbushet nëse politikat dhe procedurat e Institucionit Financiar Raportues garantojnë që adresa aktuale e rezidencës në regjistrat e tij është e njëjta adresë, ose në të njëjtin juridiksion, si ajo në Evidencat Shkresore (p.sh. karta e identitetit, leja e drejtimit, karta e votuesit ose certifikata e rezidencës). Kërkesa e tretë gjithashtu përmbushet nëse politikat dhe procedurat e Institucionit Financiar Raportues garantojnë se kur ka Evidenca Shkresore të lëshuara nga qeveria, por këto Evidenca Shkresore nuk përmbajnë një adresë rezidence të fundit ose nuk përmbajnë asnjë adresë (p.sh. pasaporta të caktuara), adresa aktuale e rezidencës në regjistrat e Institucionit Financiar Raportues është e njëjta, ose në të njëjtin juridiksion, si ajo në dokumentacionin më të fundit të lëshuar nga një organ qeveritar i autorizuar ose shoqëri shërbimesh utilitare, ose në një deklaratë të Mbajtësit individual të Llogarisë nën penalitetin e dëshmisë së rreme. Dokumentacioni i pranueshëm që lëshohet nga organi qeveritar i autorizuar përfshin, për shembull, njoftimet ose vlerësimet zyrtare nga administrata tatimore. Dokumentacioni i pranueshëm që lëshohet nga shoqëritë e shërbimeve utilitare lidhet me shërbime për një pronë të caktuar dhe përfshin faturën e ujit, energjisë elektrike, telefonit (vetëm linjën fikse), gazit ose naftës. Deklarata e Mbajtësit individual të Llogarisë nën penalitetin e dëshmisë së rreme pranohet vetëm nëse (i) Institucionit Financiar Raportues i kërkohet që ta mbledhë në bazë të legjislacionit të brendshëm për disa vite; (ii) ajo mban adresën e rezidencës së Mbajtësit të Llogarisë; dhe (iii) është datuar dhe nënshkruar nga Mbajtësi individual i Llogarisë nën penalitetin e dëshmisë së rreme. Në rrethana të tilla, standardet e njohurisë të zbatueshme për Evidencat Shkresore do të zbatohen edhe për dokumentacionin në të cilin mbështetet Institucioni Financiar Raportues (shih paragrafët 2-3 të Komentit për seksionin VII). Po kështu, Institucioni Financiar Raportues mund ta përmbushë kërkesën e tretë nëse politikat dhe procedurat e tij garantojnë se juridiksioni në adresën e rezidencës korrespondon me juridiksionin e lëshimit të Evidencave Shkresore të lëshuara nga qeveria.

11. Gjithashtu mund të ketë llogari të hapura në një kohë kur nuk kishte kërkesa për AML/KYC dhe si rrjedhojë Institucioni Financiar Raportues nuk i ka shqyrtuar Evidencat Shkresore në procesin fillestar të hapjes. Rekomandimet e FATF-së, të cilat parashtrojnë standardet ndërkombëtare për luftën kundër pastrimit të parave dhe përfshijnë kërkesat për verifikimin e identitetit të klientëve mbi bazën e burimeve të pavarura të besueshme, u përdoren për herë të parë në vitin 1990 dhe u rishikuan në vijim në vitet 1996, 2003 dhe 2012.<sup>12</sup> Edhe për llogaritë e hapura përpara futjes së këtyre kërkesave dhe që janë “përrjashtuar” nga rregullat, ka një kërkesë për të zbatuar masat e verifikimit të duhur për klientin për klientët ekzistues mbi bazën e materialitetit dhe rrezikut. Gjithashtu, për Llogaritë e Raportueshme që janë Llogari Paraekzistuese, Institucioneve Financiare Raportuese tashmë u kërkohet të bëjnë përpjekjet e arsyeshme dhe të kontaktojnë klientët e tyre për të marrë NIPT-in dhe datën e lindjes së tyre (objekt i zbatimit të paragrafëve C dhe D të seksionit I). Është e pritshme që këto kontakte do të përdoren edhe për kërkimin e Evidencave Shkresore. Si rezultat, rastet e këtyre llogarive pa Evidenca Shkresore duhet të jenë përjashtimore, lidhen me llogaritë me rrezik të ulët dhe prekin llogaritë e hapura përpara vitit 2004. Në këto rrethana, kërkesa e tretë që përmban nënparagrafi B(1) mund të përmbushet edhe nëse politikat dhe procedurat e Institucionit Financiar Raportues garantojnë se adresa aktuale e rezidencës në regjistrat e tij është në të njëjtin juridiksion (i) si ai i adresës në dokumentacionin më të fundit të mbledhur nga ky Institucion Financiar Raportues (p.sh. fatura e shërbimeve utilitare, qiraja e pasurisë së paluajtshme ose deklarata nga Mbajtësi individual i Llogarisë nën penalitetin e dëshmisë së rreme); dhe (ii) si ai i raportuar nga Institucioni Financiar Raportues lidhur me Mbajtësin individual të Llogarisë në kuadrin e çdo kërkesë tjetër raportimi tatimor të zbatueshme (nëse ka). Po kështu, për të përmbushur kërkesën e tretë në rrethanat e lartpërmendura, në rastin e një Kontrate Sigurimi në Vlerë në Para të Gatshme, Institucioni Financiar Raportues mund të mbështetet në adresën aktuale të rezidencës në regjistrat e tij deri (i) kur ndodh një ndryshim

<sup>12</sup> FATF/OECD (2013), Standardet Ndërkombëtare për Luftën kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit dhe Përhapjes së Terrorizmit, Rekomandimet e FATF-së, shkurt 2012, FATF/OECD, Paris, gjendet në [www.fatf-gafi.org/media/fatf/documents/recommendations/pdfs/FATF\\_Recommendations.pdf](http://www.fatf-gafi.org/media/fatf/documents/recommendations/pdfs/FATF_Recommendations.pdf).



në rrethana që e bën Institucionin Financiar Raportues të marrë dijeni ose të ketë arsye për të marrë dijeni se kjo adresë rezidence është e pasaktë ose e pabesueshme, ose (ii) në momentin e shlyerjes (të plotë ose të pjesshme) apo maturimit të Kontratës së Sigurimit në Vlerë në Para të Gatshme. Shlyerja ose maturimi i kësaj kontrate do të përbëjë një ndryshim në rrethana dhe do të aktivizojë procedurat përkatëse (shih paragrafin 13 më poshtë).

12. Shembujt vijues ilustrojnë zbatimin e politikave dhe procedurave të Institucioneve Financiare Raportuese lidhur me nënparagrafin B(1):

- Shembulli 1 (Karta e identitetit): M, një bankë e cila është Institucion Financiar Raportues, ka politika dhe procedura, sipas të cilave ka mbledhur një kopje të kartës së identitetit të të gjitha Llogarive të tij

Paraekzistuese Individuale dhe në bazë të të cilave ai garanton se adresa aktuale e rezidencës në regjistrat e tij për ato llogari është në të njëjtin juridiksion si adresa në kartën e tyre të identitetit. M mund t'i trajtojë këta Mbajtës Llogarish si rezidentë për qëllime tatimore të juridiksionit në të cilin ndodhet kjo adresë.

- Shembulli 2 (Pasaporta dhe fatura e shërbimeve utilitare): M ka procedura për hapjen e llogarisë sipas të cilave ai mbështetet te pasaporta e Mbajtësit të Llogarisë për të konfirmuar identitetin e Mbajtësit të Llogarisë dhe në faturat më të fundit të shërbimeve utilitare për të verifikuar adresën e tyre të rezidencës, siç janë regjistruar në sistemet e M-së. M mund t'i trajtojë Mbajtësit e tij të Llogarive Paraekzistuese Individuale si rezidentë për qëllime tatimore të juridiksionit të regjistruar në sistemet e tij.
- Shembulli 3 (Fatura e shërbimeve utilitare me detyrime raportimi): H, një bankë e cila është një Institucion Financiar Raportues, ka një sërë llogarish të hapura përpara vitit 1990 të cilat janë përjashtuar nga zbatimi i Procedurave për AML/KYC dhe rregullat e lidhura me to për materialitetin dhe rrezikun nuk kanë kërkuar ridokumentim të këtyre llogarive. H ka në regjistrat e tij një adresë aktuale rezidence për këto llogari e cila mbështetet nga faturat e shërbimeve utilitare të mbledhura pas hapjes së llogarisë. Kjo adresë është gjithashtu e njëjta adresë me atë të raportuar në mënyrë periodike nga H lidhur me ato llogari në bazë të detyrimeve të tij të raportimit tatimor jo të CRS-së. Për shkak se regjistrat e H-së nuk përmbajnë Evidenca Shkresore të lidhura me këto llogari dhe H-së nuk i kërkohet t'i mbledhë ato në bazë të Procedurave për AML/KYC, dhe adresa aktuale e rezidencës në regjistrat e H-së është e njëjtë me atë në shumicën e dokumentacionit më të fundit të mbledhur nga H dhe me atë të raportuar nga H në bazë të detyrimeve të tij të raportimit tatimor jo të CRS-së, H mund t'i trajtojë Mbajtësit e tij të Llogarisë si rezidentë për qëllime tatimore të juridiksionit në të cilin ndodhet kjo adresë.

13. Nëse Institucioni Financiar Raportues është mbështetur në testin e adresës së rezidencës të përshkruar në nënparagrafin B(1) dhe ka një ndryshim në rrethana (shih paragrafin 17 më poshtë) që e bën Institucionin Financiar Raportues të dijë ose të ketë arsye të dijë se Evidencat Shkresore origjinale (ose dokumentet e tjera siç përshkruhen në paragrafin 10 më lart) janë të pasakta ose të pabesueshme, Institucioni Financiar Raportues duhet që, nga dita më e fundit e vitit kalendarik ose një periudhe tjetër të përshtatshme raportimi, ose 90 ditë kalendarike pas njoftimit ose zbulimit të këtij ndryshimi në rrethana, të marrë një vetëvërtetim dhe Evidenca të reja Shkresore për të përcaktuar rezidencat për qëllime tatimore të Mbajtësit të Llogarisë. Nëse Institucioni Financiar Raportues nuk mund ta marrë vetëvërtetimin dhe Evidencat e reja Shkresore deri në këtë datë, Institucioni Financiar Raportues duhet të zbatojë procedurën e kërkimit elektronik të të dhënave të përshkruar në nënparagrafët B(2) deri në (6). Shembujt vijues ilustrojnë procedurat që duhen ndjekur në rast ndryshimi në rrethana:

- Shembulli 1: I, një bankë e cila është një Institucion Financiar Raportues, është mbështetur në testin e adresës së rezidencës për të trajtuar Mbajtësin individual të



Llogarisë, P, si rezident i Juridiksionit të Raportueshëm X. Pas pesë vitesh, P i komunikon I se është zhvendosur në juridiksionin Y, që gjithashtu është një Juridiksion i Raportueshëm dhe jep adresën e tij të re. I merr nga P një vetëvërtetim dhe Evidenca të reja Shkresore se ai është rezident për qëllime tatimore në juridiksionin Y. I duhet ta trajtojë P si rezident të Juridiksionit të Raportueshëm Y.

- Shembulli 2: Faktet janë njësoj si në shembullin 1, me përjashtim të faktit se I nuk merr një vetëvërtetim nga P. I duhet të zbatojë procedurën e kërimit elektronik të të dhënave të përshkruar në nënparagrafët B(2) deri në (6) dhe, si rezultat, duhet ta trajtojë P të paktën si rezident të juridiksionit Y (bazuar në adresën e re të dhënë nga Mbajtësi i Llogarisë).

### *Nënparagrafët B(2) deri në (6) – Kërkimi elektronik i të dhënave*

14. Nënparagrafët B(2) deri në (6) përshkruajnë procedurën e “kërimit të regjistrat elektronik”. Sipas kësaj procedure, Institucioni Financiar Raportues duhet të shqyrtojë të dhënat e kërkueshme në formë elektronike që mbahen nga Institucioni Financiar Raportues për secilën nga indiciet e përshkruara nga nënparagrafin B(2).

15. Nënparagrafi B(3) qartëson se nëse asnjë prej indicieve të renditura në nënparagrafin B(2) nuk zbulohen gjatë kërimit elektronik, nuk nevojiten veprime të mëtejshme deri në momentin që ka ndryshim në rrethana që rezultojnë në një ose më shumë indicie të lidhura me llogarinë, ose kur llogaria bëhet një Llogari e Vlerës së Lartë.

16. Nëse gjatë kërimit elektronik zbulohet ndonjë prej indicieve të renditura në nënparagrafin B(2)(a) deri në (e), apo nëse ka ndryshim në rrethana të cilat rezultojnë në një ose më shumë indicie të lidhura me llogarinë, atëherë sipas nënparagrafit B(4), Institucioni Financiar Raportues duhet ta trajtojë Mbajtësin e Llogarisë si rezident për qëllime tatimore të secilit prej Juridiksioneve të Raportueshme për të cilin është identifikuar një indicie, përveçse nëse ai zgjedh të zbatojë procedurën e korrigjimit të përshkruar në nënparagrafin B(6) dhe një nga përjashtimet në këtë nënparagraf zbatohet lidhur me atë llogari. Megjithatë, në rast ndryshimi në rrethana, Institucioni Financiar Raportues mund të zgjedhë ta trajtojë personin si person me të njëjtin status me atë që kishte përpara ndryshimit në rrethana deri në ditën më të fundit të vitit përkatës kalendarik ose një periudhe tjetër të përshtatshme raportimi ose 90 ditë kalendarike pas datës kur është identifikuar indicia për shkak të ndryshimit në rrethana.

17. “Ndryshimi në rrethana” përfshin çdo ndryshim që rezulton në shtimin e informacionit përkatës për statusin e personit ose në të kundërt është në konflikt me statusin e personit. Gjithashtu, ndryshimi në rrethana përfshin çdo ndryshim ose shtim informacioni në llogarinë e mbajtësit të llogarisë (duke përfshirë shtimin, zëvendësimin ose ndryshime të tjera të një mbajtësi llogarie) ose çdo ndryshim apo shtim informacioni në çdo llogari që lidhet me këtë llogari (duke zbatuar rregullat e totalizimit të llogarisë të përshkruara në nënparagrafët C(1) deri në (3) të seksionit VII) nëse ky ndryshim apo shtim informacioni ndikon në statusin e mbajtësit të llogarisë.

18. Pavarësisht faktit se indiciet e përshkruara në nënparagrafin B(2) duhet ta kufizojnë numrin e rasteve në të cilat kërkimi i regjistrat elektronik rezulton në indicie për Juridiksione të ndryshme Raportuese, këto rrethana mund të ndodhin sërish në praktikë. Disa prej këtyre rasteve mund të jenë tregues “fals” të rezidencës në një Juridiksion të Raportueshëm. Disa të tjera mund të jenë raste të vërteta të Mbajtësve të Llogarisë që janë rezidentë në disa juridiksione. Shpesh, Institucionet Financiare do të kontaktojnë me klientët e tyre për të zgjidhur këto raste (duke zbatuar procedurën e korrigjimit të përshkruar në nënparagrafin B(6)) dhe do t'i këshillojnë që nëse indicia kontradiktore nuk mund të korrigjohet, informacioni mund të shkëmbehet me dy ose më shumë juridiksione. Kjo linjë veprimi shpesh do të rezultojë nga aspektet e marrëdhënies me klientin dhe nevoja për ta trajtuar informacionin e klientit me kujdes. E njëjta gjë do të vlente edhe në kontekstin e procedurave të verifikimit të duhur për Llogaritë Paraekzistuese Individuale që janë Llogari të Vlerës së Lartë. Në masën që Mbajtësi

i Llogarisë gjithsesi do të raportohet si rezident i më shumë se një juridiksioni, pritet që Autoritetet Kompetente do t'i shkëmbejnë të gjitha juridiksionet e rezidencës me secilin juridiksion përkatës. Kjo i lejon Autoritetet përkatëse Kompetente që të zgjidhin çdo pikëpyetje lidhur me rezidencën.

19. Nënparagrafi B(5) përmban një procedurë të veçantë në rast se gjatë kërimit elektronik zbulohet udhëzimi për “ruajtjen e postës” ose një adresë “në vëmendje të”, dhe në këtë kërkim elektronik nuk është identifikuar asnjë prej indicieve të tjera të renditura në nënparagrafin B(2)(a) deri në (e) dhe asnjë adresë tjetër (brenda këtyre indicieve).

### Nënparagrafi B(2) – Indiciet

20. Nënparagrafi B(2) përmban “kërkimin real të regjistrit elektronik”. Sipas kësaj procedure, Institucioni Financiar Raportues duhet të shqyrtojë të dhënat e kërkueshme në format elektronik që mbahen nga Institucioni Financiar Raportues për secilën prej indicieve në vijim (shih paragrafin 34 të Komentit për seksionin I) dhe të zbatojë nënparagrafët B(3) deri në (6):

- a) identifikimi i Mbajtësit të Llogarisë si rezident në një Juridiksion të Raportueshëm;
- b) adresa aktuale postare dhe e rezidencës (duke përfshirë kutinë postare) në një Juridiksion të Raportueshëm;
- c) një apo më shumë numra telefoni në një Juridiksion të Raportueshëm dhe asnjë numër telefoni në juridiksionin e Institucionit Financiar Raportues;
- d) udhëzimet në fuqi (të ndryshme nga ato lidhur me Llogarinë e Depozitës) për të transferuar fonde në një llogari që mbahet në një Juridiksion të Raportueshëm;
- e) prokura aktuale e posaçme në fuqi ose autoriteti nënshkrues që i është dhënë një personi me adresë në Juridiksionin e Raportueshëm; ose
- f) udhëzimi për “ruajtjen e postës” ose adresa “në vëmendje të” në një Juridiksion të Raportueshëm nëse Institucioni Financiar Raportues nuk ka asnjë adresë tjetër në dosjen për Mbajtësin e Llogarisë.

21. Indicia që ndodhet në nënparagrafin B(2)(a) është tregues i Mbajtësit të Llogarisë si rezident i një Juridiksioni të Raportueshëm. Kjo indicie përmbushet nëse informacioni i kërkueshëm në formë elektronike i Institucionit Financiar Raportues përmban një tregues të Mbajtësit të Llogarisë si rezident i Juridiksionit të Raportueshëm për qëllime tatimore.

22. Indicia që ndodhet në nënparagrafin B(2)(b) është adresa aktuale postare ose e rezidencës (duke përfshirë kutinë postare) në një Juridiksion të Raportueshëm. Adresa postare ose e rezidencës konsiderohet si “aktuale” në rastin kur është adresa më e fundit postare ose e rezidencës që është regjistruar nga Institucioni Financiar Raportues lidhur me Mbajtësin individual të Llogarisë. Adresa postare ose e rezidencës lidhur me një llogari që është llogari e fjetur (shih paragrafin 9 më lart) do të konsiderohet si “aktuale” gjatë periudhës së fjetjes. Në rastin kur Institucioni Financiar Raportues ka regjistruar dy ose më shumë adresa postare ose rezidence lidhur me Mbajtësin e Llogarisë dhe një prej këtyre adresave është ajo e ofruesit të shërbimeve të Mbajtësit të Llogarisë (p.sh. menaxher i jashtëm i aktiveve, këshilltar për investimet ose avokat), Institucionit Financiar Raportues nuk i kërkohet ta trajtojë adresën e ofruesit të shërbimeve si një indicie të rezidencës së Mbajtësit të Llogarisë.

23. Indicia që ndodhet në nënparagrafin B(2)(c) është një ose më shumë numra telefoni në një Juridiksion të Raportueshëm dhe asnjë numër telefoni në juridiksionin e Institucionit Financiar Raportues. Numrat e telefonit në një Juridiksion të Raportueshëm kërkohen vetëm për t'u trajtuar si një indicie e rezidencës të një Mbajtësi Llogarie në rastin kur janë numra “aktuale” telefoni në një Juridiksion të Raportueshëm. Për këto qëllime, numrat e telefonit konsiderohen si “aktuale” në rastin kur janë numrat më të fundit të telefonit që janë regjistruar nga Institucioni Financiar Raportues lidhur me Mbajtësin individual të Llogarisë. Në rastin kur

Institucioni Financiar Raportues ka regjistruar dy ose më shumë numra telefoni lidhur me Mbajtësin e Llogarisë dhe një prej këtyre numrave të telefonit është ai i ofruesit të shërbimeve të Mbajtësit të Llogarisë (p.sh. menaxher i jashtëm i aktiveve, këshilltar për investimet ose avokat), Institucionit Financiar Raportues nuk i kërkohet ta trajtojë numrin e telefonit të ofruesit të shërbimeve si një indicie të rezidencës së Mbajtësit të Llogarisë.

24. Indicia që ndodhet në nënparagrafin B(2)(d) janë udhëzimet në fuqi (të ndryshme nga ato lidhur me një Llogari Depozite) për të transferuar fonde në një llogari që mbahet në një Juridiksion të Raportueshëm. Termi “udhëzime në fuqi për të transferuar fonde” nënkupton udhëzimet aktuale për pagesat që jepen nga mbajtësi i llogarisë ose agjenti i mbajtësit të llogarisë, të cilat do të përsëriten pa udhëzime të mëtejshme nga mbajtësi i llogarisë. Prandaj, për shembull, udhëzimi i transfertës për të kryer një pagesë të izoluar nuk është një udhëzim në fuqi për të transferuar fonde, edhe nëse udhëzimet jepen një vit përpara. Megjithatë, udhëzimi për të kryer pagesa për një kohë të pacaktuar është një udhëzim në fuqi për të transferuar fonde për periudhën gjatë së cilës këto udhëzime janë në fuqi, pavarësisht nëse këto udhëzime ndryshohen pas një pagese të vetme.

25. Shembulli vijues ilustron zbatimin e nënparagrafit B(2)(d): Një individ, K, mban një Llogari Kujdestarie tek E, një bankë kujdestarie rezidente në një Juridiksion të Raportueshëm R. K gjithashtu mban një Llogari Depozite te F, një bankë tregtare rezidente në një Juridiksion të Raportueshëm S. K i ka dhënë E udhëzime në fuqi për të transferuar në Llogarinë e Depozitës të gjitha të ardhurat e gjeneruara lidhur me letrat me vlerë që mbahen në Llogarinë e Kujdestarisë. Duke qenë se udhëzimet në fuqi janë lidhur me Llogarinë e Kujdestarisë dhe fondet do të transferohen në një llogari që mbahet në një Juridiksion të Raportueshëm, atëherë këto udhëzime në fuqi janë një indicie e rezidencës në Juridiksionin e Raportueshëm S.

26. Indicia që ndodhet në nënparagrafin B(2)(f) mbulon udhëzimin për “ruajtjen e postës” dhe adresën “në vëmendje të” në një Juridiksion të Raportueshëm nëse Institucioni Financiar Raportues nuk ka asnjë adresë tjetër në dosje për Mbajtësin e Llogarisë. Udhëzimi për “ruajtjen e postës” është një udhëzim aktual nga Mbajtësi i Llogarisë ose agjenti i Mbajtësit të Llogarisë, për ta mbajtur postën e Mbajtësit të Llogarisë deri në momentin e ndryshimit të këtij udhëzimi. Në rastin kur ky udhëzim është në fuqi dhe Institucioni Financiar Raportues nuk ka asnjë adresë në dosje për Mbajtësin e Llogarisë, indicia konsiderohet e përmbushur. Udhëzimi për ta dërguar të gjithë korrespondencën në rrugë elektronike nuk është një udhëzim për “ruajtjen e postës”. Në rastin kur Institucioni Financiar Raportues mban një adresë “në vëmendje të” në një Juridiksion të Raportueshëm dhe nuk ka asnjë adresë tjetër në dosje për Mbajtësin e Llogarisë, indicia konsiderohet gjithashtu e përmbushur.

### Nënparagrafi B(5) – Procedura e veçantë

27. Nënparagrafi B(5) përmban një procedurë të veçantë në rast se gjatë kërimit elektronik zbulohet udhëzimi për “ruajtjen e postës” ose një adresë “në vëmendje të”, dhe në këtë kërkim elektronik nuk është identifikuar asnjë prej indicieve të tjera të renditura në nënparagrafin B(2)(a) deri në (e) dhe asnjë adresë tjetër (brenda këtyre indicieve).

28. Në rastin kur është e zbatueshme procedura e veçantë, Institucioni Financiar Raportues duhet që, në rendin më të përshtatshëm për rrethanat, të zbatojë kërkimin manual të të dhënave të përshkruar në nënparagrafin C(2), ose të kërkojë të marrë nga Mbajtësi i Llogarisë një vetëvërtetim ose Evidencë Shkresore për të përcaktuar rezidencat për qëllime tatimore të këtij Mbajtësi Llogarie. Nëse kërrimi manual nuk arrin të përcaktojë indicien dhe përpjekja për të marrë vetëvërtetimin ose Evidencat Shkresore nuk është e suksesshme, Institucioni Financiar Raportues duhet ta raportojë llogarinë si llogari të padokumentuar.

29. Pasi Institucioni Financiar Raportues përcakton se Llogaria e Vlerës së Ulët është një llogari e padokumentuar, Institucionit Financiar Raportues nuk i kërkohet që të rizbatojë procedurën e parashtruar në nënparagrafin B(5) për të njëjtën Llogari të Vlerës së Ulët

në çdo vit pasues deri sa të ketë një ndryshim në rrethana që rezultojnë në një ose më shumë indicie lidhur me llogarinë, ose kur llogaria bëhet Llogari e Vlerës së Lartë. Sidoqoftë, Institucioni Financiar Raportues duhet ta raportojë Llogarinë e Vlerës së Ulët si një llogari të padokumentuar deri sa kjo llogari pushon së qeni e padokumentuar.

### Nënparagrafi B(6) – Procedura e korrigjimit

30. Nënparagrafi B(6) përmban një procedurë për korrigjimin e gjetjes së indicieve në bazë të paragrafit B(2). Institucionit Financiar Raportues nuk i kërkohet ta trajtojë Mbajtësin e Llogarisë si rezident të një Juridiksioni të Raportueshëm nëse:

- a) informacioni i Mbajtësit të Llogarisë përmban një adresë aktuale postare ose rezidence në Juridiksionin e Raportueshëm, një ose më shumë numra telefoni në Juridiksionin e Raportueshëm (dhe asnjë numër telefoni në juridiksionin e Institucionit Financiar Raportues) ose udhëzime në fuqi (lidhur me Llogaritë Financiare të ndryshme nga Llogaritë e Depozitës) për të transferuar fonde në një llogari që mbahet në një Juridiksion të Raportueshëm, Institucioni Financiar Raportues merr ose ka shqyrtuar më parë dhe mban në dosje:
  - i) një vetëvërtetim nga Mbajtësi i Llogarisë të juridiksioneve të rezidencës të këtij Mbajtësi Llogarie që nuk e përfshin këtë Juridiksion të Raportueshëm; dhe
  - ii) Evidenca Shkresore që përcaktojnë statusin e joraportueshëm të Mbajtësit të Llogarisë.
- b) informacioni i Mbajtësit të Llogarisë përmban një prokurë të posaçme aktuale në fuqi ose autoritet nënshkrues që i është dhënë një personi me adresë në Juridiksionin e Raportueshëm, Institucioni Financiar Raportues merr ose ka shqyrtuar më parë dhe mban në dosje:
  - i) një vetëvërtetim nga Mbajtësi i Llogarisë të juridiksioneve të rezidencës të këtij Mbajtësi Llogarie që nuk e përfshin këtë Juridiksion të Raportueshëm; ose
  - ii) Evidenca Shkresore që përcaktojnë statusin e joraportueshëm të Mbajtësit të Llogarisë.

31. Vetëvërtetimi ose Evidenca Shkresore që janë shqyrtuar më parë mund të merren si të besueshme për qëllime të procedurës së korrigjimit përveçse nëse Institucioni Financiar Raportues e di ose ka arsye të dijë se vetëvërtetimi ose Evidenca Shkresore është e pasaktë ose e pabesueshme (shih paragrafët 2-3 të Komentit për seksionin VII).

32. Vetëvërtetimi që është pjesë e procedurës së korrigjimit nuk ka nevojë të përmbajë një konfirmim të shprehur se Mbajtësi i Llogarisë nuk është rezident në një Juridiksion të Raportueshëm me kusht që Mbajtësi i Llogarisë konfirmon se ai përmban të gjitha juridiksionet e rezidencës (d.m.th. informacioni për juridiksionet e rezidencës të Mbajtësit të Llogarisë është i saktë dhe i plotë). Evidencat shkresore janë të mjaftueshme për të përcaktuar statusin e joraportueshëm të një Mbajtësi Llogarie nëse Evidenca Shkresore (i) konfirmon se Mbajtësi i Llogarisë është rezident në një juridiksion të ndryshëm nga Juridiksioni i Raportueshëm; (ii) përmban një adresë aktuale rezidence jashtë Juridiksionit përkatës të Raportueshëm; ose (iii) është lëshuar nga një organ i autorizuar qeveritar i një juridiksioni të ndryshëm nga Juridiksioni përkatës i Raportueshëm (shih paragrafin 150-162 të Komentit për seksionin VIII).

### Paragrafi C – Verifikimi i duhur për Llogaritë e Vlerës së Lartë

33. Paragrafi C përmban procedurat e përmirësuara të shqyrtimit që zbatohen lidhur me Llogaritë e Vlerës së Lartë. Këto procedura janë kërkimi elektronik i të dhënave, kërkimi manual dhe marrja në pyetje e menaxherit të marrëdhënieve.



*Nënparagrafi C(1) – Kërkimi elektronik i të dhënave*

34. “Kërkimi elektronik i të dhënave” kërkohet për të gjitha Llogaritë e Vlerës së Lartë. Siç parashikohet në nënparagrafin C(1), Institucioni Financiar Raportues duhet të shqyrtojë të dhënat e kërkueshme në formë elektronike që mbahen nga Institucioni Financiar Raportues për secilën prej indicieve të përshkruara në nënparagrafin B(2) (shih paragrafin 34 të Komentit për seksionin I).

*Nënparagrafi C(2) dhe (3) – Kërkimi manual i të dhënave*

35. Nëse bazat e të dhënave të kërkueshme në formë elektronike të Institucionit Financiar Raportues përfshijnë fusha për, dhe kapin të gjithë informacionin e përshkruar në nënparagrafin C(3), atëherë nuk kërkohet një kontroll i mëtejshëm manual i të dhënave. Kjo do të thotë se baza e të dhënave e kërkueshme në formë elektronike e Institucionit Financiar Raportues ka fusha për informacionin e përshkruar në nënparagrafin C(3) nga të cilat, përmes një kërkimi elektronik, ai mund të përcaktojë nëse fushat e përmbajnë këtë informacion. Kështu, përjashtimi për kërkimin manual të të dhënave nuk do të jetë i disponueshëm kur fusha është lënë thjesht bosh përveçse nëse, në bazë të politikave dhe procedurave të Institucionit Financiar Raportues, fakti që kjo fushë është lënë bosh do të thotë se informacioni i përshkruar në nënparagrafin C(3) nuk gjendet në regjistrat e Institucionit Financiar Raportues (p.sh. sepse nuk është dhënë numri i telefonit, ose sepse nuk është dhënë prokura e posaçme).

36. Institucionit Financiar Raportues nuk i kërkohet të kryejë kontrollin manual të të dhënave të përshkruar në nënparagrafin C(2) në pikën që informacioni i kërkueshëm në formë elektronike i Institucionit Financiar Raportues përfshin informacionin e përshkruar në nënparagrafin C(3). Kështu, nëse informacioni i kërkueshëm në formë elektronike i Institucionit Financiar Raportues nuk e përfshin të gjithë informacionin e përshkruar në nënparagrafin C(3), atëherë Institucionit Financiar Raportues i kërkohet vetëm që të kryejë kërkimin manual të të dhënave lidhur me informacionin e përshkruar në nënparagrafin C(3) që nuk përfshihet në informacionin e tij të kërkueshëm në formë elektronike. Për shembull, baza e të dhënave e kërkueshme në formë elektronike e Institucionit Financiar Raportues që përfshin të gjithë informacionin e përshkruar në nënparagrafin C(3) përveç atij që përmban nënparagrafi C(3)(d) (d.m.th. udhëzimet në fuqi për transferimin e fondeve), bën vetëm që Institucioni Financiar Raportues të kryejë kërkimin manual të të dhënave lidhur me informacionin e përshkruar në nënparagrafin C(3)(d). Po kështu, baza e të dhënave e kërkueshme në formë elektronike e Institucionit Financiar Raportues që nuk e përfshin të gjithë informacionin e përshkruar në nënparagrafin C(3) lidhur me një grup të identifikuar qartë të Llogarive të Vlerës së Lartë, bën që Institucioni Financiar Raportues të kryejë vetëm kontrollin manual të të dhënave lidhur me këtë grup llogarish dhe të kufizohet me informacionin e përshkruar në nënparagrafin C(3) që nuk përfshihet në informacionin e tij të kërkueshëm në formë elektronike.

37. Kur Institucionit Financiar Raportues i kërkohet të kryejë “kërkimin manual të të dhënave” për një Llogari të Vlerës së Lartë, ai duhet të shqyrtojë edhe dosjen kryesore aktuale të klientit dhe, për sa kohë që nuk ndodhen në dosjen kryesore aktuale të klientit, dokumentet që renditen në nënparagrafin C(2) lidhur me llogarinë dhe që merren nga Institucioni Financiar Raportues brenda pesë viteve të fundit për secilën prej indicieve të përshkruara në nënparagrafin B(2).

*Nënparagrafi C(4) – Marrja në pyetje e menaxherit të marrëdhënieve*

38. “Marrja në pyetje e menaxherit të marrëdhënieve” kërkohet përveç kërkimeve elektronike dhe manuale të të dhënave. Siç parashikohet në nënparagrafin C(4), Institucioni Financiar Raportues duhet të trajtojë si Llogari të Raportueshme çdo Llogari të Vlerës së Lartë që i caktohet një menaxheri të marrëdhënieve (duke përfshirë çdo Llogari Financiare të

totalizuar me atë Llogari të Vlerës së Lartë) nëse menaxheri i marrëdhënieve ka njohuri reale se Mbajtësi i Llogarisë është një Person i Raportueshëm.

**39.** “Menaxheri i marrëdhënieve” është një nëpunës ose punonjës tjetër i një Institucioni Financiar Raportues të cilit i është caktuar përgjegjësia për disa mbajtës llogarie në terma të vazhdueshëm (duke përfshirë dhe nëpunësin ose punonjësin që është anëtar i një departamenti bankar privat i Institucionit Financiar Raportues), i cili këshillon mbajtësit e llogarisë lidhur me shërbimet e tyre bankare, investimet, trustin, regjistrimin në besim të aktiveve (fiduciary), planifikimin e pasurisë ose nevojat filantropike dhe i jep rekomandime, bën referime ose planifikon ofrimin e produkteve, shërbimeve financiare ose të asistencave të tjera nga ofruesit e brendshëm ose të jashtëm për t’i përmbushur ato nevoja.

**40.** Që personi të konsiderohet një menaxher marrëdhëniesh, menaxhimi i marrëdhënieve duhet të jetë më shumë se thjesht një funksion pune dytësor ose rastësor. Prandaj, personi, funksionet e të cilit nuk përfshijnë kontaktin direkt me klientin ose të cilat i përkasin natyrës administrative, të zyrave ose shkresore, nuk konsiderohet menaxher i marrëdhënieve. Pranohet që kontakti i rregullt mund të ekzistojë ndërmjet një Mbajtësi Llogarie dhe një punonjësi të Institucionit Financiar Raportues pa bërë që punonjësi të jetë një menaxher marrëdhëniesh. Për shembull, personi në Institucionin Financiar Raportues që është kryesisht përgjegjës për përpunimin e transaksioneve/urdhrave ose kërkesave të posaçme mundet që si konkluzion ta njohë mirë Mbajtësin e Llogarisë. Sidoqoftë, personi nuk konsiderohet menaxher marrëdhëniesh përveçse nëse ai person është në fakt i ngarkuar me menaxhimin e çështjeve të Mbajtësit të Llogarisë pranë Institucionit Financiar Raportues.

**41.** Pavarësisht paragrafëve 39-40 më lart, personi është menaxher marrëdhëniesh vetëm për qëllimet e nënparagrafit C(4) lidhur me llogarinë që ka një bilanc ose vlerë të totalizuar prej më shumë se 1 000 000 USD, duke marrë në konsideratë totalizimin e llogarisë dhe rregullat e përkthimit të monedhës të përshkruara në paragrafin C të seksionit VII. Prandaj, për të përcaktuar nëse një nëpunës ose punonjës i Institucionit Financiar Raportues është menaxher marrëdhëniesh, (i) punonjësi duhet të përmbushë përkufizimin e menaxherit të marrëdhënieve dhe (ii) bilanci ose vlera e totalizuar e llogarisë së Mbajtësit të Llogarisë duhet t’i kalojë 1 000 000 USD.

**42.** Shembujt vijues ilustrojnë se si të përcaktohet nëse një punonjës i Institucionit Financiar Raportues është menaxher marrëdhëniesh:

- Shembulli 1: Individi, P, mban një llogari kujdestarie pranë R, një bankë e cila është Institucion Financiar Raportues. Vlera në llogarinë e P-së në fund të vitit është 1 200 000 USD. Punonjësi i departamentit bankar privat, O, mbikëqyr llogarinë e P vazhdimisht. Duke qenë se O e përmbush përkufizimin e “menaxherit të marrëdhënieve” dhe vlera në llogarinë e P-së është më shumë se 1 000 000 USD, O është një menaxher marrëdhëniesh lidhur me llogarinë e P-së.
- Shembulli 2: Të njëjtat fakte si shembulli 1, përveçse vlera në llogarinë e kujdestarisë së P-së në fund të vitit është 800 000 USD. Gjithashtu, P mban një llogari depozite te R, bilanci i së cilës në fund të vitit është 400 000 USD. Të dyja llogaritë lidhen me P dhe me njëra tjetrën duke iu referuar numrit të brendshëm të identifikimit të R-së. Duke qenë se O përmbush përkufizimin e “menaxherit të marrëdhënieve” dhe, pasi të jenë zbatuar rregullat për totalizimin e llogarisë, bilanci ose vlera e totalizuar në llogaritë e P-së është më shumë se 1 000 000 USD, O është menaxher marrëdhëniesh lidhur me llogaritë e P-së.
- Shembulli 3: Të njëjtat fakte si shembulli 2, përveçse funksionet e O-së nuk përfshijnë kontaktin direkt me P. Duke qenë se O nuk përmbush përkufizimin e “menaxherit të marrëdhënieve”, O nuk është një menaxher marrëdhëniesh për llogaritë e P-së.



*Nënparagrafi C(5) – Efekti i gjetjes së indicieve*

43. Nëse gjatë shqyrtimit të përmirësuar të Llogarive të Vlerës së Lartë nuk zbulohet asnjë prej indicieve të renditura në nënparagrafin B(2), dhe llogaria nuk identifikohet si e mbajtur nga një Person i Raportueshëm në nënparagrafin C(4), atëherë, sipas nënparagrafit C(5)(a), nuk nevojiten veprime të mëtejshme deri sa të ketë ndryshim në rrethana që rezultojnë në një ose më shumë indicie që lidhen me llogarinë.

44. Nëse gjatë shqyrtimit të përmirësuar të Llogarive të Vlerës së Lartë zbulohet ndonjë prej indicieve të renditura në nënparagrafin B(2)(a) deri në (e), ose nëse ka ndryshime pasuese në rrethana që rezultojnë në një ose më shumë indicie të lidhura me llogarinë, atëherë, sipas paragrafit C(5)(b), Institucioni Financiar Raportues duhet ta trajtojë llogarinë si Llogari të Raportueshme lidhur me çdo Juridiksion të Raportueshëm për të cilin identifikohet një indicie, përveçse nëse ai zgjedh të zbatojë procedurën e korrigjimit në nënparagrafin B(6) dhe një prej përjashtimeve në këtë nënparagraf zbatohet lidhur me atë llogari. Indicia e zbuluar në një procedurë shqyrtimi si kërkimi manual i të dhënave ose marrja në pyetje e menaxherit të marrëdhënieve, nuk mund të përdoret për të korrigjuar një indicie të identifikuar në një tjetër procedurë shqyrtimi si kërkimi elektronik i të dhënave. Për shembull, adresa aktuale e rezidencës në një Juridiksion të Raportueshëm brenda njohurive të menaxherit të marrëdhënieve nuk mund të përdoret për të korrigjuar një adresë tjetër rezidence që gjendet aktualisht në dosje pranë Institucionit Financiar Raportues e cila zbulohet gjatë kërkit manual të të dhënave.

45. Nëse udhëzimi për “ruajtjen e postës” ose adresa “në vëmendje të” zbulohet gjatë shqyrtimit të përmirësuar të Llogarive të Vlerës së Lartë dhe nuk identifikohet asnjë adresë tjetër dhe asnjë prej indicieve të tjera të renditura në nënparagrafin B(2)(a) deri në (e) për Mbajtësin e Llogarisë, atëherë, sipas nënparagrafit C(5)(c), Institucioni Financiar Raportues duhet të marrë nga ky Mbajtës Llogarie një vetëvërtetim ose Evidencë Shkresore për të përcaktuar rezidencat për qëllime tatimore të Mbajtësit të Llogarisë. Nëse Institucioni Financiar Raportues nuk mund ta marrë këtë vetëvërtetim ose Evidencë Shkresore, ai duhet ta raportojë llogarinë si llogari të padokumentuar deri në momentin që kjo llogari pushon së qeni e padokumentuar.

*Nënparagrafët C(6) deri në (9) – Procedurat shitesë*

46. Sipas nënparagrafit C(6), nëse një Llogari Paraekzistuese Individuale nuk është një Llogari e Vlerës së Lartë duke filluar nga data 31 dhjetor [xxxx] (d.m.th. është Llogari e Vlerës së Ulët), por bëhet Llogari e Vlerës së Lartë duke filluar nga dita e fundit e vitit pasues kalendarik, Institucioni Financiar Raportues duhet ta përfundojë shqyrtimin e përmirësuar për Llogaritë e Vlerës së Lartë lidhur me këtë llogari brenda vitit kalendarik pas vitit në të cilin llogaria bëhet Llogari e Vlerës së Lartë. Nëse bazuar në këtë shqyrtim kjo llogari identifikohet si Llogari e Raportueshme, Institucioni Financiar Raportues duhet ta raportojë informacionin e kërkuar për këtë llogari lidhur me vitin në të cilin ajo identifikohet si Llogari e Raportueshme dhe në vitet pasuese për çdo vit, përveçse nëse Mbajtësi i Llogarisë pushon së qeni një Person i Raportueshëm.

47. Ndërsa përzgjedhja e vitit të përmendur në nënparagrafin C(6) është vendim i juridiksion që zbaton Standardin e Përbashkët të Raportimit, pritet që viti i përzgjedhur për atë qëllim të jetë i njëjti vit si viti i përzgjedhur për termin “Llogari Paraekzistuese”.

48. Sipas nënparagrafit C(7), pasi Institucioni Financiar Raportues zbaton procedurat e përmirësuar të shqyrtimit të Llogarive të Vlerës së Lartë, Institucionit Financiar Raportues nuk i kërkohet t'i rizbatojë këto procedura, përveç marrjes në pyetje të menaxherit të marrëdhënieve, për të njëjtën Llogari të Vlerës së Lartë në çdo vit pasues përveçse nëse llogaria është e padokumentuar. Në këtë rast, Institucioni Financiar Raportues duhet t'i rizbatojë ato çdo vit derisa kjo llogaria pushon së qeni e padokumentuar. Po kështu, lidhur me marrjen në pyetje të menaxherit të marrëdhënieve, verifikimet vjetore janë të mjaftueshme pa qenë nevoja

që menaxheri i marrëdhënieve të konfirmojë për çdo llogari se nuk ka njohuri reale që secili Mbajtës Llogarie që i është caktuar është Person i Raportueshëm.

**49.** Sipas nënparagrafit C(8), nëse ka ndryshim në rrethana lidhur me Llogarinë e Vlerës së Lartë që rezulton në një ose më shumë indicie të përshkruara në nënparagrafin B(2) të cilat lidhen me llogarinë, atëherë Institucioni Financiar Raportues duhet ta trajtojë llogarinë si Llogari të Raportueshme lidhur me çdo Juridiksion të Raportueshëm për të cilin është identifikuar një indicie përveçse nëse zgjedh të zbatojë nënparagrafin B(6) dhe një prej përjashtimeve në këtë nënparagraf zbatohet lidhur me atë llogari. Sidoqoftë, Institucioni Financiar Raportues mund të zgjedhë ta trajtojë personin si me të njëjtin status që kishte përpara ndryshimit të rrethanave gjatë 90 ditëve kalendarike pas datës që është identifikuar indicia për shkak të ndryshimeve në rrethana (shih gjithashtu paragrafin 17 më lart).

**50.** Institucioni Financiar Raportues duhet të ketë procedura dhe kanale të përshtatshme komunikimi për të garantuar që menaxheri i marrëdhënieve identifikon çdo ndryshim në rrethanat e një llogarie, siç parashikohet në nënparagrafin C(9). Për shembull, nëse menaxheri i marrëdhënieve njoftohet se Mbajtësi i Llogarisë ka një adresë të re postare në një Juridiksion të Raportueshëm, Institucionit Financiar Raportues i kërkohet ta trajtojë adresën e re si një ndryshim në rrethana dhe, nëse ai zgjedh të zbatojë nënparagrafin B(6), i kërkohet të marrë dokumentacionin e duhur nga Mbajtësi i Llogarisë.

#### **Paragrafët D dhe E – Koha e shqyrtimit dhe procedurat shtesë**

**51.** Paragrafi D përmban rregullin që rregullon kohën e procedurave të shqyrtimit për identifikimin e Llogarive të Raportueshme ndërmjet Llogarive Paraekzistuese Individuale. Ky rregull kërkon që shqyrtimi të përfundojë deri më datë [xx/xx/xxxx]. Ndërkohë që përzgjedhja e kësaj date është vendim i juridiksionit që zbaton Standardin e Përbashkët të Raportimit, pritet që data e përzgjedhur për atë qëllim që jetë viti pas vitit të përzgjedhur për termin “Llogari Paraekzistuese” lidhur me Llogaritë e Vlerës së Lartë, dhe viti i dytë pas vitit të përzgjedhur për këtë term lidhur me Llogaritë e Vlerës së Ulët.

**52.** Paragrafi E përmban një procedurë shtesë të zbatueshme për Llogaritë Paraekzistuese Individuale: çdo Llogari Paraekzistuese Individuale që është identifikuar si Llogari e Raportueshme sipas seksionit III duhet të trajtohet si Llogari e Raportueshme në të gjitha vitet pasuese, përveçse nëse Mbajtësi i Llogarisë pushon se qeni një Person i Raportueshëm.

## Koment për seksionin IV lidhur me Verifikimin e Duhur për Llogaritë e Reja Individuale

1. Ky seksion përmban procedurat e verifikimit të duhur për Llogaritë e Reja Individuale dhe parashikon mbledhjen e vetëvërtetimit (dhe konfirmimin e arsyeshmërisë së tij).
2. Sipas paragrafit A, pas hapjes së llogarisë, Institucioni Financiar Raportues duhet:
  - të marrë një vetëvërtetim, i cili mund të jetë pjesë e dokumentacionit për hapjen e llogarisë, që i lejon Institucionit Financiar Raportues të përcaktojë rezidencat e Mbajtësit të Llogarisë për qëllime tatimore; dhe
  - të konfirmojë arsyeshmërinë e këtij vetëvërtetimi bazuar në informacionin e marrë nga Institucioni Financiar Raportues lidhur me hapjen e llogarisë, duke përfshirë çdo dokumentacion të mbledhur sipas Procedurave për AML/KYC.
3. Nëse vetëvërtetimi përcakton se Mbajtësi i Llogarisë është rezident për qëllime tatimore në një Juridiksion të Raportueshëm, atëherë, siç parashikohet në paragrafin B, Institucioni Financiar Raportues duhet ta trajtojë llogarinë si Llogari të Raportueshme.
4. Vetëvërtetimi duhet të lejojë përcaktimin e rezidencave të Mbajtësit të Llogarisë për qëllime tatimore. Përgjithësisht, një individ do të ketë vetëm një juridiksion rezidence. Sidoqoftë, një individ mund të jetë rezident për qëllime tatimore në dy ose më shumë juridiksione. Legjislacionet e brendshme të juridiksioneve të ndryshme përcaktojnë kushtet sipas të cilave individ do të trajtohet si “rezident” fiskal. Ato mbulojnë forma të ndryshme të lidhjes me një juridiksion që, në legjislacionet e brendshme tatimore, formojnë bazën e tatimit gjithëpërfshirës (përgjegjësi e plotë ndaj tatimeve). Ato gjithashtu mbulojnë raste kur individ, sipas legjislacioneve tatimore të një juridiksioni, vlerësohet të jetë rezident i atij juridiksioni (p.sh. diplomatët ose persona të tjerë në shërbim qeveritar). Për të zgjidhur rastet e rezidencës së dyfishtë, konventat tatimore përmbajnë rregulla të veçanta të cilat i japin lidhjes me një juridiksion më tepër preferencë se sa me një tjetër për qëllime të atyre konventave. Përgjithësisht, një individ do të jetë rezident për qëllime tatimore në një juridiksion nëse, sipas ligjeve të atij juridiksioni (duke përfshirë konventat tatimore), ai paguan ose duhet të paguajë tatime aty për shkak të vendbanimit të tij, rezidencës ose një kriteri tjetër të ngjashëm, dhe jo vetëm nga burimet në atë juridiksion. Individët me rezidencë të dyfishtë mund të mbështeten në rregullat “tiebreaker” (të zhbllokimit të rezultatit) që ndodhen në konventat tatimore (nëse zbatohen) për të zgjidhur rastet e rezidencës së dyfishtë për të përcaktuar rezidencën e tyre për qëllime tatimore (shih paragrafin 23 më poshtë).
5. Shembujt vijues ilustrojnë se si mund të përcaktohet rezidenca e një individ për qëllime tatimore:
  - Shembulli 1: Individ i ka banesën e përhershme në Juridiksionin A dhe tatohet si rezident i Juridiksionit A. Ai ka qëndruar për më shumë se gjashtë muaj në Juridiksionin B dhe sipas legjislacionit të Juridiksionit të fundit, si pasojë e kohëzgjatjes së qëndrimit, ai tatohet si rezident i atij juridiksioni. Prandaj, ai është rezident i të dyja juridiksioneve.
  - Shembulli 2: Të njëjtat fakte si shembulli 1, përveçse individ ka qëndruar vetëm për tetë javë në Juridiksionin B dhe sipas legjislacionit të atij juridiksioni, për shkak të kohëzgjatjes së qëndrimit, ai nuk tatohet si rezident i Juridiksionit B. Prandaj, ai është rezident vetëm i Juridiksionit A.
6. Juridiksionet Pjesëmarrëse priten që t’i ndihmojnë tatimpaguesit të përcaktojnë, si dhe t’u japin atyre informacion lidhur me, rezidencat e tyre për qëllime tatimore. Kjo për shembull mund të bëhet përmes kanaleve të ndryshme të shërbimit që përdoren për publikimin e informacionit ose të orientimeve për tatimpaguesit mbi zbatimin e legjislacioneve tatimore (p.sh. telefon, zyra të aksesueshme lehtësisht, internet). OECD do të bëjë përpjekjet për të lehtësuar shpërhapjen e këtij informacioni.

**Kërkesat për vlefshmërinë e vetëvërtetimeve**

7. “Vetëvërtetimi” është një vërtetim nga Mbajtësi i Llogarisë i cili jep statusin e Mbajtësit të Llogarisë dhe çdo informacion tjetër që mund të kërkohej në mënyrë të arsyeshme nga Institucioni Financiar Raportues për të përmbushur detyrimet e tij të raportimit dhe verifikimit të duhur, si p.sh. nëse Mbajtësi i Llogarisë është rezident për qëllime tatimore në një Juridiksion të Raportueshëm. Lidhur me Llogaritë e Reja Individuale, vetëvërtetimi është i vlefshëm vetëm nëse nënshkruhet (ose në të kundërt konfirmohet pozitivisht) nga Mbajtësi i Llogarisë, mban datën më të fundit të marrjes dhe përmban të dhënat e vijuese të Mbajtësit të Llogarisë:

- a) emrin;
- b) adresën e rezidencës;
- c) juridiksionet e rezidencës për qëllime tatimore;
- d) NIPT-in lidhur me çdo Juridiksion të Raportueshëm (shih paragrafin 8 më poshtë); dhe
- e) datën e lindjes (shih paragrafin 8 më poshtë).

Vetëvërtetimi mund të popullohet paraprakisht nga Institucioni Financiar Raportues për të përfshirë informacionin e Mbajtësit të Llogarisë, përveç juridiksioneve të rezidencës për qëllime tatimore, deri në atë masë që disponohet në regjistrat e tij.

8. Nëse Mbajtësi i Llogarisë është rezident për qëllime tatimore në një Juridiksion të Raportueshëm, vetëvërtetimi duhet të përfshijë (i) NIPT-in e Mbajtësit të Llogarisë lidhur me çdo Juridiksion të Raportueshëm, sipas paragrafit D të seksionit I (shih paragrafët 29-32 të Komentit për Seksionin I); dhe (ii) datën e lindjes së Mbajtësit të Llogarisë. Vetëvërtetimi nuk ka nevojë të përfshijë vendin e lindjes të Mbajtësit të Llogarisë sepse, sipas paragrafit E të seksionit I, vendi i lindjes nuk kërkohej të raportohet përveçse nëse Institucionit Financiar Raportues në të kundërt i kërkohej ta marrë dhe ta raportojë atë sipas legjislacionit të brendshëm dhe disponohet në të dhënat e kërkueshme në formë elektronike që mbahen nga Institucioni Financiar Raportues.

9. Vetëvërtetimi mund të jepet në çdo mënyrë dhe në çdo formë (p.sh. elektronikisht, si format portativ i dokumentit (.pdf) ose dokumente të skanuara). Nëse vetëvërtetimi jepet në formë elektronike, sistemi elektronik duhet të sigurojë që informacioni i marrë është informacioni i dërguar, dhe duhet të dokumentojë të gjitha rastet e aksesit nga përdoruesi që rezultojnë në dorëzimin, rinovimin ose ndryshimin e vetëvërtetimit. Gjithashtu, projektimi dhe funksionimi i sistemit elektronik, duke përfshirë procedurat e aksesit, duhet të garantojnë që personi që hyn në sistem dhe furnizon vetëvërtetimin është personi i emërtuar në vetëvërtetim, dhe duhet që të jetë i aftë që të lëshojë një kopje fizike, me kërkesë, të të gjitha vetëvërtetimeve të dhëna elektronikisht. Në rastin kur informacioni jepet si pjesë e dokumentacionit të hapjes së llogarisë, nuk është e nevojshme që të jetë në ndonjë faqe specifike të dokumentacionit ose në ndonjë formë specifike, mjafton që të jetë i plotë.

10. Shembujt vijues ilustrojnë se si mund të jepet një vetëvërtetim:

- Shembulli 1: Individi A plotëson një aplikim online për të hapur një llogari pranë Institucionit Financiar Raportues K. I gjithë informacioni që kërkohej për vetëvërtetimin hidhet nga A në një aplikim elektronik (duke përfshirë konfirmimin e juridiksionit të A-së për qëllime tatimore). Informacioni i A-së, siç jepet në vetëvërtetimin elektronik, konfirmohet nga ofruesi i shërbimeve të K-së se është i bazuar realisht në informacionin e mbledhur në bazë të Procedurave për AML/KYC. Vetëvërtetimi i A-së është i vlefshëm.
- Shembulli 2: Individi B bën një aplikim personalisht për të hapur një llogari pranë bankës L. B jep kartën e tij të identitetit si provë të identifikimit dhe jep të gjithë informacionin e kërkuar për vetëvërtetim te punonjësi i L-së i cili bën hedhjen e informacionit në sistemet e L-së. Më pas aplikimi nënshkruhet nga B. Vetëvërtetimi i B-së është i vlefshëm.

11. Vetëvërtetimi mund të nënshkruhet (ose në të kundërt të konfirmohet pozitivisht) nga çdo person i autorizuar për të nënshkruar për llogari të Mbajtësit të Llogarisë në bazë të legjislacionit të brendshëm. Personi i autorizuar për të nënshkruar një vetëvërtetim përgjithësisht përfshin ekzekutuesin e pasurisë, çdo person ekuivalent me këtë titull, dhe çdo person tjetër të cilit i është dhënë autorizim me shkrim nga Mbajtësi i Llogarisë për të nënshkruar dokumentacione për llogari të këtij personi.

12. Vetëvërtetimi mbetet i vlefshëm deri sa të ketë një ndryshim të rrethanave që e bëjnë Institucionin Financiar Raportues të dijë, ose të ketë arsye të dijë, se vetëvërtetimi fillestar është i pasaktë ose i pabesueshëm (shih paragrafët 17 të Komentit për seksionin III dhe 2-3 të Komentit për seksionin VII). Në këtë rast, sipas paragrafit C, Institucioni Financiar Raportues nuk mund të mbështetet në vetëvërtetimin fillestar dhe duhet të marrë (i) një vetëvërtetim të vlefshëm që përcakton rezidencat për qëllime tatimore të Mbajtësit të Llogarisë ose (ii) një shpjegim dhe dokumentim të arsyeshëm (sipas rastit) që mbështet vlefshmërinë e vetëvërtetimit fillestar (dhe të mbajë një kopje ose shënim të këtij shpjegimi dhe dokumentimi). Prandaj, Institucioni Financiar Raportues pritët që të ndërmarrë procedura për të garantuar që çdo ndryshim, i cili përbën një ndryshim në rrethana, të identifikohet nga Institucioni Financiar Raportues. Gjithashtu, Institucioni Financiar Raportues pritët që të njoftojë çdo person që jep vetëvërtetim mbi detyrimin e personit për të njoftuar Institucionin Financiar Raportues lidhur me ndryshimet në rrethana.

13. Ndryshimi në rrethana që prek vetëvërtetimin e dhënë për Institucionin Financiar Raportues do t'i japë fund vlefshmërisë së vetëvërtetimit lidhur me informacionin që nuk është më i besueshëm, deri në momentin që informacioni të përditësohet (shih paragrafin 17 të Komentit për seksionin III).

14. Vetëvërtetimi bëhet i pavlefshëm në datën që Institucioni Financiar Raportues i cili mban vetëvërtetimin e di ose ka arsye të dijë se rrethanat që prekin saktësinë e vetëvërtetimit kanë ndryshuar. Megjithatë, Institucioni Financiar Raportues mund të zgjedhë ta trajtojë një person si me status të njëjtë me atë që kishte përpara ndryshimit në rrethana deri në momentin më të hershëm të 90 ditëve kalendarike nga data që vetëvërtetimi është bërë i pavlefshëm për shkak të ndryshimeve në rrethana, data që vlefshmëria e vetëvërtetimit është konfirmuar ose data që është marrë vetëvërtetimi i ri. Institucioni Financiar Raportues mund të mbështetet te vetëvërtetimi pa qenë nevoja për të hetuar nëpër ndryshimet e mundshme të rrethanave që mund të prekin vlefshmërinë e deklaratës, përveçse nëse ai e di ose ka arsye të dijë se rrethanat kanë ndryshuar.

15. Nëse Institucioni Financiar Raportues nuk mund të marrë një konfirmim të vlefshmërisë së vetëvërtetimit fillestar ose një vetëvërtetim të vlefshëm gjatë kësaj periudhe 90 ditore, Institucioni Financiar Raportues duhet ta trajtojë Mbajtësin e Llogarisë si rezident të juridiksionit në të cilin Mbajtësi i Llogarisë ka pretenduar të jetë rezident në vetëvërtetimin fillestar dhe të juridiksionit në të cilin Mbajtësi i Llogarisë mund të jetë rezident si rezultat i ndryshimit në rrethana.

16. Institucioni Financiar Raportues mund të ruajë një kopje origjinale, të vërtetuar ose fotokopje (duke përfshirë një mikrofshë, skanim elektronik ose mjet të ngjashëm të ruajtjes elektronike) të vetëvërtetimit. Çdo dokumentacion që ruhet elektronikisht duhet të vihet në dispozicion në kopje fizike me kërkesë.

### **Korrigjimi i gabimeve të vetëvërtetimit**

17. Institucioni Financiar Raportues mund ta trajtojë vetëvërtetimin si të vlefshëm, pavarësisht se vetëvërtetimi përmban një gabim të parëndësishëm, nëse Institucioni Financiar Raportues ka në dosje dokumentacion të mjaftueshëm për të plotësuar informacionin që mungon nga vetëvërtetimi për shkak të gabimit. Në këtë rast, dokumentacioni ku mbështet korrigjimi i gabimit të parëndësishëm duhet të jetë përcaktues. Për shembull, vetëvërtetimi në të cilin individ i që ka dorëzuar formularin ka paraqitur në formë të shkurtuar juridiksionin e rezidencës mund të trajtohet si i vlefshëm, pavarësisht shkurtimit, nëse Institucioni Financiar Raportues ka një identifikim të lëshuar nga qeveria për personin nga juridiksioni që përputhet në mënyrë të arsyeshme me



shkurtimin. Në krahun tjetër, shkurtimi i juridiksionit të rezidencës që nuk përputhet në mënyrë të arsyeshme me juridiksionin e rezidencës të treguar në pasaportën e personit nuk është gabim i parëndësishëm. Gjithashtu, informacioni rreth vetëvërtetimit që bie në kontradiktë me informacionet e tjera që gjenden në vetëvërtetim ose në dosjen kryesore të klientit nuk është gabim i parëndësishëm.

### **Vetëvërtetimet që furnizohen mbi bazë llogarie**

18. Përgjithësisht, Institucioni Financiar Raportues pranë të cilit klienti mund të hapë një llogari duhet të marrë një vetëvërtetim mbi bazë llogarie. Sidoqoftë, Institucioni Financiar Raportues mund të mbështetet mbi vetëvërtetimin e furnizuar nga klienti për një llogari tjetër nëse të dyja llogaritë trajtohen si një llogari e vetme për qëllime të përmbushjes së kërkesave të standardeve të njohurisë të parashtruara në paragrafin A të seksionit VII.

### **Dokumentacioni i mbledhur nga persona të tjerë**

19. Siç parashikohet në paragrafin D të seksionit II, Juridiksioni Pjesëmarrës mund t'i lejojë Institucionet Financiare Raportuese që të përdorin ofruesit e shërbimeve për të përmbushur detyrimet e tyre të raportimit dhe verifikimit të duhur. Në këto raste, Institucioni Financiar Raportues mund të përdorë dokumentacionin (duke përfshirë vetëvërtetimin) e mbledhur nga ofruesit e shërbimeve (p.sh. ofruesit e të dhënave, konsulentët financiarë, agjentët e sigurimeve), në bazë të kushteve të përshtatshme në legjislacionin e brendshëm. Sidoqoftë, detyrimet e raportimit dhe të verifikimit të duhur mbeten përgjegjësi e Institucionit Financiar Raportues.

20. Institucioni Financiar Raportues mund të mbështetet në dokumentacionin (duke përfshirë vetëvërtetimin) e mbledhur nga agjenti (duke përfshirë konsulentin e fondit për fondet e përbashkëta, fondet e mbulimit, ose grupin e kapitalit privat) i Institucionit Financiar Raportues. Agjenti mund ta ruajë dokumentacionin si pjesë e një sistemi informacioni të mbajtur për një Institucion të vetëm Financiar Raportues ose për disa Institucione Financiare Raportuese me kusht që sipas sistemit, çdo Institucion Financiar Raportues për llogari të të cilit agjenti ruan dokumentacionin mund të hyjë me lehtësi në të dhënat që lidhen me natyrën e dokumentacionit, informacionin që ndodhet në dokumentacion (duke përfshirë edhe një kopje të vetë dokumentacionit) dhe vlefshmërinë e tij, dhe duhet ta lejojë këtë Institucion Financiar Raportues që t'i transmetojë të dhënat me lehtësi, qoftë direkt në një sistem elektronik ose duke ia dhënë këtë informacion agjentit, lidhur me çdo fakt për të cilin ai vihet në dijeni se mund të ndikojë në besueshmërinë e dokumentacionit. Institucioni Financiar Raportues duhet të jetë i aftë të përcaktojë, për aq sa është e mundur, mënyrën se si dhe kur i ka transmetuar të dhënat lidhur me çdo fakt për të cilin ai vihet në dijeni se mund të ndikojë në besueshmërinë e dokumentacionit dhe duhet të jetë i aftë të përcaktojë se çdo të dhënë që e ka transmetuar është përpunuar dhe janë kryer verifikimet e duhura të përshtatshme lidhur me vlefshmërinë e informacionit. Agjenti duhet të ketë një sistem në fuqi për të garantuar që çdo informacion që merr për faktet që prekin besueshmërinë e dokumentacionit ose statusin që i është dhënë klientit u jepet të gjitha Institucioneve Financiare Raportuese për të cilat agjenti mban dokumentacionin.

21. Institucioni Financiar Raportues që blen/merr një llogari nga një paraardhës ose transferues në një shkrirje ose blerje në grup të llogarive për vlerën, përgjithësisht do të lejohet të mbështetet në dokumentacionin e vlefshëm (duke përfshirë vetëvërtetimin e vlefshëm) ose kopje të dokumentacionit të vlefshëm të mbledhur nga paraardhësi ose transferuesi. Gjithashtu, Institucioni Financiar Raportues që blen një llogari në një shkrirje ose blerje në grup të llogarive për vlerën nga një tjetër Institucion Financiar Raportues që i ka kryer të gjitha verifikimet e duhura sipas seksioneve II deri në VII lidhur me llogaritë e transferuara, përgjithësisht do të lejohet të mbështetet edhe mbi përcaktimin e statusit të një Mbajtësi Llogarie të bërë nga paraardhësi ose transferuesi deri në momentin që blerësi merr dijeni ose ka arsye të ketë dijeni se statusi është i pasaktë ose ka ndodhur një ndryshim në rrethana (shih paragrafin 17 të Komentit për seksionin III).



**Arsyeshmëria e vetëvërtetimit**

22. Siç përmendet në paragrafin 2 më lart, në momentin e hapjes së llogarisë, pasi Institucioni Financiar Raportues të ketë marrë vetëvërtetimin që e lejon të përcaktojë rezidencat e Mbajtësit të Llogarisë për qëllime tatimore, Institucioni Financiar Raportues duhet të konfirmojë arsyeshmërinë e këtij vetëvërtetimi bazuar në informacionin e marrë lidhur me hapjen e llogarisë, duke përfshirë çdo dokumentacion të mbledhur sipas Procedurave për AML-KYC (d.m.th. testin e “arsyeshmërisë”).

23. Institucioni Financiar Raportues konsiderohet se e ka konfirmuar “arsyeshmërinë” e vetëvërtetimit nëse, gjatë procesit të procedurave të hapjes së llogarisë dhe pas shqyrtimit të informacionit të marrë lidhur me hapjen e llogarisë (duke përfshirë çdo dokumentacion të mbledhur sipas Procedurave për AML/KYC), ai nuk e di ose nuk ka arsye të dijë se vetëvërtetimi është i pasaktë ose i pabesueshëm (shih paragrafët 2-3 të Komentit për seksionin VII). Nuk pritet që Institucionet Financiare Raportuese të kryejnë një analizë të pavarur ligjore të legjislacioneve përkatëse tatimore për të konfirmuar arsyeshmërinë e vetëvërtetimit.

24. Shembujt vijues ilustrojnë zbatimin e testit të “arsyeshmërisë”:

- Shembulli 1: Institucioni Financiar Raportues merr një vetëvërtetim nga Mbajtësi i Llogarisë në momentin e hapjes së llogarisë. Adresa e juridiksionit të rezidencës që gjendet në vetëvërtetim nuk përkon me atë që ndodhet në dokumentacionin e mbledhur sipas Procedurave për AML/KYC. Për shkak të informacionit kontradiktor, vetëvërtetimi është i pasaktë ose i pabesueshëm dhe, si rrjedhojë, ai nuk e kalon testin e “arsyeshmërisë”.
- Shembulli 2: Institucioni Financiar Raportues merr një vetëvërtetim nga Mbajtësi i Llogarisë në momentin e hapjes së llogarisë. Adresa e rezidencës që ndodhet në vetëvërtetim nuk është në juridiksionin në të cilin Mbajtësi i Llogarisë pretendon të jetë rezident për qëllime tatimore. Për shkak të informacionit kontradiktor, vetëvërtetimi nuk e kalon testin e arsyeshmërisë.

25. Në rastin e një vetëvërtetimi që në të kundërt nuk do ta kalonte testin e arsyeshmërisë, pritet që gjatë procesit të hapjes së llogarisë Institucioni Financiar Raportues të marrë (i) një vetëvërtetim të vlefshëm, ose (ii) një shpjegim të arsyeshëm dhe dokumentacion (sipas rastit) në mbështetje të arsyeshmërisë së vetëvërtetimit (dhe të mbajë një kopje ose një shënim të këtij shpjegimi dhe dokumentacioni). Shembuj të këtij “shpjegimi të arsyeshëm” përfshijnë deklaratën e individit se ai ose ajo (1) është student në një institucion arsimor në juridiksionin përkatës dhe ka vizën përkatëse (nëse zbatohet); (2) është mësues, i trajnuar ose praktikant në një institucion arsimor në juridiksionin përkatës ose pjesëmarrës në një program vizitorësh për shkëmbime kulturore ose arsimore, dhe ka vizën përkatëse (nëse zbatohet); (3) është individ i huaj që është emëruar në një post diplomatik ose post në konsullatë apo ambasadë në juridiksionin përkatës; ose (4) është një punonjës kufiri ose punonjës që punon në kamion apo tren i cili udhëton ndërmjet juridiksioneve. Shembulli vijues ilustron zbatimin e këtij paragrafi: Institucioni Financiar Raportues merr një vetëvërtetim për Mbajtësin e Llogarisë në momentin e hapjes së llogarisë. Juridiksioni i rezidencës për qëllime tatimore që ndodhet në vetëvërtetim bie në kontradiktë me adresën e rezidencës që ndodhet në dokumentacionin e mbledhur sipas Procedurave për AML/KYC. Mbajtësja e Llogarisë shpjegon se ajo është diplomate nga një juridiksion përkatës dhe se, si rrjedhojë, ajo është rezidente në këtë juridiksion; ajo paraqet edhe pasaportën e saj diplomatike. Për shkak se Institucioni Financiar Raportues ka marrë një shpjegim të arsyeshëm dhe dokumentacion që mbështet arsyeshmërinë e vetëvërtetimit, vetëvërtetimi e kalon testin e arsyeshmërisë.

## Koment për seksionin V lidhur me Verifikimin e Duhur për Llogaritë Paraekzistuese të Njësive Ekonomike

1. Ky seksion përshkruan procedurat e verifikimit të duhur për Llogaritë Paraekzistuese të Njësive Ekonomike.

### Paragrafi A – Llogaritë që nuk kërkohen të shqyrtohen, identifikohen ose raportohen

2. Paragrafi A përjashton nga shqyrtimi të gjitha Llogaritë Paraekzistuese të Njësive Ekonomike me një bilanc ose vlerë llogarie që nuk e kalon vlerën 250 000 USD duke filluar më datë 31 dhjetor [xxxx], deri në momentin që ky bilanc apo kjo vlerë e kalon nivelin 250 000 USD duke filluar nga dita e fundit e çdo viti pasues kalendarik. Ky prag jepet për të reduktuar barrën e përputhshmërisë për institucionet financiare, duke pranuar që procedurat e verifikimit të duhur për llogaritë e mbajtura nga Njësitë Ekonomike janë më tepër komplekse se sa ato për llogaritë e mbajtura nga individët.

3. Sidoqoftë, zbatimi i paragrafit A është objekt i (i) juridiksioneve zbatuese që i lejojnë Institucionet Financiare Raportuese të zbatojnë përjashtimin dhe (ii) Institucionit Financiar Raportues që zgjedh ta zbatojë atë, qoftë lidhur me të gjitha Llogaritë Paraekzistuese të Njësive Ekonomike ose, veçmas, lidhur me çdo grup të identifikuar qartë të këtyre llogarive. Prandaj, nëse rregullat e zbatimit në një juridiksion nuk parashikojnë një zgjedhje të tillë ose nëse Institucioni Financiar Raportues nuk e bën një zgjedhje të tillë, të gjitha Llogaritë Paraekzistuese të Njësive Ekonomike kërkohen të shqyrtohen në pajtim me procedurat e parashtruara në paragrafin D.

4. Ndërkohë që përzgjedhja e viteve të përmendura në paragrafët A dhe B është vendim i juridiksionit që zbaton Standardin e Përbashkët të Raportimit, pritet që viti i përzgjedhur për atë qëllim të jetë i njëjti vit si viti i përzgjedhur për termin “Llogari Paraekzistuese”.

### Paragrafët B dhe C – Llogaritë që janë objekt i shqyrtimit dhe raportimit

5. Sipas paragrafit B, çdo Llogari Paraekzistuese e Njësive Ekonomike që nuk është e përshkruar në paragrafin A (d.m.th. me një bilanc ose vlerë që e kalon nivelin 250 000 USD duke filluar nga data 31 dhjetor e çdo viti kalendarik) duhet të shqyrtohet në pajtim me procedurat e parashtruara në paragrafin D. Si rrjedhojë, kërkohet shqyrtimi i një Llogarie Paraekzistuese të Njësive Ekonomike në rastin kur:

- a) ajo ka një bilanc ose vlerë llogarie që e kalon nivelin 250 000 USD duke filluar nga data 31 dhjetor [xxxx]; ose
- b) ajo nuk e kalon nivelin 250 000 USD duke filluar nga data 31 dhjetor [xxxx], por bilanci apo vlera e llogarisë e së cilës e kalon nivelin 250 000 USD duke filluar nga dita e fundit e çdo viti pasues kalendarik.

6. Sidoqoftë, Llogaria e Njesisë Ekonomike Paraekzistuese që nuk është e përshkruar në paragrafin A, duhet të trajtohet vetëm si Llogari e Raportueshme, sipas paragrafit C, nëse ajo mbahet nga një ose më shumë Njësi Ekonomike që janë:

- a) Persona të Raportueshëm, ose
- b) NFE Pasive me një ose më shumë Persona Kontrollues të cilët janë Persona të Raportueshëm.

7. Llogaria Paraekzistuese e Njësive Ekonomike që mbahet nga një NFE Pasive me një ose më shumë Persona Kontrollues të cilët janë Persona të Raportueshëm, nuk do të thotë që nuk arrin të kualifikohet si Llogari e Raportueshme sipas paragrafit C, vetëm sepse vetë Llogaria në vetvete nuk është një Person i Raportueshëm ose sepse ndonjë prej Personave Kontrollues të NFE-së Pasive është rezident në të njëjtin Juridiksion si NFE-ja Pasive.

**Paragrafi D – Procedurat e shqyrtimit**

8. Paragrafi D përmban procedurat e shqyrtimit për të identifikuar Llogaritë e Raportueshme ndërmjet Llogarive Paraekzistuese të Njësive Ekonomike. Këto procedura u kërkojnë Institucioneve Financiare Raportuese të përcaktojnë:

- a) nëse Llogaria Paraekzistuese e Njësive Ekonomike mbahet nga një ose më shumë Njësi Ekonomike që janë Persona të Raportueshëm; dhe
- b) nëse Llogaria Paraekzistuese e Njësive Ekonomike mbahet nga një ose më shumë Njësi Ekonomike që janë NFE Pasive me një ose më shumë prej Personave Kontrollues që janë Persona të Raportueshëm.

*Nënparagrafi D(1) – Procedurat e shqyrtimit për Mbajtësit e Llogarisë*

9. Nënparagrafi D(1) përmban procedurën e shqyrtimit për të përcaktuar nëse Llogaria Paraekzistuese e Njësive Ekonomike mbahet nga një ose më shumë Njësi Ekonomike që janë Persona të Raportueshëm. Nëse ndonjëra prej Njësive Ekonomike është Person i Raportueshëm, atëherë llogaria duhet të trajtohet si Llogari e Raportueshme.

10. Institucioni Financiar Raportues duhet të shqyrtojë informacionin që mbahet për qëllime rregullatore ose të marrëdhënies me klientin (duke përfshirë informacionin e mbledhur sipas Procedurave për AML/KYC) për të përcaktuar nëse informacioni tregon se Mbajtësi i Llogarisë është rezident në një Juridiksion të Raportueshëm. Për këtë qëllim, informacioni që tregon se Mbajtësi i Llogarisë është rezident në një Juridiksion të Raportueshëm përfshin:

- vendin e themelimit ose të organizimit në një Juridiksion të Raportueshëm;
- adresën në një Juridiksion të Raportueshëm (për shembull, kjo ka gjasa të zbatohet për Njësitë Ekonomike që trajtohen si transparente nga pikëpamja fiskale dhe mund të pasqyrojë adresën e regjistruar, zyrën qendrore ose vendin e menaxhimit efektiv); ose
- adresën e një ose më shumë administratorëve të besuar të trustit në një Juridiksion të Raportueshëm.

Sidoqoftë, ekzistenca e një ndërmarrjeje të përhershme (duke përfshirë degën) në një Juridiksion të Raportueshëm (duke përfshirë adresën e një ndërmarrjeje të përhershme) nuk është në vetvete një tregues i rezidencës për këtë qëllim.

11. Nëse informacioni tregon se Mbajtësi i Llogarisë është rezident në një Juridiksion të Raportueshëm, atëherë, siç parashikohet në nënparagrafin D(1)(b), Institucioni Financiar Raportues duhet ta trajtojë llogarinë si Llogari të Raportueshme përveçse nëse merr një vetëvërtetim nga Mbajtësi i Llogarisë, ose përcakton me arsye bazuar në informacionin që disponon apo që është i disponueshëm publikisht, se Mbajtësi i Llogarisë nuk është një Person i Raportueshëm lidhur me këtë Juridiksion të Raportueshëm.

12. Informacioni i “disponueshëm publikisht” përfshin informacionin e publikuar nga një organ qeveritar i autorizuar (për shembull, një qeveri ose agjenci e saj, ose një bashki) i një juridiksioni, i tillë si informacioni në një listë të publikuar nga administrata tatimore që përmban emrat dhe numrat identifikues të institucioneve financiare (p.sh. lista e Institucioneve të Huaja Financiare e IRS-së); informacionin në një regjistër të aksesueshëm publikisht që mbahet ose autorizohet nga një organ qeveritar i autorizuar i një juridiksioni; informacioni që bëhet i disponueshëm në një treg të konsoliduar të letrave me vlerë (shih paragrafin 112 të Komentit për seksionin VIII); dhe çdo klasifikim të aksesueshëm publikisht lidhur me Mbajtësin e Llogarisë që është përcaktuar bazuar në një sistem kodimi të standardizuar të industrisë dhe që është dhënë p.sh. nga një organizatë tregtare ose dhomë tregtie, në pajtim me praktikat normale të biznesit (shih paragrafin 154 të Komentit për seksionin VIII). Në këtë drejtim, Institucioni Financiar Raportues pritet që të mbajjë një shënim të llojit të informacionit të shqyrtuar, dhe datën kur është shqyrtuar informacioni.

**13.** Kur përcakton nëse një Llogari Paraekzistuese e Njësive Ekonomike mbahet nga një ose më shumë Njësi Ekonomike që janë Persona të Raportueshëm, Institucioni Financiar Raportues mund të ndjekë udhëzimet në nënparagrafët D(1)(a) dhe (b) sipas rendit më të përshtatshëm në varësi të rrethanave. Kjo do ta lejonte Institucionin Financiar Raportues, për shembull, që të përcaktojë në bazë të paragrafit D(1)(a) se Llogaria Paraekzistuese e Njësive Ekonomike mbahet nga një Njësi Ekonomike që nuk është Person i Raportueshëm (p.sh. një korporatë e tregtuar publikisht) dhe, si rrjedhojë, llogaria nuk është Llogari e Raportueshme.

**14.** Siç përmendet në paragrafin 7 të Komentit për seksionin IV, “vetëvërtetimi” është një vërtetim nga Mbajtësi i Llogarisë i cili jep statusin e Mbajtësit të Llogarisë dhe çdo informacion tjetër që mund të kërkohej në mënyrë të arsyeshme nga Institucioni Financiar Raportues për të përmbushur detyrimet e tij të raportimit dhe verifikimit të duhur, si p.sh. nëse Mbajtësi i Llogarisë është rezident për qëllime tatimore në një Juridiksion të Raportueshëm ose nëse Mbajtësi i Llogarisë është një NFE Pasive. Lidhur me Llogaritë Paraekzistuese të Njësive Ekonomike, vetëvërtetimi është i vlefshëm vetëm nëse nënshkruhet (ose në të kundërt konfirmohet pozitivisht) nga personi i cili është i veshur me autoritetin për të nënshkruar në emër të Mbajtësit të Llogarisë, mban datën më të fundit të marrjes dhe përmban të dhënat e vijuese të Mbajtësit të Llogarisë:

- a) emrin;
- b) adresën;
- c) juridiksionet e rezidencës për qëllime tatimore; dhe
- d) NIPT-in lidhur me çdo Juridiksion të Raportueshëm.

Vetëvërtetimi mund të popullohet paraprakisht nga Institucioni Financiar Raportues për të përfshirë informacionin e Mbajtësit të Llogarisë, përveç juridiksioneve të rezidencës për qëllime tatimore, deri në atë masë që disponohet në regjistrat e tij.

**15.** Personi me autoritetin për të nënshkruar një vetëvërtetim përgjithësisht përfshin një zyrtar ose drejtorin e korporatës, një partner të partneritetit, administratorin e besuar të trustit, çdo titull ekuivalent të titujve të mëparshëm, dhe çdo person tjetër të cilit i është dhënë autorizimi me shkrim nga Mbajtësi i Llogarisë për të nënshkruar dokumentacionin për llogari të këtij personi.

**16.** Vetëvërtetimi i lidhur me Llogaritë Paraekzistuese të Njësive Ekonomike mund të përmbajë edhe statusin e Mbajtësit të Llogarisë. Në këtë rast, statusi i Mbajtësit të Llogarisë mund të jetë një nga vijuesit:

- a) Institucion Financiar:
  - (1) Njësia Ekonomike e Investimeve e përshkruar në nënparagrafin A(6)(b) të seksionit VIII.
  - (2) Institucion Financiar (tjetër).
- b) NFE:
  - (1) korporatë që tregtohet publikisht ose një filial i një korporate që tregtohet publikisht.
  - (2) Subjekt Qeveritar.
  - (3) Organizatë Ndërkombëtare.
  - (4) NFE Aktive (të ndryshme nga to nga 1 deri në 3).
  - (5) NFE Pasive (që nuk përfshin Njësine Ekonomike të Investimeve në nënparagrafin A(6)(b) të seksionit VIII).

Kur kërkojnë vetëvërtetim, Institucionet Financiare Raportuese priten që t’u japin Mbajtësve të Llogarive informacionin i cili është i rëndësishëm për këta të fundit për të përcaktuar statusin e tyre (p.sh. përkufizimi i termit “NFE Aktive” që ndodhet në nënparagrafin D(9) të seksionit VIII).

**17.** Kërkesat për vlefshmërinë e vetëvërtetimeve lidhur me Llogaritë e Reja Individuale janë të zbatueshme për vlefshmërinë e vetëvërtetimeve për Llogaritë Paraekzistuese të Njësive Ekonomike (shih paragrafët 7-16 të Komentit për seksionin IV). E njëjta gjë zbatohet për korrigjimin e gabimeve

të vetëvërtetimit, kërkesën për të marrë vetëvërtetime mbi bazë llogarie dhe dokumentacionin e mbledhur nga persona të tjerë (shih paragrafët 17-21 të Komentit për seksionin IV).

### *Nënparagrafi D(2) – Procedurat e shqyrtimit për Personat Kontrollues*

18. Nënparagrafi D(2) përmban procedurën e shqyrtimit për të përcaktuar nëse një Llogari Paraekzistuese mbahet nga një ose më shumë Njësi Ekonomike që janë NFE Pasive me një ose më shumë Persona Kontrollues të cilët janë Persona të Raportueshëm. Nëse ndonjëri prej Personave Kontrollues të NFE-së Pasive është Person i Kontrollueshëm, atëherë llogaria duhet të trajtohet si Llogari e Raportueshme (edhe nëse Personi Kontrollues është rezident në të njëjtin juridiksion si NFE-ja Pasive).

19. Kur bën këto përcaktime, Institucioni Financiar Raportues duhet të ndjekë udhëzimet në nënparagrafët D(2)(a) deri në (c) në rendin më të përshtatshëm sipas rrethanave. Ato nënparagrafë kanë për qëllim të përcaktojnë:

- a) nëse Mbajtësi i Llogarisë është një NFE Pasive;
- b) Personat Kontrollues të kësaj NFE-je Pasive; dhe
- c) nëse ndonjë prej këtyre Personave Kontrollues është Person i Raportueshëm.

20. Për qëllime të përcaktimit nëse Mbajtësi i Llogarisë është një NFE Pasive, sipas nënparagrafit D(2)(a), Institucioni Financiar Raportues duhet të marrë një vetëvërtetim nga Mbajtësi i Llogarisë për të përcaktuar statusin e tij, përveçse nëse disponon informacion ose informacioni është i disponueshëm publikisht (shih paragrafin 12 më lart), në bazë të të cilit ai mund të përcaktojë me arsye se Mbajtësi i Llogarisë është një NFE Aktive ose një Institucion Financiar i ndryshëm nga njësi ekonomike investimesh jopjesëmarrëse e menaxhuar në mënyrë profesionale (d.m.th. një Njësi Ekonomike Investimesh si ajo e përshkruar në nënparagrafin A(6)(b) të seksionit VIII e cila është një Institucion Financiar i Juridiksionit Pjesëmarrës). Për shembull, Institucioni Financiar Raportues mund të përcaktojë në mënyrë të arsyeshme se Mbajtësi i Llogarisë është një NFE Aktive në rastin kur Mbajtësi i Llogarisë e ka të ndaluar me ligj kryerjen e aktiviteteve ose operacioneve, ose mbajtjen e aktiveve, për prodhimin e të ardhurave Pasive (shih paragrafin 126 të Komentit për seksionin VIII). Vetëvërtetimi për të përcaktuar statusin e Mbajtësit të Llogarisë duhet të pajtohet me kërkesat për vlefshmërinë e vetëvërtetimit lidhur me Llogaritë Paraekzistuese të Njësive Ekonomike (shih paragrafët 13-17 më lart). Institucioni Financiar Raportues i cili nuk mund të përcaktojë statusin e Mbajtësit të Llogarisë si një NFE Aktive ose Institucion Financiar i ndryshëm nga njësi ekonomike e investimeve jopjesëmarrëse e menaxhuar në mënyrë profesionale, duhet të supozojë se ai është një NFE Pasive.

21. Për qëllime të përcaktimit të Personave Kontrollues të një Mbajtësi Llogarie, sipas nënparagrafit D(2)(b), Institucioni Financiar Raportues mund të mbështetet në informacionin e mbledhur dhe të mbajtur sipas Procedurave për AML/KYC.

22. Për qëllime të përcaktimit të Personave Kontrollues të një Mbajtësi Llogarie, sipas nënparagrafit D(2)(b), Institucioni Financiar Raportues mund të mbështetet në informacionin e mbledhur dhe të mbajtur sipas Procedurave për AML/KYC. Sidoqoftë, në rastin e një Llogarie Paraekzistuese të Njësive Ekonomike me një bilanc ose vlerë llogarie që e kalon nivelin 1 000 000 USD, nënparagrafi D(2)(c)(ii) parashikon mbledhjen e një vetëvërtetimi nga Mbajtësi i Llogarisë ose Personi Kontrollues, i cili mund të jepet në të njëjtin vetëvërtetim si ai i dhënë nga Mbajtësi i Llogarisë për të certifikuar statusin e tij. Vetëvërtetimi lidhur me Personin Kontrollues është i vlefshëm vetëm nëse nënshkruhet (ose në të kundërt konfirmohet pozitivisht) nga Personi Kontrollues ose personi me autoritetin për të nënshkruar për llogari të Mbajtësit të Llogarisë ose Personit Kontrollues, mban datën më të fundit të datës së marrjes dhe përmban të dhënat e mëposhtme për secilin Person Kontrollues:

- a) emrin;
- b) adresën;



- c) juridiksionet e rezidencës për qëllime tatimore;
- d) NIPT-in lidhur me secilin Juridiksion të Raportueshëm (shih paragrafin 8 të Komentit për seksionin IV); dhe
- e) datën e lindjes (shih paragrafin 8 të Komentit për seksionin IV).

Vetëvërtetimi mund të popullohet paraprakisht nga Institucioni Financiar Raportues për të përfshirë informacionin e Personit Kontrollues, përveç juridiksioneve të rezidencës për qëllime tatimore, deri në atë masë që disponohet në regjistrat e tij.

23. Kërkesat për vlefshmërinë e vetëvërtetimeve lidhur me Llogaritë e Reja Individuale janë të zbatueshme për vlefshmërinë e vetëvërtetimeve për të përcaktuar nëse një Person Kontrollues i një NFE-je Pasive është Person i Raportueshëm (shih paragrafët 7-16 të Komentit për seksionin IV). E njëjta gjë zbatohet për korrigjimin e gabimeve të vetëvërtetimit, kërkesën për të marrë vetëvërtetime mbi bazë llogarie dhe dokumentacionin e mbledhur nga persona të tjerë (shih paragrafët 17-21 të Komentit për seksionin IV).

24. Nëse kërkohet mbledhja e vetëvërtetimit dhe nuk merret lidhur me Personin Kontrollues të një NFE-je Pasive, Institucioni Financiar Raportues duhet të mbështetet në indiciet e përshkruara në nënparagrafin B(2) të seksionit III që ka në dosjet e tij për këtë Person Kontrollues me qëllim përcaktimin nëse është Person i Raportueshëm. Nëse Institucioni Financiar Raportues nuk ka asnjë nga këto indicie në dosjet e tij, atëherë nuk do të kërkohen veprime të mëtejshme deri sa të ketë ndryshime në rrethana të cilat rezultojnë në një ose më shumë indicie për Personin Kontrollues që lidhen me llogarinë.

#### **Paragrafi E – Koha e shqyrtimit dhe procedurat shtesë**

25. Nënparagrafët E(1) dhe (2) përmbajnë rregullat që rregullojnë kohën e procedurave të shqyrtimit për identifikimin e Llogarive të Raportueshme ndërmjet Llogarive Paraekzistuese të Njësive Ekonomike. Këto rregulla kërkojnë që shqyrtimi të kryhet:

- a) për llogaritë me një bilanc ose vlerë llogarie që e kalon nivelin 250 000 USD duke filluar nga data 31 dhjetor [xxxx], deri më 31 dhjetor [xxxx]; dhe
- b) për llogaritë me një bilanc ose vlerë llogarie që nuk e kalon nivelin 250 000 USD deri më datë 31 dhjetor [xxxx], por e kalon vlerën 250 000 duke filluar nga data 31 dhjetor e vitit pasues, brenda vitit kalendarik që vjen pas vitit në të cilin bilanci ose vlera e llogarisë e kalon nivelin 250 000 USD.

26. Ndërsa përzgjedhja e viteve të përmendua në nënparagrafët E(1) dhe (2) është vendim i juridiksionit që zbaton Standardin e Përbashkët të Raportimit, pritet që vitet e përzgjedhura për atë qëllim të jenë të njëjtat si me vitin e përzgjedhur për termin “Llogari Paraekzistuese”. Sidoqoftë, në rastin e vitit të dytë të përmendur në nënparagrafët E(1), pritet që viti i përzgjedhur për atë qëllim të jetë viti i dytë më i hershëm kalendarik që vjen pas vitit të përzgjedhur për termin “Llogari Paraekzistuese”.

27. Nënparagrafi E(3) përmban një procedurë shtesë të zbatueshme për Llogaritë Paraekzistuese të Njësive Ekonomike: nëse ka ndryshim të rrethanave lidhur me Llogarinë Paraekzistuese të Njësive Ekonomike që e bën Institucionin Financiar Raportues të dijë, ose të ketë arsye të dijë, se vetëvërtetimi ose dokumentacioni tjetër i lidhur me llogarinë është i pasaktë ose i pabesueshëm, Institucioni Financiar Raportues duhet ta ripërcaktojë statusin e llogarisë në pajtim me procedurat e parashtruara në paragrafin D. Standardet e njohurisë të zbatueshme për Evidencat Shkresore zbatohen edhe për dokumentacione të tjera ku mbështetet ky institucion sipas procedurave të parashtruara në paragrafin D (shih paragrafët 14 të Komentit për seksionin IV dhe 2-3 të Komentit për seksionin VII). Në këtë rast, Institucioni Financiar Raportues duhet të zbatojë procedurat vijuese nga dita më e fundit e vitit përkatës kalendarik ose një periudhe tjetër të përshtatshme raportimi, ose brenda 90 ditëve kalendarike pas njoftimit ose zbulimit të ndryshimit në rrethana:



- lidhur me përcaktimin nëse Mbajtësi i Llogarisë është një Person i Raportueshëm: Institucioni Financiar Raportues duhet të marrë (i) një vetëvërtetim, ose (ii) një shpjegim të arsyeshëm ose dokumentacion (sipas rastit) në mbështetje të arsyeshmërisë të dokumentacionit ose vetëvërtetimit fillestar (dhe të mbajë një kopje ose shënim të këtij shpjegimi ose dokumentacioni). Nëse Institucioni Financiar Raportues nuk arrin të marrë një vetëvërtetim ose të konfirmojë arsyeshmërinë e dokumentacionit ose të vetëvërtetimit fillestar, ai duhet ta trajtojë Mbajtësin e Llogarisë si Person të Raportueshëm lidhur me të dyja juridiksionet.
- lidhur me përcaktimin nëse Mbajtësi i Llogarisë është një Institucion Financiar, NFE Aktive ose NFE Pasive: Institucioni Financiar Raportues duhet të marrë dokumentacion shtesë ose një vetëvërtetim (sipas rastit) për të përcaktuar statusin e Mbajtësit të Llogarisë si një NFE Aktive ose Institucion Financiar. Nëse Institucioni Financiar Raportues nuk arrin ta bëjë këtë gjë, ai duhet ta trajtojë Mbajtësin e Llogarisë si NFE Pasive.
- lidhur me përcaktimin nëse Personi Kontrollues i një NFE-je Pasive është një Person i Raportueshëm: Institucioni Financiar Raportues duhet të marrë (i) një vetëvërtetim, ose (ii) një shpjegim të arsyeshëm ose dokumentacion (sipas rastit) në mbështetje të arsyeshmërisë të vetëvërtetimit ose dokumentacionit të mbledhur më parë (dhe të mbajë një kopje ose shënim të këtij shpjegimi ose dokumentacioni). Nëse Institucioni Financiar Raportues nuk arrin të marrë një vetëvërtetim ose të konfirmojë arsyeshmërinë e dokumentacionit ose të vetëvërtetimit të mbledhur më parë, ai duhet të mbështetet në indiciet e përshkruara në nënparagrafin B(2) të seksionit III që ka në dosjet e tij për këtë Person Kontrollues për të përcaktuar nëse është Person i Raportueshëm.

## Koment për seksionin VI lidhur me Verifikimin e Duhur për Llogaritë e Reja të Njësive Ekonomike

1. Ky seksion përshkruan procedurat e verifikimit të duhur për Llogaritë e Reja të Njësive Ekonomike. Procedurat janë gjerësisht të ngjashme si ato për Llogaritë Paraekzistuese të Njësive Ekonomike. Sidoqoftë, pragu 250 000 USD nuk zbatohet sepse do të ishte më e lehtë të mbledheshin vetëvërtetimet për Llogaritë e Reja të Njësive Ekonomike.
2. Paragrafi A përmban procedurat e shqyrtimit për të identifikuar Llogaritë e Raportueshme ndërmjet Llogarive të Reja të Njësive Ekonomike. Këto procedura u kërkojnë Institucioneve Financiare Raportuese që të përcaktojnë:
  - a) nëse një Llogari e Re e Njësive Ekonomike mbahet nga një ose më shumë Njësi Ekonomike që janë Persona të Raportueshëm; dhe
  - b) nëse Llogaria e Re e Njësive Ekonomike mbahet nga një ose më shumë Njësi Ekonomike që janë NFE Pasive me një ose më shumë Persona Kontrollues të cilët janë Persona të Raportueshëm.

### Nënparagrafi A(1) – Procedurat e shqyrtimit për Mbajtësit e Llogarisë

3. Nënparagrafi A përmban procedurën e shqyrtimit për të përcaktuar nëse Llogaria e Re e Njësive Ekonomike mbahet nga një ose më shumë Njësi Ekonomike që janë Persona të Raportueshëm. Nëse ndonjë prej Njësive Ekonomike është Person i Raportueshëm, atëherë Llogaria duhet të trajtohet si Llogari e Raportueshme.
4. Për të përcaktuar nëse Njësia Ekonomike është Person i Raportueshëm, nënparagrafi A(1)(a) kërkon që, pas hapjes së llogarisë, Institucioni Financiar Raportues:
  - të marrë një vetëvërtetim që e lejon Institucionin Financiar Raportues të përcaktojë rezidencat e Mbajtësit të Llogarisë për qëllim tatimore; dhe
  - të konfirmojë arsyeshmërinë e këtij vetëvërtetimi bazuar në informacionin e marrë nga Institucioni Financiar Raportues lidhur me hapjen e llogarisë, duke përfshirë çdo dokumentacion të mbledhur sipas Procedurave për AML/KYC.
5. Nëse vetëvërtetimi tregon se Mbajtësi i Llogarisë është rezident në një Juridiksion të Raportueshëm, atëherë, siç parashikohet në nënparagrafin A(1)(b), Institucioni Financiar Raportues duhet ta trajtojë llogarinë si Llogari të Raportueshme përveçse nëse ai përcakton me arsye bazuar në informacionin që disponon ose që është i disponueshëm publikisht (shih paragrafin 12 të Komentit për seksionin V), se Mbajtësi i Llogarisë nuk është Person i Raportueshëm lidhur me këtë Juridiksion të Raportueshëm (p.sh. një korporatë që tregtohet publikisht ose një Subjekt Qeveritar).
6. Kur përcakton nëse një Llogari e Re e Njësive Ekonomike mbahet nga një ose më shumë Njësi Ekonomike që janë Persona të Raportueshëm, Institucioni Financiar Raportues mund të ndjekë udhëzimet në nënparagrafët A(1)(a) dhe (b) sipas rendit më të përshtatshëm në varësi të rrethanave. Kjo do ta lejonte Institucionin Financiar Raportues, për shembull, që të përcaktojë në bazë të paragrafit A(1)(b) se Llogaria e Re e Njësive Ekonomike mbahet nga një Njësi Ekonomike që nuk është Person i Raportueshëm (p.sh. një korporatë e tregtuar publikisht) dhe, si rrjedhojë, Llogaria nuk është Llogari e Raportueshme.
7. Vetëvërtetimi duhet të lejojë përcaktimin e rezidencave të Mbajtësit të Llogarisë për qëllime tatimore. Në praktikë mund të jetë e rrallë që një Njësi Ekonomike të jetë objekt i tatimeve si rezidente në më shumë se një juridiksion, por sigurisht që është e mundur. Legjislacionet e brendshme të juridiksioneve të ndryshme përcaktojnë kushtet sipas të cilave Njësia Ekonomike duhet të trajtohet si “rezidente” nga pikëpamja fiskale. Ato mbulojnë forma të ndryshme lidhjeje ndaj një juridiksioni që, në legjislacionin e brendshëm, formojnë bazën e tatimit gjithëpërfshirës

(përgjegjësi e plotë ndaj tatimeve). Për të zgjidhur rastet e rezidencës së dyfishtë, konventat tatimore përmbajnë rregulla të veçanta të cilat i japin lidhjes me një juridiksion më tepër preferencë se sa me një tjetër për qëllime të atyre konventave. Përgjithësisht, një Njësi Ekonomike do të jetë rezidente për qëllime tatimore në një juridiksion nëse, sipas ligjeve të atij juridiksioni (duke përfshirë konventat tatimore), ajo paguan ose duhet të paguajë tatime aty për shkak të vendbanimit të saj, rezidencës, vendit të menaxhimit ose themelimit ose një kriteri tjetër të ngjashëm, dhe jo vetëm nga burimet në atë juridiksion. Njësitë Ekonomike me rezidencë të dyfishtë mund të mbështeten në rregullat “tiebreaker” (të zhblllokimit të rezultatit) që ndodhen në konventat tatimore (nëse zbatohen) për të zgjidhur rastet e rezidencës së dyfishtë për të përcaktuar rezidencën e tyre për qëllime tatimore (shih paragrafin 13 më poshtë).

8. Shembujt vijues ilustrojnë mënyrën se si mund të përcaktohet rezidenca e Njësive Ekonomike për qëllime tatimore:

- Shembulli 1: Shoqëria është themeluar në Juridiksionin A dhe e ka vendin e menaxhimit efektiv në Juridiksionin B. Sipas ligjeve të Juridiksionit A, rezidenca për qëllime tatimore përcaktohet duke iu referuar vendit të themelimit. E njëjta gjë vlen edhe në bazë të ligjeve të Juridiksionit B. Prandaj, shoqëria është rezidente vetëm në Juridiksionin A.
- Shembulli 2: Faktet janë njësoj si shembulli 1 me përjashtim të faktit se sipas ligjeve të Juridiksionit B, rezidenca për qëllime tatimore përcaktohet duke iu referuar vendit të menaxhimit efektiv. Prandaj, shoqëria është rezidente në të dyja Juridiksionet A dhe B.
- Shembulli 3: Faktet janë njësoj si shembulli 1 me përjashtim të faktit se sipas ligjeve të Juridiksionit A dhe B, rezidenca për qëllime tatimore përcaktohet duke iu referuar vendit të menaxhimit efektiv. Prandaj, shoqëria është rezidente vetëm në Juridiksionin B.
- Shembulli 4: Faktet janë njësoj si shembulli 1 me përjashtim të faktit se sipas ligjeve të Juridiksionit A, rezidenca për qëllime tatimore përcaktohet duke iu referuar vendit të menaxhimit efektiv dhe, sipas ligjeve të Juridiksionit B, rezidenca për qëllime tatimore përcaktohet duke iu referuar vendit të themelimit. Prandaj, shoqëria nuk është rezidente në asnjë prej Juridiksioneve A dhe B.

9. Juridiksionet Pjesëmarrëse priten që t’i ndihmojnë tatimpaguesit të përcaktojnë, si dhe t’u japin atyre informacion lidhur me, rezidencat e tyre për qëllime tatimore. Kjo për shembull mund të bëhet përmes kanaleve të ndryshme të shërbimit që përdoren për dhënien e informacionit ose të orientimeve për tatimpaguesit mbi zbatimin e legjislacioneve tatimore (p.sh. telefon, zyra të aksesueshme lehtësisht, internet). OECD do të bëjë përpjekjet për të lehtësuar shpërhapjen e këtij informacioni.

10. Siç qartësohet edhe nga termi “Person i Juridiksionit të Raportueshëm”, Njësia Ekonomike e tillë si partneriteti, partneriteti me përgjegjësi të kufizuar ose struktura të ngjashme juridike që nuk kanë rezidencë për qëllime tatimore, do të trajtohen si rezidentë në juridiksionin në të cilin ndodhet vendi i saj i menaxhimit efektiv (shih paragrafin 109 të Komentit për seksionin VIII). Në këtë rast dhe kur kjo Njësi Ekonomike vërteton se nuk ka rezidencë për qëllime tatimore, nënparagrafi A(1)(b) i lejon Institucionet Financiare Raportuese që të mbështeten në adresën e zyrës së saj qendrore si faktor për përcaktimin e rezidencës së saj (shih paragrafin 153 të Komentit për seksionin VIII). Shembuj të Njësive Ekonomike që nuk kanë rezidencë për qëllime tatimore përfshijnë ato që trajtohen si transparente nga pikëpamja fiskale dhe ato me të njëjtin model faktesh si në shembullin 4 të paragrafit 8 më lart.

### *Vlefshmëria e vetëvërtetimeve*

11. Siç përmendet në paragrafin 7 të Komentit për seksionin IV, “vetëvërtetimi” është një vërtetim nga Mbajtësi i Llogarisë i cili jep statusin e Mbajtësit të Llogarisë dhe çdo informacion tjetër që mund të kërkohet në mënyrë të arsyeshme nga Institucioni Financiar Raportues për të përmbushur detyrimet e tij të raportimit dhe verifikimit të duhur, si p.sh. nëse Mbajtësi i Llogarisë është rezident për qëllime tatimore në një Juridiksion të Raportueshëm ose nëse Mbajtësi i Llogarisë është një NFE

Pasive. Lidhur me Llogaritë e Reja të Njësive Ekonomike, vetëvërtetimi është i vlefshëm vetëm nëse është në pajtim me kërkesat për vlefshmërinë e vetëvërtetimeve për Llogaritë Paraekzistuese të Njësive Ekonomike (shih paragrafët 14-18 të Komentit për seksionin V). E njëjta gjë vlen për korrigjimin e gabimeve të vetëvërtetimit, kërkesën për të marrë vetëvërtetime në bazë llogarie dhe dokumentacionin e mbledhur nga persona të tjerë.

### *Arsyeshmëria e vetëvërtetimeve*

12. Siç përmendet në paragrafin 4 më lart, në momentin e hapjes së llogarisë, pasi Institucioni Financiar Raportues të ketë marrë vetëvërtetimin që e lejon të përcaktojë rezidencat e Mbajtësit të Llogarisë për qëllime tatimore, Institucioni Financiar Raportues duhet të konfirmojë arsyeshmërinë e këtij vetëvërtetimi bazuar në informacionin e marrë lidhur me hapjen e llogarisë, duke përfshirë çdo dokumentacion të mbledhur sipas Procedurave për AML-KYC (d.m.th. testin e “arsyeshmërisë”).

13. Institucioni Financiar Raportues konsiderohet se e ka konfirmuar “arsyeshmërinë” e vetëvërtetimit nëse, gjatë procesit të procedurave të hapjes së llogarisë dhe pas shqyrtimit të informacionit të marrë lidhur me hapjen e llogarisë (duke përfshirë çdo dokumentacion të mbledhur sipas Procedurave për AML/KYC), ai nuk e di ose nuk ka arsye të dijë se vetëvërtetimi është i pasaktë ose i pabesueshëm (shih paragrafët 2-3 të Komentit për seksionin VII). Nuk pritet që Institucionet Financiare Raportuese të kryejnë një analizë të pavarur ligjore të legjislacioneve përkatëse tatimore për të konfirmuar arsyeshmërinë e vetëvërtetimit.

14. Shembujt vijues ilustrojnë zbatimin e testit të “arsyeshmërisë”:

- Shembulli 1: Institucioni Financiar Raportues merr një vetëvërtetim nga Mbajtësi i Llogarisë në momentin e hapjes së llogarisë. Adresa që gjendet në vetëvërtetim nuk përkon me atë që ndodhet në dokumentacionin e mbledhur sipas Procedurave për AML/KYC. Për shkak të informacionit kontradiktor, vetëvërtetimi është i pasaktë ose i pabesueshëm dhe, si rrjedhojë, ai nuk e kalon testin e “arsyeshmërisë”.
- Shembulli 2: Institucioni Financiar Raportues merr një vetëvërtetim nga Mbajtësi i Llogarisë në momentin e hapjes së llogarisë. Dokumentacioni i mbledhur sipas Procedurave për AML/KYC tregon vetëm vendin e themelimit të Mbajtësit të Llogarisë. Në vetëvërtetim, Mbajtësi i Llogarisë pretendon se është rezident për qëllime tatimore në juridiksionin që ndryshon nga juridiksioni i themelimit. Mbajtësi i Llogarisë i shpjegon Institucionit Financiar Raportues se sipas legjislacioneve përkatëse tatimore rezidenca e tij për qëllime tatimore përcaktohet duke iu referuar vendit të menaxhimit, dhe se juridiksioni ku ndodhet menaxhimi i tij efektiv ndryshon nga juridiksioni në të cilin është themeluar. Prandaj, për shkak se ka një shpjegim të arsyeshëm të informacionit kontradiktor, vetëvërtetimi nuk është i pasaktë ose i pabesueshëm dhe, si rrjedhojë, e kalon testin e arsyeshmërisë.

15. Në rastin e një vetëvërtetimi që nuk e kalon testin e arsyeshmërisë, pritet që Institucioni Financiar Raportues të marrë një vetëvërtetim të vlefshëm gjatë procedurave të hapjes së llogarisë.

### **Nënparagrafi A(2) – Procedurat e shqyrtimit për Personat Kontrollues**

16. Nënparagrafi A(2) përmban procedurën e shqyrtimit për të përcaktuar nëse një Llogari e Re e Njësive Ekonomike mbahet nga një ose më shumë Njësi Ekonomike që janë NFE Pasive me një ose më shumë Persona Kontrollues të cilët janë Persona të Raportueshëm. Nëse ndonjëri prej Personave Kontrollues të NFE-së Pasive është Person i Kontrollueshëm, atëherë llogaria duhet të trajtohet si Llogari e Raportueshme (edhe nëse Personi Kontrollues është rezident në të njëjtin juridiksion si NFE-ja Pasive).

17. Kur bën këto përcaktime, Institucioni Financiar Raportues duhet të ndjekë udhëzimet në nënparagrafët A(2)(a) deri në (c) në rendin më të përshtatshëm sipas rrethanave. Ato nënparagrafë kanë për qëllim të përcaktojnë:

- a) nëse Mbajtësi i Llogarisë është një NFE Pasive;
- b) Personat Kontrollues të kësaj NFE-je Pasive; dhe
- c) nëse ndonjë prej këtyre Personave Kontrollues është Person i Raportueshëm.

**18.** Për qëllime të përcaktimit nëse Mbajtësi i Llogarisë është një NFE Pasive, sipas nënparagrafit A(2)(a), Institucioni Financiar Raportues duhet të mbështetet në vetëvërtetimin nga Mbajtësi i Llogarisë për të përcaktuar statusin e tij, përveçse nëse disponon informacion ose informacioni është i disponueshëm publikisht (shih paragrafin 12 më lart të Komentit për seksionin V), në bazë të të cilit ai mund të përcaktojë me arsye se Mbajtësi i Llogarisë është një NFE Aktive ose një Institucion Financiar i ndryshëm nga njësi ekonomike investimesh jopjesëmarrëse e menaxhuar në mënyrë profesionale (d.m.th. një Njësi Ekonomike Investimesh si ajo e përshkruar në nënparagrafin A(6)(b) të seksionit VIII e cila është një Institucion Financiar i Juridiksionit Pjesëmarrës). Ky vetëvërtetim duhet të pajtohet me kërkesat për vlefshmërinë e vetëvërtetimeve lidhur me Llogaritë Paraekzistuese të Njësive Ekonomike (shih paragrafin 11 më lart). Siç përmendet në paragrafin 18 të Komentit për seksionin IV, Institucioni Financiar Raportues duhet të mbështetet në vetëvërtetimin e furnizuar nga klienti për një llogari tjetër nëse të dyja llogaritë trajtohen si një llogari e vetme për qëllime të përmbushjes së kërkesave të standardeve të njohurisë të parashtruara në paragrafin A të seksionit VII. Institucioni Financiar Raportues që nuk mund ta përcaktojë statusin e Mbajtësit të Llogarisë si një NFE Aktive ose Institucion Financiar i ndryshëm nga njësitë ekonomike të investimeve jopjesëmarrëse të menaxhuara në mënyrë profesionale duhet të supozojë se është një NFE Pasive.

**19.** Për qëllime të përcaktimit të Personave Kontrollues të një Mbajtësi Llogarie, sipas nënparagrafit A(2)(b), Institucioni Financiar Raportues mund të mbështetet në informacionin e mbledhur dhe të mbajtur sipas Procedurave për AML/KYC.

**20.** Për qëllime të përcaktimit nëse një Person Kontrollues i një NFE-je Pasive është Person i Raportueshëm, Institucioni Financiar Raportues mund të mbështetet vetëm në vetëvërtetimin nga Mbajtësi i Llogarisë ose Personi Kontrollues (shih paragrafët 22-23 të Komentit për seksionin V).

**21.** Nëse ka ndryshim në rrethana (shih paragrafin 17 të Komentit për seksionin III) lidhur me Llogaritë e Reja të Njësive Ekonomike që e bëjnë Institucionin Financiar Raportues të dijë ose të ketë arsye të dijë se vetëvërtetimi ose dokumentacione të tjera lidhur me llogarinë janë të pasakta ose të pabesueshme, Institucioni Financiar Raportues duhet ta ripërcaktojë statusin e llogarisë në pajtim me procedurat e parashtruara në paragrafin 27 të Komentit për seksionin V.



## Koment për seksionin VII lidhur me Kërkesat e Veçanta të Verifikimit të Duhur

1. Ky seksion përmban rregullat e veçanta të verifikimit të duhur që kërkohen të zbatohen nga Institucionet Financiare Raportuese përveç kërkesave të përgjithshme të verifikimit të duhur të parashtruara në seksionin II dhe përveç çdo procedure specifike të verifikimit të duhur të zbatohen për llogaritë e mbajtura prej tyre. Këto rregulla janë standardet e njohurisë të zbatueshme për vetëvërtetimin dhe Evidencat Shkresore, një procedurë alternative e verifikimit të duhur për Kontratat e Sigurimit në Vlerë në Para të Gatshme dhe Kontratat e Pensionit që mbahen nga përfituesit individualë, dhe për rregullat e totalizimit të llogarisë dhe të përkthimit të monedhës.

### Paragrafi A – Mbështetja te vetëvërtetimi dhe Evidencat Shkresore

2. Paragrafi A përmban standardet e njohurisë të zbatueshme për vetëvërtetimin ose Evidencat Shkresore. Ai parashikon se Institucioni Financiar Raportues mund të mos mbështetet te vetëvërtetimi ose Evidencat Shkresore nëse Institucioni Financiar Raportues e di (d.m.th. ka njohuri reale) ose ka arsye të dijë se vetëvërtetimi ose Evidenca Shkresore është e pasaktë ose e pabesueshme.

3. Institucioni Financiar Raportues ka arsye të dijë se vetëvërtetimi ose Evidencat Shkresore janë të pabesueshme ose të pasakta nëse njohuritë e tij të fakteve përkatëse ose deklaratave që ndodhen në vetëvërtetim apo dokumentacione të tjera, duke përfshirë njohurinë e menaxherëve përkatës të marrëdhënieve, nëse ka (shih paragrafët 38-42 dhe 50 të Komentit për seksionin III), janë të atilla që një person me gjykim të arsyeshëm në pozicionin e Institucionit Financiar Raportues do ta vinte në dyshim pretendimin e bërë. Institucioni Financiar Raportues gjithashtu ka arsye të dijë se vetëvërtetimi ose Evidencat Shkresore janë të pabesueshme ose të pasakta nëse ka informacion në dokumentacion ose në dosjet e llogarisë së Institucionit Financiar Raportues që bien në kontradiktë me pretendimin e personit lidhur me statusin e tij.

### *Standardet e njohurisë të zbatueshme për vetëvërtetimet*

4. Institucioni Financiar Raportues ka arsye të dijë se vetëvërtetimi i dhënë nga një person është i pabesueshëm ose i pasaktë nëse vetëvërtetimi është i paplotë lidhur me çdo zë në vetëvërtetim që ka lidhje me pretendimet e bëra nga personi, vetëvërtetimi përmban çdo lloj informacioni që nuk është në pajtim me pretendimin e personit, ose Institucioni Financiar Raportues ka informacione të tjera për llogarinë që nuk janë në përputhje me pretendimin e personit. Institucioni Financiar Raportues që mbështetet tek ofruesi i shërbimeve për shqyrtimin dhe mbajtjen e vetëvërtetimit konsiderohet se di ose ka arsye të dijë fakte brenda njohurive të ofruesit të shërbimeve.

### *Standardet e njohurive të zbatueshme për Evidencat Shkresore*

5. Institucioni Financiar Raportues mund të mos mbështetet në Evidencat Shkresore të dhëna nga një person nëse Evidencat Shkresore nuk e përcaktojnë në mënyrë të arsyeshme identitetin e personit që paraqet Evidencat Shkresore. Për shembull, Evidencat Shkresore nuk janë të besueshme nëse jepen personalisht nga individi dhe fotografia ose nënshkrimi në Evidencat Shkresore nuk përputhet me paraqitjen ose nënshkrimin e personit që paraqet dokumentin. Institucioni Financiar Raportues mund të mos mbështetet në Evidencat Shkresore nëse Evidencat Shkresore përmbajnë informacione që nuk janë në përputhje me pretendimin e personit sa i përket statusit të tij, Institucioni Financiar Raportues ka informacione të tjera të llogarisë që nuk janë në pajtim me statusin e personit ose Evidencat Shkresore nuk kanë informacionin e nevojshëm për të përcaktuar statusin e personit.

6. Institucioni Financiar Raportues nuk është i detyruar të mbështetet në një pasqyrë financiare të audituar për të përcaktuar nëse mbajtësi i llogarisë përmbush pragun e caktuar të aktiveve.

Sidoqoftë, nëse Institucioni Financiar Raportues zgjedh ta bëjë këtë, ai ka arsye të dijë se statusi i pretenduar është i pabesueshëm ose i pasaktë vetëm nëse aktivet totale në pasqyrën financiare të audituar për mbajtësin e llogarisë nuk janë brenda pragjeve të lejueshme, ose shënimet apo shënime në fund të faqes të pasqyrës financiare tregojnë se mbajtësi i llogarisë nuk kualifikohet për statusin e pretenduar. Nëse Institucioni Financiar Raportues zgjedh që të mbështetet në pasqyrën financiare të audituar për të përcaktuar se mbajtësi i llogarisë është një NFE Aktive, do të kërkohej që të shqyrtohet bilanci dhe pasqyra e të ardhurave për të përcaktuar nëse mbajtësi i llogarisë përmbush pragun e të ardhurave dhe aktiveve të parashtruar në nënparagrafin D(9)(a) të seksionit VIII dhe shënimet ose shënime në fund të faqes të pasqyrës financiare për një tregues se mbajtësi i llogarisë është institucion financiar. Nëse Institucioni Financiar Raportues zgjedh të mbështetet në pasqyrën financiare të audituar për të përcaktuar statusin e një mbajtësi llogarie që nuk i kërkon mbajtësit të llogarisë të përmbushë pragun e aktiveve ose të të ardhurave, do të kërkohej vetëm shqyrtimi i shënimeve ose shënimeve në fund të faqes të pasqyrës financiare për të përcaktuar nëse pasqyra financiare e mbështet pretendimin e statusit. Nëse Institucioni Financiar Raportues nuk zgjedh të mbështetet në pasqyrën financiare të audituar për të përcaktuar statusin e mbajtësit të llogarisë (për shembull, sepse ka dokumentacione të tjera që përcaktojnë statusin e mbajtësit të llogarisë), Institucionit Financiar Raportues nuk i kërkohej të vlerësojë veçmas pasqyrën financiare vetëm për arsye se ai gjithashtu ka mbledhur pasqyrën financiare të audituar gjatë hapjes së llogarisë ose procedurave të tjera.

7. Institucioni Financiar Raportues nuk është i detyruar të mbështetet në dokumente organizative për të përcaktuar se Njësia Ekonomike ka një status të caktuar. Sidoqoftë, nëse Institucioni Financiar Raportues zgjedh të veprojë kështu, do të kërkohej vetëm shqyrtimi i dokumentit deri në masën e nevojshme për të përcaktuar se kërkesat e zbatueshme për statusin e caktuar janë përmbushur, dhe se dokumenti është ekzekutuar, por nuk do të kërkohej shqyrtimi i pjesës së mbetur të dokumentit.

### *Kufizimet në të drejtën për të ditur*

8. Për qëllime të përcaktimit nëse një Institucion Financiar Raportues që mban një Llogari Paraekzistuese të Njësive Ekonomike ka arsye të dijë se statusi që i është dhënë Njesisë Ekonomike është i pasaktë ose i pabesueshëm, Institucionit Financiar Raportues i kërkohej vetëm që të shqyrtojë informacionin që është në kontradiktë me statusin e pretenduar nëse ky informacion ndodhet në dosjen kryesore aktuale të klientit, vetëvërtetimin më të fundit dhe Evidencat Shkresore për personin, kontratën më të fundit të hapjes së llogarisë dhe dokumentacionin më të fundit të marrë nga Institucioni Financiar Raportues për qëllime të Procedurave për AML/KYC ose për qëllime të tjera rregullatore.

9. Institucioni Financiar Raportues që mban disa llogari për një person të vetëm do të ketë arsye të dijë se statusi për personin është i pasaktë bazuar në informacionin e llogarisë për një tjetër llogari që mbahet nga personi vetëm deri në masën që llogaritë ose kërkohej të totalizohen sipas rregullave të parashtruara në paragrafin C të seksionit VII për totalizimin e llogarisë ose në të kundërt trajtohen si një llogari e vetme për qëllime të përmbushjes së kërkesave të standardeve të njohurisë të parashtruara në paragrafin A të seksionit VII.

10. Institucioni Financiar Raportues nuk e di ose nuk ka arsye të dijë se vetëvërtetimi ose Evidencat Shkresore janë të pabesueshme ose të pasakta vetëm për shkak të ndryshimit të adresës në të njëjtin juridiksion si ai i adresës së mëparshme. Gjithashtu, Institucioni Financiar Raportues nuk e di ose nuk ka arsye të dijë se vetëvërtetimi ose Evidencat Shkresore janë të pabesueshme ose të pasakta vetëm sepse ai zbulon ndonjë prej indicieve të renditura në nënparagrafin B(2)(c) deri në (e) të seksionit III dhe këto indicie bien në kontradiktë me vetëvërtetimin ose Evidencat Shkresore. Shembujt vijues ilustrjnë zbatimin e kufizimeve për standardet e njohurisë:

- Shembulli 1: A, një bankë e cila është Institucion Financiar Raportues, mban një Llogari Depozite për P, një Mbajtës individual Llogarie. Llogaria e Depozitës është një Llogari Paraekzistuese dhe A është mbështetur në adresën në regjistrat e saj për P, mbështetur nga

pasaporta e tij dhe fatura e shërbimeve utilitare e mbledhur në momentin e hapjes së llogarisë, për të përcaktuar se P është rezident për qëllime tatimore në juridiksionin X (zbatimi i testit të adresës së rezidencës). Pas pesë vitesh, P i jep një prokurë të posaçme motrës së tij, e cila jeton në juridiksionin Y, për të vepruar me llogarinë e tij. Fakti që P i ka dhënë këtë prokurë nuk mjafton për t'i dhënë arsye A të dijë se Evidencat Shkresore mbi të cilat u mbështet për ta trajtuar P si rezident të juridiksionit X janë të pabesueshme ose të pasakta.

- Shembulli 2: B, një shoqëri sigurimesh e cila është një Institucion Financiar Raportues, ka nënshkruar një Kontratë Sigurimi në Vlerë në Para të Gatshme me Q. Duke qenë se kontrata është një Llogari e Re Individuale, B ka marrë një vetëvërtetim nga Q dhe e ka konfirmuar arsyeshmërinë e tij mbi bazën e dokumentacionit për AML/KYC të mbledhur nga Q. Vetëvërtetimi konfirmon se Q është rezident për qëllime tatimore në juridiksionin V. Dy vite pasi Q ka hyrë në marrëdhënie kontraktuale me Q, Q i jep B një numër telefoni në juridiksionin W. Edhe pse B nuk ka pasur më parë ndonjë numër telefoni në regjistrat e tij për Q, thjesht marrja e numrit të telefonit në juridiksionin W nuk përbën arsye për të ditur se vetëvërtetimi fillestar është i pabesueshëm ose i pasaktë.

## **Paragrafi B – Procedurat alternative për Kontratat në Vlerë në Para të Gatshme dhe të Pensionit**

11. Paragrafi B përmban një procedurë alternative për Kontratat e Sigurimit në Vlerë në Para të Gatshme dhe Kontratat e Sigurimit të mbajtura nga përfitues individualë që thjeshtëson procedurat e verifikimit të duhur të cilat janë gjithashtu të zbatueshme. Institucioni Financiar Raportues mund të supozojë se përfituesi individual (i ndryshëm nga pronari) i një Kontrate Sigurimi në Vlerë në Para të Gatshme ose Kontrate Pensioni që përfiton pension familjar nuk është Person i Raportueshëm dhe mund ta trajtojë këtë Llogari Financiare si të ndryshme nga Llogaria e Raportueshme përveçse nëse Institucioni Financiar Raportues ka njohuri reale ose arsye të dijë se përfituesi është një Person i Raportueshëm.

12. Institucioni Financiar Raportues ka arsye të dijë se përfituesi i Kontratës së Sigurimit në Vlerë në Para të Gatshme ose i Kontratës së Pensionit është një Person i Raportueshëm nëse informacioni i mbledhur nga Institucioni Financiar Raportues dhe që lidhet me përfituesin përmban indicie siç përshkruhen në paragrafin B të seksionit III. Nëse Institucioni Financiar Raportues ka njohuri reale, ose arsye të dijë, se përfituesi është një Person i Raportueshëm, Institucioni Financiar Raportues duhet të ndjekë procedurat në paragrafin B të seksionit III.

13. Një procedurë alternative e ngjashme me atë të diskutuar mund të jetë e nevojshme për disa kontrata pensioni ose kontrata sigurimi në grup të sponsorizuara nga punëdhënësi. Kur një kontratë sigurimi në grup ose kontratë pensioni vjetor i lëshohet një punëdhënësi dhe punëmarrësit individualë janë të siguruarit/përfituesit, shoqëria e sigurimeve nuk ka një marrëdhënie direkte me punëmarrësin/mbajtësit e certifikatës në fillimin e kontratës. Juridiksionet që duan të ofrojnë këtë procedurë mund të përfshijnë dispozitën vijuese:

*Institucioni Financiar Raportues mund ta trajtojë Llogarinë Financiare, që është interes i një anëtari në një Kontratë Sigurimi në Grup në Vlerë në Para të Gatshme ose Kontratë Pensioni në Grup, si Llogari Financiare që nuk është e Llogari e Raportueshme deri në datën në të cilën shumat i paguhet punëmarrësit/mbajtësit të certifikatës ose përfituesit, nëse Llogaria Financiare që është interesi i një anëtari në Kontratë Sigurimi në Grup në Vlerë në Para të Gatshme ose Kontratë Pensioni në Grup të përmbushë kërkesat vijuese:*

a) *Kontrata e Sigurimit në Grup në Vlerë në Para të Gatshme ose Kontrata e Pensionit në Grup i lëshohet një punëdhënësi dhe mbulon njëzetë e pesë ose më shumë punëmarrës/mbajtës certifikatash;*

b) *Punëmarrësit/mbajtësit e certifikatave kanë të drejtë të përfitojnë çdo vlerë kontrate që lidhet me interesat e tyre dhe të caktojnë përfituesit për përfitimin e pagesës që kryhet pas vdekjes së punëmarrësit; dhe*

c) *Shuma e totalizuar që i paguhet çdo punonjësi/mbajtësi certifikate ose përfituesi nuk e kalon vlerën 1 000 000 USD.*

*Termi “Kontratë e Sigurimit në Grup në Vlerë në Para të Gatshme” është Kontrata e Sigurimit në Vlerë në Para të Gatshme që (i) ofron sigurim për individët të cilët janë të lidhur përmes një punëdhënësi, shoqate tregtare, sindikate pune ose shoqate apo grupi tjetër; dhe (ii) tarifton një prim për çdo anëtar të grupit (ose anëtar të kategorisë brenda grupit) që përcaktohet pa iu referuar karakteristikave shëndetësore të individit përveçse moshës, gjinisë dhe zakonet e duhanpirjes së anëtarit (ose kategorisë së anëtarëve) të grupit. Termi “Kontratë Pensioni në Grup” është Kontrata e Pensionit sipas së cilës personat ndaj të cilëve ka detyrime janë individë të cilët janë të lidhur përmes një punëdhënësi, shoqate tregtare, sindikate pune ose shoqate apo grupi tjetër.*

### **Paragrafi C – Rregullat e totalizimit të llogarisë dhe të përkthimit të monedhës**

#### *Nënparagrafët C(1) deri në (3) – Rregullat e totalizimit të llogarisë*

14. Nënparagrafët C(1) deri në (3) përmbajnë rregullat e totalizimit të llogarisë që duhet të ndjekin Institucionet Financiare Raportuese për qëllime të përcaktimit të bilancit dhe të vlerës së totalizuar të Llogarive Financiare.

15. Rregulli i parë dhe i dytë i totalizimit të llogarisë janë identikë, përveç se rregulli i parë është i zbatueshëm për Llogaritë Financiare që mbahen nga individë dhe rregulli i dytë për ato që mbahen nga Njësitë Ekonomike. Rregullat parashikojnë që:

- Institucionit Financiar Raportues i kërkohet të totalizojë (ose të marrë në konsideratë) të gjitha Llogaritë Financiare që mbahen nga Institucioni Financiar Raportues, ose nga një Njësi Ekonomike e Lidhur me të, por deri në masën që sistemet e kompjuterizuara të Institucionit Financiar Raportues i lidhin Llogaritë Financiare duke iu referuar një elementi të dhënash si numri i klientit ose NIPT-i, dhe lejojnë totalizimin e vlerave ose të balanceve të llogarisë.
- secilit mbajtës të një Llogarie Financiare të mbajtur bashkërisht i atribuohet i gjithë bilanci ose vlera e Llogarisë Financiare të mbajtur bashkërisht për qëllime të zbatimit të kërkesave të totalizimit.

16. Rregulli i tretë i totalizimit të llogarisë është një rregull i veçantë që zbatohet për të përcaktuar nëse një Llogari Financiare është një Llogari e Vlerës së Lartë. Në bazë të këtij rregulli, Institucionit Financiar Raportues i kërkohet që, përveç rregullave të tjera të totalizimit të llogarisë, të totalizojë të gjitha Llogaritë Financiare për të cilat menaxheri i marrëdhënieve ka dijeni, ose ka arsye të ketë dijeni, se janë direkt ose indirekt të zotëruara, kontrolluara ose të krijuara (përveçse në cilësinë e mbajtjes në besueshmëri) nga i njëjti person (shih paragrafin 3 më lart dhe 38-42 të Komentit për seksionin III). Kjo kërkesë përfshin totalizimin e të gjitha llogarive që menaxheri i marrëdhënieve i ka lidhur me njëra tjetrën nëpërmjet emrit, kodit të marrëdhënies, numri të identifikimit të klientit, NIPT-it ose treguesi tjetër të ngjashëm, apo që menaxheri i marrëdhënieve do t'i lidhte me njëra tjetrën në mënyrë tipike sipas procedurave të institucionit financiar (apo të departamentit, divizionit ose njësisë me të cilën lidhet menaxheri i marrëdhënieve).

17. Në disa juridiksione, legjislacioni i brendshëm nuk e lejon zbatimin e rregullave të totalizimit të llogarisë siç parashikohet në nënparagrafët C(1) deri në (3). Për shembull, sistemet e kompjuterizuara të Institucionit Financiar Raportues mund të jenë të aftë për të lidhur të gjitha Llogaritë Financiare që mbahen nga Institucioni Financiar Raportues dhe Njësitë e tij të Lidhura Ekonomike, por legjislacioni i brendshëm mund ta kufizojë një ose më shumë nga këto Njësi të Lidhura Ekonomike që të ndajë të dhënat personale të mbajtësit të llogarisë me Institucionin Financiar Raportues. Kur ndodh kështu, Institucionit Financiar Raportues i kërkohet të zbatojë



rregullat e totalizimit të llogarisë siç parashtrohen në nënparagrafët C(1) deri në (3), por deri në masën që lejohet nga legjislacioni i brendshëm.

**18. Shembujt vijues ilustrojnë zbatimin e rregullave të totalizimit të llogarisë:**

- Shembulli 1 (Institucionet Raportuese Financiare të cilave nuk u kërkohet të totalizojnë llogaritë): Njësia Ekonomike, U, mban një llogari depozite pranë AP, një bankë tregtare e cila është një Institucion Financiar Raportues. Bilanci në llogarinë e U-së në fund të vitit 1 është 160 000 USD. U gjithashtu mban dhe një llogari tjetër depozite pranë AP, me një bilanc prej 165 000 USD në fund të vitit 1. Veprimtaritë bankare për individë të AP-së kanë sisteme të përbashkëta të kompjuterizuara të menaxhimit të informacionit, por llogaritë e U-së nuk janë të lidhura me njëra tjetrën në sistemin e përbashkët të kompjuterizuar. Duke qenë se llogaritë nuk janë të lidhura në sistemin e AP-së, AP-së nuk i kërkohet t'i totalizojë llogaritë sipas nënparagrafëve C(2) dhe (3) dhe të dyja llogaritë kualifikohen për përjashtimin e përshkruar në paragrafin A të seksionit V sepse asnjëra prej tyre nuk e kalon pragun prej 250 000 USD.
- Shembulli 2 (Institucionet Raportuese Financiare të cilave u kërkohet të totalizojnë llogaritë): Të njëjtat fakte si shembulli 1, përveçse të dyja llogaritë e depozitës së U-së lidhen me U-në dhe me njëra tjetrën duke iu referuar numrit të brendshëm të identifikimit të AP-së. Sistemi tregon bilancet e llogarisë për të dyja llogaritë, dhe këto bilance mund të totalizohen elektronikisht, pavarësisht se sistemi nuk tregon një bilanc të kombinuar për llogaritë. Për të përcaktuar nëse këto llogari përmbushin përjashtimin që përshkruhet në paragrafin A të seksionit V për llogaritë me një bilanc ose vlerë të totalizuar prej 250 000 USD ose më pak, AP-së i kërkohet t'i totalizojë bilancet e llogarisë të të gjitha llogarive të depozitës sipas rregullave të totalizimit të llogarisë. Sipas atyre rregullave, U trajtohet si mbajtëse e llogarive të depozitës pranë AP me një bilanc të totalizuar prej 325 000 USD. Përkatesisht, asnjëra prej llogarive nuk kualifikohet për përjashtim, sepse kur totalizohen, llogaritë e kalojnë pragun prej 250 000 USD.
- Shembulli 3 (Rregullat e totalizimit për llogaritë e përbashkëta që mbahen nga një Institucion Financiar Raportues): Në vitin 1, individ U mban një llogari kujdestarie që është një llogari paraekzistuese në institucionin e kujdestarisë SH, një Institucion Financiar Raportues. Bilanci në llogarinë e Kujdestarisë së U-së pranë SH-së në fund të vitit 1 është 700 000 USD. U gjithashtu mban një llogari kujdestarie të përbashkët e cila është një llogari paraekzistuese së bashku me motrën e saj, A, pranë një institucioni tjetër kujdestarie SH2. Bilanci në llogarinë e përbashkët në fund të vitit 1 gjithashtu është 700 000 USD. SH dhe SH2 janë Njësi të Lidhura Ekonomike dhe kanë sisteme të përbashkëta të kompjuterizuara të menaxhimit të informacionit. Si llogaria e kujdestarisë e U-së në SH dhe llogaria e kujdestarisë së U-së dhe A-së në SH2 lidhen me U-në dhe me njëra tjetrën përmes numrit të brendshëm të identifikimit të SH-së dhe sistemi lejon totalizimin e llogarive. Për të përcaktuar nëse këto llogari përmbushin përkufizimin e “Llogarisë së Vlerës së Lartë”, SH-së i kërkohet të totalizojë bilancet e llogarive të llogarive që mbahen tërësisht ose pjesërisht nga i njëjti mbajtës llogarie sipas rregullave të totalizimit të llogarisë. Sipas atyre rregullave, U vlerësohet se ka llogari financiare pranë SH dhe SH2, secila me një bilanc të totalizuar prej 1 400 000 USD. Përkatesisht, të dyja llogaritë e U-së janë Llogari të Vlerës së Lartë. A-ja vlerësohet se ka vetëm një llogari financiare pranë SH2 me një bilanc prej 700 000 USD duke qenë se nuk është një Mbajtës Llogarie e llogarisë së kujdestarisë së U-së pranë SH. Kështu, llogaria e A-së është një Llogari e Vlerës së Ulët.

**19. Shembujt vijues shtesë ilustrojnë zbatimin e rregullit të veçantë të totalizimit që zbatohet për menaxherët e marrëdhënieve:**

- Shembulli 1 (Llogaritë që mbahen nga një NFE Pasive dhe nga një prej Personave të saj Kontrollues): Një NFE Pasive T, mban një llogari depozite pranë A-së, një bankë tregtare e cila është Institucion Financiar Raportues. Një prej Personave Kontrollues të T-së, N, gjithashtu mban një llogari depozite pranë A-së. Të dyja llogaritë lidhen me N dhe me njëra



tjetrën duke iu referuar numrit të brendshëm të identifikimit të A-së. Gjithashtu, A ka caktuar një menaxher marrëdhëniesh për N-në. Për shkak se llogaritë janë të lidhura në sistemin e A-së dhe përmes një menaxheri marrëdhëniesh, A-së i kërkohet t'i totalizojë llogaritë sipas nënpragrafëve C(1) deri në (3).

- Shembulli 2 (Llogaritë që mbahen nga NFE të ndryshme Pasive me një Person të Përbashkët Kontrollues): Të njëjtat fakte si në shembullin 1. Përveç atyre, edhe një NFE tjetër Pasive, I, mban një llogari depozite pranë A-së. N është gjithashtu një prej Personave Kontrollues të I-së. Llogaria e I-së nuk lidhet me N-në dhe as me llogaritë e T-së dhe të N-së përmes numrit të brendshëm të identifikimit të A-së. Duke qenë se llogaritë lidhen përmes një menaxheri marrëdhëniesh, A-së i kërkohet t'i totalizojë llogaritë sipas nënpragrafëve C(1) deri në (3).

#### *Nënparagrafi C(4) – Rregulli i përkthimit të monedhës*

**20.** Nënparagrafi C(4) përmban rregullin e përkthimit të monedhës, sipas së cilit të gjitha shumat në dollarë janë në dollarë amerikanë dhe do të lexohen se përfshijnë shumat ekuivalente në monedha të tjera, siç përcaktohet nga legjislacioni i brendshëm. Kur zbatojnë Standardin e Përbashkët të Raportimit, juridiksionet priten që të përdorin shumat të cilat janë ekuivalente në monedhën e tyre me shumat e pragjeve në dollarë amerikanë të përshkruara në Standard. Gjithsesi, atyre nuk u kërkohet të përdorin shumat e sakta ekuivalente me shumat e pragjeve në dollarë amerikanë. Mjaftojnë edhe shumat e përafërta ekuivalente.

**21.** Kur zbatojnë Standardin e Përbashkët të Raportimit, juridiksionet mund t'i lejojnë Institucionet Financiare Raportuese që të zbatojnë shumat e pragjeve në dollarë amerikanë të përshkruara në Standard, së bashku me shumat ekuivalente në monedha të tjera. Kjo do t'i lejonte institucionet financiare që veprojnë në disa juridiksione që t'i zbatojnë shumat pragje në të njëjtën monedhë në të gjitha juridiksionet në të cilat veprojnë.

## Koment për seksionin VIII lidhur me termat e përkufizuara

1. Seksioni VIII përmban termat e përkufizuara, të grupuara rreth 5 temave: A) Institucion Financiar Raportues; B) Institucion Financiar Joraportues, C) Llogari Financiare, D) Llogari e Raportueshme dhe E) Të ndryshme.

### Paragrafi A – Institucioni Financiar Raportues

#### *Nënparagrafët A(1) dhe (2) – Institucioni Financiar Raportues*

#### Institucioni Financiar Raportues

2. Nënparagrafi A(1) e përkufizon termin “Institucion Financiar Raportues” si çdo Institucion Financiar i Juridiksionit Pjesëmarrës që nuk është Institucion Financiar Joraportues. Prandaj, që një Institucion Financiar të jetë një Institucion Financiar Raportues, së pari, ai duhet të jetë një Institucion Financiar i Juridiksionit Pjesëmarrës dhe, më pas, të mos jetë një Institucion Financiar Jopjesëmarrës. Paragrafi B parashtron kuptimin e termit “Institucion Financiar Joraportues” përmes disa përkufizimeve.

#### Institucioni Financiar i Juridiksionit Pjesëmarrës

3. Termi “Institucion Financiar i Juridiksionit Pjesëmarrës” përkufizohet në nënpragrafin A(2) dhe është:
  - çdo Institucion Financiar që është rezident në Juridiksionin Pjesëmarrës, por përjashton çdo degë të atij Institucioni Financiar që ndodhet jashtë këtij Juridiksioni Pjesëmarrës, dhe
  - çdo degë që ndodhet në Juridiksionin Pjesëmarrës të Institucionit Financiar, që në vetvete nuk është rezident në këtë Juridiksion Pjesëmarrës.
4. Për këtë qëllim, Institucioni Financiar është “rezident” në një Juridiksion Pjesëmarrës nëse është objekt i juridiksionit të këtij Juridiksioni Pjesëmarrës (d.m.th. Juridiksioni Pjesëmarrës mund të bëjë të zbatueshëm raportimin nga Institucioni Financiar). Përgjithësisht, kur Institucioni Financiar është rezident për qëllime tatimore në një Juridiksion Pjesëmarrës, ai është objekt i juridiksionit të këtij Juridiksioni Pjesëmarrës dhe, si rezultat, është një Institucion Financiar i Juridiksionit Pjesëmarrës. Në rastin e një trusti që është Institucion Financiar (pavarësisht nëse është rezident për qëllime tatimore në një Juridiksion Pjesëmarrës), trusti konsiderohet se është objekt i juridiksionit të Juridiksionit Pjesëmarrës nëse një apo më shumë prej administratorëve të tij të besuar janë rezidentë në këtë Juridiksion Pjesëmarrës, përveçse nëse trusti e raporton të gjithë informacionin që kërkohet të raportohet sipas CRS-së lidhur me Llogaritë e Raportueshme që mbahen nga trusti te një tjetër Juridiksion Pjesëmarrës për shkak se është rezident për qëllime tatimore në këtë Juridiksion Pjesëmarrës. Sidoqoftë, në rastin kur Institucioni Financiar (i ndryshëm nga trusti) nuk ka rezidencë për qëllime tatimore (p.sh. sepse trajtohet si transparent nga pikëpamja fiskale, ose sepse ndodhet në një juridiksion që nuk ka tatim mbi të ardhurat), konsiderohet se është objekt i juridiksionit të një Juridiksioni Pjesëmarrës dhe, si rrjedhojë, është Institucion Financiar i Juridiksionit Pjesëmarrës nëse:

- a) është themeluar sipas ligjeve të Juridiksionit Pjesëmarrës;

- b) e ka vendin e menaxhimit (duke përfshirë menaxhimin efektiv) në Juridiksionin Pjesëmarrës; ose
- c) është objekt i mbikëqyrjes financiare në Juridiksionin Pjesëmarrës.

Në këtë kontekst, termi “Institucion Pjesëmarrës” i referohet një juridiksioni që ka zbatuar Standardin e Përbashkët të Raportimit.

5. Në rastin kur një Institucion Financiar (i ndryshëm nga trusti) është rezident në dy ose më shumë Juridiksione Pjesëmarrëse, ky Institucion Financiar do të jetë objekt i detyrimeve të raportimit dhe verifikimit të duhur të Juridiksionit Pjesëmarrës në të cilin ai mban Llogaritë Financiare.
6. “Dega” është një njësi, biznes ose zyrë e Institucionit Financiar që trajtohet si degë në bazë të regjimit rregullator të juridiksionit ose që në të kundërt rregullohet sipas ligjeve të juridiksionit veçmas nga zyrat, njësitë ose degët e tjera të Institucionit Financiar. Dega përfshin një njësi, biznes ose zyrë të Institucionit Financiar që ndodhet në një juridiksion në të cilin është rezident Institucioni Financiar, si dhe një njësi, biznes ose zyrë të një Institucioni Financiar Raportues që ndodhet në juridiksionin ku është krijuar ose organizuar Institucioni Financiar. Të gjitha njësitë, bizneset ose zyrat e Institucionit Financiar Raportues në një juridiksion të vetëm do të trajtohen si një degë e vetme.

### *Nënparagrafët A(3) deri në (8) – Institucioni Financiar*

7. Termi “Institucion Financiar” është një Institucion Kujdestarie, Institucion Depozite, Njësi Ekonomike Investimesh ose një Shoqëri Sigurimesh e Specifikuar, siç përcaktohet në nënparagrafin A(3).

8. Nëse Njësia Ekonomike është objekt i ligjeve dhe rregulloreve financiare të një Juridiksioni Pjesëmarrës, ose është objekt i mbikëqyrjes dhe shqyrtimit nga agjencitë që bëjnë mbikëqyrjen rregullatore të institucioneve financiare, lidhet me, por jo domosdoshmërisht përcaktuese e, faktit nëse Njësia Ekonomike kualifikohet si Institucion Financiar sipas nënparagrafit A(3).

### *Institucioni i Kujdestarisë*

9. Nënparagrafi A(4) e përkufizon termin “Institucion Kujdestarie” si çdo Njësi Ekonomike që mban, si pjesë thelbësore të biznesit të saj, Aktive Financiare për llogari të të tjerëve.

10. Më pas përcakton testin e “pjesës thelbësore”. Njësia Ekonomike mban Aktive Financiare për llogari të të tjerëve si pjesë thelbësore e biznesit të saj nëse të ardhurat bruto të Njesisë Ekonomike që i atribuohen mbajtjes së Aktiveve Financiare dhe shërbimeve financiare të lidhura me to janë të barabarta me ose i tejkalojnë 20% të të ardhurave bruto të Njesisë Ekonomike gjatë periudhës më pak se:

- tre vjeçare që mbaron më 31 dhjetor (ose në ditën e fundit të periudhës kontabël të vitit jokalendarik) përpara vitit në të cilin bëhet përcaktimi; ose
- periudha gjatë së cilës Njësia Ekonomike ka ekzistuar.

“Të ardhurat që i atribuohen mbajtjes së Aktiveve Financiare dhe shërbimeve të lidhura me to” janë tarifat për kujdestarinë, mirëmbajtjen e llogarisë dhe transfertat; komisionet dhe tarifat e fituara nga ekzekutimi dhe vendosja e çmimeve për transaksionet e letrave me vlerë lidhur me Aktivet Financiare që mbahen nën kujdestari; të ardhurat e fituara nga dhënia e kredive për klientët lidhur me Aktivet Financiare që mbahen nën kujdes (ose të blera përmes zgjerimit të kësaj linje kredie); të ardhurat e fituara nga marzhi midis çmimit të kërkuar dhe atij të ofruar të Aktiveve Financiare që mbahen nën kujdes; dhe tarifat për ofrimin e këshillave financiare lidhur me Aktivet Financiare që mbahen nën (ose që ka gjasa të mbahen nën) kujdestari nga njësia ekonomike; dhe për shërbime kompensimi dhe shlyerjeje.

11. Njësitë Ekonomike që mbajnë të sigurt Aktivet Financiare për llogari të tjerëve si bankat e kujdestarisë, brokerat dhe thesaret qendrore të letrave me vlerë, përgjithësisht do të konsiderohen si Institucione Kujdestarie. Njësitë Ekonomike që nuk mbajnë Aktive Financiare për llogari të tjerëve, si brokerat e sigurimeve, nuk do të jenë Institucione Kujdestarie.

### Institucion Depozite

12. Nënparagrafi A(5) e përkufizon termin “Institucion Depozite” si çdo Njësi Ekonomike që pranon depozita në funksionimin e zakonshëm të veprimtarisë bankare ose të ngjashme me të.

13. Njësia Ekonomike konsiderohet se është e angazhuar në “veprimtari bankare ose të ngjashme me to” nëse, gjatë funksionimit të zakonshëm të veprimtarisë së saj me klientë, Njësia Ekonomike pranon depozita ose investime të tjera të ngjashme fondesh dhe angazhohet rregullisht në një ose më shumë prej veprimtarive vijuese:

- a) jep kredi personale, hipotekare, industriale ose të tjera, apo ofron linja të tjera kredie;
- b) blen, shet, zbret ose negocion llogari të arkëtueshme, detyrime këstesh, nota, çeqe, kambiale, pranime bankare ose evidenca të tjera detyrimi;
- c) lëshon letër kredi dhe negocion çeqe të plotësuar në bazë të tyre;
- d) ofron shërbime trusti ose fiduciare;
- e) financon transaksionet e këmbimit valutor; ose
- f) hyn në, blen ose zgjidh qira financiare ose aktive të dhëna/marra me qira.

Njësia Ekonomike nuk konsiderohet se është e angazhuar në veprimtari bankare ose të ngjashme me të nëse Njësia Ekonomike pranon vetëm depozita nga personat si kolateral ose siguri në bazë të shitjes ose qirasë së pasurisë, ose në bazë të një instrumenti financiar të ngjashëm ndërmjet kësaj Njësie dhe personit që mban depozitën pranë Njesisë Ekonomike.

14. Bankat e kursimeve, bankat tregtare, shoqatat e kursimeve dhe të kredive, si dhe unionet e kredive përgjithësisht do të konsiderohen Institucione Depozituese. Sidoqoftë, nëse Njësia Ekonomike kryen një veprimtari bankare ose të ngjashme përcaktohet bazuar në karakterin e veprimtarive aktuale të kësaj Njësie Ekonomike.

### Njësia Ekonomike e Investimeve

15. Termi “Njësi Ekonomike e Investimeve” përfshin dy lloje Njësish Ekonomike: Njësitë që kryesisht ushtrojnë veprimtari ose operacione biznesi të investimeve për llogari të personave të tjerë, dhe Njësitë që menaxhohen nga ato Njësi Ekonomike ose Institucione të tjera Financiare.

16. Nënparagrafi A(6)(a) e përkufizon llojin e parë të “Njesisë Ekonomike të Investimeve” si çdo Njësi Ekonomike që kryesisht ushtron si veprimtari biznesi një ose më shumë prej veprimtarive ose operacioneve të mëposhtme për llogari dhe në emër të klientit:

- a) tregti në instrumentet e tregut të parasë (çeqe, kambiale, certifikata depozite, derivativë, etj); këmbim valutor; këmbim, normë interesi dhe instrumente indeksi; letra me vlerë të transferueshme; ose transaksione me kontratat e së ardhmes (future) për mallrat;
- b) menaxhim të portofoleve individuale dhe kolektive; ose
- c) gjithashtu investon, administron ose menaxhon aktivet financiare ose paratë për llogari të personave të tjerë.

Këto aktivitete ose operacione nuk përfshijnë ofrimin e këshillave jo të detyrueshme për investimet për klientët.

17. Nënparagrafi A(6)(b) e përkufizon llojin e dytë të “Njesisë Ekonomike të Investimeve” si çdo Njësi Ekonomike të ardhurat bruto të së cilës i atribuohen kryesisht investimeve, riinvestimeve ose tregtisë në aktive financiare, nëse Njësia menaxhohet nga një tjetër Njësi Ekonomike që është Institucion Depozite, Institucion Kujdestarie, Shoqëri e Sigurimeve e Specifikuar ose një Njësi Ekonomike e përshkruar në nënparagrafin A(6)(a). Njësia Ekonomike “menaxhohet nga” një tjetër Njësi Ekonomike nëse Njësia menaxhuese, qoftë direkt ose përmes një tjetër ofruesi shërbimesh, kryen ndonjë prej aktiviteteve ose operacioneve të përshkruara në nënparagrafin A(6)(a) për llogari të Njesisë Ekonomike të menaxhuar. Sidoqoftë, një Njësi nuk e menaxhon një Njësi tjetër nëse nuk ka autoritetin e pavarur për të menaxhuar aktivet e Njesisë Ekonomike (tërësisht ose pjesërisht). Në rastin kur Njësia Ekonomike menaxhohet nga një miks Institucionesh Financiare, NFE dhe individë, Njësia konsiderohet se menaxhohet nga një tjetër Njësi Ekonomike që është Institucion Depozite, Institucion Kujdestarie, Shoqëri Sigurimesh e Specifikuar ose një Njësi Investimesh e përshkruar në nënparagrafin A(6)(a), nëse ndonjë prej Njësive Ekonomike menaxhuese është kjo Njësia tjetër.
18. Njësia Ekonomike trajtohet se po kryhen kryesisht si biznes një ose më shumë prej veprimtarive të përshkruara në nënparagrafin A(6)(a), ose të ardhurat bruto të Njesisë Ekonomike i atribuohen kryesisht investimeve, riinvestimeve ose tregtisë në aktive financiare për qëllime të nënparagrafit A(6)(b), nëse të ardhurat bruto të Njesisë Ekonomike që i atribuohen veprimtarive përkatëse janë të barabarta ose i tejkalojnë 50% të të ardhurave bruto të Njesisë Ekonomike në më pak se:
- periudha tre vjeçare që përfundon më 31 dhjetor të vitit që vjen përpara vitit në të cilin është bërë përcaktimi; ose
  - periudha gjatë së cilës Njësia Ekonomike ka ekzistuar.
19. Termi “Njësi Ekonomike Investimi”, siç përcaktohet në nënparagrafin A(6), nuk përfshin Njësine Ekonomike që është një NFE Aktive sepse ajo përmbush ndonjë prej kriterëve në nënparagrafët D(9)(d) deri në (g) (d.m.th NFE holding dhe qendra thesari që janë anëtarë të një grupi jofinanciar; NFE të reja (start-up); dhe NFE që janë në likuidim ose po dalin nga falimentimi).
20. Njësia Ekonomike përgjithësisht do të konsiderohet një Njësi Ekonomike e Investimeve nëse funksionon ose vepron si një instrument investimesh kolektive, fond i përbashkët, fond i listuar në bursë, fond privat në kapital neto, fond mbulimi, fond me sipërmarrje kapitali, fond blerjeje me financim nga të tretë ose si çdo instrument tjetër i ngjashëm investimesh i krijuar përmes një strategjie investimesh të investimit, riinvestimit ose tregtimit në Aktive Financiare. Njësia Ekonomike e cila ushtron kryesisht veprimtarinë e biznesit në investim, administrim ose menaxhim të interesave të drejtpërdrejta jodebitore në pasuri të paluajtshme për llogari të të tjerëve, të tilla si trusti i investimeve në pasuri të paluajtshme, nuk do të jetë një Njësi Ekonomike Investimesh.
21. Nënparagrafi A(6) gjithashtu shprehet se përkufizimi i termit “Njësi Ekonomike Investimesh” do të interpretohet në një mënyrë të pajtueshme me gjuhën e ngjashme të parashtruar në përkufizimin e “institucionit financiar” në Rekomandimet e Task Forcës për Aksionin Financiar<sup>13</sup>.
22. Shembujt vijues ilustrojnë zbatimin e nënparagrafit A(6):

<sup>13</sup> FATF/OECD (2013), Standardet Ndërkombëtare për Luftën kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit dhe Përhapjes së Terrorizmit, Rekomandimet e FATF-së, shkurt 2012, FATF/OECD, Paris, gjendet në [www.fatf-gafi.org/media/fatf/documents/recommendations/pdfs/FATF\\_Recommendations.pdf](http://www.fatf-gafi.org/media/fatf/documents/recommendations/pdfs/FATF_Recommendations.pdf).



- Shembulli 1 (Këshilltari i investimeve): Menaxheri i fondit është një Njësi Ekonomike Investimesh brenda kuptimit të nënparagrafit A(6)(a). Menaxheri i fondit, ndërmjet operacioneve të tij të ndryshme të biznesit, organizon dhe menaxhon një shumëllojshmëri fondesh, duke përfshirë Fondin A, një fond i cili kryesisht investon në kapitale neto. Menaxheri i fondit kontraktin këshilltarin e investimeve, një Njësi Ekonomike, për të ofruar këshilla dhe menaxhim të kujdesshëm të një pjese të Aktiveve Financiare që mbahen nga Fondi A. Këshilltari i investimeve i ka fituar më shumë se 50% të të ardhurave të tij bruto për tre vitet e fundit nga ofrimi i shërbimeve të ngjashme. Për shkak se këshilltari i investimeve kryesisht ushtron veprimtarinë e biznesit të menaxhimit të Aktiveve Financiare për llogari të klientëve, këshilltari i investimeve është një Njësi Ekonomike Investimesh sipas nënparagrafit A(6)(a). Gjithsesi, pranohet se vetëm Njësia Ekonomike e Investimeve që mban Llogaritë Financiare do të jetë përgjegjëse për detyrimet e raportimit dhe të verifikimit të duhur lidhur me këto Llogari Financiare (shih paragrafët 57-65 të Komentit për seksionin VIII).
- Shembulli 2 (Njësia Ekonomike që menaxhohet nga një Institucion Financiar): Faktet janë njësoj si në shembullin 1. Gjithashtu, çdo vit që prej vitit kur është organizuar, Fondi A i ka fituar më shumë se 50% të të ardhurave të tij bruto nga investimi në Aktive Financiare. Përkatesisht, Fondi A është një Njësi Ekonomike Investimesh sipas paragrafit A(6)(b) sepse menaxhohet nga një menaxheri i fondit dhe këshilltar i investimesh, si dhe të ardhurat e saj bruto i atribuohen kryesisht investimeve, riinvestimeve ose tregtisë në Aktive Financiare.
- Shembulli 3 (Menaxheri i investimeve): Menaxheri i investimeve, një njësi e Juridiksionit B, është një Njësi Ekonomike brenda kuptimit të nënparagrafit A(6)(a). Menaxheri i investimeve e organizon dhe regjistron Fondin A në Juridiksionin A. Menaxheri i investimeve është i autorizuar të lehtësojë blerjen dhe shitjen e Aktiveve Financiare që mbahen nga Fondi A në pajtim me strategjinë e investimeve të Fondit A. Çdo vit që kur është organizuar, Fondi A i ka fituar më shumë se 50% të të ardhurave të tij bruto nga investimet, riinvestimet ose tregtia në Aktive Financiare. Prandaj, Fondi A është një Njësi Ekonomike e Investimeve sipas nënparagrafit A(6)(b).
- Shembulli 4 (Fondi i investimeve në pasuri të paluajtshme që menaxhohet nga një Institucion Financiar): Faktet janë njësoj si në shembullin 3, me përjashtim të faktit që aktivet e Fondit A përbëhen vetëm nga interesat të drejtpërdrejta jodebitore në pasuri të paluajtshme që ndodhen brenda dhe jashtë juridiksionit B. Fondi A nuk është një Njësi Ekonomike Investimesh sipas paragrafit A(6)(b), edhe pse menaxhohet nga menaxheri i investimeve, sepse më pak se 50% të të ardhurave të tij bruto i atribuohen investimit, riinvestimit ose tregtisë në Aktive Financiare.
- Shembulli 5 (Trusti i menaxhuar nga një individ): X, një individ, krijon Trustin A, një trust i parevokueshëm në përfitim të fëmijëve të X-it, Y dhe Z. X cakton Administratorin e besuar A, një individ, për të vepruar si administratori i besuar i Trustit A. Aktivet e trustit të A-së përbëhen vetëm nga Aktive Financiare, dhe të ardhurat e tij përbëhen vetëm nga të ardhurat nga ato Aktive Financiare. Sipas kushteve të instrumentit të trustit, Administratori i besuar A menaxhon dhe administron aktivet e trustit. Administratori A nuk kontraktin asnjë Njësi Ekonomike si ofrues shërbimesh për të realizuar ndonjë prej aktiviteteve të përshkruara në nënparagrafin A(6)(b) sepse menaxhohet vetëm nga Administratori i besuar A, që është një individ.
- Shembulli 6 (Brokëri individual): B, një broker individual, ushtron kryesisht veprimtarinë e biznesit të ofrimit të këshillave për klientët, ka autoritetin jodetyrues për të menaxhuar aktivet e klientëve, dhe përdor shërbimet e një njësie ekonomike për të

kryer dhe ekzekutuar tregtinë për llogari të klientëve. B ofron shërbime si këshilltar investimesh dhe menaxher i E-së, e cila është një korporatë. E i ka fituar 50% ose më shumë prej të ardhurave të saj bruto në tre vitet e fundit nga investimi, riinvestimi ose tregtia në Aktive Financiare. Për shkak se B është një individ, pavarësisht se B kryesisht kryen disa aktivitete të caktuara të lidhura me investimet, B nuk është një Njësi Ekonomike Investimesh sipas nënparagrafit A(6)(a). Më tej, E nuk është një Njësi Ekonomike Investimesh sipas nënparagrafit A(6)(b) sepse E menaxhohet nga B, i cili është një individ.

## Aktiv Financiar

23. Termi “Aktiv Financiar” përdoret në përkufizimin e termave “Institucion Kujdestarie”, “Njësi Ekonomike e Investimeve”, “Llogari Kujdestarie” dhe “Llogari e Përfshirë”. Ndërkohë që nuk i referohet aktiveve të çdo lloji, ai nënkupton përfshirjen e çdo aktivi që mund të mbahet në një llogari të mbajtur nga një Institucion Financiar me përjashtim të interesit të drejtpërdrejtë jodebitor në pasuri të paluajtshme.
24. Në kuadër të atij konteksti, nënparagrafi A(7) parashikon se termi “Aktiv Financiar” përfshin një letër me vlerë (për shembull, një përqindje aksionesh në një korporatë; partneritet ose interes përfitimor nga pronësia në një trust ose shoqëri tregtare me shumë aksionerë ose të kuotuar në bursë; dëftesë, bono, instrumente borxhi, ose evidenca të tjera borxhi), interesin e partnerit në partneritet, mallra, marrëveshje shkëmbimi (swap) (për shembull, normë interesi swap, swap në valutë, swap bazë, kufijtë maksimalë të normës së interesit, kufijtë minimalë të normës së interesit, swaps-et e mallrave, swaps-et e kapitalit, swaps-et e indeksit të kapitalit dhe marrëveshje të ngjashme), Kontratat e Sigurimeve ose Kontratat e Pensionit Vjetor, ose çdo interes (duke përfshirë kontratat future ose forward ose opsionet) në letra me vlerë, interes partneriteti, mallra, swap, Kontratë Sigurimesh ose Kontratë Pensioni Vjetor. Megjithatë, termi “Aktiv Financiar” nuk përfshin një interes të drejtpërdrejtë jodebitor në pasuri të paluajtshme.
25. Instrumentet e borxhit të panegociueshme që tregtohen në një treg të rregulluar ose treg jashtë burse dhe shpërndahen e mbahen përmes Institucioneve Financiare, dhe aksioneve ose njësive në një trust investimesh në pasuri të paluajtshme, përgjithësisht do të konsiderohen si Aktive Financiare.

## Shoqëri Sigurimesh e Specifikuara

26. Nënparagrafi A(8) përkufizon termin “Shoqëri Sigurimesh e Specifikuara” si çdo Njësi Ekonomike që është një shoqëri sigurimesh (ose shoqëria kontrolluese (holding) e shoqërisë së sigurimeve) që lëshon ose është e detyruar të kryejë pagesa lidhur me Kontratat e Sigurimit në Vlerë në Para të Gatshme ose Kontratat e Pensionit Vjetor.
27. “Shoqëria e sigurimeve” është Njësia Ekonomike (i) e cila rregullohet si një biznes sigurimesh në bazë të ligjeve, rregulloreve ose praktikave të çdo juridiksioni në të cilin Njësia Ekonomike kryen biznes; (ii) të ardhurat bruto të së cilës (për shembull, primi bruto dhe të ardhurat bruto nga investimet) që vijnë nga sigurimet, risigurimet dhe Kontratat e Pensionit për vitin paraardhës kalendarik i kalojnë 50% të të ardhurave bruto totale për këtë vit; ose (iii) vlera e totalizuar e aktiveve të së cilës shoqëruar me sigurimet, risigurimet dhe Kontratat e Pensionit në çdo moment gjatë vitit paraardhës kalendarik e tejkalon 50% të aktiveve totale në çdo moment gjatë këtij viti.
28. Shumica e shoqërive të sigurimit të jetës përgjithësisht do të konsiderohen Shoqëri Sigurimi të Specifikuara. Njësitë Ekonomike, të cilat nuk lëshojnë Kontrata Sigurimi në Vlerë në Para të Gatshme ose Kontrata Pensioni dhe që as nuk janë të detyruara të kryejnë pagesa lidhur me to, si pjesa më e madhe e shoqërive të sigurimit jojetë, pjesa më e madhe e shoqërive kontrolluese të sigurimit, dhe brokerat e sigurimit, nuk do të jenë Shoqëri Sigurimi të Specifikuara.

29. Veprimtaritë rezervuese të një shoqërie sigurimesh nuk do të bëjnë që shoqëria të jetë një Institucion Kujdestarie, Institucion Depozite ose një Njësi Ekonomike Investimesh.

## **Paragrafi B – Institucionet Financiare Joraportuese**

### *Nënparagrafi B(1) – Në përgjithësi*

30. Nënparagrafi B(1) parashtron kategoritë e ndryshme të Institucioneve Financiare Joraportuese (d.m.th. Institucionet Financiare që përjashtohen nga raportimi). “Institucion Financiar Joraportues është çdo Institucion Financiar që:
- a) është një Organ Qeveritar, Organizatë Ndërkombëtare ose Bankë Qendrore, përveçse lidhur me pagesa të cilat rrjedhin nga detyrimet e mbajtura në lidhje me një veprimtari financiare tregtare të llojit të atyre të realizuara nga një Shoqëri Sigurimesh e Specifikuar, një Institucion Kujdestarie ose një Institucion Depozite;
  - b) është një Fond Pensioni me Pjesëmarrje të Gjerë; një Fond Pensioni me Pjesëmarrje të Kufizuar; një Fond Pensioni i një Organi Qeveritar, Organizate Ndërkombëtare ose Banke Qendrore; ose një Emetues i Kualifikuar i Kartave të Kreditit;
  - c) çdo Njësi tjetër Ekonomike që paraqet rrezik të ulët për t’u përdorur për shmangie tatimore, ka shumë karakteristika të ngjashme me secilën prej njësive të përshkruara në nënparagrafët B(1)(a) dhe (b), dhe është përcaktuar në legjislacionin e brendshëm si një Institucion Financiar Joraportues, me kusht që statusi i kësaj njësie si Institucion Financiar Joraportues nuk cenon qëllimet e Standardit të Përbashkët të Raportimit;
  - d) është një Instrument Investimesh Kolektive i Përjashtuar; ose
  - e) është një trust deri në masën që administratori i besuar i trustit është një Institucion Financiar Raportues dhe e raporton të gjithë informacionin që duhet raportuar në pajtim me seksionin I lidhur me të gjitha Llogaritë e Raportueshme të trustit.

### *Nënparagrafët B(2) deri në (4) – Organi Qeveritar, Organizata Ndërkombëtare dhe Banka Qendrore*

31. Institucioni Financiar i cili është një Organ Qeveritar, Organizatë Ndërkombëtare ose Bankë Qendrore është një Institucion Financiar Joraportues, sipas nënparagrafit B(1)(a), përveç pagesave që rrjedhin nga një detyrim i mbajtur lidhur me një aktivitet financiar tregtar të llojit ku përfshihen Shoqëritë e Sigurimit të Specifikuara, Institucionet e Kujdestarisë ose Institucionet e Depozitës. Prandaj, për shembull, Banka Qendrore që kryen një aktivitet financiar tregtar, si ai i veprimit si ndërmjetës për llogari të personave përveçse në cilësinë e bankës si Bankë Qendrore, nuk është një Institucion Financiar Joraportues sipas paragrafit B(1)(a) lidhur me pagesat e marra për një llogari të mbajtur lidhur me këtë aktivitet.

### **Organi Qeveritar**

32. Nënparagrafi B(2) e përkufizon termin “Organ Qeveritar” si qeveria e një juridiksioni, çdo nënndarje politike e një juridiksioni (që për të shmangur dyshimet përfshin shtetin, provincën, kontenë ose bashkinë), ose çdo agjenci ose organizëm që i përket plotësisht juridiksionit ose ndonjë apo më shumë prej të lartpërmendurave (ku secila prej tyre përbën një “Organ Qeveritar”). Këtu gjithashtu përfshihen pjesët integrale, njësitë e kontrolluara dhe nënndarjet politike të një juridiksioni. “Pjesa integrale” dhe “njësia e kontrolluar” përkufizohen në nënparagrafët B(2)(a) dhe (b), të cilat kërkojnë që asnjë pjesë e të ardhurave të tyre të shkojnë në përfitim të personave privatë. Ndërsa nënparagrafi B(2)(c) e qartëson se kur ndodh kështu, të ardhurat gjithashtu mund të konsiderohen në përfitim të personave privatë nëse këto të ardhura shkojnë në përfitim të personave privatë përmes përdorimit të një Organi Qeveritar si kanal për investimet

personale, ose të personave privatë që këto të dhëna i devijojnë nga përdorimi i tyre i synuar duke ushtruar ndikim ose kontroll përmes mjeteve të miratuara në mënyrë eksplicite ose implicite nga juridiksioni.

33. Me qëllim promovimin e zhvillimit dhe tregtisë ndërkombëtare, shumë juridiksione kanë krijuar agjenci ose programe financimi zhvillimi dhe eksporti të cilat mund të japin hua direkt ose të sigurojnë apo garantojnë direkt hua të dhëna nga huadhënësit tregtarë. Ato agjenci përgjithësisht do të konsiderohen Organe Qeveritare dhe, si rrjedhojë, Institucione Financiare Joraportuese (shih paragrafin 31 më lart).

### Organizata Ndërkombëtare

34. Termi “Organizatë Ndërkombëtare”, siç përkufizohet në nënparagrafin B(3), është çdo organizatë ndërkombëtare ose agjenci apo organizëm i zotëruar plotësisht prej tyre. Këtu përfshihet çdo organizatë ndërqeveritare (duke përfshirë organizatat supranacionale) (1) që përbëhet kryesisht nga qeveritë; (2) që ka në fuqi një marrëveshje për selinë ose një marrëveshje të ngjashme në thelb me juridiksionin; dhe (3) të ardhurat e së cilës nuk shkojnë në përfitim të personave privatë (sipas parimeve të nënparagrafit B(2)(c)). Strukturat e ngjashme në thelb me strukturat e selive përfshijnë, për shembull, strukturat që i japin të drejtën zyrtare të organizatës ose njërive në juridiksion (p.sh. nëndivizion, ose zyrë lokale apo rajonale) për privilegje dhe imunitete.

### Banka Qendrore

35. Sipas nënparagrafit B(4), termi “Bankë Qendrore” është një institucion që me ligj ose akt shtetëror është autoriteti kryesor që, përveç qeverisë së vetë juridiksionit, emeton instrumente që kanë për qëllim të qarkullohen si monedhë. Ky institucion përgjithësisht është kujdestari i rezervave bankare të juridiksionit në bazë të ligjeve të të cilit është organizuar. Ky institucion mund të përfshijë një organizëm që është i ndarë nga qeveria e juridiksionit, pavarësisht nëse zotërohet apo jo plotësisht ose pjesërisht nga juridiksioni.

### *Nënparagrafët B(5) deri në (7) – Fondet*

#### Fond Pensioni me Pjesëmarrje të Gjerë

36. Nënparagrafi B(5) e përkufizon termin “Fond Pensioni me Pjesëmarrje të Gjerë” si fondi i krijuar për të dhënë pension pleqërie, invaliditeti ose familjar, apo një kombinim të tyre, për përfituesit që janë punëmarrës aktualë ose të mëparshëm (ose persona të zgjedhur nga këta punëmarrës) të një ose më shumë punëdhënësve për shërbimet e kryera, me kusht që fondi:
- a) të mos ketë asnjë përfitues të vetëm me të drejtë në më shumë se pesë për qind të aktiveve të fondit;
  - b) të jetë objekt i rregulloreve dhe të raportojë informacione pranë autoriteteve tatimore; dhe
  - c) të përmbushë të paktën një prej katër kritereve të renditura në nënparagrafin B(5)(c) (d.m.th. fondi është i favorizuar nga pikëpamja tatimore; pjesa më e madhe e kontributeve merren nga punëdhënësit e sponsorizuar; shpërndarjet ose tërheqjet lejohen vetëm pasi ndodhin ngjarje të specifikuar dhe kontributet e punëmarrësve kufizohen nga shuma).
37. Raportimi i informacionit që kërkohet në nënparagrafin B(5)(b) mund të ndryshojë nga juridiksioni në juridiksion. Ndërkohë që një juridiksion mund të kërkojë që fondi të japë informacione mujore rreth kontributeve dhe lehtësimeve tatimore të lidhura me to, një tjetër juridiksion mund të kërkojë që fondi të japë informacione vjetore për përfituesit e tij dhe kontributet totale nga punëdhënësit e sponsorizuar. Megjithatë, fakti nëse fondi raporton informacion për autoritetet përkatëse tatimore në juridiksionin në të cilin ai

është themeluar ose vepron, është përcaktues i faktit nëse fondi e përmbush kërkesën sipas atij paragrafi.

### Fond Pensioni me Pjesëmarrje të Kufizuar

38. Termi “Fond Pensioni me Pjesëmarrje të Kufizuar”, siç përkufizohet në nënparagrafin B(6), është fondi i krijuar për të dhënë pension pleqërie, invaliditeti ose familjar, për përfituesit që janë punëmarrës aktualë ose të mëparshëm (ose persona të zgjedhur nga këta punëmarrës) të një ose më shumë punëdhënësve për shërbimet e kryera, me kusht që të përmbushen të gjitha kërkesat e renditura në atë nënparagraf.
39. Nënparagrafi B(6)(c) kërkon që kontributet e punëmarrësit dhe të punëdhënësit në fond të kufizohen përkatësisht në bazë të të ardhurave të fituara dhe kompensimit nga punëmarrësi. Ndërsa ai nënparagraf i përjashton disa transferta aktivesh nga pragu (d.m.th. ato nga llogaritë e pensionit të pleqërisë dhe pensionit të përshkruara në nënparagrafin C(17)(a)), gjithashtu mund të përjashtohen edhe transferta të tjera aktivesh, si ato nga plane të tjera të përshkruara në nënparagrafët B(5) deri në (7).
40. Raportimi i informacionit që kërkohet në nënparagrafin B(6)(e) mund të ndryshojë nga juridiksioni në juridiksion. Siç përmendet në paragrafin 37 më lart, fakti nëse fondi raporton informacion për autoritetet përkatëse tatimore në juridiksionin në të cilin ai është themeluar ose vepron, është përcaktues i faktit nëse fondi e përmbush kërkesën sipas atij paragrafi.

### Fond Pensioni i një Organi Qeveritar, Organizate Ndërkombëtare ose Banke Qendrore

41. Sipas nënparagrafit B(7), termi “Fond Pensioni i një Organi Qeveritar, Organizate Ndërkombëtare ose Banke Qendrore” është fondi i krijuar nga Organi Qeveritar, Organizata Ndërkombëtare ose Banka Qendrore për të dhënë pensione pleqërie, invaliditeti ose familjar për përfituesit ose pjesëmarrësit që janë punëmarrës aktualë ose të mëparshëm (ose persona të caktuar nga këta punëmarrës), ose që nuk janë punëmarrës aktualë ose të mëparshëm, nëse pensionet që u jepen këtyre përfituesve ose pjesëmarrësve janë në pajtim me shërbimet personale të realizuara për Organin Qeveritar, Organizatën Ndërkombëtare ose Bankën Qendrore.

### *Nënparagrafi B(8) – Emetues i Kualifikuar i Kartave të Kreditit*

42. Nënparagrafi B(8) e përkufizon termin “Emetues i Kualifikuar i Kartave të Kreditit” si një Institucion Financiar që përmbush kriteret e mëposhtme:
  - a) Institucioni Financiar është një Institucion Financiar vetëm sepse është emetues i kartave të kreditit që pranon depozita vetëm kur klienti kryen pagesa që tejkalojnë bilancin e përcaktuar për kartën dhe kjo mbipagesë nuk i rimbursohet menjëherë klientit; dhe
  - b) duke filluar më ose përpara datës [xx/xx/xxxx], Institucioni Financiar zbaton politika dhe procedura qoftë për ta ndaluar klientin që të kryejë mbipagesa që i tejkalojnë 50 000 USD, ose për të garantuar se çdo mbipagesë e klientit që e tejkalon vlerën 50 000 USD (dhe i bilancit të përcaktuar të kartës) t’i rimbursohet klientit brenda 60 ditëve, në çdo rast duke zbatuar rregullat e parashtruara në paragrafin C të seksionit VII për totalizimin e llogarisë dhe përkthimin e monedhës. Për këtë arsye, mbipagesa e klientit nuk i referohet balanceve të kreditit që përfshijnë tarifa të kundërshtuara por përfshijnë bilancet e kreditit që vijnë si rezultat i kthimit të mallit.
43. Ndërsa përzgjedhja e datës së përmendur në nënparagrafin B(8)(b) është vendim i juridiksionit që zbaton Standardin e Përbashkët të Raportimit, pritet që data e përzgjedhur për atë qëllim të jetë e njëjta me datën e përzgjedhur për termin “Llogari e Re”. Për këtë arsye, Institucioni Financiar që është formuar ose organizuar pas datës së



përzgjedhur duhet të përmbushë kërkesën e përshkruar në nënparagrafin B(8)(b) brenda gjashtë muajve pas datës kur ky Institucion Financiar është formuar ose organizuar.

44. Institucioni Financiar Raportues që nuk përmbush kërkesat për të qenë një Emetues i Kualifikuar i Kartave të Kreditit, por pranon depozita kur klienti kryen një pagesë që e tejkalon bilancin e përcaktuar të një karte krediti ose të një instrumenti tjetër kredie të rinovueshme, mund të mos e raportojë një Llogari Depozite nëse kualifikohet si Llogari e Përrjashtuar sipas paragrafit C(17)(f).

*Nënparagrafi B(1)(c) – Institucionet Financiare Joraportuese me rrezik të ulët*

45. Institucioni Financiar gjithashtu mund të jetë një Institucion Financiar Joraportues, sipas nënparagrafit B(1)(c), me kusht që:
- a) Institucioni Financiar të paraqesë rrezik të ulët për t'u përdorur për shmangie tatimore;
  - b) Institucioni Financiar të ketë karakteristika në thelb të ngjashme me secilin prej Institucioneve Financiare të përshkruar në nënparagrafët B(1)(a) dhe (b);
  - c) Institucioni Financiar të jetë përcaktuar në legjislacionin e brendshëm si Institucion Financiar Joraportues; dhe
  - d) statusi i Institucionit Financiar si Institucion Financiar Joraportues të mos cenojë qëllimet e Standardit të Përbashkët të Raportimit.
46. Kjo kategori “e hapur” e Institucioneve Financiare Joraportuese ka për qëllim të akomodojë llojet e institucioneve financiare specifike për juridiksionin që përmbushin kërkesat e renditura në nënparagrafin B(1)(c), dhe shmang nevojën e negocimit të kategorive të Institucioneve Financiare Joraportuese kur arrin një marrëveshje për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarisë financiare.
47. Kërkesa e parë e përshkruar në nënparagrafin B(1)(c) është që Institucioni Tatimor të paraqesë një rrezik të ulët për t'u përdorur për shmangie tatimore. Faktorët që mund të përdoren për ta përcaktuar këtë rrezik përfshijnë:
- e) faktorët me rrezik të ulët:
    - (1) Institucioni Financiar është objekt i rregullores.
    - (2) është i nevojshëm raportimi nga Institucioni Financiar për autoritetet doganore.
  - b) faktorët me rrezik të lartë:
    - (1) lloji i Institucionit Financiar nuk është objekt i Procedurave për AML/KYC.
    - (2) lloji i Institucionit Financiar lejohet që të lëshojë aksione në formën e bartësit dhe nuk është objekt i masave në fuqi që zbatojnë Rekomandimet e FATF-së lidhur me transparencën dhe pronësinë fitimprurëse të personave juridikë.<sup>14</sup>
    - (3) lloji i Institucionit Financiar promovohet si një instrument i minimizimit tatimor.

<sup>10</sup>. FATF/OECD (2013), Standardet Ndërkombëtare për Luftën kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit dhe Përhapjes së Terrorizmit, Rekomandimet e FATF-së, shkurt 2012, FATF/OECD, Paris, gjendet në [www.fatf-gafi.org/media/fatf/documents/recommendations/pdfs/FATF\\_Recommendations.pdf](http://www.fatf-gafi.org/media/fatf/documents/recommendations/pdfs/FATF_Recommendations.pdf).

46. Kërkesa e dytë që përshkruhet në nënparagrafin B(1)(c) është që Institucioni Financiar të ketë karakteristika në thelb të ngjashme me secilin Institucion Financiar që përshkruhet në nënparagrafët B(1)(a) dhe (b). Kjo kërkesë nuk mund të përdoret thjesht

<sup>14</sup> FATF/OECD (2013), Standardet Ndërkombëtare për Luftën kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit dhe Përhapjes së Terrorizmit, Rekomandimet e FATF-së, shkurt 2012, FATF/OECD, Paris, gjendet në [www.fatf-gafi.org/media/fatf/documents/recommendations/pdfs/FATF\\_Recommendations.pdf](http://www.fatf-gafi.org/media/fatf/documents/recommendations/pdfs/FATF_Recommendations.pdf).

për të eliminuar një element specifik të përshkrimit. Secili juridiksion mund ta vlerësojë zbatimin e kësaj kërkesë për një lloj Institucioni Financiar që nuk përmbush të gjitha kërkesat e një përshkrimi të caktuar të renditura në nënparagrafët B(1)(a) ose (b). Si pjesë e këtij vlerësimi, juridiksioni mund të identifikojë se cilat kërkesa përmbushen dhe cilat jo, dhe lidhur me kërkesat që nuk përmbushen, duhet të identifikojë ekzistencën e një kërkesë zëvendësuese që ofron garanci ekuivalente se lloji përkatës i Institucionit Financiar paraqet rrezik të ulët për shmangie tatimore.

47. Kërkesa e tretë e përshkruar në nënparagrafin B(1)(c) është që Institucioni Financiar të jetë përcaktuar në legjislacionin e brendshëm si një Institucion Financiar Joraportues. Kjo kërkesë përmbushet në rastin kur juridiksioni e përcakton një lloj specifik të Institucionit Financiar si Institucion Financiar Joraportues, dhe ai përcaktim ndodhet në legjislacionin e brendshëm. Për këtë qëllim, juridiksioni në mënyrë tipike do të ishte në pajtim me llojet e Institucioneve Financiare që trajtohen si “pronarë përfitues të përjashtuar” ose “Institucione Financiare të Huaja të konsideruara si të pajtueshme” në marrëveshjen ndërqeveritare të nënshkruar ndërmjet këtij juridiksioni dhe Shteteve të Bashkuara për të përmirësuar përputhshmërinë tatimore ndërkombëtare edhe me FATCA-n, me kusht që këto lloje Institucioneve Financiare të përmbushin të gjitha kërkesat e renditura në nënparagrafin B(1)(c). Pritet që secili juridiksion të ketë vetëm një listë të vetme të Institucioneve Financiare Raportuese të përcaktuar brenda vendit (në krahasim me lista të ndryshme për Juridiksione të ndryshme Pjesëmarrëse) dhe se këtë listë do ta vendosë në dispozicion të publikut.
48. Kërkesa e katërt që përshkruhet në nënparagrafin B(1)(c) është që statusi i Institucionit Financiar si një Institucion Financiar Joraportues të mos cenojë qëllimet e Standardit të Përbashkët të Raportimit. Pritet që kjo kërkesë të monitorohet, ndër të tjera, përmes sa më poshtë vijon:
  - a) procedurat administrative që juridiksioni duhet të ketë për të garantuar se Institucionet Financiare të përcaktuara në legjislacionin e brendshëm si Institucione Financiare Joraportuese vijnë në tërësi nën një rrezik të ulët për t’u përdorur për shmangie tatimore (shih nënparagrafin A(4) të seksionit IX);
  - b) pezullimi i mundshëm i Marrëveshjes së Autoritetit Kompetent kur Autoriteti tjetër Kompetent e ka përcaktuar statusin e Institucioneve Financiare si Institucione Financiare Joraportuese në një mënyrë të atillë që cenon qëllimet e Standardit të Përbashkët të Raportimit (shih paragrafin 2 të seksionit 7 të Marrëveshjes Model të Autoritetit Kompetent); dhe
  - c) mekanizmi për të shqyrtuar zbatimin e Standardit të Përbashkët të Raportimit që i është mandatuar Forumit Global për Transparencën dhe Shkëmbimin e Informacionit për Qëllime Tatimore nga G20 (shih paragrafin 51 të Deklaratës së Liderëve të G20, Samiti i Sent Petersburgut, 5-6 shtator 2013).<sup>15</sup>
49. Shembujt vijues ilustrojnë zbatimin e nënparagrafit B(1)(c):
  - Shembulli 1 (Organizatë jofitimprurëse): Lloji i organizatës jofitimprurëse që nuk është një Institucion Financiar nuk i përmbush të gjitha kërkesat e çdo përshkrimi të renditur në nënparagrafët B(1)(a) ose (b). Ky lloj Institucioni Financiar Joraportues nuk mund të përcaktohet në legjislacionin e brendshëm si Institucion Financiar Joraportues vetëm sepse është një organizatë jofitimprurëse.
  - Shembulli 2 (Fond pensioni edhe për individët e vetëpunësuar): Lloji i fondit të pensionit që është Institucion Financiar i përmbush të gjitha kërkesat e renditura në nënparagrafin B(5). Megjithatë, sipas ligjeve të juridiksionit ku fondi është krijuar ose vepron, gjithashtu kërkohet që t’u jepen përfitime edhe përfituesve të cilët janë individë

<sup>15</sup> Disponohet në <https://www.g20.org/>.

të vetëpunësuar. Duke qenë se ka një kërkesë të përgjithshme zëvendësuese që jep garanci ekuivalente se fondi paraqet një rrezik të ulët për shmangie tatimore, ky lloj Institucioni Financiar mund të përcaktohet në legjislacionin e brendshëm si Institucion Financiar Joraportues.

- Shembull 3 (Fondi i pensionit i pakufizuar): Lloji i fondit të pensionit që është një Institucion Financiar i përmbush të gjitha kërkesat e renditura në nënparagrafin B(6), përveç asaj që ndodhet në nënparagrafin B(6)(c) (d.m.th. kontributet e punëmarrësit dhe punëdhënësit nuk janë të kufizuara). Megjithatë, lehtësimi tatimor që lidhet me kontributet e punëdhënësit dhe punëmarrësit kufizohet përkatësisht nga të ardhurat e fituara dhe kompensimet e punëmarrësit.

Për shkak se ka një kërkesë zëvendësuese që ofron garanci ekuivalente se fondi paraqet rrezik të ulët për shmangie tatimore, ky lloj Institucioni Financiar mund të përcaktohet në legjislacionin e brendshëm si Institucion Financiar Joraportues.

- Shembulli 4 (Instrumenti i investimeve ekskluzivisht për fondet e pensionit): Një lloj instrumenti investimesh që është Institucion Financiar është krijuar ekskluzivisht për të fituar të ardhura në përfitim të një ose më shumë fondeve të pensionit ose pensionit të pleqërisë të përshkruara në nënparagrafët B(5) deri në (7), ose llogaritë e pensionit të pleqërisë ose pensionit që përshkruhen në nënparagrafët C(17)(a). Duke qenë se të gjitha të ardhurat e instrumentit shkojnë në përfitim të Institucioneve Financiare Joraportuese ose Llogarive të Përrjashtuara, dhe ka një kërkesë të përgjithshme zëvendësuese që ofron garanci ekuivalente se instrumenti paraqet një rrezik të ulët për shmangie tatimore, ky lloj Institucioni Financiar mund të përcaktohet në legjislacionin e brendshëm si Institucion Financiar Joraportues.

### *Nënparagrafi B(9) – Instrumenti i Investimeve Kolektive i Përrjashtuar*

**52.** Termi “Instrument Investimesh Kolektive i Përrjashtuar”, siç përkufizohet në nënparagrafin B(9), është një Njësi Ekonomike Investimesh që rregullohet si një instrument investimesh kolektive, me kusht që të gjitha interesat në instrumentin e investimeve kolektive të mbahen nga ose nëpërmjet individëve ose Njësive Ekonomike që nuk janë Persona të Raportueshëm (p.sh. sepse janë Institucione Financiare), përveç NFE-së Pasive me Persona Kontrollues të cilët janë Persona të Raportueshëm.

**53.** Si çështje praktike, një Njësi Ekonomike Investimesh në të cilën të gjitha interesat mbahen nga ose nëpërmjet Personave të Paraportueshëm përgjithësisht nuk do të ketë detyrime raportimi, pavarësisht nëse kualifikohet si një Instrument Investimesh Kolektive i Përrjashtuar sipas nënparagrafit B(9). Megjithatë, ky kualifikim mund të ketë rëndësi për detyrimet e tjera që vendosen mbi Njësine Ekonomike të Investimeve, siç është depozitimi i zero raportimit në mungesë të Llogarive të Raportueshme (nëse parashikohet në ligjin e brendshëm).

**54.** Rregulli që përdoret në rastin kur juridiksioni i ka lejuar më parë instrumentet e investimeve kolektive të emetojnë aksione në formën e bartësit, parashikohet më tej në nënparagrafin B(9). Njësia Ekonomike e Investimeve që rregullohet si një instrument investimesh kolektive nuk dështon të kualifikohet si një Instrument i Investimeve Kolektive i Përrjashtuar vetëm sepse Instrumenti i Investimeve Kolektive i ka emetuar bartësit aksione fizike, me kusht që:

- a) instrumenti i investimeve kolektive nuk ka emetuar dhe nuk emeton asnjë aksion fizik për bartësin pas datës [xx/xx/xxxx];
- b) instrumenti i investimeve kolektive i tërheq të gjitha këto aksione menjëherë pas heqjes dorë;
- c) instrumenti i investimeve kolektive kryen procedurat e verifikimit të duhur të parashtruara në seksionet II deri në VII dhe raporton çdo informacion që kërkohet të

raportohet lidhur me këto aksione kur këto aksione paraqiten për riblerje ose për pagesa të tjera; dhe

- d) instrumenti i investimeve kolektive disponon politika dhe procedura për të garantuar se këto aksione riblihen ose mbahen rezervë sa më shpejt të jetë e mundur, dhe në çdo rast përpara datës [xx/xx/xxxx].

### *Nënparagrafi B(1)(e) – Trust i Dokumentuar nga Administratori i Besuar*

55. Trusti i cili është një Institucion Financiar (p.sh. për shkak se është një Njësi Ekonomike Investimesh) është një Institucion Financiar Joraportues, sipas nënparagrafit B(1)(e), në masën që administratori i besuar i trustit është një Institucion Financiar Raportues dhe raporton të gjithë informacionin e kërkuar për raportim sipas seksionit I lidhur me të gjitha Llogaritë e Raportueshme të trustit.

56. Kjo kategori e Institucionit Financiar Joraportues arrin një rezultat të ngjashëm si ai në paragrafin D të seksionit II, sipas së cilit Institucionet Financiare Raportuese mund të lejohen të mbështeten tek ofruesit e shërbimeve për të përmbushur detyrimet e tyre të raportimit dhe verifikimit të duhur. Ndryshimi i vetëm ndërmjet atij paragrafi dhe kësaj kategorie është se detyrimet e raportimit dhe të verifikimit të duhur që përmbushen nga ofruesit e shërbimeve mbeten përgjegjësi e Institucionit Financiar Raportues, ndërsa përgjegjësia e atyre të përmbushura nga administratori i besuar i një Trusti të Dokumentuar nga Administratori i Besuar i transferohen nga trusti administratorit të tij të besuar. Sidoqoftë, kjo kategori nuk modifikon kohën dhe mënyrën e detyrimeve të raportimit dhe verifikimit të duhur të cilat mbeten po njësoj sikur të ishin ende përgjegjësi e trustit. Për shembull, administratori i besuar nuk duhet të raportojë informacion lidhur me një Llogari të Raportueshme të Trustit të Dokumentuar nga Administratori i Besuar sikur të ishte Llogari e Raportueshme e administratorit të besuar. Administratori i besuar duhet ta raportojë këtë informacion siç do ta kishte raportuar Trusti i Dokumentuar nga Administratori i Besuar (p.sh. për të njëjtin juridiksion) dhe të identifikojë Trustin e Dokumentuar nga Administratori i Besuar lidhur me të cilin ai përmbush detyrimet e raportimit dhe të verifikimit të duhur. Kjo kategori e Institucionit Financiar Joraportues gjithashtu mund të aplikohet për një strukturë ligjore që është ekuivalente ose e ngjashme me trustin, si për shembull një *fideicomiso*.

## **Paragrafi C – Llogaria Financiare**

### *Nënparagrafi C(1) – Në përgjithësi*

57. Nënparagrafi C(1) e përkufizon termin “Llogari Financiare” si një llogari që mbahet nga Institucioni Financiar dhe më tej qartëson se ky term përfshin:

- Llogaritë e Depozitave;
- Llogaritë e Kujdestarisë;
- Interesin e kapitalit dhe të borxhit në disa Njësi Ekonomike Investimesh;
- Kontratat e Sigurimit në Vlerë në Para të Gatshme; dhe
- Kontratat e Pensionit Vjetor.

58. Termi “Llogari Financiare, sidoqoftë, nuk përfshin çdo llogari që është një Llogari e Përrjashtuar dhe, si rrjedhojë, nuk është objekt i procedurave të verifikimit të duhur që zbatohen për qëllime të identifikimit të Llogarive të Raportueshme ndërmjet Llogarive Financiare (si marrja e një vetëvërtetimi). Gjithashtu, termi “Llogari Financiare” nuk përfshin disa Kontrata Pensioni Vjetor që përshkruhen në nënparagrafin C(1)(c): pension jetësor i menjëhershëm i patransferueshëm dhe jo i lidhur me investimet që i jepet një individ dhe monetizon një

pension ose përfitim invaliditeti në një llogari që është Llogaria e Përrjashtuar. Pensioni ose përfitimet e invaliditetit përfshijnë përkatësisht pensionet e pleqërisë dhe familjarë.

**59.** “Pensioni jetësor i menjëhershëm i patransferueshëm dhe jo i lidhur me investimet është një Kontratë Pensioni Vjetor e patransferueshme që (i) nuk është një kontratë pensioni e lidhur me investimet; (ii) është një pension i menjëhershëm; dhe (iii) është një kontratë pensioni jete. Termi “kontratë pensioni e lidhur me investimet” është një Kontratë Pensioni Vjetor sipas së cilës rregullohen përfitimet dhe primet për të pasqyruar kthimin mbi investimin ose vlerën në treg të aktiveve në bazë të kontratës. Termi “pension i menjëhershëm” është një Kontratë Pensioni Vjetor që (i) blihet me një prim ose pension të vetëm; dhe (ii) jo më vonë se një vit nga data e blerjes së kontratës fillon të paguajë çdo vit ose më shpesh pagesa periodike të barabarta në thelb. Termi “kontratë e pensioni jetësor” është Kontrata e Pensionit Vjetor që parashikon pagesat për jetën ose jetët e një ose më shumë individëve.

**60.** Sipas nënparagrafit C(1)(a), çdo interes në kapital ose borxh në një Njësi Ekonomike Investimesh konsiderohet një Llogari Financiare. Sidoqoftë, interesat në kapital ose borxh në një Njësi Ekonomike që është Njësi Ekonomike Investimesh, vetëm sepse është një këshilltare investimesh ose menaxhere investimesh, nuk janë Llogari Financiare. Prandaj, Interesat në kapital ose borxh në një Njësi Ekonomike Investimesh (i) e cila është një njësi ekonomike investimesh e menaxhuar profesionalisht, ose (ii) e cila funksionon ose vepron si një instrument investimesh kolektive, fond i përbashkët, fond i listuar në bursë, fond privat në kapital neto, fond mbulimi, fond me sipërmarrje kapitali, fond blerjeje me financim nga të tretë ose si çdo instrument tjetër i ngjashëm investimesh i krijuar përmes një strategjie investimesh të investimit, riinvestimit ose tregtimit në Aktive Financiare.

**61.** Sipas nënparagrafit C(1)(b), interesi në kapital ose borxh në një Institucion Financiar të ndryshëm nga ata të përshkruar në nënparagrafin C(1)(a) konsiderohet Llogari Financiare vetëm nëse kategoria e interesave është krijuar me qëllimin e shmangies së raportimit në pajtim me seksionin I. Prandaj, interesat në kapital ose borxh në një Institucion Kujdestarie, Institucion Depozite, Njësi Ekonomike Investimesh që ndryshon nga këshilltari i investimeve ose menaxheri i investimeve që përshkruhet në nënparagrafin C(1)(a), ose Shoqëri Sigurimesh e Specifikuar, që janë krijuar me qëllimin për të shmangur raportimin, do të jenë Llogari Financiare.

**62.** Në përgjithësi, llogaria do të konsiderohet se mbahet nga Institucioni Financiar si më poshtë:

- në rastin e një Llogarie Kujdestarie, nga Institucioni Financiar që ka nën kujdes aktivet në llogari (duke përfshirë Institucionin Financiar që mban aktive nën emrin e firmës së brokerimit për një Mbajtës Llogarie në këtë institucion).
- në rastin e një Llogarie Depozite, nga Institucioni Financiar që është i detyruar të kryejë pagesa lidhur me llogarinë (duke përjashtuar agjentin e një Institucioni Financiar pavarësisht nëse ky agjent është një Institucion Financiar).
- në rastin e çdo interesi në kapital ose borxh në një Institucion Financiar që përbën Llogarinë Financiare, nga ky Institucion Financiar.
- në rastin e një Kontrate Sigurimi në Vlerë në Para të Gatshme ose një Kontrate Pensioni Vjetor, nga Institucioni Financiar që ka për detyrë të kryejë pagesa lidhur me kontratën.

**63.** Sidoqoftë, juridiksionet kanë kuadro të ndryshëm ligjorë, administrativë dhe operacionalë dhe sisteme të ndryshme financiare, dhe kuptimi i “të mbajtur të një llogarie” mund të variojë ndërmjet juridiksioneve në varësi të mënyrës se si strukturohet një industri financiare. Në disa raste, Institucioni Financiar Raportues mund të mos posedojë të gjithë informacionin që duhet të raportohet lidhur me një llogari dhe mund të duhen orientime të brendshme në këtë drejtim. Në miratimin e këtyre orientimeve, duhet të tregohet kujdes për të trajtuar çdo papërputhshmëri që mund të dalë nga konteksti ndërkufitar, veçanërisht lidhur me juridiksionet që nuk janë Juridiksione Pjesëmarrëse ose lidhur me Institucionet Financiare që



nuk janë Institucione Financiare të Juridiksioneve Pjesëmarrëse, me qëllim që orientimet të mos cenojnë qëllimet e Standardit të Përbashkët të Raportimit (shih paragrafin 5 të Komentit për seksionin IX).

**64.** Për shembull, në disa Juridiksione Pjesëmarrëse letrat me vlerë mund të mbahen në llogari të regjistruara nga pronari të cilat mbahen nga një depozitë qendrore e letrave me vlerë dhe që vihen në funksionim nga Institucione të tjera Financiare. Në parim, depozita qendrore e letrave me vlerë do të trajtohet si Institucioni Financiar Raportues lidhur me llogaritë dhe, si rrjedhojë, do të jetë përgjegjës për përmbushjen e të gjitha detyrimeve të raportimit dhe verifikimit të duhur. Megjithatë, duke qenë se marrëdhëniet me klientin menaxhohen dhe procedurat e verifikimit të duhur zbatohen nga Institucionet e tjera Financiare në cilësinë e tyre si operatorë të llogarisë, depozita qendrore e letrave me vlerë mund të mos jetë në pozicionin për të qenë në pajtim me këto detyrime. Për shembull, Juridiksionet Pjesëmarrëse mund ta adresojnë këtë çështje duke i trajtuar Llogaritë përkatëse të Kujdestarisë si përgjegjëse për çdo raportim që kërkohet lidhur me këto Llogari Kujdestarie. Sidoqoftë, në rastin kur Llogaritë përkatëse të Kujdestarisë trajtohen sikur mbahen nga Institucione të tjera Financiare, në pajtim me paragrafin D të seksionit II, depozita qendrore e letrave me vlerë mund të raportojë për llogari të këtyre Institucioneve të tjera Financiare.

**65.** Një rast i ngjashëm mund të ndodhë në disa Juridiksione Pjesëmarrëse kur preket tregtimi i interesave në kapital në një fond të tregtuar në bursë, dhe procedurat e verifikimit të duhur zbatohen, nga brokerët, por investitorët fundorë regjistrohen direkt në regjistrin e interesave në fond. Në parim, fondi do të trajtohej si një Institucion Financiar Raportues lidhur me interesat në kapital. Megjithatë, nuk do të kishte informacionin për të qenë në pajtim me detyrimet e tij të raportimit. Juridiksionet Pjesëmarrëse mund ta adresojnë këtë çështje, për shembull, duke kërkuar që brokerët të japin të gjithë informacionin e nevojshëm pranë fondit, me qëllim që të jetë në pajtim me detyrimet e raportimit.

### *Nënparagrafi C(2) – Llogari Depozite*

**66.** Termi “Llogari Depozite”, siç përkufizohet në nënparagrafin C(2), përfshin çdo llogari tregtare, llogari rrjedhëse, llogari kursimesh, llogari me afat, ose llogari që identifikohet përmes një certifikate depozite, certifikate kursimesh, certifikate investimesh, certifikate borxhi, ose instrumente të tjera të ngjashme që mbahen nga Institucioni Financiar në punën e zakonshme të aktivitetit bankar ose të ngjashëm me të. Llogaria e Depozitës përfshin gjithashtu shumën e mbajtur nga shoqëria e sigurimeve sipas kontratës së investimeve të garantuara ose marrëveshjes së ngjashme me të për të paguar ose kredituar interesat përkatës.

**67.** Llogaria e cila vërtetohet nga libreza e kursimeve, përgjithësisht do të konsiderohet një Llogari Depozite. Siç përmendet në paragrafin 25 më lart, instrumentet e negociueshme të borxhit të cilat tregtohen në tregje të rregulluara ose tregje jashtë bursave dhe që shpërndahen dhe mbahen përmes Institucioneve Financiare, përgjithësisht nuk do të konsiderohen Llogari Depozite, por Aktive Financiare.

### *Nënparagrafi C(3) – Llogari Kujdestarie*

**68.** Nënparagrafi C(3) e përkufizon termin “Llogari Kujdestarie” si një llogari (e ndryshme nga Kontratat e Sigurimeve ose Kontratat e Pensionit Vjetor) që mban një ose më shumë aktive financiare në përfitim të një personi tjetër.

### *Nënparagrafi C(4) – Interesi në kapital*

**69.** Përkufizimi i termit “Interes në kapital” trajton në mënyrë specifike interesat në partneritete dhe truste. Në rastin e një partneriteti që është Institucion Financiar, termi “Interes në kapital” është qoftë interesi në kapital ose interesi në përfitime nga partneriteti. Në rastin e një trusti që është Institucion Financiar, Interesi në kapital konsiderohet se mbahet nga çdo person që trajtohet si krijuesi i trustit ose përfituesi i të gjithë ose i një pjese të trustit, ose çdo

person tjetër fizik që ushtron kontroll efektiv themelor mbi trustin. E njëjta gjë si për trustin që është një Institucion Financiar zbatohet për strukturën ligjore që është ekuivalente ose e ngjashme me trustin, ose fondacionin që është Institucion Financiar.

**70.** Sipas nënparagrafit C(4), Personi i Raportueshëm do të trajtohet si përfitues i një trusti nëse ky Person i Raportueshëm ka të drejtën të marrë direkt ose indirekt (për shembull, përmes një përfaqësuesi të caktuar) një shpërndarje të detyrueshme ose mund të marrë, direkt ose indirekt, një shpërndarje diskrete nga trusti. Për këto qëllime, përfituesi i cili mund të marrë një shpërndarje diskrete vetëm nga trusti do të trajtohet si përfitues i një trusti nëse ky person e merr shpërndarjen në vitin kalendarik ose në një periudhë tjetër të përshtatshme raportimi (d.m.th. shpërndarja ose është paguar ose është bërë e pagueshme). E njëjta gjë vlen për trajtimin e një Personi të Raportueshëm si përfitues i një strukture ligjore që është ekuivalente ose e ngjashme me trustin ose fondacionin.

**71.** Në rastin kur Interesat në Kapital mbahen përmes një Institucioni Kujdestarie, Institucioni Kujdestar është përgjegjës për raportimin dhe jo Njësia Ekonomike e Investimeve. Shembulli vijues ilustron mënyrën se si duhet të bëhet ky raportim: Personi i Raportueshëm A mban aksione në një fond investimesh L. A-ja i mban aksionet në kujdestari përmes kujdestarit Y. Fondi i investimeve L është një Njësi Ekonomike Investimesh dhe, nga perspektiva e saj, aksionet e saj janë Llogari Financiare (d.m.th. Interesa në Kapital në një Njësi Ekonomike Investimesh). L mund ta trajtojë kujdestarin Y si Mbajtësin e tij të Llogarisë. Duke qenë se Y është një Institucion Financiar (d.m.th. një Institucion Kujdestarie) dhe Institucionet Financiare nuk janë Persona të Raportueshëm, këto aksione nuk janë objekt i raportimit nga fondi i investimeve L. Për kujdestarin Y, aksionet e mbajtura për A janë Aktive Financiare që mbahen në një Llogari Kujdestarie. Si Institucion Kujdestarie, Y është përgjegjës për raportimin e aksioneve që mban për llogari të A-së.

#### *Nënparagrafët C(5) deri në (8) – Kontratat e Sigurimit dhe të Pensionit Vjetor*

**72.** Nënparagrafët C(5) deri në (8) përmbajnë përkufizimet e ndryshme që lidhen me produktet e sigurimit: “Kontratë Sigurimi”, “Kontratë Pensioni Vjetor”, “Kontratë Sigurimi në Vlerë në Para të Gatshme” dhe “Vlerë në Para”. Ndërsa termat “Kontratë Sigurimi” dhe “Vlerë në Para” nevojiten për të përcaktuar qëllimin e termit “Kontratë Sigurimi në Vlerë në Para të Gatshme”, vetëm kontrata e cila është një Kontratë Sigurimi në Vlerë në Para të Gatshme ose Kontrata e Pensionit Vjetor mund të jetë një Llogari Financiare.

**73.** Termi “Kontratë Pensioni Vjetor”, siç përkufizohet në nënparagrafin C(6), është kontrata sipas së cilës emetuesi bie dakord të kryejë pagesa për një periudhë kohore të përcaktuar plotësisht ose pjesërisht duke iu referuar jetëgjatësisë së një ose më shumë individëve. Termi gjithashtu përfshin kontratën që konsiderohet të jetë një Kontratë Pensioni Vjetor në përputhje me ligjet, rregulloret ose praktikatat e juridiksionit në të cilin është lëshuar kontrata, dhe sipas së cilës emetuesi bie dakord të kryejë pagesa për një numër të caktuar vitesh.

**74.** Sipas nënparagrafit C(5), termi “Kontratë Sigurimi” është një kontratë (e ndryshme nga Kontrata e Pensionit Vjetor) sipas së cilës emetuesi bie dakord të paguajë një shumë të caktuar menjëherë pas ndodhjes së një kontigjence specifike që përfshin vdekjen, sëmundshmërinë, aksidentin, detyrimin ose riskun e pronës. Termi “Kontratë Sigurimi në Vlerë në Para të Gatshme”, siç përkufizohet më tej në nënparagrafin C(7), është Kontrata e Sigurimeve (e ndryshme nga kontrata e risigurimit ndërmjet dy shoqërive të sigurimeve) që ka një Vlerë në Para të Gatshme.

**75.** Nënparagrafi C(8) e përkufizon termin “Vlerë në Para të Gatshme” si sasia më e madhe e shumave vijuese (i) shuma që mbajtësi i policës ka të drejtë të marrë menjëherë pas mbylljes vullnetare ose zgjidhjes së kontratës (e përcaktuar pa llogaritur zbritjen e mundshme në formë penalizimi për çdo mbyllje vullnetare ose hua mbi policën), dhe (ii) shuma që mbajtësi i policës mund të marrë hua sipas kontratës ose lidhur me të (për shembull, e vendosur

si kolateral). Pavarësisht nga sa më sipër, termi “Vlerë në Para të Gatshme” nuk përfshin shumën që paguhet sipas Kontratës së Sigurimit:

- a) vetëm për shkak të vdekjes së individit të siguruar sipas kontratës së sigurimit të jetës;
- b) në formën e përfitimit personal nga lëndimi ose sëmundja ose të përfitimeve të tjera që zhdëmtojnë humbjen ekonomike të pësuar për shkak të ndodhisë së një ngjarjeje ndaj të cilës është siguruar;
- c) në formën e një rimbursimi të një primi të paguar më parë (minus kostot e shpenzimeve të sigurimeve pavarësisht nëse vendosen apo jo) sipas Kontratës së Sigurimit (e ndryshme nga kontrata e sigurimit të jetës lidhur me një investim ose kontrata e pensionit vjetor) për shkak të anulimit ose zgjidhjes së kontratës, uljes së rrezikut të ekspozimit gjatë periudhës së veprimit të kontratës, ose si rezultat i korrigjimit të njoftimit apo gabimit të ngjashëm lidhur me primin e kontratës;
- d) në formën e dividendit të mbajtësit të policës (i ndryshëm nga dividendi në zgjidhjen e kontratës) me kusht që dividendi të lidhet me një Kontratë Sigurimi sipas së cilës të vetmet përfitime të pagueshme janë të përshkruara në nënparagrafin C(8)(b); ose
- e) në formën e kthimit të primit të parapaguar ose të depozitës së primit për Kontratën e Sigurimit për të cilën primi paguhet të paktën çdo vit nëse shuma e primit të parapaguar ose e depozitës së primit nuk e kalon primin vijues vjetor që do të paguhet sipas kontratës.

**76.** Nënparagrafi C(8)(b) përjashton nga termi “Vlerë në Para të Gatshme” shumë që paguhet sipas një Kontrate Sigurimi si lëndim personal ose sëmundje, ose përfitime të tjera që zhdëmtojnë humbjen ekonomike të pësuar për shkak të ndodhisë së një ngjarjeje ndaj të cilës është siguruar. Këto “përfitime të tjera” nuk përfshijnë asnjë përfitim që paguhet sipas një kontrate sigurimi të lidhur me investimin. “Kontrata e sigurimit e lidhur me investimin” është kontrata e sigurimit sipas së cilës përfitimet, primet ose periudhat e mbulimit rregullohen për të pasqyruar kthimin mbi investimin ose vlerën në treg të aktiveve që lidhen me kontratën.

**77.** Përjashtimet që përshkruhen në nënparagrafët C(8)(a) dhe (c) janë shumat që paguhen lidhur me një kontratë sigurimi jete e lidhur me investimet dhe, në nënparagrafin C(8)(c), edhe një kontratë pensioni vjetor jete e lidhur me investimet. “Kontrata e sigurimit të jetës e lidhur me investimet” është një Kontratë Sigurimesh e cila (i) është një kontratë sigurimesh e lidhur me investimet (shih paragrafin 76 më lart); dhe (ii) është një kontratë sigurimi jete (shih paragrafin 78 më poshtë). “Kontrata e pensionit vjetor e lidhur me investimet” është Kontrata e Pensionit Vjetor që (i) është një kontratë pensioni vjetor e lidhur me investimet; dhe (ii) është një kontratë pensioni vjetor jete (shih paragrafin 59 më lart).

**78.** “Kontrata e sigurimit të jetës” është një Kontratë Sigurimi sipas së cilës emetuesi, në këmbim të marrjes në konsideratë, bie dakord të paguajë një shumë parash pas vdekjes së një ose më shumë individëve. Fakti që kontrata parashikon një ose më shumë pagesa (për shembull, përfitimet nga sigurimi i jetës me kursim ose përfitimet e invaliditetit) përveç pensionit familjar, nuk bën që kontrata të jetë e ndryshme nga kontrata e sigurimit të jetës.

**79.** Dividendi i mbajtësit të policës që përmbush të gjitha kërkesat e përshkruara në nënparagrafin C(8)(d) përjashtohet nga termi “Vlerë në Para të Gatshme”. “Dividendi i mbajtësit të policës” është çdo dividend ose shpërndarje e ngjashme për mbajtësit e policës në kapacitetin e tyre si të tillë, duke përfshirë:

- a) shumën e paguar apo të kredituar (duke përfshirë shumën si rritje e përfitimeve) nëse shuma nuk është fiksuar në kontratë, por në fakt varet nga përvoja e shoqërisë së sigurimeve ose gjykimi i drejtuesve;
- b) reduktimin në prim që, me përjashtim të reduktimit, do të ishte kërkuar të paguhej; dhe
- c) rimbursimin ose kredinë e vlerësuar nga përvoja bazuar vetëm në përvojën me pretendimet e kontratës ose grupit të përfshirë.

Dividendi i mbajtësit të policës nuk mund t'i kalojë primet e paguara më parë për kontratën, minus shumën e kostos së sigurimit dhe ndryshimet në shpenzime (pavarësisht nëse janë vendosur realisht ose jo) përgjatë ekzistencës së kontratës dhe shumën e totalizuar të çdo dividendi të paguar ose kredituar lidhur me kontratën.

Dividendi i mbajtësit të policës nuk përfshin asnjë shumë që është në natyrën e interesit që paguhet ose kreditohet të mbajtësi i kontratës deri në masën që kjo shumë e tejkalon normën minimale të interesit që kërkohet të kreditohet lidhur me vlerat e kontratës sipas legjislacionit lokal.

**80.** Kontratat e mikrosigurimit që nuk kanë një Vlerë në Para të Gatshme (duke përfshirë Vlerën në Para të Gatshme të barabartë me zero) nuk do të konsiderohen Kontrata Sigurimi në Vlerë në Para të Gatshme. Produktet e mbulimit me sigurim, të tilla si kontratat e sigurimit privat të jetës, përgjithësisht do të konsiderohen Kontrata Sigurimi në Vlerë në Para të Gatshme. “Produkti i mbuluar me sigurim” përfshin kontratën e sigurimit, aktivet e së cilës (i) mbahen në një llogari që mbahet nga një institucion financiar dhe (ii) menaxhohen në pajtim me strategjinë e personalizuar të investimeve ose nën kontrollin apo ndikimin e mbajtësit të policës, pronarit ose përfituesit të kontratës.

### *Nënparagrafët C(9) deri në (16) – Llogaritë Paraekzistuese dhe të Reja Individuale dhe të Njësive Ekonomike*

**81.** Nënparagrafët C(9) deri në (16) përmbajnë kategoritë e ndryshme të Llogarive Financiare që klasifikohen duke iu referuar datës së hapjes, Mbajtësit të Llogaritë dhe bilancit ose vlerës: “Llogaria Paraekzistuese”, “Llogaria e Re”, “Llogaria Paraekzistuese Individuale”, “Llogaria e Re Individuale”, “Llogaria Paraekzistuese e Njesisë Ekonomike”, “Llogaria e Vlerës së Ulët”, “Llogaria e Vlerës së Lartë” dhe “Llogaria e Re e Njësive Ekonomike”.

**82.** Së pari, Llogaria Financiare klasifikohet në varësi të datës së hapjes. Prandaj, Llogaria Financiare mund të jetë qoftë një “Llogari Paraekzistuese” ose një “Llogari e Re”. Nënparagrafët C(9) dhe (10) i përkufizojnë ato terma përkatësisht si Llogari Financiare që mbahen nga Institucioni Financiar Raportues duke filluar nga data [xx/xx/xxx], dhe që hapen më datë ose pas datës [xx/xx/xxx]. Sidoqoftë, kur zbatojnë Standardin e Përbashkët të Raportimit, juridiksionet kanë lirinë e ndryshimit të paragrafit C(9) me qëllim që të përfshijnë edhe disa llogari të reja të klientëve paraekzistues. Në këtë rast, nënparagrafi C(9) duhet të zëvendësohet me tekstin më poshtë:

#### *9. Termi “Llogari Paraekzistuese” është:*

a) *Llogaria Financiare që mbahet nga Institucioni Financiar Raportues duke filluar nga data [xx/xx/xxxx].*

b) *çdo Llogari Financiare e një Mbajtësi Llogarie, pavarësisht datës së hapjes të kësaj Llogarie Financiare, nëse:*

i) *Mbajtësi i Llogarisë gjithashtu mban pranë Institucionit Financiar Raportues (apo pranë një Njësie të Lidhur me të brenda të njëjtit juridiksion si Institucioni Financiar Raportues) një Llogari Financiare e cila është një Llogari Paraekzistuese sipas nënparagrafit C(9)(a);*

ii) *Institucioni Financiar Raportues (dhe, sipas rastit, Njësia e Lidhur me të brenda të njëjtit juridiksion si Institucioni Financiar Raportues) i trajton të dyja Llogaritë Financiare të lartpërmendura, dhe çdo Llogari tjetër Financiare të Mbajtësit të Llogarisë që trajtohet si Llogari Paraekzistuese sipas paragrafit C(9)(b), si një Llogari Financiare e vetme për qëllime të përmbushjes së kërkesave të standardit të njohurisë të parashtruara në paragrafin A të seksionit VII, dhe për qëllime të përcaktimit të bilancit ose vlerës së secilës prej Llogarive Financiare kur zbatohet ndonjë prej pragjeve të llogarisë;*

iii) *lidhur me një Llogari Financiare që është objekt i Procedurave për AML/KYC, Institucionit Financiar Raportues i lejohet të përmbushë këto Procedura për AML/KYC për*



*Llogarinë Financiare duke u mbështetur te Procedurat për AML/KYC të realizuara për Llogaritë Paraekzistuese të përshkruara në nënparagrafin C(9)(a); dhe*

*iv) hapja e Llogarisë Financiare nuk kërkon ofrimin e informacionit të ri, shtesë ose të ndryshuar për klientin nga Mbajtësi i Llogarisë përveçse për qëllimet e parashikuara në Standardin e Përbashkët të Raportimit.*

Shembuj të rasteve kur kërkohet informacion i ri, shtesë ose i ndryshuar për klientin janë kur Mbajtësi i Llogarisë që aktualisht mban një Llogari Depozite hap një Llogari Kujdestarie (meqë Mbajtësit të Llogarisë shpesh do t'i kërkohej të japë informacion lidhur me profilin e tij të rrezikut), ose kur Mbajtësi i Llogarisë nënshkruan një Kontratë të re Sigurimi. Thjesht pranimi i termave dhe kushteve, apo thjesht autorizimi i një vlerësimi kredie, lidhur me Llogarinë Financiare nuk përbën informacion për klientin.

Lidhur me nënparagrafin C(9)(b)(ii), për shembull, nëse Institucioni Financiar Raportues ka arsye të dijë se statusi që i është dhënë Mbajtësit të Llogarisë të një prej Llogarive Financiare është i pasaktë, atëherë ai ka arsye të dijë se statusi që i është dhënë të gjitha Llogarive të tjera Financiare të Mbajtësit të Llogarisë është i pasaktë. Po kështu, deri në masën që bilanci ose vlera e llogarisë ka rëndësi për qëllime të zbatimit të çdo pragu llogarie për një ose më shumë Llogari Financiare, Institucioni Financiar Raportues duhet të totalizojë bilancin ose vlerën e të gjitha këtyre Llogarive Financiare.

Ndoshta fondi nuk do të kualifikohet si Njësi e Lidhur e një tjetër fondi sipas nënparagrafit E(4) dhe, si rrjedhojë, përkufizimi alternativ i termit “Llogari Paraekzistuese” nuk do të zbatohet për interesat e rinj në kapital ose borxh që mbahen nga investitorët fundorë të cilët janë direkt të regjistruar në regjistrin e interesave të fondit. Juridiksionet që dëshirojnë ta adresojnë këtë situatë duhet gjithashtu ta zëvendësojnë nënparagrafin E(4) me tekstin vijues:

*4. Njësia Ekonomike është një “Njësi Ekonomike e Lidhur” nëse (a) secila prej Njësive kontrollon tjetrën; (b) të dyja njësitë janë nën kontroll të përbashkët; ose (c) të dyja Njësitë Ekonomike janë Njësi Ekonomike Investimesh që përshkruhen në nënparagrafin A(6)(b), janë nën menaxhim të përbashkët dhe ky menaxhim përmbush detyrimet e verifikimit të duhur të këtyre Njësive Ekonomike të Investimeve. Për këtë qëllim kontrolli përfshin pronësi direkte ose indirekte të më shumë se 50% të votave dhe vlerave në një Njësi Ekonomike.*

**83.** Llogaria Paraekzistuese dhe Llogaria e Re klasifikohen duke iu referuar llojit të Mbajtësit të Llogarisë. Prandaj, Llogaria Paraekzistuese mund të jetë qoftë një “Llogari Paraekzistuese Individuale” ose një “Llogari Paraekzistuese e Njësive Ekonomike” dhe Llogaria e Re mund të jetë qoftë një “Llogari e Re Individuale” ose një “Llogari e Re e Njësive Ekonomike”. Nënparagrafët C(11) deri në (13) dhe (16) i përkufizojnë këto terma përkatësisht.

**84.** Si përfundim, Llogaria Paraekzistuese Individuale klasifikohet mbi bazën e bilancit ose vlerës së saj që e kalon vlerën 1 000 000 USD. Prandaj, Llogaria Paraekzistuese Individuale mund të jetë qoftë një “Llogari e Vlerës së Lartë” ose një “Llogari e Vlerës së Ulët”. Nënparagrafët C(14) dhe (15) i përkufizojnë ato terma si vijon:

- termi “Llogari e Vlerës së Ulët” është Llogaria Paraekzistuese Individuale me një bilanc ose vlerë të totalizuar duke filluar nga data 31 dhjetor [xxxx] që nuk e kalon nivelin 1 000 000 USD.
- termi “Llogari e Vlerës së Lartë” është Llogaria Paraekzistuese Individuale me një bilanc ose vlerë të totalizuar që e kalon nivelin 1 000 000 USD duke filluar nga data 31 dhjetor [xxxx] ose data 31 dhjetor e çdo viti pasues.

Pasi llogaria bëhet Llogari e Vlerës së Lartë, ajo e mban këtë status deri në datën e mbylljes dhe, si rrjedhojë, nuk mund të konsiderohet më një Llogari e Vlerës së Ulët.

**85.** Ndërsa përzgjedhja e datave për ta klasifikuar një Llogari Financiare qoftë si “Llogari Paraekzistuese” ose “Llogari e Re” është vendim i juridiksionit që zbaton Standardin e Përbashkët të Raportimit, pritet që data për termin “Llogari e Re” të jetë dita pas datës së



përzgjedhur për termin “Llogari Paraekzistuese” (shih shtojcën 5 – Qasja me e gjerë ndaj Standardit të Përbashkët të Raportimit). Lidhur me përzgjedhjen e vitit për ta klasifikuar një Llogari Financiare qoftë si “Llogari të Vlerës së Lartë” ose “Llogari të Vlerës së Ulët” pritet që për të dyja termat të përzgjidhet i njëjti vit.

### *Nënparagrafi C(17) – Llogaria e Përrjashtuar*

**86.** Nënparagrafi C(17) përmban kategoritë e ndryshme të Llogarive të Përrjashtuara (d.m.th. që nuk janë Llogari Financiare dhe, si rrjedhojë, përrjashtohen nga raportimi), të cilat janë:

- a) llogaritë e pensionit të pleqërisë dhe të pensionit;
- b) llogaritë e favorizuara nga tatimet jo llogari pensioni pleqërie;
- c) kontratat e sigurimit të jetës me afat;
- d) llogaritë e pasurive;
- e) llogaritë me garanci të bllokuar;
- f) Llogaritë e Depozitës për shkak të mbipagesave të pakthyera; dhe
- g) llogaritë e përrjashtuara me rrezik të ulët.

Këto kategori në mënyrë tipike do të jenë në pajtim me llojet e llogarive të përrjashtuara nga përkufizimi i “Llogarive Financiare” në marrëveshjen ndërqeveritare të nënshkruar ndërmjet këtij juridiksioni dhe Shteteve të Bashkuara për të përmirësuar përputhshmërinë ndërkombëtare tatimore duke përfshirë edhe me FATCA-n, me kusht që këto lloje llogarish të përmbushin të gjitha kërkesat përkatëse të renditura në nënparagrafin C(17).

**87.** Për qëllime të përcaktimit nëse llogaria përmbush të gjitha kërkesat e një kategorie të veçantë të Llogarisë së Përrjashtuar, Institucioni Financiar Raportues mund të mbështetet në informacionin që posedon (duke përfshirë informacionin e mbledhur sipas Procedurave për AML/KYC) apo që është i disponueshëm publikisht, bazuar në të cilin ai mund të përcaktojë në mënyrë të arsyeshme që llogaria është një Llogari e Përrjashtuar (shih paragrafin 12 të Komentit për seksionin V). Në terma praktikë, Institucioni Financiar Raportues që mban vetëm llogari të cilat janë Llogari të Përrjashtuara nuk ka detyrime raportimi. Sidoqoftë, ai mund të ketë detyrime të tjera që i vendosen Institucionit Financiar Raportues, të tilla si depozitimi i raportimit zero në mungesë të Llogarive të Raportueshme (nëse parashikohet nga legjislacioni i brendshëm).

### **Llogaritë e pensionit të pleqërisë dhe të pensionit**

**88.** Llogaria e pensionit të pleqërisë ose e pensionit mund të jetë një Llogari e Përrjashtuar me kusht që të përmbushë të gjitha kërkesat e renditura në nënparagrafin C(17)(a). Ato kërkesa mund të përmbushen sipas ligjeve të juridiksionit ku mbahet llogaria. Në fjalë të tjera, kërkohet që:

- a) llogaria të jetë objekt i rregullores;
- b) llogaria të jetë e favorizuar nga tatimet;
- c) lidhur me llogarinë, autoriteteve tatimore i kërkohet që të raportojnë informacion;
- d) tërheqjet të kufizohen me arritjen e një moshe të specifikuar pensioni, invaliditetin ose vdekjen, ose do të aplikohen sanksione për tërheqjet e bëra përpara këtyre ngjarjeve të specifikuara; dhe
- e) ose (i) kontributet vjetore të jenë të kufizuara në 50 000 USD ose më pak, ose (ii) të ketë një kufi maksimal të kontributit gjatë të gjithë jetës në llogari prej 1 000 000 USD ose më pak, duke përrjashtuar riinvestimet.

**89.** Raportimi i informacionit që kërkohet në nënparagrafin C(17)(a)(iii) mund të variojë ndërmjet juridiksioneve. Ndërkohë që një juridiksion mund të kërkojë informacion vjetor për llogarinë, një tjetër mund të kërkojë informacion mujor për kontributet në llogari dhe lehtësirat tatimore të lidhura me to, dhe informacion vjetor për Mbajtësit e Llogarisë dhe kontributet totale në llogari. Prandaj, nëse ka raportim të informacionit që kërkohet nga autoritetet tatimore përkatëse në juridiksionin ku mbahet llogaria, koha dhe mënyra e raportimit nuk përcakton nëse llogaria e përmbush kërkesën sipas nënparagrafit C(17)(a)(iii).

### Llogaritë e favorizuara nga tatimet jo llogari pensioni pleqërie

**90.** Një llogari jo pensioni mund të jetë një Llogari e Përrjashtuar, me kusht që të përmbushë të gjitha kërkesat e renditura në nënparagrafin C(17)(b). Ato kërkesa duhet të përmbushen sipas ligjeve të juridiksionit ku mbahet llogaria. Me fjalë të tjera, kërkohet që:

- a) llogaria të jetë objekt i rregullores, dhe në të rastin e një instrumenti investimi të jetë i tregtuar rregullisht në një treg të konsoliduar të letrave me vlerë (shih paragrafin 112 më poshtë);
- b) llogaria të jetë e favorizuar nga tatimet;
- c) tërheqjet të jenë të kushtëzuara nga përmbushja e kriterëve të specifikuar, ose do të zbatohen penalitete për tërheqjet e bëra përpara përmbushjes së këtyre kriterëve; dhe
- d) kontributet vjetore të jenë të kufizuara në 50 000 USD ose më pak, duke përjashtuar riinvestimet.

### Kontratat e sigurimit të jetës me afat

**91.** Kontrata e sigurimit të jetës me një periudhë mbulimi që do të mbarojë përpara se individ i siguruar të arrijë moshën 90 vjeçare, mund të jetë një Llogari e Përrjashtuar, me kusht që kontrata të përmbushë të gjitha kërkesat e renditura në nënparagrafin C(17)(c). Siç përmendet në paragrafin 77 më lart, “kontrata e sigurimit të jetës” është një Kontratë Sigurimi sipas së cilës emetuesi, në këmbim të marrjes në konsideratë, bie dakord ta paguajë shumën pas vdekjes së një ose më shumë individëve.

### Llogaritë e pasurive

**92.** Sipas nënparagrafit C(17)(d), llogaria që mbahet vetëm nga një pasuri mund të jetë një Llogari e Përrjashtuar nëse dokumentacioni për këtë llogari përfshin një kopje të testamentit të personit të vdekur ose certifikatën e vdekjes. Për këtë qëllim, Institucioni Financiar Raportues duhet ta trajtojë llogarinë si me të njëjtin status që kishte përpara vdekjes së Mbajtësit të Llogarisë deri në datën kur e merr këtë kopje. Për të përcaktuar se çfarë nënkuptohet me “pasuri”, i duhet referuar rregullave të veçanta të secilit juridiksion për transferimin dhe trashëgiminë e të drejtave dhe detyrimeve në rast vdekjeje (p.sh. rregullat për trashëgiminë universale).

### Llogaritë me garanci të bllokuar

**93.** Nënparagrafi C(17)(e) në përgjithësi i referohet llogarive ku paratë mbahen nga një palë e tretë për llogari të palëve në transaksion (d.m.th. llogari me garanci të bllokuar). Këto llogari mund të jenë Llogari të Përrjashtuara në rastin kur janë krijuar përmes një nga pikave vijuese:

- a) një urdhër ose vendim gjykate.
- b) një shitje, shkëmbim ose qira të pasurisë së paluajtshme ose personale, me kusht që llogaria të përmbushë të gjitha kërkesat e renditura në nënparagrafin C(17)(e)(ii).

- c) detyrimi i Institucionit Financiar që jep një hua të siguruar me pasuri të paluajtshme për të hequr mënjatë një pjesë të pagesës thjesht për të lehtësuar pagesën e tatimeve ose sigurimeve që lidhen me pasurinë e paluajtshme në një moment të mëvonshëm.
- d) detyrimi i Institucionit Financiar thjesht për të lehtësuar pagesën e tatimeve në një moment të mëvonshëm.

**94.** Llogaria e Përrjashtuar, siç përshkruhet në nënparagrafin C(17)(e)(ii), duhet të krijohe lidhur me shitjen, shkëmbimin ose qiranë e pasurisë së paluajtshme ose personale. Përkufizimi i konceptit të pasurisë së paluajtshme ose personale duke iu referuar ligjeve të juridiksionit ku mbahet llogaria, do të ndihmojë në shmangien e vështirësive të interpretimit mbi pyetjen nëse një aktiv ose e drejtë do të cilësohet si pasuri e paluajtshme (p.sh. pasuri e paluajtshme), pasuri personale apo asnjëra prej tyre.

### Llogaritë e Depozitës për shkak të mbipagesave të pakthyera

Siç përmendet në paragrafin 44 më lart, Institucioni Financiar Raportues që nuk përmbush kërkesat për të qenë një Emetues i Kualifikuar i Kartave të Kreditit, por që pranon depozita kur klienti kryen një pagesë që e tejkalon bilancin e përcaktuar lidhur me kartën e kreditit ose instrumentet e tjera të kredive të rinovueshme, mund të vijoje ta raportojë një Llogari Depozite që kualifikohet si një Llogari e Përrjashtuar sipas nënparagrafit C(17)(f). Ky nënparagraf kërkon që:

- a) llogaria të ekzistojë vetëm sepse klienti kryen një pagesë përtej bilancit të caktuar lidhur me një kartë krediti ose instrumente të tjera kredie të rinovueshme dhe mbipagesa nuk i kthehet menjëherë klientit; dhe
  - b) duke filluar më datë ose përpara datës [xx/xx/xxxx], Institucioni Financiar zbaton politika dhe procedura qoftë për ta penguar klientin që të kryejë mbipagesa të cilat i tejkalojnë 50 000 USD, ose për të garantuar që çdo mbipagesë e klientit që e tejkalon vlerën 50 000 USD i rimburohet klientit brenda 60 ditëve, në secilin rast zbatohen rregullat e parashtruara në paragrafin C të seksionit VII për përkthimin e monedhës. Për këtë arsye, mbipagesa e klientit nuk i referohet balanceve të kreditit që përfshijnë tarifa të kundërshtuara por përfshijnë bilancet e kreditit që vijnë si rezultat i kthimit të mallit.
- 96.** Ndërsa përzgjedhja e datës së përmendur në nënparagrafin C(17)(f)(ii) është vendim i juridiksionit që zbaton Standardin e Përbashkët të Raportimit, pritët që data e përzgjedhur për atë qëllim të jetë e njëjta datë si data e përzgjedhur për termin “Llogari e Re”. Për këtë arsye, Institucioni Financiar që formohet ose organizohet pas datës së përzgjedhur duhet të përmbushë kërkesën e përshkruar në nënparagrafin C(17)(f)(ii) brenda gjashtë muajve pas datës në të cilën është formuar ose organizuar ky Institucion Financiar.

### Llogaritë e Përrjashtuara me rrezik të ulët

- 97.** Llogaria mund të jetë gjithashtu një Llogari e Përrjashtuar, sipas nënparagrafit C(17)(g), me kusht që:
- a) llogaria të paraqesë rrezik të ulët të përdorimit për shmangie tatimore;
  - b) llogaria të ketë karakteristika në thelb të ngjashme me çdo llogari të përshkruar në nënparagrafët C(17)(a) deri në (f);
  - c) llogaria të jetë e përcaktuar në legjislacionin e brendshëm si Llogari e Përrjashtuar; dhe
  - d) statusi i llogarisë si Llogari e Përrjashtuar të mos cenojë qëllimet e Standardit të Përbashkët të Raportimit.
- 98.** Kjo kategori “e hapur” e Llogarive të Përrjashtuara ka për qëllim të akomodojë llojet e llogarive specifike për juridiksionin që përmbushin kërkesat e renditura në listën në

nënparagrafin C(17)(g), dhe shmang nevojën për të negociuar kategoritë e Llogarive të Përfjashtuara kur arrihet një marrëveshje për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarisë financiare.

**99.** Kërkesa e parë e përshkruar në nënparagrafin C(17)(g) është që llogaria të paraqesë rrezik të ulët për t'u përdorur për shmangie tatimore. Faktorët që mund të konsiderohen për të përcaktuar këtë lloj rreziku përfshijnë:

a) faktorët me rrezik të ulët:

(1) llogaria është objekt i rregullores.

(2) llogaria është e favorizuar nga pikëpamja tatimore.

(3) lidhur me llogarinë kërkohet raportimi i informacionit pranë autoriteteve tatimore.

(4) kontributet ose lehtësirat tatimore të lidhura me to janë të kufizuara.

(5) lloji i llogarisë ofron shërbime të përcaktuara siç duhet dhe të kufizuara për disa lloje klientësh, me qëllim rritjen e aksesit për qëllime të përfshirjes financiare.

b) faktorët me rrezik të lartë:

(1) lloji i llogarisë nuk është objekt i Procedurave për AML/KYC.

(2) lloji i llogarisë promovohet si një instrument i minimizimit tatimor.

**100.** Kërkesa e dytë që përshkruhet në nënparagrafin C(17)(g) është që llogaria të ketë karakteristika të ngjashme në thelb me secilën prej llogarive të përshkruara në nënparagrafët C(17)(a) deri në (f). Kjo kërkesë nuk mund të përdoret vetëm për të eliminuar një element specifik të përshkrimit. Secili juridiksion mund ta vlerësojë zbatimin e kësaj kërkesë për një lloj kërkesë që nuk përmbush të gjitha kërkesat e një përshkrimi të caktuar të renditur në nënparagrafët C(17)(a) deri në (f). Si pjesë e këtij vlerësimi, juridiksioni mund të identifikojë se cilat kërkesa janë përmbushur dhe cilat jo, dhe lidhur me ato kërkesa që nuk janë përmbushur, duhet të identifikojë ekzistencën e një kërkesë zëvendësuese që ofron garanci ekuivalente se lloji përkatës i llogarisë paraqet rrezik të ulët për shmangie tatimore.

**101.** Kërkesa e tretë e përshkruar në nënparagrafin C(17)(g) është që llogaria të jetë përcaktuar në legjislacionin e brendshëm si një Llogari e Përfjashtuar. Kjo kërkesë përmbushet në rastin kur juridiksioni e përcakton një lloj specifik të llogarisë si Llogari të Përfjashtuar, dhe ai përcaktim ndodhet në legjislacionin e brendshëm. Për këtë qëllim, juridiksioni në mënyrë tipike do të ishte në pajtim me llojet e llogarive të përfjashtuara nga përkufizimi i "Llogarive Financiare" në marrëveshjen ndërqeveritare të nënshkruar ndërmjet këtij juridiksioni dhe Shteteve të Bashkuara për të përmirësuar përputhshmërinë tatimore ndërkombëtare edhe me FATCA-n (p.sh. llogaritë e kursimeve që akoma nuk janë Llogari të Përfjashtuara), me kusht që këto lloje llogarish të përmbushin të gjitha kërkesat e renditura në nënparagrafin C(17)(g). Pritet që secili juridiksion të ketë vetëm një listë të vetme të Llogarive të Përfjashtuara të përcaktuar brenda vendit (në krahasim me lista të ndryshme për Juridiksione të ndryshme Pjesëmarrëse) dhe se këtë listë do ta vendosë në dispozicion të publikut.

**102.** Kërkesa e katërt që përshkruhet në nënparagrafin C(17)(b) është që statusi i llogarisë si Llogari e Përfjashtuar të mos cenojë qëllimet e Standardit të Përbashkët të Raportimit. Pritet që kjo kërkesë të monitorohet, ndër të tjera, përmes sa më poshtë vijon:

a) procedurat administrative që juridiksioni duhet të ketë për të garantuar se llogaritë e përcaktuara në legjislacionin e brendshëm si Llogari të Përfjashtuara vijnë nën një rrezik të ulët për t'u përdorur për shmangie tatimore (shih nënparagrafin A(4) të seksionit IX);

- b) pezullimi i mundshëm i Marrëveshjes së Autoritetit Kompetent kur Autoriteti tjetër Kompetent e ka përcaktuar statusin e llogarive si Llogari të Përbashkuara në një mënyrë të atillë që cenon qëllimet e Standardit të Përbashkët të Raportimit (shih paragrafin 2 të seksionit 7 të Marrëveshjes Model të Autoritetit Kompetent); dhe
- c) mekanizmi për të shqyrtuar zbatimin e Standardit të Përbashkët të Raportimit që i është mandatuar Forumit Global për Transparencën dhe Shkëmbimin e Informacionit për Qëllime Tatimore nga G20 (shih paragrafin 51 të Deklaratës së Liderëve të G20, Samiti i Sent Petersburgut, 5-6 shtator 2013).<sup>16</sup>

**103. Shembujt vijues ilustrojnë zbatimin e nënparagrafit C(17)(g):**

- Shembulli 1 (Kontratë Pensioni Vjetor e Pakufizuar): Lloj Kontrate Pensioni Vjetor që përmbush të gjitha kërkesat e renditura në nënparagrafin C(17)(a), përveç asaj që ndodhet në nënparagrafin C(17)(a)(v) (d.m.th. kontributet nuk janë të kufizuara). Sidoqoftë, penalitetet e zbatueshme zbatohen për të gjitha tërheqjet e bëra përpara arritjes së një moshe të specifikuar pensioni dhe përfshijnë tatimin e kontributeve që më përpara ishin të favorizuara nga tatimet me një mbitatim takse të sheshtë të lartë (p.sh. 60%). Duke qenë se ka një kërkesë zëvendësuese që ofron garanci ekuivalente se llogaria paraqet rrezik të ulët të shmangies tatimore, kjo lloj llogarie mund të përcaktohet në legjislacionin e brendshëm si Llogari e Përbashkuar.
- Shembulli 2 (Llogari e kursimeve e pakufizuar): Lloj llogarie kursimesh që përmbush të gjitha kërkesat e renditura në nënparagrafin C(17)(b), përveç asaj që ndodhet në nënparagrafin C(17)(b)(iv) (d.m.th. kontributet nuk janë të kufizuara). Sidoqoftë, lehtësirat tatimore që lidhen me kontributet kufizohen duke iu referuar shumës së indeksuar. Duke qenë se ka një kërkesë zëvendësuese që ofron garanci ekuivalente se llogaria paraqet rrezik të ulët të shmangies tatimore, kjo lloj llogarie mund të përcaktohet në legjislacionin e brendshëm si Llogari e Përbashkuar.
- Shembulli 3 (Kontratë Mikrosigurimi në Vlerë në Para të Gatshme): Lloj Kontrate Sigurimi në Vlerë në Para të Gatshme që përmbush vetëm kërkesën e përshkruar në nënparagrafin C(17)(b)(i) (d.m.th. rregullohet si instrument kursimesh për qëllime të ndryshme nga ato për pension pleqërie). Megjithatë, sipas rregullave të mikrosigurimit të Juridiksionit Pjesëmarrës, (i) ajo synohet për individët (ose grupet e individëve) që janë në nivelin e varfërisë (p.sh. që jetojnë me më pak se 1,25 USD për person në ditë sipas dollarit amerikan në vitin 2005), dhe (ii) shuma totale bruto e pagueshme sipas kontratës nuk mund ta tejkalojë vlerën 7000 USD.

Duke qenë se ka një kërkesë të përgjithshme zëvendësuese që ofron garanci ekuivalente se llogaria paraqet rrezik të ulët të shmangies tatimore, kjo lloj llogarie mund të përcaktohet në legjislacionin e brendshëm si Llogari e Përbashkuar.

- Shembulli 4 (Llogari e mirëqenies sociale): Një lloj llogarie kursimesh që përmbush vetëm kërkesën e përshkruar në nënparagrafin C(17)(b)(i) (d.m.th. rregullohet si instrument kursimesh për qëllime të ndryshme nga ato të pensionit të pleqërisë). Sidoqoftë, sipas rregulloreve për mirëqenien sociale të Juridiksionit Pjesëmarrës, ajo mund të mbahet vetëm nga një individ që (i) është nën vijën e varfërisë (p.sh. jeton me më pak se 1,25 USD për person në ditë sipas dollarit amerikan në vitin 2005) ose me të ardhura të ulëta, dhe (ii) merr pjesë në një program të mirëqenies sociale. Duke qenë se ka një kërkesë të përgjithshme zëvendësuese që ofron garanci ekuivalente se llogaria paraqet rrezik të ulët të shmangies tatimore, kjo lloj llogarie mund të përcaktohet në legjislacionin e brendshëm si Llogari e Përbashkuar.

<sup>16</sup> Disponohet në <https://www.g20.org/>.



- Shembulli 5 (Llogari e përfshirjes financiare): Një lloj Llogarie Depozite që përmbush vetëm kërkesat që përshkruhen në nënparagrafët C(17)(b)(i) dhe (iv) (d.m.th. rregullohet si instrument investimesh për qëllime të ndryshme nga ato për pension pleqërie, dhe kontributet vjetore janë të kufizuara). Sidoqoftë, sipas rregulloreve financiare të Juridiksionit Pjesëmarrës, (i) ajo ofron shërbime të përcaktuara dhe të kufizuara për individët, me qëllim rritjen e aksesit për qëllime të përfshirjes financiare; (ii) depozitat mujore nuk mund t'i kalojnë 1250 USD (duke përfshirë depozitat nga një organ qeveritar i autorizuar sipas programit të mirëqenies sociale); dhe (iii) institucionet financiare janë lejuar të zbatojnë Procedurat e thjeshtuara për AML/KYC lidhur me këtë lloj Llogarie, duke qenë se është cilësuar si llogari me rrezik më të ulët të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në pajtim me Rekomandimet e FATF-së. Duke qenë se ka kërkesa të përgjithshme zëvendësuese që ofrojnë garanci ekuivalente se llogaria paraqet rrezik të ulët të shmangies tatimore, kjo lloj Llogarie mund të përcaktohet në legjislacionin e brendshëm si Llogari e Përfshirës.
- Shembulli 6 (Llogari e fjetur): Një lloj Llogarie Depozite (i) me një bilanc vjetor që nuk e kalon nivelin prej 1000 USD, (ii) që është një llogari e fjetur (shih paragrafin 9 të Komentit për seksionin III).

Duke qenë se ka kërkesa të përgjithshme zëvendësuese që ofrojnë garanci ekuivalente se llogaria paraqet rrezik të ulët të shmangies tatimore, kjo lloj Llogarie mund të përcaktohet në legjislacionin e brendshëm si Llogari e Përfshirës për gjatë periudhës së fjetjes.

## Paragrafi D – Llogari e Raportueshme

**104.** Paragrafi D përmban përkufizimin e termit “Llogari e Raportueshme” dhe të gjithë termat e tjerë të përkufizuar që kanë rëndësi për të përcaktuar nëse një llogari është Llogari e Raportueshme.

### *Nënparagrafi D(1) – Llogari e Raportueshme*

**105.** Siç përcaktohet në nënparagrafin D(1), termi “Llogari e Raportueshme” është llogaria që mbahet nga një ose më shumë Persona të Raportueshëm ose nga një NFE Pasive me një ose më shumë Persona Kontrollues që është Person i Raportueshëm, me kusht që të jetë identifikuar si e tillë në bazë të procedurave të verifikimit të duhur të përshkruara në seksionet II deri në VII.

### *Nënparagrafët D(2) dhe (3) – Person i Raportueshëm dhe Person i Juridiksionit të Raportueshëm*

#### Person i Juridiksionit të Raportueshëm

**106.** Si rregull i përgjithshëm, individ i ose Njësia Ekonomike është “Person i Juridiksionit të Raportueshëm” nëse është rezident në një Juridiksion të Raportueshëm sipas legjislacioneve tatimore të këtij juridiksioni. Si përjashtim nga ky rregull, Njësia Ekonomike që nuk ka rezidencë për qëllime tatimore (p.sh. sepse trajtohet si transparente nga pikëpamja fiskale) konsiderohet si rezidente në juridiksionin në të cilin ndodhet vendi i saj i menaxhimit efektiv.

**107.** Legjislacionet tatimore ndryshojnë në mënyrën e trajtimit të partneriteteve (duke përfshirë partneritetet me përgjegjësi të kufizuar). Disa juridiksione i trajtojnë partneritetet si njësi të tatueshme (ndonjëherë edhe si shoqëri), ndërsa juridiksionet e tjera adoptojnë atë që mund të cilësohet edhe si qasja transparente nga pikëpamja fiskale, sipas së cilës partneriteti nuk merret në konsideratë për qëllime tatimore. Në rastin kur partneriteti trajtohet si shoqëri ose tatohet në të njëjtën mënyrë, në përgjithësi do të konsiderohet si rezident i Juridiksionit të

Raportueshëm që e taton partneritetin. Sidoqoftë, në rastin kur partneriteti trajtohet si transparent nga pikëpamja fiskale në një Juridiksion të Raportueshëm, partneriteti nuk “ka detyrime tatimore” në atë juridiksion, dhe, si rrjedhojë, nuk mund të jetë rezident i tij.

**108.** Njësia Ekonomike e tillë si partneriteti, partneriteti me përgjegjësi të kufizuar ose struktura të ngjashme ligjore që nuk ka rezidencë për qëllime tatimore, sipas nënparagrafit D(3), do të trajtohet si rezidente në juridiksionin në të cilin ndodhet vendi i saj i menaxhimit efektiv. Për këto qëllime, personi juridik ose struktura ligjore konsiderohet “e ngjashme” me partneritetin dhe partneritet me përgjegjësi të kufizuar në rastin kur nuk trajtohet si njësi e tatueshme në një Juridiksion Pjesëmarrës sipas legjislacioneve tatimore të këtij juridiksioni. Sidoqoftë, për të shmangur raportimin e dyfishtë (nisur nga qëllimi i gjerë i termit “Person Kontrollues” në rastin e trusteve), trusti që është NFE Pasive mund të mos konsiderohet një strukturë e ngjashme ligjore.

**109.** “Vendi i menaxhimit efikas” është vendi ku në thelb realizohen vendimet tregtare dhe menaxhimet kryesore që janë të nevojshme për kryerjen në tërësi të biznesit të Njesisë Ekonomike. Të gjitha faktet dhe rrethanat përkatëse duhet të ekzaminohen për të përcaktuar vendin e menaxhimit efikas. Njësia Ekonomike mund të ketë më shumë se një vend menaxhimi, por mund të ketë vetëm një vend menaxhimi efikas në çdo kohë.

**110.** Termi “Person i Juridiksionit të Raportueshëm” gjithashtu përfshin pasurinë e personit të vdekur që ka qenë rezident në një Juridiksion të Raportueshëm. Siç përmendet në paragrafin 92 më lart, kur përcaktohet se çfarë nënkuptohet me “pasuri”, i duhet referuar rregullave të veçanta të secilit juridiksion për transferimin ose trashëgimin e të drejtave dhe detyrimeve në rast vdekjeje (p.sh. rregullat për trashëgiminë universale).

## Person i Raportueshëm

**111.** Nënparagrafi D(2) e përkufizon termin “Person i Raportueshëm” si Person i Juridiksionit të Raportueshëm i ndryshëm nga:

- a) korporata, aksionet e së cilës tregtohen rregullisht në një ose më shumë tregje të konsoliduara të letrave me vlerë;
- b) çdo korporatë që është Njësi Ekonomike e lidhur me korporatën e përshkruar më parë;
- c) Organi Qeveritar;
- d) Organizata Ndërkombëtare;
- e) Banka Qendrore; ose
- f) Institucioni Financiar.

**112.** Nëse korporata e cila është Person i Juridiksionit të Raportueshëm është një Person i Raportueshëm, siç përshkruhet në nënparagrafin D(2)(i), mund të varet nga aksionet e asaj korporate që po tregtohen rregullisht në një ose më shumë tregje të konsoliduara të letrave me vlerë. Aksionet “tregtohen rregullisht” nëse ka një volum të konsiderueshëm të tregtimit të vazhdueshëm lidhur me aksionet, dhe “treg i konsoliduar i letrave me vlerë” është një bursë e cila njihet zyrtarisht dhe monitorohet nga autoriteti qeveritar në të cilin ndodhet tregu dhe që ka një vlerë të konsiderueshme vjetore të aksioneve të tregtuara në bursë.

**113.** Lidhur me secilën kategori aksionesh të korporatës, ka një “volum të konsiderueshëm të tregtimit të vazhdueshëm” nëse (i) tregtia në secilën kategori kryhet, të ndryshme nga ato në sasi de minimis, në një ose më shumë tregje të konsoliduara të letrave me vlerë në të paktën 60 ditë pune gjatë vitit të mëparshëm kalendarik; dhe (ii) numri i totalizuar i aksioneve në secilën kategori që tregtohet në këtë treg apo tregje gjatë vitit të kaluar është të paktën 10% e numrit mesatar të aksioneve në qarkullim në atë kategori gjatë vitit të mëparshëm kalendarik.

**114.** Kategoria e aksioneve përgjithësisht do të trajtohet se e përmbush kërkesën “të tregtuara rregullisht” për një vit kalendarik nëse aksionet tregtohen gjatë këtij viti në një treg

të konsoliduar të letrave me vlerë dhe kuotohen rregullisht nga tregtarët në tregun e aksioneve. Tregtar në tregun e aksioneve është personi i cili ofron rregullisht dhe aktivisht për, dhe në fakt kështu vepron, blen aksione nga, dhe shet aksione për, klientët të cilët nuk janë persona të lidhur me tregtarin në veprimtarinë e zakonshme të biznesit.

**115.** Bursa ka një “vlerë të konsiderueshme vjetore të aksioneve që tregtohen në bursë” nëse ajo ka një vlerë vjetore të aksioneve që tregtohen në bursë (ose bursë paraardhëse) që e kalon vlerën 1 000 000 000 USD gjatë secilës periudhë prej tre vitesh kalendarike që vjen menjëherë përpara vitit kalendarik në të cilin bëhet përcaktimi. Nëse bursa ka më tepër se një shkallë të nivelit të tregut ku aksionet mund të listohen dhe tregtohen veçmas, secila shkallë e tillë duhet të trajtohet si bursë më vete.

**116.** Sipas nënparagrafit D(2)(vi), Institucionet Financiare përjashtohen nga termi “Person i Raportueshëm” duke qenë se do të bëjnë raportimin e tyre vetjak ose cilësohen se paraqesin rrezik të ulët për t’u përdorur për shmangie tatimore. Prandaj ato përjashtohen nga raportimi, përveç Njërive Ekonomike të Investimeve që përshkruhen në nënparagrafin A(6)(b) të cilat nuk janë Institucione Financiare të Juridiksionit Pjesëmarrës, që trajtohen si NFE Pasive dhe, si pasojë, raportohen.

### *Nënparagrafët D(4) dhe (5) – Juridiksionet e Raportueshme dhe Pjesëmarrëse*

**117.** Nënparagrafët D(4) dhe (5) i përkufizojnë termat “Juridiksion i Raportueshëm” dhe “Juridiksion Pjesëmarrës” si vijon:

- termi “Juridiksion i Raportueshëm” është juridiksioni (i) me të cilin ekziston një marrëveshje sipas së cilës ka një detyrim për të ofruar informacionin e specifikuar në seksionin I dhe (ii) i cili është i identifikuar në listën e publikuar.
- termi “Juridiksion Pjesëmarrës” është juridiksioni (i) me të cilin ekziston një marrëveshje sipas së cilës ka një detyrim për të ofruar informacionin e specifikuar në seksionin I dhe (ii) i cili është i identifikuar në listën e publikuar.

**118.** Ato terma janë të rëndësishme për qëllimin e institucioneve financiare të cilave u kërkohet të raportojnë dhe mbajtësit e llogarive që janë objekt i raportimit, si edhe për kërkesën për të verifikuar njësitë ekonomike jopjesëmarrëse të investimeve të menaxhuara në mënyrë profesionale. Ndërkohë që të dy termat duken të ngjashëm, ka dallime të konsiderueshme: termi “Juridiksion Pjesëmarrës” kualifikon juridiksionin me të cilin ekziston një marrëveshje për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarisë financiare (d.m.th. informacioni i specifikuar në seksionin I), ndërsa termi “Juridiksion i Raportueshëm” kualifikon një Juridiksion Pjesëmarrës me të cilin ekziston detyrimi për të dhënë informacion të llogarisë financiare.

**119.** Nënparagrafët D(4) dhe (5) kërkojnë që juridiksioni të identifikohet në një listë të publikuar, përkatësisht, si Juridiksion i Raportueshëm dhe si Juridiksion Pjesëmarrës. Secili juridiksion duhet ta bëjë publike këtë listë dhe ta përditësojë siç duhet (p.sh. çdoherë që juridiksioni nënshkruan një marrëveshje për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarisë financiare, ose kur kjo marrëveshje hyn në fuqi).

**120.** Shembujt vijues ilustrojnë zbatimin e nënparagrafëve D(4) dhe (5):

- Shembulli 1 (Shkëmbimi i ndërsjellë): Juridiksioni A dhe Juridiksioni B kanë një marrëveshje të ndërsjellë për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarisë financiare. Sipas asaj marrëveshjeje, të dyja Juridiksionet janë të detyruara të shkëmbejnë informacionin e specifikuar në seksionin I. Për shkak se Juridiksioni A ka një marrëveshje me Juridiksionin B sipas së cilës ka një detyrim për të dhënë informacionin e specifikuar në seksionin I, nga perspektiva e Juridiksionit A, Juridiksioni B është si Juridiksion Pjesëmarrës dhe Juridiksion i Raportueshëm. E njëjta gjë vlen nga perspektiva e Juridiksionit B lidhur me Juridiksionin A.

- Shembulli 2 (Shkëmbimi jo i ndërsjellë): Juridiksioni X, i cili nuk ka tatim mbi të ardhurat, dhe Juridiksioni Y kanë një marrëveshje joreciproke për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarisë financiare. Sipas asaj marrëveshjeje, vetëm Juridiksioni X është i detyruar të shkëmbejë informacionin e specifikuar në seksionin I. Për shkak se Juridiksioni X ka një marrëveshje me Juridiksionin Y sipas së cilës ka një detyrim për të dhënë informacionin e specifikuar në seksionin I, nga perspektiva e Juridiksionit X, Juridiksioni Y është si Juridiksion Pjesëmarrës dhe Juridiksion i Raportueshëm. Megjithatë, për shkak se Juridiksioni Y ka një marrëveshje me Juridiksionin C, por nuk ka detyrimin për të dhënë informacionin e specifikuar në seksionin I sipas asaj marrëveshjeje, nga perspektiva e Juridiksionit Y, Juridiksioni X është një Juridiksion Pjesëmarrës, por jo një Juridiksion i Raportueshëm.

### *Nënparagrafët D(6) deri në (9) – NFE dhe Personat Kontrollues*

#### **NFE, NFE Pasive dhe NFE Aktive**

**121.** Nënparagrafët D(6) deri në (9) përkufizojnë termat “NFE”, “NFE Pasive”, “NFE Aktive” dhe “Persona Kontrollues”, të cilat janë të rëndësishme për qëllime të përcaktimit nëse Njësia Ekonomike është një NFE Pasive me një ose më shumë Persona Kontrollues të cilët janë Persona të Raportueshëm. Në rast se ndodh kështu, siç përshkruhet në nënparagrafët D(2) të seksionit V dhe A(2) të seksionit VI, atëherë llogaria duhet të trajtohet si Llogari e Raportueshme.

**122.** Termi “NFE” është një shkurtesë për Njësine Ekonomike Jofinanciare dhe, sipas nënparagrafit D(7), është çdo Njësi Ekonomike që nuk është një Institucion Financiar. NFE-ja mund të jetë NFE Pasive ose NFE Aktive. Nënparagrafët D(8) dhe (9) parashtrojnë përkatësisht kuptimin e termave “NFE Pasive” dhe “NFE Aktive”.

**123.** Në parim, “NFE Pasive” është një NFE që nuk është një NFE Aktive. Megjithatë, nënparagrafi D(8) përfshin gjithashtu Njësine Ekonomike të Investimeve që përshkruhet në nënparagrafin A(6)(b) që nuk është një Institucion Financiar i Juridiksionit Pjesëmarrës. Si rezultat, Institucioneve Financiare Raportuese u kërkohet ta shqyrtojnë atë lloj Njësie Ekonomike Investimesh, siç ilustron nga shembulli vijues: Juridiksioni A ka një marrëveshje reciproke për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarisë financiare me Juridiksionin B, por nuk ka një marrëveshje me Juridiksionin C. W, një Institucion Financiar Raportues i Juridiksionit A, mban Llogari Financiare për Njësitë Ekonomike X dhe Y, të dyja Njësi Ekonomike Investimesh siç përshkruhet në nënparagrafin A(6)(b). Njësia Ekonomike X është rezidente në Juridiksionin B dhe Njësia Ekonomike Y është rezidente në Juridiksionin C. Nga perspektiva e W, Njësia Ekonomike X është një Institucion Financiar i Juridiksionit Pjesëmarrës. Si rezultat, W duhet ta trajtojë Njësine Y si një NFE Pasive në bazë të nënparagrafit D(8).

**124.** Çdo NFE mund të jetë një NFE Aktive, me kusht që të përmbushë secilën prej kriterëve të renditura në nënparagrafin D(9). Me fjalë të tjera, ato kriterë i referohen:

- a) NFE-ve aktive për shkak të të ardhurave dhe aktiveve;
- b) NFE-ve të tregtuara publikisht;
- c) Organeve Qeveritare, Organizatave Ndërkombëtare, Bankave Qendrore, ose Njësive të tyre Ekonomike të zotëruara plotësisht;
- d) NFE-ve kontrolluese (holding) të cilat janë anëtare të një grupi jofinanciar;
- e) NFE-ve të reja;
- f) NFE-ve të cilat janë në proces likuidimi ose po dalin nga falimentimi;
- g) qendrat e thesarit të cilat janë anëtare të një grupi jofinanciar; ose

h) NFE-të jofitimprurëse.

**125.** Nënparagrafi D(9)(a) përshkruan kriterin për t'u kualifikuar për statusin e NFE-së Aktive për "NFE-të aktive për shkak të të ardhurave dhe aktiveve" si vijon: më pak se 50% e të ardhurave bruto të NFE-së për vitin paraardhës kalendarik ose një periudhë tjetër të përshtatshme raportimi janë të ardhura Pasive dhe më pak se 50% të aktiveve që mbahen nga NFE-ja gjatë vitit paraardhës kalendarik ose një periudhe tjetër të përshtatshme raportimi janë aktive që gjenerojnë ose që mbahen për gjenerimin e të ardhurave Pasive.

**126.** Kur përcaktohet se çfarë nënkuptohet me "të ardhura Pasive", i duhet referuar rregullave të secilit juridiksion pjesëmarrës. Të ardhurat Pasive përgjithësisht do të konsiderohen se përfshijnë pjesën e të ardhurave bruto që përbëhen nga:

- a) dividendët;
- b) interesat;
- c) të ardhurat ekuivalente me interesat;
- d) qiratë dhe pagesat për përdorimin e pronës, të ndryshme nga qiratë dhe pagesat për përdorimin e pronës që vijnë gjatë kryerjes së biznesit në mënyrë aktive nga punonjësit e NFE-së, të paktën pjesërisht;
- e) pagesat vjetore;
- f) tepricat e fitimeve mbi humbjet nga shitja ose shkëmbimi i Aktiveve Financiare të cilat rezultojnë në të ardhurat Pasive të përshkruara më parë;
- g) tepricat e fitimeve mbi humbjet nga transaksionet (duke përfshirë kontratat future, forward, opsionet dhe transaksione të ngjashme) në çdo Aktive Financiare;
- h) tepricat e fitimeve nga valuta e huaj mbi humbjet nga valuta e huaj;
- i) të ardhurat neto nga swaps-et; ose
- j) shumat e marra sipas Kontratave të Sigurimit në Vlerë në Para të Gatshme.

Pavarësisht nga sa më sipër, të ardhurat Pasive nuk do të përfshijnë, në rastin e një NFE-je që vepron rregullisht si tregtar i Aktiveve Financiare, asnjë të ardhur nga transaksionet në të cilat hyn gjatë veprimtarisë së zakonshme të biznesit të këtij tregtari si tregtar i tillë.

**127.** Vlera e aktiveve të NFE-së përcaktohet bazuar në vlerën e tyre të saktë në treg ose vlerën kontabël të aktiveve që pasqyrohet në bilancin e NFE-së.

**128.** Nënparagrafi D(9)(b) përshkruan kriterin për t'u kualifikuar për statusin NFE Aktive për "NFE-të e tregtuara publikisht" si vijon: aksionet e NFE-së tregtohen rregullisht në një treg të konsoliduar letrash me vlerë ose NFE-ja është një Njësi Ekonomike e Lidhur e një Njësie Ekonomike aksionet e së cilës tregtohen rregullisht në tregun e konsoliduar të letrave me vlerë. Siç përmendet në paragrafin 112 më lart, aksionet "tregtohen rregullisht" nëse ka një volum të konsiderueshëm të tregtimit të vazhdueshëm lidhur me aksionet, dhe "treg i konsoliduar i letrave me vlerë" është një bursë e cila njihet zyrtarisht dhe monitorohet nga autoriteti qeveritar në të cilin ndodhet tregu dhe që ka një vlerë të konsiderueshme vjetore të aksioneve të tregtuara në bursë.

**129.** Nënparagrafi D(9)(d) përshkruan kriterin për t'u kualifikuar për statusin e NFE-së Aktive për "NFE-të holding që janë anëtare të një grupi jofinanciar" si vijon: në thelb të gjitha aktivitetet e NFE-së përbëhen nga kontrolli (totalisht ose pjesërisht) i aksioneve në qarkullim të, ose nga ofrimi i financimeve dhe shërbimeve për, një ose më shumë filiale që angazhohen në tregti ose biznese të ndryshme nga biznesi i Institucionit Financiar, me përjashtim të rasteve kur Njësia Ekonomike nuk kualifikohet për këtë status nëse Njësia Ekonomike funksionon (ose vepron) si një fond investimesh, i tillë si fond privat me kapital neto, fond me sipërmarrje kapitali, fond blerjeje me financim nga të tretë, ose çdo instrument investimi qëllimi i të cilit



është blerja ose financimi i shoqërive dhe më pas mbajtja e interesave në ato shoqëri si aktive kapitali për qëllime investimi.

**130.** Lidhur me aktivitetet e përmendura në nënparagrafin D(9)(d), “në thelb të gjitha” nënkupton 80% ose më shumë. Sidoqoftë, nëse holdingu i NFE-së ose aktivitetet financiare të grupit përbëjnë më pak se 80% të aktiviteve të saj, por NFE-ja merr edhe të ardhura aktive (d.m.th. të ardhura që nuk janë të ardhura Pasive), ajo kualifikohet për statusin e NFE-së Aktive, me kusht që shuma totale e aktiviteve të përmbushë “testin në thelb të gjitha”. Për qëllime të përcaktimit nëse aktivitetet e ndryshme nga holdingu dhe aktivitetet financiare të grupit të NFE-së e kualifikojnë atë si një NFE Aktive, për këto aktivitete të tjera mund të aplikohet testi i nënparagrafit D(9)(a). Për shembull, nëse shoqëria holding ka aktivitete holdingu ose financimi dhe shërbime në një ose më shumë filiale për 60% dhe gjithashtu funksionon për 40% si qendër e shpërndarjes për mallrat e prodhuara nga grupi të cilit i përket dhe të ardhurat e aktiviteve të qendrës së saj të shpërndarjes janë aktive sipas nënparagrafit D(9)(a), ajo është një NFE Aktive, pavarësisht faktit se më pak se 80% e aktiviteve të saj përbëhen nga kontrolli i aksioneve në qarkullim të, ose ofrimi i financimeve dhe shërbimeve për, një ose më shumë filiale. Termi “në thelb të gjitha” mbulon gjithashtu kombinimin e aksioneve të dhe ofrimit të financimit dhe shërbimeve për një ose më shumë filiale. Termi “filial” nënkupton çdo njësi ekonomike aksionet në qarkullim të së cilës mbahen direkt ose indirekt nga NFE-ja (totalisht ose pjesërisht).

**131.** Një nga kërkesat e renditura në nënparagrafin D(9)(h) për “NFE-të Jofitimprurëse” për t’u kualifikuar për statusin e NFE-së Aktive është që ligjet e zbatueshme të juridiksionit të rezidencës së NFE-së ose dokumentet e formimit të NFE-së nuk lejojnë që të ardhurat ose aktivet e NFE-së të shpërndahen te, apo të shkojnë në përfitim të, një personi privat ose Njësie Ekonomike jobamirëse përveçse në zbatim të realizimit të aktiviteve bamirëse të NFE-së, ose si pagesë e kompensimit të arsyeshëm për shërbimet e dhëna, ose si pagesë që përfaqëson vlerën e drejtë në treg të pasurisë së blerë nga NFE-ja. Gjithashtu, të ardhurat ose aktivet e NFE-së mund të shpërndahen te, ose të shkojnë në përfitim të personave privatë ose Njësive Ekonomike bamirëse si pagesë e arsyeshme për përdorimin e pasurisë.

## Personat Kontrollues

**132.** Nënparagrafi D(6) parashtroi përkufizimin e termit “Persona Kontrollues”. Ky term korrespondon me termin “pronar përfitues” siç përkufizohet në Rekomandimin 10 dhe Shënimin Interpretues për Rekomandimin 10 të Rekomandimeve të Task Forcës për Aksionin Financiar (miratuar në shkurt 2012)<sup>17</sup>, dhe duhet të interpretohet në mënyrë të pajtueshme me këto Rekomandime, me qëllim mbrojtjen e sistemit financiar ndërkombëtar nga keqpërdorimi duke përfshirë edhe krimet tatimore.

**133.** Për një Njësi Ekonomike që është person juridik, termi “Person Kontrollues” janë personat fizikë të cilët ushtrojnë kontroll mbi Njësinë Ekonomike. “Kontroll” mbi një Njësi Ekonomike përgjithësisht ushtrohet nga personat fizikë të cilët kanë një interes pronësie kontrolli në Njësinë Ekonomike. “Interesi i pronësisë së kontrollit” varet nga struktura e pronësisë e personit juridik dhe zakonisht identifikohet mbi bazën e një pragu duke zbatuar një qasje të bazuar në rrezik (p.sh. çdo person që zotëron më shumë se një përqindje të caktuar të personit juridik, si p.sh. 25%). Në rast se asnjë person fizik nuk ushtron kontroll përmes interesave të pronësisë, Personat Kontrollues të Njësive Ekonomike do të jenë personat fizikë që ushtrojnë kontroll të Njësive Ekonomike përmes mjeteve të tjera. Në rastin kur nuk identifikohet asnjë person fizik si person që ushtron kontroll të Njësive Ekonomike, Personat

<sup>17</sup> FATF/OECD (2013), Standardet Ndërkombëtare për Luftën kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit dhe Përhapjes së Terrorizmit, Rekomandimet e FATF-së, shkurt 2012, FATF/OECD, Paris, gjendet në [www.fatf-gafi.org/media/fatf/documents/recommendations/pdfs/FATF\\_Recommendations.pdf](http://www.fatf-gafi.org/media/fatf/documents/recommendations/pdfs/FATF_Recommendations.pdf).

Kontrollues të Njesisë Ekonomike do të jenë personat fizikë të cilët mbajnë pozicionin e zyrtarit të lartë drejtues.

**134.** Në rastin e një trusti, termi “Persona Kontrollues” nënkupton krijuesit e trustit, administratorët e trustit, mbrojtësit (nëse ka), përfituesit ose kategoritë e përfituesve dhe çdo person tjetër fizik që ushtron kontroll efektiv mbi trustin. Krijuesit e trustit, administratorët e besuar të trustit, mbrojtësit e trustit (nëse ka) dhe përfituesit ose kategoritë e përfituesve, gjithmonë duhet të trajtohen si Persona Kontrollues të trustit, pavarësisht nëse ndonjëri prej tyre ushtron apo jo kontroll mbi trustin. Kjo është arsyeja që fjalë e dytë e nënparagrafit D(6) plotëson fjalinë e parë të këtij nënparagrafi. Gjithashtu, çdo person tjetër fizik që ushtron kontroll efektiv mbi trustin (duke përfshirë përmes një zinxhiri kontrolli ose pronësie) duhet të konsiderohet si Person Kontrollues i trustit. Me qëllim përcaktimit të burimit të fondeve në llogaritë që mbahen nga trusti, ku krijuesi i tij është një Njësi Ekonomike, Institucionet Financiare Raportuese duhet të identifikojnë edhe Personat Kontrollues të krijuesit të trustit dhe t’i raportojnë si Persona Kontrollues të trustit. Për ata përfitues të trustit të cilët caktohen sipas karakteristikave ose kategorisë, Institucionet Financiare Raportuese duhet të marrin informacion të mjaftueshëm lidhur me përfituesit për t’i dhënë mundësinë Institucionit Financiar Raportues që të përcaktojë identitetin e përfituesve në momentin e shlyerjes ose kur përfituesit kanë për qëllim të ushtrojnë të drejtat që u janë dhënë. Prandaj, ai rast do të përbëjë një ndryshim në rrethana dhe do të aktivizojë procedurat përkatëse. Kur zbaton Standardin e Përbashkët të Raportimit, juridiksioni mund t’i lejojë Institucionet Financiare Raportuese që të bashkërendojnë qëllimin e përfituesve të trustit të trajtuar si Persona Kontrollues të trustit me qëllimin e përfituesve të trustit që trajtohen si Persona të Raportueshëm të trustit që është Institucion Financiar (shih paragrafët 69-70 më lart).

**135.** Në rastin e një strukture ligjore të ndryshme nga trusti, termi “Persona Kontrollues” janë personat në pozicione ekuivalente ose të ngjashme me ata që janë Persona Kontrollues të trustit, Prandaj, duke marrë në konsideratë format dhe strukturat e ndryshme të strukturave ligjore, Institucionet Financiare Raportuese duhet të identifikojnë dhe raportojnë personat me pozicione ekuivalente dhe të ngjashme, si ato që kërkohen për t’u identifikuar dhe raportuar për trustin.

**136.** Në rastin e personave ligjorë që janë të ngjashëm nga pikëpamja funksionale me trustet (p.sh. fondacionet), Institucionet Financiare Raportuese duhet t’i identifikojnë Personat Kontrollues përmes të njëjtave procedura të verifikimit të duhur të klientëve si ato që kërkohen për trustet, me qëllimin për të arritur nivelet e duhura të raportimit.

**137.** Në rastin kur Institucioni Financiar Raportues mbështetet në informacionin e mbledhur dhe të mbajtur sipas Procedurave për AML/KYC për qëllime të përcaktimit të Personave Kontrollues të një Mbajtësi Llogarie të Llogarisë të Re të Njesisë Ekonomike (shih nënparagrafin A(2)(b) të seksionit VI), këto Procedura për AML/KYC duhet të jenë në pajtim me Rekomandimet 10 dhe 25 të Rekomandimeve të FATF-së (miratuar në shkurt 2012), gjithmonë duke përfshirë trajtimin e krijuesve të trustit si Persona Kontrollues të trustit dhe trajtimin e themeluesve të fondacionit si Persona Kontrollues të fondacionit. Për qëllime të përcaktimit të Personave Kontrollues të një Mbajtësi Llogarie të Llogarisë Paraekzistuese të Njesisë Ekonomike (shih nënparagrafin D(2)(b) të seksionit V), Institucioni Financiar Raportues duhet të mbështetet në informacionin e mbledhur dhe të mbajtur sipas Procedurave për AML/KYC të Institucionit Financiar Raportues.

## **Paragrafi E – Të ndryshme**

### *Nënparagrafi E(1) – Mbajtësi i Llogarisë*

**138.** Nënparagrafi E(1) e përkufizon termin “Mbajtës Llogarie” si personin e listuar ose identifikuar si mbajtësi i Llogarisë Financiare nga Institucioni Financiar që mban llogarinë. Kjo pavarësisht nëse ky person është një Njësi Ekonomike me transparencë

fiskale. Prandaj, për shembull, nëse trusti ose pasuria është e listuar si mbajtësi ose pronari i Llogarisë Financiare, trusti ose pasuria është Mbajtësi i Llogarisë, dhe jo pronarët ose përfituesit e tij. Po kështu, nëse një partneritet është i listuar si mbajtësi ose pronari i Llogarisë Financiare, partneriteti është Mbajtësi i Llogarisë dhe jo partnerët në partneritet.

139. Personi, i ndryshëm nga Institucioni Financiar, që mban një Llogari Financiare në përfitim të ose për llogari të një personi tjetër si agent, kujdestar, i emëruar, nënshkrues, këshilltar investimesh, ndërmjetës ose kujdestar ligjor, nuk trajtohet si person që e mban llogarinë sipas nënparagrafit E(1). Por është ky person tjetër që trajtohet si mbajtës i Llogarisë. Për këto qëllime, Institucioni Financiar Raportues mund të mbështetet në informacionin që ka në posedim (duke përfshirë informacionin e mbledhur sipas Procedurave për AML/KYC), në bazë të të cilave ai mund të përcaktojë me arsye nëse personi po vepron në përfitim të ose për llogari të personit tjetër.
140. Lidhur me llogaritë që mbahen bashkërisht, secili mbajtës i përbashkët trajtohet si një Mbajtës Llogarie për qëllime të përcaktimit nëse llogaria është Llogari e Raportueshme. Kështu, llogaria është Llogari e Raportueshme nëse secili prej Mbajtësve të Llogarisë është Person i Raportueshëm ose NFE Pasive me një ose më shumë Persona Kontrollues të cilët janë Persona të Raportueshëm. Në rastin kur më shumë se një Person i Raportueshëm është një mbajtës i përbashkët, secili Person i Raportueshëm trajtohet si Mbajtës Llogarie dhe i atribuohet i gjithë bilanci i llogarisë së mbajtur bashkërisht, duke përfshirë për qëllime të zbatimit të rregullave të totalizimit të parashtruara në nënparagrafët C(1) deri në (3) të seksionit VII.
141. Në rastin e një Kontrate Sigurimi në Vlerë në Para të Gatshme ose një Kontrate Pensioni Vjetor, Mbajtësi i Llogarisë është çdo person i cili ka të drejtë të hyjë në Vlerën në Para të Gatshme ose të ndryshojë përfituesin e kontratës. Nëse asnjë person nuk mund të hyjë në Vlerën në Para të Gatshme ose të ndryshojë përfituesin, Mbajtësi i Llogarisë është çdo person i emëruar si pronar në kontratë dhe çdo person me të drejtë pagese sipas kushteve të kontratës. Pas maturimit të Kontratës së Sigurimit në Vlerë në Para të Gatshme ose Kontratës së Pensionit Vjetor (d.m.th. në rastin kur detyrimi për të paguar shumën sipas kontratës bëhet fiks), çdo person që ka të drejtë të marrë një pagesë sipas kontratës trajtohet si Mbajtës Llogarie.
142. Shembujt vijues ilustrojnë zbatimin e nënparagrafit E(1):
- Shembulli 1 (Llogaria që mbahet nga agjenti): F mban një prokurë të posaçme nga U, një Person i Raportueshëm, i cili autorizon F-në të hapë, mbajë dhe kryejë depozita dhe tërheqje lidhur me Llogarinë e Depozitës për llogari të U-së. Bilanci i llogarisë për vitin kalendarik është 100 000 USD. F është i listuar si mbajtësi i Llogarisë së Depozitës në Institucionin Financiar Raportues, por për shkak se F e mban llogarinë si një agent në përfitim të U-së, F nuk ka të drejtën e fondeve në llogari. Për shkak se Llogaria e Depozitës trajtohet si e mbajtur nga U, i cili është Person i Raportueshëm, llogaria është një Llogari e Raportueshme.
  - Shembulli 2 (Llogaritë që mbahen bashkërisht): U, një Person i Raportueshëm, mban një Llogari Depozite në një Institucion Financiar Raportues. Bilanci i llogarisë për vitin kalendarik është 100 000 USD. Llogaria mbahet bashkërisht me A-në, një individ i cili nuk është Person i Raportueshëm. Për shkak se një prej mbajtësve të përbashkët është Person i Raportueshëm, llogaria është Llogari e Raportueshme.
  - Shembulli 3 (Llogaritë të mbahen bashkërisht): U dhe Q, të dy Persona të Raportueshëm, mbajnë një Llogari Depozite në një Institucion Financiar të Raportueshëm. Bilanci i llogarisë për vitin kalendarik është 100 000 USD. Llogaria është Llogari e Raportueshme dhe si U dhe Q trajtohen si Mbajtës Llogarie të llogarisë.

### *Nënparagrafi E(2) – Procedurat për AML/KYC*

**143.** Termi “Procedura për AML/KYC”, siç përkufizohet në nënparagrafin E(2), janë procedurat e verifikimit të duhur për klientin e Institucionit Financiar Raportues në bazë të kërkesave kundër pastrimit të parave ose të ngjashme me to kundrejt të cilave ky Institucion Financiar Raportues është objekt (p.sh. dispozitat “njih klientin tënd”). Këto procedura përfshijnë identifikimin dhe verifikimin e identitetit të klientit (duke përfshirë pronarët përfitues të klientit), të kuptuarin e natyrës dhe të qëllimit të llogarisë, dhe monitorimin e vazhdueshëm.

### *Nënparagrafët E(3) dhe (4) – Njësia Ekonomike dhe Njësia Ekonomike e Lidhur*

**144.** Nënparagrafi E(3) e përkufizon termin “Njësi Ekonomike si person juridik ose strukturë ligjore. Ky term ka për qëllime të mbulojë çdo person përveç individit (d.m.th. person fizik), përveç çdo strukture ligjore. Me fjalë të tjera, p.sh. korporata, partneriteti, trusti, *fideicomiso*, fondacioni (*fundacion*, *Stiftung*), shoqëria, kooperativa, shoqata ose *asociacion en participacion* (shoqata me pjesëmarrje), përfshihen brenda kuptimit të termit “Njësi Ekonomike”.

**145.** Njësia Ekonomike është një “Njësi Ekonomike e Lidhur” e një Njësie tjetër Ekonomike, siç përcaktohet në nënparagrafin E(4), nëse secila prej Njësive Ekonomike kontrollon Njësinë tjetër, ose të dyja Njësitë janë nën kontroll të përbashkët. Për këtë qëllim, kontrolli përfshin pronësinë direkte ose indirekte të më shumë se 50% të votave dhe vlerave në një Njësi Ekonomike. Fakti nëse një Njësi Ekonomike është një Njësi e Ekonomike e Lidhur ka rëndësi për rregullat për totalizimin e bilancit të llogarisë që parashtrohen në nënparagrafin C të seksionit VII, qëllimin e termit “Person i Raportueshëm” të përshtatur në nënparagrafin D(2)(ii), dhe kriterin e përshtatur në nënparagrafin D(9)(b) që mund të përmbushë një NFE për të qenë një NFE Aktive.

### *Nënparagrafi E(5) – NIPT-i*

**146.** Sipas nënparagrafit E(5), termi “NIPT” nënkupton Numrin e Identifikimit të Tatimpaguesit (ose ekuivalentin funksional në mungesë të një Numri Identifikimi të Tatimpaguesit). Numri i Identifikimit të Tatimpaguesit është një kombinim unik shkronjash dhe shifrash, pavarësisht përshkrimit, që i caktohet individit ose Njesisë Ekonomike nga juridiksioni dhe që përdoret për të identifikuar individin ose Njësinë Ekonomike për qëllime të administrimit të legjislacionit tatimor të këtij juridiksioni.

**147.** NIPT-et janë gjithashtu të dobishme për të identifikuar tatimpaguesit të cilët investojnë në juridiksione të tjera. Specifikimet e NIPT-it (d.m.th. struktura, sintaksa, etj) përcaktohen nga administrata tatimore e secilit juridiksion. Disa juridiksione madje kanë edhe një strukturë të ndryshme të NIPT-it për tatime të ndryshme ose kategori të ndryshme të tatimpaguesve (p.sh. rezidentë dhe jo rezidentë).

**148.** Ndërsa shumë juridiksione e përdorin NIPT-in për arsye tatimi të korporatave ose të personave, disa të tjera nuk përdorin NIPT. Megjithatë, këto juridiksione shpesh përdorin numra të tjerë me integritet të lartë me një nivel ekuivalent identifikimi (një “ekuivalent funksional”). Shembuj të këtij lloji numri përfshijnë, për individët është numri i sigurimeve shoqërore/sigurimeve, numri i identifikimit personal/i shtetasit/kodit të shërbimeve, dhe numri i regjistrimit si rezident, ndërsa për Njësitë Ekonomike është numri/kodi i regjistrimit të biznesit/shoqërisë.

**149.** Juridiksionet Pjesëmarrëse priten që t’u japin Institucioneve Financiare Raportuese informacion lidhur me lëshimin, mbledhjen dhe, për aq sa është e mundur dhe praktike, me strukturën dhe specifikimet e tjera të numrave të identifikimit të tatimpaguesit. OECD do të përpiqet që të lehtësojë shpërndarjen e tij. Ky informacion do të lehtësojë mbledhjen e NIPT-ve të saktë nga Institucionet Financiare Raportuese.



*Nënparagrafi E(6) – Evidencat Shkresore*

**150.** Nënparagrafi E(6) përshkruan atë që konsiderohet si “Evidencë Shkresore” për qëllime të procedurave të verifikimit të duhur që përshkruhen në seksionet II deri në VII. Ato përfshijnë sa më poshtë:

- a) certifikatën e rezidencës të lëshuar nga një organ qeveritar i autorizuar (për shembull, qeveria ose agjenci e saj, ose bashkia) i juridiksionit në të cilin paguesi pretendon se është rezident.
- b) lidhur me individin, çdo identifikim të vlefshëm të lëshuar nga një organ qeveritar i autorizuar (për shembull, qeveria ose agjenci e saj, ose bashkia), që përfshin emrin e individit dhe zakonisht përdoret për qëllime identifikimi.
- c) lidhur me Njësinë Ekonomike, çdo dokument zyrtar të lëshuar nga një organ qeveritar i autorizuar (për shembull, qeveria ose agjenci e saj, ose bashkia) që përfshin emrin e Njesisë Ekonomike si dhe adresën e selisë së saj qendrore në juridiksionin në të cilin pretendon se është rezidente ose juridiksionin në të cilin Njësia Ekonomike ishte themeluar ose organizuar.
- d) çdo pasqyrë financiare të audituar, raport kredie të palëve të treta, aplikim për faliment ose raport të rregullatorit të letrave me vlerë.

**151.** Ndërsa Institucioni Financiar Raportues mund të mbështetet në Evidencat Shkresore, përveçse nëse e di ose ka arsye të dijë se janë të pasakta ose të pabesueshme (shih paragrafët 2-3 të Komentit për seksionin VIII), pritet që ai t’i japë përparësi pjesës së Evidencave Shkresore që janë më të fundit, ose më specifike, krahasuar me pjesën tjetër të Evidencave Shkresore.

**152.** Nënparagrafi E(6)(a) i referohet certifikatës së rezidencës së lëshuar nga organi qeveritar i autorizuar i juridiksionit ku paguesi pretendon se është rezident. Shembuj të kësaj certifikate përfshijnë certifikatën e rezidencës për qëllime tatimore (që tregon, p.sh. se mbajtësi i llogarisë ka depozituar kthimin e tij më të fundit të tatimit mbi të ardhurat si rezident i atij juridiksioni); informacionin e rezidencës të publikuar nga një organ qeveritar i autorizuar i juridiksionit, si lista e publikuar nga administrata tatimore që përmban emrat dhe rezidencat e tatimpaguesve; dhe informacionin e rezidencës në një regjistër të aksesueshëm publikisht që mbahet ose autorizohet nga një organ qeveritar i autorizuar i juridiksionit, si regjistri publik që mbahet nga administrata tatimore.

**153.** Një nga kërkesat që përshkruhet në nënparagrafin E(6)(c) është që dokumentacioni zyrtar të përfshijë adresën e zyrave qendrore të Njesisë Ekonomike në juridiksionin ku ajo pretendon se është rezidente ose në juridiksionin ku Njësia Ekonomike është themeluar ose organizuar. Adresa e zyrave qendrore të Njesisë Ekonomike është përgjithësisht vendi ku ndodhet vendi i saj e menaxhimit efektiv (shih paragrafin 109 më lart). Adresa e Institucionit Financiar në të cilin Njësia Ekonomike mban një llogari, kuti postare ose adresë që përdoret vetëm për qëllime postare nuk është adresa e zyrave qendrore të Njesisë Ekonomike përveçse nëse kjo adresë është e vetmja adresë që përdoret nga Njësia Ekonomike dhe paraqitet si adresa e regjistruar e Njesisë Ekonomike në dokumentet organizative të Njesisë Ekonomike. Gjithashtu, adresa e cila jepet sipas udhëzimeve për të ruajtur postën në atë adresë nuk është adresa e zyrave qendrore të Njesisë Ekonomike.

**154.** Me qëllim mbështetjen në praktikat ekzistuese, lidhur me Llogaritë Paraekzistuese të Njësive Ekonomike, secili juridiksion mund t’i lejojë Institucionet Financiare Raportuese që të përdorin si Evidenca Shkresore çdo klasifikim në regjistrat e Institucionit Financiar Raportues lidhur me Mbajtësin e Llogarisë që është përcaktuar mbi bazën e një sistemi kodimi të standardizuar të industrisë, që është regjistruar nga Institucioni Financiar Raportues në pajtim me praktikat e tij normale të biznesit për qëllime të Procedurave AML/KYC ose qëllime të tjera rregullatore (të ndryshme nga qëllimet tatimore) dhe që është zbatuar nga Institucioni Financiar Raportues përpara datës së përdorur për ta klasifikuar Llogarinë Financiare si Llogari



Paraekzistuese, me kusht që Institucioni Financiar Raportues nuk e di ose nuk ka arsye të dijë se ky klasifikim është i pasaktë ose i pabesueshëm. Termi “sistem kodimi i standardizuar i industrisë” është sistemi i kodimit që përdoret për të klasifikuar njësitë sipas llojit të biznesit për qëllime të ndryshme nga ato tatimore. Shembuj të një sistemi kodimi të standardizuar të industrisë përfshijnë Klasifikimin Ndërkombëtar Standard Industrial (ISIC) nga Kombet e Bashkuara, klasifikimin statistikor të aktiviteteve ekonomike në Komunitetin Evropian (NACE) dhe Sistemin e Klasifikimit të Industrisë në Amerikën e Veriut (NAICS).

### Kërkesat për vlefshmërinë e Evidencave Shkresore

**155.** Evidencat Shkresore që përmbajnë një datë skadimi mund të trajtohen si të vlefshme deri në ditën më të fundit të asaj date skadimi, ose deri në ditën e fundit të vitit të pestë kalendarik pas vitit në të cilin Evidencat Shkresore i janë dhënë Institucionit Financiar Raportues. Megjithatë, Evidencat vijuese Shkresore cilësohen se mbeten në fuqi pa afat:

- Evidencat Shkresore që jepen nga një organ qeveritar i autorizuar (si pasaporta);
- Evidencat Shkresore që në përgjithësi nuk rinovohen ose nuk ndryshohen (si certifikata e themelimit); ose
- Evidencat Shkresore që jepen nga Institucioni Financiar Joraportues ose Personi i Juridiksionit të Raportueshëm që nuk është një Person i Raportueshëm.

Të gjitha Evidencat e tjera Shkresore janë të vlefshme deri në ditën e fundit të vitit të pestë kalendarik pas vitit në të cilin Evidencat Shkresore i jepen Institucionit Financiar Raportues.

**156.** Pavarësisht periudhave të vlefshmërisë, Institucioni Financiar Raportues mund të mos mbështetet në Evidencat Shkresore, sipas paragrafit A të Seksionit VII, nëse e di ose ka arsye të dijë se Evidencat Shkresore janë të pasakta ose të pabesueshme (p.sh. për shkak të ndryshimit në rrethanat të cilat e bëjnë informacionin në dokumentacion të pasaktë). Prandaj, Institucioni Financiar Raportues pritet që të ndërmarrë procedurat për të garantuar se çdo ndryshim në dosjet kryesore të klientit që përbëjnë ndryshim në rrethana të identifikohet nga Institucioni Financiar Raportues (shih paragrafin 26 të Komentit për seksionin I dhe 17 të Komentit për seksionin III). Gjithashtu, Institucioni Financiar Raportues pritet që të njoftojë çdo person që jep dokumentacionin mbi detyrimin e personit për të njoftuar Institucionin Financiar Raportues mbi ndryshimin në rrethana.

**157.** Institucioni Financiar Raportues mund të ruajë një kopje origjinale, të vërtetuar ose fotokopje (duke përfshirë një mikrofshë, skanim elektronik ose mjet të ngjashëm të ruajtjes elektronike) të Evidencave Shkresore ose, të paktën, një shënim të llojit të dokumentacionit të shqyrtuar, datën e shqyrtimit të dokumentacionit dhe numrin e identifikimit të dokumentacionit (nëse ka) (për shembull, numri i pasaportës). Çdo dokumentacion që ruhet elektronikisht duhet të vihet në dispozicion në kopje fizike me kërkesë.

**158.** Institucioni Financiar Raportues mund të pranojë kopje elektronike të Evidencave Shkresore nëse sistemi elektronik garanton që informacioni i marrë është informacioni i dërguar, dhe dokumenton të gjitha rastet e aksesit nga përdoruesi që rezultojnë në dorëzimin, rinovimin ose ndryshimin e Evidencave Shkresore. Gjithashtu, projektimi dhe funksionimi i sistemit elektronik, duke përfshirë procedurat e aksesit, duhet të garantojnë që personi që hyn në sistem dhe furnizon Evidencat Shkresore është personi i emërtuar në këto Evidenca Shkresore.

**159.** Në përgjithësi, Institucioni Financiar Raportues pranë të cilit klienti mund të hapë një llogari duhet të marrë Evidenca Shkresore mbi bazë llogarie. Megjithatë, Institucioni Financiar Raportues mund të mbështetet në Evidencat Shkresore të dhëna nga klienti për një tjetër llogari nëse të dyja llogaritë trajtohen si llogari e vetme për qëllime të përmbushjes së kërkesave të standardeve të njohurisë të parashtruara në paragrafin A të seksionit VII.

## Dokumentacioni i mbledhur nga persona të tjerë

**160.** Siç parashikohet në paragrafin D të seksionit II, Juridiksioni Pjesëmarrës mund t'i lejojë Institucionet Financiare Raportuese që të përdorin ofrues shërbimesh për të përmbushur detyrimet e tyre të verifikimit të duhur dhe raportimit. Kur ndodh kështu, Institucioni Financiar Raportues mund të përdorë dokumentacionin e mbledhur nga ofruesit e shërbimeve (p.sh. ofruesit e të dhënave, konsulentët financiarë, agjentët e sigurimeve), në bazë të kushteve që përshkruhen në legjislacionin e brendshëm. Megjithatë, detyrimet e raportimit dhe verifikimit të duhur mbeten përgjegjësi e Institucionit Financiar Raportues.

**161.** Institucioni Financiar Raportues mund të mbështetet në dokumentacionin e mbledhur nga agjenti (duke përfshirë konsulentin e fondit për fondet e përbashkëta, fondet e mbulimit, ose grupin e kapitalit privat) i Institucionit Financiar Raportues. Agjenti mund ta ruajë dokumentacionin si pjesë e një sistemi informacioni të mbajtur për një Institucion të vetëm Financiar Raportues ose për disa Institucione Financiare Raportuese me kusht që sipas sistemit, çdo Institucion Financiar Raportues për llogari të të cilit agjenti ruan dokumentacionin mund të hyjë me lehtësi në të dhënat që lidhen me natyrën e dokumentacionit, informacionin që ndodhet në dokumentacion (duke përfshirë edhe një kopje të vetë dokumentacionit) dhe vlefshmërinë e tij, dhe duhet ta lejojë këtë Institucion Financiar Raportues që t'i transmetojë të dhënat me lehtësi, qoftë direkt në një sistem elektronik ose duke ia dhënë këtë informacion agjentit, lidhur me çdo fakt për të cilin ai vihet në dijeni se mund të ndikojë në besueshmërinë e dokumentacionit. Institucioni Financiar Raportues duhet të jetë i aftë të përcaktojë, për aq sa është e mundur, mënyrën se si dhe kur i ka transmetuar të dhënat lidhur me çdo fakt për të cilin ai vihet në dijeni se mund të ndikojë besueshmërinë e dokumentacionit dhe duhet të jetë i aftë të përcaktojë se çdo të dhënë që e ka transmetuar është përpunuar dhe janë kryer verifikimet e duhura të përshtatshme lidhur me vlefshmërinë e informacionit. Agjenti duhet të ketë një sistem në fuqi për të garantuar që çdo informacion që merr për faktet që prekin besueshmërinë e dokumentacionit ose statusin që i është dhënë klientit u jepet të gjitha Institucioneve Financiare Raportuese për të cilat agjenti mban dokumentacionin.

**162.** Institucioni Financiar Raportues që blen/merr një llogari nga një paraardhës ose transferues në një shkrirje ose blerje në grup të llogarive për vlerën, përgjithësisht do të lejohet të mbështetet në dokumentacionin e vlefshëm (ose kopje të dokumentacionit të vlefshëm) të mbledhur nga paraardhësi ose transferuesi. Gjithashtu, Institucioni Financiar Raportues që blen një llogari në një shkrirje ose blerje në grup të llogarive për vlerën nga një tjetër Institucion Financiar Raportues që i ka kryer të gjitha verifikimet e duhura sipas seksioneve II deri në VII lidhur me llogaritë e transferuara, përgjithësisht do të lejohet të mbështetet edhe mbi përcaktimin e statusit të një Mbajtësi Llogarie të bërë nga paraardhësi ose transferuesi deri në momentin që blerësi merr dijeni ose ka arsye të ketë dijeni se statusi është i pasaktë ose ka ndodhur një ndryshim në rrethana (shih paragrafin 17 të Komentit për seksionin III).

## Koment për seksionin IX lidhur me Zbatimin Efikas

1. Qëllimi i këtij seksioni është të garantojë se Standardi i Përbashkët i Raportimit zbatohet me efikasitet nga Juridiksionet Pjesëmarrëse, se ai respektohet dhe nuk shmanget. Kjo arrihet duke u kërkuar juridiksioneve që të kenë disa rregulla dhe procedura administrative. Këto rregulla mund të jenë në formën e legjislacionit parësor dhe dytësor (p.sh. rregulloret) dhe shpesh do të plotësohen me udhëzime. Procedurat administrative mund të parashtrohen në manuale ose lloje të tjera komunikimi të cilat u jepen audituesve ose autoriteteve të tjera përkatëse.
2. Sipas seksionit IX, juridiksioni duhet të ketë rregulla dhe procedura administrative për të garantuar zbatimin efikas të, dhe pajtueshmërinë me, procedurat e raportimit dhe verifikimit të duhur të parashtruara në Standardin e Përbashkët të Raportimit. Standardi nuk do të konsiderohet si i zbatuar me efikasitet përveçse nëse miratohet në mirëbesim lidhur me Komentin e tij që kërkon të promovojë zbatimin e qëndrueshëm të tij nëpër juridiksione. Duke qenë se zbatimi i CRS-së kërkon që ai të përkthehet në legjislacionin e brendshëm, mund të ketë dallime në zbatimin e brendshëm. Prandaj, në kontekstin ndërkufitar, i duhet referuar ligjit të juridiksionit zbatues. Për shembull, mund të lindë pyetja nëse një Njësi Ekonomike e caktuar e cila është rezidente në një Juridiksion Pjesëmarrës dhe ka një Llogari Financiare në një tjetër Juridiksion Pjesëmarrës, përmbush përkufizimin e “Institucionit Financiar”. Njësia Ekonomike mund të përmbushë testin e “pjesës thelbësore” për të qenë një Institucion Kujdestarie në një Juridiksion Pjesëmarrës, por teknikat e ndryshme të matjes për të ardhurat bruto mund të nënkuptojnë se Njësia Ekonomike nuk e përmbush këtë test në një Juridiksion tjetër Pjesëmarrës. Në këtë rast, klasifikimi i Njesisë Ekonomike duhet të zgjidhet sipas ligjit të Juridiksionit Pjesëmarrës ku është rezidente Njësia Ekonomike.
3. Nënparagrafët A(1) dhe (2) parashikojnë që juridiksioni duhet të ketë rregullat vijuese:
  - të ndalojë çdo Institucion Financiar, person ose ndërmjetës që të miratojë praktika që kanë për synim shmangien e Standardit të Përbashkët të Raportimit;
  - t’i kërkojë Institucioneve Financiare Raportuese që të mbajnë të dhëna mbi hapat e ndërmarra dhe çdo evidencë ku janë mbështetur për realizimin e procedurave të verifikimit të duhur të parashtruara në CRS; dhe
  - të kenë masat e duhura për të marrë të dhënat e regjistruara më lart.
4. Rregulli i parë që përshkruhet në nënparagrafin A(1) është ai i cili përgjithësisht njihet si rregulli kundër shmangies. Rregulli kundër shmangies mund të marrë formë të ndryshme. Shumë juridiksione kanë miratuar një rregull të përgjithshëm kundër shmangies në legjislacionin e tyre tatimor që gjithashtu mund të plotësohet nga rregulla specifike kundër shmangies. Në juridiksione të tjera, legjislacioni mund të përfshijë vetëm rregulla specifike kundër shmangies. Mënyra se si hartohet rregulli kundër shmangies për CRS-në do të varet nga qasja e përgjithshme e miratuar nga juridiksionet për adresimin e shmangies si edhe për zbatimin e Standardit të Përbashkët të Raportimit. Për shembull, rregulli i përgjithshëm kundër shmangies mund të mbulojë detyrimet e raportimit dhe të verifikimit të duhur. Forma e rregullit në vetvete nuk është e rëndësishme për sa kohë ai është efikas në parandalimin e shmangies së kërkesave të raportimit dhe të procedurave të verifikimit të duhur.
5. Më poshtë janë shembujt e situatave ku pritet që të zbatohet rregulli kundër shmangies:
  - Shembulli 1 (Zhvendosja e mirëmbajtjes së llogarisë): Institucioni Financiar Raportues e këshillon klientin që ta mbajë llogarinë me një Njësi Ekonomike të Lidhur në një Juridiksion Jopjesëmarrës që i mundëson Institucionit Financiar Raportues të shmangë raportimin ndërkohë që i ofron shërbime dhe mbajtjen e marrëdhënieve me klientin sikur llogaria të ishte mbajtur nga vetë Institucioni Financiar Raportues. Në këtë rast, Institucioni Financiar

- Raportues duhet të konsiderohet si mbajtës i llogarisë dhe që ka kërkesat e raportimit dhe të verifikimit të duhur të cilat vijnë si rezultat i kësaj.
- Shembulli 2 (shumat në fundin e vitit fiskal): Institucionet Financiare, individët, Njësitë Ekonomike ose ndërmjetësit manipulojnë shumat në fundin e vitit fiskal, si bilancet e llogarive, për të shmangur raportimin ose që t'u raportohet.
  - Shembulli 3 (Depozitimi i parave pranë Emetuesve të Kualifikuar të Kartave të Kreditit): Individët ose Njësitë Ekonomike i depozitojnë bilancet nga Llogari të tjera të Raportueshme pranë Emetuesve të Kualifikuar të Kartave të Kreditit për një periudhë të shkurtër në fund të vitit për të shmangur raportimin.
  - Shembulli 4 (Regjistrat elektronikë dhe sistemet e kompjuterizuara): Institucioni Financiar Raportues me qëllim nuk krijon asnjë regjistrë elektronik (në mënyrë të atillë që kërkimi elektronik i të dhënave nuk do të nxirrte asnjë rezultat) ose mban sisteme të kompjuterizuara që janë të shkëputura në mënyrë artificiale (për të shmangur rregullat e totalizimit të llogarisë).
6. Për të rritur besueshmërinë e vetëvërtetimeve, pritet që juridiksionet të përfshijnë një dispozitë specifike në legjislacionin e tyre të brendshëm e cila vendos sanksione për nënshkrimin (ose konfirmimin pozitiv) e një vetëvërtetimi të rremë.
  7. Nënparagafi A(2) i kërkon juridiksionit që të ketë rregulla të cilat u kërkojnë Institucioneve Financiare Raportuese që të mbajnë të dhëna për hapat e ndërmarra dhe për çdo evidencë mbi të cilën mbështeten për realizimin e procedurave të verifikimit të duhur të parashtuara në CRS. Këto të dhëna duhet të jenë të disponueshme për një kohë mjaftueshëm të gjatë dhe në çdo rast për një periudhë jo më pak se 5 vite pas përfundimit të periudhës brenda së cilës Institucioni Financiar Raportues duhet të raportojë informacionin që kërkohet të raportohet sipas Standardit të Përbashkët të Raportimit.
  8. Evidencat Shkresore përkufizohen në nënparagrafin E(6) të seksionit VIII dhe kanë rëndësi për zbatimin, p.sh. e testit të adresës së rezidencës të parashtuar në nënparagrafin B(1) të seksionit III dhe procedurën e korrigjimit që ndodhet në nënparagrafin B(6) të seksionit III. Siç përmendet në paragrafin 157 të Komentit për seksionin VIII, Evidencat Shkresore që mbahen nga Institucioni Financiar Raportues nuk kanë pse të jenë origjinale dhe mund të jenë një kopje ose fotokopje e vërtetuar ose, të paktën, një shënim i llojit të dokumentacionit të shqyrtuar, data kur është shqyrtuar dokumentacioni dhe numri i identifikimit të dokumentacionit (nëse ka).
  9. Në disa raste, për shembull, siç parashtrohet në paragrafin 13 të Komentit për seksionin I lidhur me përpjekjet e arsyeshme për të marrë një NIPT për Llogaritë Paraekzistuese, manuali procedural që përshkruan “përpjekjet e arsyeshme” të duhura mund të jetë një e dhënë që përshkruan hapat e ndërmarra me kusht që të ketë edhe evidenca për mënyrën se si ndiqen ato politika dhe procedura. Për shembull, në rastin e një kombinimi të postës, nuk do t'i kërkohej Institucionit Financiar Raportues që të mbajë kopje aktuale të letrave të dërguara, por të japë me kërkesë dokumentin që përmban informacionin i cili është i njëjtë në çdo version dhe dosjen e të dhënave ku ruhet informacioni unik.
  10. Nënparagafi A(2) gjithashtu i kërkon juridiksionit që të ketë masa të përshtatshme për të marrë të dhënat nga Institucionet Financiare Raportuese. Shumica e juridiksioneve kanë rregulla për ta detyruar tatimpaguesin ose palën e tretë që të japë dokumentet të cilat janë të nevojshme për të zbatuar legjislacionin e tyre të brendshëm tatimor. Këto rregulla përgjithësisht zbatohen për të marrë informacion për t'iu përgjigjur një kërkesë për informacion nga partneri në shkëmbim sipas instrumentit për shkëmbimin e informacionit. Disa juridiksione, veçanërisht ato pa tatim mbi të ardhurat, kanë rregulla të cilat merren në mënyrë specifike me procedurat për marrjen e informacionit sipas një instrumenti për shkëmbimin e informacionit.

11. Nënparagrafët A(3) dhe (4) i kërkojnë juridiksioneve të kenë procedurat vijuese administrative:
  - të verifikojnë përputhshmërinë e Institucioneve Financiare Raportuese me procedurat e raportimit dhe verifikimit të duhur që parashtrihen në CRS;
  - të monitorojnë së bashku me Institucionin Financiar Raportues rastet kur raportohen llogari të padokumentuara; dhe
  - të garantojnë që Njësitë Ekonomike dhe llogaritë e përcaktuara në legjislacionin e brendshëm si Institucione Jofinanciare Raportuese dhe Llogari të Përfshirë vijojnë të kenë rrezik të ulët për t'u përdorur për shmangie tatimore.
12. Juridiksionet duhet të kenë procedura për të verifikuar në mënyrë periodike përputhshmërinë e Institucioneve Financiare Raportuese. Kjo mund të realizohet si pjesë e një auditimi të rregullt tatimor ose si një shqyrtim apo investigim i veçantë.
13. Juridiksionet gjithashtu duhet të kenë procedura për të monitoruar së bashku me Institucionin Financiar Raportues rastet kur raportohen llogari të padokumentuara. Përgjithësisht "llogaria e padokumentuar" lind kur Institucioni Financiar Raportues e ka të pamundur të marrë informacion nga Mbajtësi i Llogarisë lidhur me një Llogari Paraekzistuese (shih paragrafët 28-29, 45 dhe 48 të Komentit për seksionin III). Kjo mund të vijë si rezultat i procedurave të papërshtatshme që po zbatohen nga Institucioni Financiar Raportues për të marrë informacionin e nevojshëm ose Mbajtësi i Llogarisë nuk është në përputhshmëri. Secili rast përbën rast shqetësimi.
14. Pritet që juridiksioni të monitorojë së bashku me çdo Institucion Financiar Raportues që raporton një llogari të padokumentuar. Në rastin e një numri të vogël llogarish të padokumentuara, thjesht një investigim i Institucionit Financiar Raportues mund të jetë i mjaftueshëm. Megjithatë, nëse ky Institucion Financiar Raportues raporton një numër më të madh se mesatarja të llogarive të padokumentuara në një vit çfarëdolloj ose numri i llogarive të padokumentuara që raportohen vijon të rritet, mund të nevojitet një auditim i plotë i procedurave të verifikimit të duhur të Institucionit Financiar Raportues. Në këtë rast, kur është e mundur dhe logjike, juridiksioni mund ta gjykojë të përshtatshme që të këshillojë përfshirjen e autoriteteve për AML në pajtim me legjislacionin e brendshëm.
15. Siç përshkruhet më lart, juridiksioni duhet të ketë procedura për të garantuar se Institucionet Financiare Joraportuese dhe Llogaritë e Përfshirë në legjislacionin e brendshëm vijojnë të kenë një rrezik të ulët për t'u përdorur për shmangie tatimore. Kjo mund të përfshijë veçanërisht Njësi Ekonomike ose lloje të caktuara Njësish Ekonomike. Këto procedura duhet të përfshijnë shqyrtimin periodik të këtij statusi. Ky shqyrtim mund të realizohet si pjesë e një auditimi të rregullt tatimor ose si një investigim apo shqyrtim i veçantë.
16. Shembuj të situatave kur juridiksioni duhet të rivlerësojë përshtatshmërinë e një Njësie Ekonomike ose llogarie të përcaktuar si të tillë përfshin situatën kur Njësia Ekonomike ndryshon biznesin e saj ose Llogaria Financiare ndryshon natyrën e saj.
17. Pasi juridiksioni përcakton se një lloj Njësie Ekonomike ose një llogari nuk i përmbush më kërkesat e shfaqjes së një rreziku të ulët për shmangie tatimore, ai duhet të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme sa më shpejt të jetë e mundur për ta hequr këtë Njési Ekonomike ose llogari nga lista e Institucioneve Financiare Joraportuese ose e Llogarive të Përfshirë në legjislacionin e tij të brendshëm. Ky juridiksion duhet t'i këshillojë partnerët e tij të shkëmbimit për ndryshimin në status të Njësisë Ekonomike ose të llogarisë. Shih gjithashtu paragrafin 2 të seksionit 7 të CAA-së Model ku përcaktimi i statusit të Njësive Ekonomike ose llogarive si Institucione Financiare Joraportuese ose si Llogari të Përfshirë në një mënyrë të atillë që do të cenonte qëllimet e CRS-së do të përbënte një papërpunueshmëri të konsiderueshme e cila mund të rezultojë në pezullimin e CAA-së Model nga partneri i shkëmbimit.



18. Nënparagrafi A(5) kërkon që një juridiksion duhet të ketë dispozita efikase të zbatimit për të trajtuar papërputhshmërinë. Në disa raste, rregulli kundër shmangies që përshkruhet në nënparagrafin A(1) mund të jetë mjaftueshëm i gjerë për të mbuluar zbatimin. Në raste të tjera, mund të ketë rregulla të veçanta ose më tepër specifike që adresojnë çështje të caktuara të zbatimit në terma më të ngushta. Për shembull, një juridiksion mund të ketë rregulla të cilat parashikojnë vendosjen e gjobave ose penaliteteve të tjera në rastin kur personi nuk jep informacionin që kërkohet nga autoriteti tatimor. Gjithashtu, duke qenë se marrja e një vetëvërtetimi për Llogaritë e Reja është një aspekt kritik i garantimit se CRS është efikas, pritet që juridiksionet të kenë masa të forta për të garantuar se për Llogaritë e Reja merren gjithmonë vetëvërtetime të vlefshme. Një mënyrë efikase për ta arritur këtë rezultat do të ishte hartimi i një legjislacionin që do ta bënte hapjen e një Llogarie të Re të kushtëzuar me marrjen e një vetëvërtetimi të vlefshëm gjatë procedurave për hapjen e llogarisë. Juridiksionet e tjera mund të zgjedhin metoda të ndryshme. Për shembull, të vendosin penalitete të konsiderueshme mbi Mbajtësit e Llogarive që nuk japin një vetëvërtetim, ose mbi Institucionet Financiare Raportuese që nuk marrin masa të përshtatshme për të marrë një vetëvërtetim në momentin e hapjes së llogarisë.

## Shtojcat

## *Shtojca 1*

### **Marrëveshja Model Shumëpalëshe e Autoritetit Kompetent**

1. Ky dokument është versioni shumëpalësh i Marrëveshjes Model të Autoritetit Kompetent. Baza ligjore është neni 6 i Konventës Shumëpalëshe për Ndihmën e Ndërsjellë Administrative në Çështjet Tatimore i cili parashikon në mënyrë specifike se dy ose më shumë palë mund të bien dakord bashkërisht për të shkëmbyer informacion në mënyrë automatike. Shkëmbimi aktual i informacionit ne vetvete do të ishte mbi baza dypalëshe.
2. Ndryshimet kryesore për të përshtatur CAA-në Model dypalëshe me modelin shumëpalësh janë shtesat në preambulë, përkufizimet e përgjithshme për Juridiksionin dhe termin “Standard i Përbashkët Raportimi”, data e hyrjes në fuqi në paragrafin 1 të seksionit 7 duke përfshirë procedurën që juridiksionet të bashkohen pasi të ketë hyrë në fuqi Marrëveshja, dhe dërgimi i njoftimeve pranë Sekretariatit të Organit Koordinues të Konventës. Gjithashtu modeli shumëpalësh parashikon si juridiksionet që marrin pjesë në baza reciproke dhe ato në baza joreciproke (shih paragrafin 1 të seksionit 2). Juridiksionet që dërgojnë informacion por që nuk marrin informacion do të renditen në shtojcën A.

#### **MARRËVESHJA MODEL PËR SHKËMBIMIN AUTOMATIK TË INFORMACIONIT TË LLOGARISË FINANCIARE PËR TË PËRMIRËSUAR PËRPUTHSHMËRINË TATIMORE NDËRKOMBËTARE**

Meqë, Juridiksionet janë Palë të, ose territore të mbuluara nga, Konventa Shumëpalëshe për Ndihmën e Ndërsjellë Administrative në Çështjet Tatimore (“Konventa”) dhe kanë një marrëdhënie afatgjatë dhe të ngushtë lidhur me ndihmën e ndërsjellë në çështjet tatimore dhe dëshirojnë të përmirësojnë përputhshmërinë tatimore ndërkombëtare duke e ndërtuar më tej këtë marrëdhënie;

Meqë, ligjet e juridiksioneve të tyre përkatëse [pritet t’u kërkojnë]/[u kërkojnë]/[u kërkojnë ose pritët t’u kërkojnë] institucioneve financiare që të raportojnë informacion lidhur me llogari të caktuara dhe të ndjekin procedurat e verifikimit të duhur, në përputhje me qëllimin e shkëmbimit të parashikuar nga Seksioni 2 i kësaj Marrëveshjeje dhe me procedurat e raportimit dhe verifikimit të duhur që përmban Standardi i Përbashkët i Raportimit;

Meqë, pritët që ligjet e Juridiksioneve të ndryshohen herë pas here për të reflektuar përditësimet në Standardin e Përbashkët të Raportimit dhe pasi të jenë miratuar këto ndryshime nga Juridiksioni, përkufizimi i “Standardit të Përbashkët të Raportimit” do të gjykohet se i referohet versionit të përditësuar për atë Juridiksion;

Meqë, kapitulli III i Konventës autorizon shkëmbimin e informacionit për qëllime tatimore, duke përfshirë shkëmbimin e informacionit mbi baza automatike, dhe i lejon autoritetet kompetente të Juridiksioneve (“Autoritetet Kompetente”) që të bien dakord për qëllimin dhe modalitetet e këtyre shkëmbimeve automatike;

Meqë neni 6 i Konventës parashikon se dy ose më shumë Palë mund të bien dakord në mënyrë të ndërsjellë për të shkëmbyer informacion në mënyrë automatike, shkëmbimi aktual i informacionit do të jetë mbi baza dypalëshe;

Meqë Autoritetet Kompetente të Juridiksioneve ose territoreve të renditura në shtojcën A të kësaj Marrëveshjeje do të dërgojnë informacion sipas seksionit 2, Autoritetet Kompetente nuk do ta marrin këtë informacion;

Meqë, Juridiksionet disponojnë (i) masat e duhura mbrojtëse për të garantuar se informacioni i marrë në përputhje me këtë Marrëveshje do të mbetet konfidencial dhe do të përdoret vetëm për qëllimet e parashtruara në Konventë, dhe (ii) infrastrukturën për një marrëdhënie shkëmbimi efikase (duke përfshirë proceset për garantimin e shkëmbimeve në kohë, të sakta dhe konfidenciale të informacionit, komunikimet efikase dhe të besueshme, dhe aftësitë për të zgjidhur menjëherë pikëpyetjet dhe shqetësimet mbi shkëmbimet ose kërkesat për shkëmbime dhe për të administruar dispozitat e Seksionit 4 të kësaj Marrëveshjeje);

Meqë, Autoritetet Kompetente të Juridiksioneve dëshirojnë të arrijnë një marrëveshje për të përmirësuar përputhshmërinë tatimore ndërkombëtare bazuar në shkëmbimin automatik sipas Konventës, dhe që është objekt i konfidencialitetit dhe masave të tjera mbrojtëse të parashikuara në dokument, duke përfshirë dispozitat që kufizojnë përdorimin e informacionit të shkëmbyer sipas Konventës;

Si rrjedhojë, nisur nga sa më sipër, Autoritetet Kompetente kanë rënë dakord si më poshtë:

## SEKSIONI 1

### *Përkufizime*

1. Për qëllime të kësaj marrëveshjeje (“Marrëveshja”), termat e mëposhtëm kanë kuptimet vijuese:

- a) termi “**Juridiksion**” është juridiksioni që është Palë e, ose territori që mbulohet nga, Konventa dhe Autoriteti Kompetent i cili është nënshkrues i kësaj Marrëveshjeje.
- b) termi “**Autoritet Kompetent**” për çdo Juridiksion përkatës, janë personat dhe autoritetet e renditura në shtojcën B të Konventës.
- c) termi “**Institucion Financiar i Juridiksionit**” për çdo juridiksion përkatës, është (i) çdo Institucion Financiar që është rezident në Juridiksion, por që përjashton çdo degë të atij Institucioni Financiar që ndodhet jashtë Juridiksionit, dhe (ii) çdo degë e një Institucioni Financiar që nuk është rezident në Juridiksion, nëse ajo degë ndodhet në Juridiksion.
- d) termi “**Institucion Financiar Raportues**” është çdo Institucion Financiar i cili nuk është një Institucion Financiar Joraportues.
- e) termi “**Llogari e Raportueshme**” është një Llogari Financiare që mbahet nga Institucioni Financiar Raportues dhe që, sipas procedurave të verifikimit të duhur në pajtim me Standardin e Përbashkët të Raportimit, është identifikuar si një llogari që mbahet nga një ose më shumë persona që janë Persona të Raportueshëm lidhur me një Juridiksion tjetër ose nga një NFE Pasive me një ose më shumë Persona Kontrollues që janë Persona të Raportueshëm lidhur me një Juridiksion tjetër.
- f) termi “**Standard i Përbashkët Raportimi**” është standardi për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarisë financiare i zhvilluar nga OECD, me vendet e G20-ës, paraqitur pranë G20-ës në vitin 2014 dhe publikuar në faqen e internetit të OECD-së.
- g) termi “**Sekretariat i Organit Koordinues**” është Sekretariati i OECD-së që, sipas paragrafit 3 të nenit 24 të Konventës, i ofron ndihmë organit koordinues që përbëhet nga përfaqësues të autoriteteve kompetente të Palëve në Konventë.

2. Termat me germa kapitale, të papërkufizuar ndryshe në këtë Marrëveshje, kanë kuptimin që i është dhënë në atë kohë sipas ligjit të Juridiksionit zbatues të Marrëveshjes, kuptim i cili është në

përputhje me kuptimin e përcaktuar në Standardin e Përbashkët të Raportimit. Çdo term i papërkufizuar ndryshe në këtë Marrëveshje apo në Standardin e Përbashkët të Raportimit, përveç nëse konteksti kërkon ndryshe ose Autoritetet Kompetente bien dakord për një kuptim të përbashkët (siç lejohet nga legjislacioni i brendshëm), kanë kuptimin që u është dhënë atyre në atë kohë sipas ligjit të Juridiksionit zbatues të Marrëveshjes, çdo kuptim sipas ligjeve tatimore në fuqi të atij Juridiksioni që kanë përparësi mbi kuptimin që i është dhënë termit sipas ligjeve të tjera të atij Juridiksioni.

## SEKSIONI 2

### *Shkëmbimi i informacionit në lidhje me Llogaritë e Raportueshme*

1. Në bazë të dispozitave të nenit 6 dhe 22 të Konventës dhe rregullave të zbatueshme të raportimit dhe verifikimit të duhur në përputhje me Standardin e Përbashkët të Raportimit, secili Autoritet Kompetent do të shkëmbejë çdo vit me Autoritetet e tjera Kompetente mbi baza automatike informacionin e marrë sipas këtyre rregullave dhe të specifikuar në paragrafin 2. Pavarësisht fjalisë së mëparshme, Autoritetet Kompetente të Juridiksioneve të renditura nga shtojcën A do të shkëmbejnë, por nuk do të marrin, informacionin e specifikuar në paragrafin 2. Juridiksionet që nuk janë të renditura në shtojcën A do ta marrin gjithmonë informacionin e specifikuar në paragrafin 2, por nuk do ta shkëmbejnë këtë informacion me Juridiksionet e renditura në shtojcën A.

2. Informacioni që do të shkëmbehet është në lidhje me çdo Llogari të Raportueshme të Juridiksionit tjetër:

- a) emrin, adresën, NIPT-in, datën dhe vendin e lindjes (në rastin e një individi) të secilit Person të Raportueshëm që është Mbajtës Llogarie i llogarisë dhe, në rastin e çdo Njësie Ekonomike që është Mbajtëse Llogarie dhe që, pas zbatimit të procedurave të verifikimit të duhur në përputhje me Standardin e Përbashkët të Raportimit, është identifikuar se ka një ose më shumë Persona Kontrollues që janë Person i Raportueshëm, emrin, adresën dhe NIPT-in e Njësisë Ekonomike dhe emrin, adresën, NIPT-in, datën dhe vendin e lindjes së secilit Person të Raportueshëm;
- b) numrin e llogarisë (ose ekuivalentin funksional në mungesë të një numri të llogarisë);
- c) emrin dhe numrin identifikues (nëse ka) të Institucionit Financiar Raportues;
- d) gjendjen e llogarisë ose vlerën (duke përfshirë, në rastin e Kontratës së Sigurimit në Vlerë në Para të Gatshme ose Kontratë Pensioni Vjetor, Vlerën në Para të Gatshme ose vlerën e mbylljes vullnetare) duke filluar në fund të vitit përkatës kalendarik ose në një periudhë tjetër të përshtatshme raportimi ose, nëse llogaria është mbyllur gjatë atij viti apo asaj periudhe, në mbylljen e llogarisë;
- e) në rastin e një Llogarie Kujdestarie:
  - (1) shumën totale bruto të interesit, shumën totale bruto të dividendëve, dhe shumën totale bruto të të ardhurave të tjera të krijuara në lidhje me aktivet e mbajtura në llogari, në çdo rast paguar apo kredituar në llogari (ose në lidhje me llogarinë) gjatë vitit kalendarik ose një periudhe tjetër të përshtatshme raportimi; dhe
  - (2) të ardhurat totale bruto nga shitja apo shlyerja e aktiveve financiare të paguara apo të kredituara në llogari gjatë vitit kalendarik ose një periudhe tjetër të përshtatshme të raportimit në lidhje me të cilën Institucioni Financiar Raportues ka vepruar, si: kujdestar, ndërmjetës, kandidat ose ndryshe si një agjent për Mbajtësin e Llogarisë;
- f) në rastin e ndonjë Llogarie Depozite, shumën totale bruto të interesit të paguar apo të kredituar në llogari gjatë vitit kalendarik ose një periudhe tjetër të përshtatshme raportimi; dhe



- g) në rastin e ndonjë llogarie të papërs shkruar në nënparagrafin 2 (e) ose (f), shumën totale bruto të paguar apo të kredituar për Mbajtësin e Llogarisë në lidhje me llogarinë gjatë vitit kalendarik ose një periudhe tjetër të përshtatshme raportimi në lidhje me të cilën Institucioni Financiar Raportues është institucioni që ka detyrim ose debitori, duke përfshirë edhe shumën totale të pagesave të shlyerjeve të bëra për Mbajtësin e Llogarisë gjatë vitit kalendarik ose një periudhe tjetër të përshtatshme raportimi.

## SEKSIONI 3

### *Koha dhe mënyra e shkëmbimit të informacionit*

1. Për qëllime të shkëmbimit të informacionit në Seksionin 2, shuma dhe karakterizimi i pagesave të bëra në lidhje me një Llogari të Raportueshme mund të përcaktohen në përputhje me parimet e ligjeve tatimore të Juridiksionit që kryen shkëmbimin e informacionit.
2. Për qëllime të shkëmbimit të informacionit në seksionin 2, informacioni i shkëmbyer do të identifikojë monedhën në të cilën është shprehur çdo shumë përkatëse.
3. Në lidhje me paragrafin 2 të seksionit 2, informacioni do të shkëmbehet lidhur me [xxxx] dhe të gjitha vitet e specifikuar dhe do të shkëmbehet brenda nëntë muajve pas përfundimit të vitit kalendarik me të cilin lidhet informacioni. Pavarësisht nga fjalia e mësipërme, informacioni kërkohet të shkëmbehet vetëm lidhur me një vit kalendarik nëse të dyja Juridiksionet e tyre përkatëse kanë në fuqi legjislacionin që kërkon raportim në lidhje me vitin kalendarik që është në përputhje me qëllimin e shkëmbimit të parashikuar në seksionin 2 dhe procedurat e raportimit dhe të verifikimit të përfshira në Standardin e Përbashkët të Raportimit.
4. Pavarësisht paragrafit 3, informacioni që do të shkëmbehet lidhur me [xxxx] është informacioni i përshkruar në paragrafin 2 të seksionit 2, me përjashtim të të ardhurave bruto të përshkruara në nënparagrafin 2 (e) (2) të seksionit 2.
5. Autoritetet Kompetente do të shkëmbejnë automatikisht informacionin e përshkruar në seksionin 2 në skemën standarde të raportimit të përbashkët në një gjuhë të zgjeruar të caktuar (XML).
6. Autoritetet Kompetente do të bien dakord mbi një ose më shumë metoda për transmetimin e të dhënave, duke përfshirë standardet e kodimit.

## SEKSIONI 4

### *Bashkëpunimi mbi pajtueshmërinë dhe zbatimin*

Një Autoritet Kompetent do të njoftojë Autoritetin tjetër Kompetent kur Autoriteti i përmendur së pari ka arsye të besojë se një gabim mund të ketë çuar në informacione të pasakta ose të paplota, ose raportimi nuk është në pajtim, nga një Institucion Financiar Raportues, me kërkesat e zbatueshme të raportimit dhe procedurat e verifikimit në përputhje me Standardin e Përbashkët të Raportimit. Autoriteti Kompetent do të njoftohet të ndërmarrë të gjitha masat e duhura, të disponueshme sipas legjislacionit të tij të brendshëm për të trajtuar gabimet ose papajtueshmërinë e përshkruar në njoftim.

## SEKSIONI 5

### *Konfidencialiteti dhe ruajtja e të dhënave*

1. I gjithë informacioni i shkëmbyer është objekt i rregullave të konfidencialitetit dhe masave të tjera mbrojtëse të parashikuara në Konventë, duke përfshirë dispozitat që kufizojnë përdorimin e informacionit të shkëmbyer dhe, në masën e nevojshme për të siguruar nivelin e nevojshëm të

mbrojtjes së të dhënave personale, në përputhje me masat mbrojtëse të cilat mund të specifikohen nga Autoriteti Kompetent dhënës, siç kërkohet sipas legjislacionit të tij të brendshëm.

2. Autoriteti Kompetent do të njoftojë menjëherë Sekretariatit e Organit Koordinues në lidhje me çdo shkelje të konfidencialitetit apo dështimin e masave mbrojtëse dhe për çdo sanksion dhe veprime përmirësuese pasuese.

## SEKSIONI 6

### *Konsultimet dhe ndryshimet*

1. Në rast të ndonjë vështirësie që lind në zbatimin ose interpretimin e kësaj Marrëveshjeje, Autoriteti Kompetent mund të kërkojë konsultime me një ose më shumë prej Autoriteteve Kompetente për zhvillimin e masave të duhura për sigurimin e përmbushjes së kësaj Marrëveshjeje. Autoriteti Kompetent që ka kërkuar konsultimet duhet të garantojë se Sekretariati i Organit Koordinues vihet në dijeni për çdo masë të duhur që është zhvilluar dhe Sekretariati i Organit Koordinues do të njoftojë të gjitha Autoritetet Kompetente, edhe ato që nuk kanë marrë pjesë në konsultime, për çdo masë të zhvilluar.

2. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet me konsensus me marrëveshje me shkrim të të gjitha Autoriteteve Kompetente. Me përjashtim të rastit kur bihet dakord ndryshe, një ndryshim i tillë hyn në fuqi në ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe prej një muaji pas datës së nënshkrimit të fundit të marrëveshjes së tillë me shkrim.

## SEKSIONI 7

### *Afati i marrëveshjes*

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën në të cilën dy ose më shumë Autoritete Kompetente kanë njoftuar, dhe ky njoftim është marrë nga, Sekretariati i Organit Koordinues se Juridiksioni i tyre ka ligjet e nevojshme për të vënë në zbatim Marrëveshjen. Pas datës së hyrjes në fuqi Autoriteti Kompetent mund të bëjë një kërkesë për të nënshkruar Marrëveshjen. Pavarësisht fjalisë paraardhëse, Autoriteti Kompetent që dëshiron ta nënshkruajë Marrëveshjen përpara se ajo të hyjë në fuqi, por pasi të jetë nënshkruar nga një grup Autoritetesh Kompetente të cilët janë nënshkruesit e parë të Marrëveshjes, Autoriteti Kompetent i përmendur i pari duhet të paraqesë një kërkesë për nënshkrimin e Marrëveshjes.

2. Vendimi për të ftuar Autoritetin Kompetent, dhe nëse Autoriteti Kompetent do të renditet në shtojcën A, do të merret me konsensusin e Autoriteteve Kompetente që kanë nënshkruar Marrëveshjen. Pas nënshkrimit Autoriteti Kompetent duhet të njoftojë Sekretariatit e Organit Koordinues se Juridiksioni i tij ka ligjet e nevojshme për të vënë në zbatim Marrëveshjen. Marrëveshja do të hyjë në fuqi lidhur me Autoritetin Kompetent njoftues në datën kur njoftimi i tij të jetë marrë nga Sekretariati i Organit Koordinues.

3. Një Autoritet Kompetent mund ta pezullojë shkëmbimin e informacionit sipas kësaj Marrëveshjeje duke njoftuar me shkrim Autoritetin tjetër Kompetent se ka konstatuar se ka ose ka pasur papajtueshmëri të konsiderueshme nga Autoriteti tjetër Kompetent me këtë Marrëveshje. Ky pezullim do të hyjë menjëherë në fuqi. Për qëllime të këtij paragrafi, papajtueshmëria e konsiderueshme përfshin, po nuk kufizohet me, papajtueshmërinë me dispozitat për konfidencialitetin dhe ruajtjen e të dhënave të kësaj Marrëveshjeje dhe të Konventës, pamundësinë e Autoritetit Kompetent për të dhënë informacion në kohë dhe të mjaftueshëm siç kërkohet në bazë të kësaj Marrëveshjeje ose për të përcaktuar statusin e Njësive Ekonomike ose të llogarive si Institucione Financiare Joraportuese dhe Llogari të Përfjashtuara në mënyrë të atillë që cenon qëllimet e Standardit të Përbashkët të Raportimit.

4. Autoriteti Kompetent mund ta zgjidhë pjesëmarrjen në këtë Marrëveshje duke i dhënë njoftim me shkrim për zgjidhjen Sekretariatit të Organit Koordinues. Kjo zgjidhje do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe prej 12 muajsh pas datës së njoftimit të zgjidhjes. Në rast të zgjidhjes, i gjithë informacioni i marrë më parë sipas kësaj Marrëveshjeje do të mbetet konfidencial dhe do të jetë objekt i kushteve të Konventës.

## SEKSIONI 8

### *Njoftimet e marra nga Sekretariati i Organit Koordinues*

Përveçse nëse parashikohet ndryshe në këtë Marrëveshje, Sekretariati i Organit Koordinues do të njoftojë të gjitha Autoritetet Kompetente për çdo njoftim që ka marrë sipas kësaj Marrëveshjeje.

Nënshkruar në [...] më [...].

Autoriteti Kompetent për  
[Juridiksionin]:

Nënshkruar në [...] më [...]

Autoriteti Kompetent për  
[Juridiksionin]:

## SHTOJCA A: LISTA E JURIDIKSIONEVE

[Juridiksioni]

[Juridiksioni]

## *Shtojca 2*

### **Marrëveshja Model Joreciproke e Autoritetit Kompetent**

1. Mund të ketë situata kur shkëmbimi automatik i informacionit të llogarisë financiare nuk duhet të jetë reciprok (p.sh. për shkak se njëri prej juridiksioneve nuk ka tatim mbi të ardhurat). Në këto raste, informacioni do të dërgohet vetëm nga [Juridiksioni A] te [Juridiksioni B], por jo nga [Juridiksioni B] te [Juridiksioni A].
2. Ndërkohë që marrëveshja joreciproke mund të bazohet gjerësisht mbi Marrëveshjen Model të Autoritetit Kompetent, disa ndryshime janë të nevojshme për të pasqyruar natyrën e saj joreciproke. Për shembull, përkufizimi i termit “Institucion Financiar Raportues” do të duhet të modifikohet me qëllim që vetëm Institucionet Financiare të [Juridiksionit A] të mund të jenë Institucione Financiare Raportuese.
3. Lista e plotë e dispozitave që do të duhet të modifikohet ose të hiqet është si më poshtë vijon:
  - dispozitat që do të duhet të modifikohen: klauzola e dytë, e katërt dhe e pestë e Preambulës; nënparagrafët 1(f), (g) dhe (h) të seksionit 1; paragrafët 1 dhe 2 (pa nënparagrafët e tyre) të seksionit 2; paragrafi 5 i seksionit 3; seksionet 4 dhe 5; dhe paragrafi 1 i seksionit 7; dhe
  - dispozitat që do të duhet të hiqen: nënparagrafët 1(e), (h), (j) dhe (m) të seksionit 1 dhe fjalja e dytë e paragrafit 3 të seksionit 3.
4. Këto ndryshime janë inkorporuar në Marrëveshjen Model Joreciproke vijuese të Autoritetit Kompetent:

#### **MARRËVESHJA MODEL NDËRMJET AUTORITETEVE KOMPETENTE TË [JURIDIKSIONIT A] DHE [JURIDIKSIONIT B] PËR SHKËMBIMIN AUTOMATIK TË INFORMACIONIT TË LLOGARISË FINANCIARE PËR TË PËRMIRËSUAR PËRPUTHSHMËRINË TATIMORE NDËRKOMBËTARE**

Meqë, qeveria e [Juridiksionit A] dhe qeveria e [Juridiksionit B] kanë një marrëdhënie afatgjatë dhe të ngushtë lidhur me ndihmën e ndërsjellë në çështjet tatimore dhe dëshirojnë të përmirësojnë përputhshmërinë tatimore ndërkombëtare duke e ndërtuar më tej këtë marrëdhënie;

Meqë, ligjet e [Juridiksionit A] [pritet t’u kërkojnë]/[u kërkojnë] institucioneve financiare që të raportojnë informacion lidhur me llogari të caktuara dhe të ndjekin procedurat e verifikimit të duhur, në përputhje me qëllimin e shkëmbimit të parashikuar nga Seksioni 2 i kësaj Marrëveshjeje dhe me procedurat e raportimit dhe verifikimit të duhur që përmban Standardi i Përbashkët i Raportimit;

Meqë, [Neni [...]] i Konventës për Tatimin mbi të Ardhurat ndërmjet [Juridiksionit A] dhe [Juridiksionit B]/[Neni 6 i Konventës për Ndihmën e Ndërsjellë Administrative në Çështjet Tatimore] (“Konventa”)/[i ndonjë instrumenti tjetër ligjor të zbatueshëm (“Instrumenti”)], autorizon shkëmbimin e informacionit për qëllime tatimore, duke përfshirë shkëmbimin e informacionit mbi baza automatike, dhe i lejon autoritetet kompetente të [Juridiksionit A] dhe [Juridiksionit B] ( “Autoritetet Kompetente”) për të rënë dakord për qëllimin dhe modalitetet e këtyre shkëmbimeve automatike;

Meqë, [Juridiksioni B] disponon (i) masat e duhura mbrojtëse për të garantuar se informacioni i marrë në përputhje me këtë Marrëveshje do të mbetet konfidencial dhe do të përdoret vetëm për qëllimet e parashtruara në [Konventë]/[Instrument], dhe (ii) infrastrukturën për një marrëdhënie shkëmbimi efikase (duke përfshirë proceset për garantimin e shkëmbimeve në kohë, të sakta dhe konfidenciale të informacionit, komunikimet efikase dhe të besueshme, dhe aftësitë për të zgjidhur menjëherë pikëpyetjet dhe shqetësimet mbi shkëmbimet ose kërkesat për shkëmbime dhe për të administruar dispozitat e Seksionit 4 të kësaj Marrëveshjeje);

Meqë, Autoritetet Kompetente dëshirojnë të arrijnë një marrëveshje për të përmirësuar përputhshmërinë tatimore ndërkombëtare bazuar në shkëmbimin automatik reciprok sipas [Konventës]/[Instrumentit], dhe që është objekt i konfidencialitetit dhe masave të tjera mbrojtëse të parashikuara në dokument, duke përfshirë dispozitat që kufizojnë përdorimin e informacionit të shkëmbyer sipas [Konventës]/[Instrumentit];

Si rrjedhojë, nisur nga sa më sipër, Autoritetet Kompetente kanë rënë dakord si më poshtë:

## SEKSIONI 1

### *Përkufizime*

1. Për qëllime të kësaj marrëveshjeje (“Marrëveshja”), termat e mëposhtëm kanë kuptimet vijuese:

- a) termi “[**Juridiksioni A**]” është [...].
- b) termi “[**Juridiksioni B**]” është [...].
- c) termi “[**Autoriteti Kompetent**]” është:
  - (1) në rastin e [Juridiksionit A], [...]; dhe
  - (2) në rastin e [Juridiksionit B], [...].
- d) termi “[**Institucion Financiar i [Juridiksionit A]**]” është (i) çdo Institucion Financiar që është rezident në [Juridiksionin A], por që përjashton çdo degë të atij Institucioni Financiar që ndodhet jashtë [Juridiksionit A], dhe (ii) çdo degë e një Institucioni Financiar që nuk është rezident në [Juridiksionin A], nëse ajo degë ndodhet në [Juridiksionin A].
- e) termi “[**Institucion Financiar Raportues**]” është çdo Institucion Financiar i [Juridiksionit A] i cili nuk është një Institucion Financiar Joraportues.
- f) termi “[**Llogari e Raportueshme**]” është një Llogari e Raportueshme e [Juridiksionit B], me kusht që të jetë identifikuar si e tillë në përputhje me procedurat e verifikimit të duhur, në pajtim me Standardin e Përbashkët të Raportimit, që ekzistojnë në [Juridiksionin A].
- g) termi “[**Llogari e Raportueshme e [Juridiksionit B]**]” është një Llogari Financiare që mirëmbahet nga një Institucion Financiar Raportues i [Juridiksionit A] dhe mbahet nga një ose më shumë Persona të [Juridiksionit B] të cilët janë Persona të Raportueshëm ose nga një NFE Pasive me një ose më shumë Persona Kontrollues që është një Person i Raportueshëm i [Juridiksionit B].
- h) termi “[**Person i [Juridiksionit B]**]” është një individ ose njësi ekonomike që është identifikuar nga një Institucion Financiar Raportues i [Juridiksionit A] si rezident në [Juridiksionin B] sipas procedurave të verifikimit të duhur në përputhje me Standardin e Përbashkët të Raportimit, ose një pasuri e një personi të vdekur që ka qenë rezident i [Juridiksionit B].
- i) termi “[**Numri i Identifikimit të Tatimpaguesit (NIPT)**]” është NIPT-i në [Juridiksionin B].
- j) termi “[**NIPT-i i [Juridiksionit B]**]” është një [...].



- k) termi **“Standard i Përbashkët Raportimi”** është standardi për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarisë financiare i zhvilluar nga OECD, me vendet e G20-ës, paraqitur pranë G20-ës në vitin 2014 dhe publikuar në faqen e internetit të OECD-së.
2. Termat me germa kapitale, të papërkufizuar ndryshe në këtë Marrëveshje, kanë kuptimin që i është dhënë në atë kohë sipas ligjit të Juridiksionit zbatues të Marrëveshjes, kuptim i cili është në përputhje me kuptimin e përcaktuar në Standardin e Përbashkët të Raportimit. Çdo term i papërkufizuar ndryshe në këtë Marrëveshje apo në Standardin e Përbashkët të Raportimit, përveç nëse konteksti kërkon ndryshe ose Autoritetet Kompetente bien dakord për një kuptim të përbashkët (siç lejohet nga legjislacioni i brendshëm), kanë kuptimin që u është dhënë atyre në atë kohë sipas ligjit të Juridiksionit zbatues të Marrëveshjes, çdo kuptim sipas ligjeve tatimore në fuqi të atij Juridiksioni që kanë përparësi mbi kuptimin që i është dhënë termit sipas ligjeve të tjera të atij Juridiksioni.

## SEKSIONI 2

### *Shkëmbimi i informacionit në lidhje me Llogaritë e Raportueshme*

1. Në bazë të dispozitave të nenit [...] të [Konventës]/ [Instrumentit] dhe rregullave të zbatueshme të raportimit dhe verifikimit në përputhje me Standardin e Përbashkët të Raportimit, Autoriteti Kompetent i [Juridiksionit A] do të shkëmbejë çdo vit me Autoritetin Kompetent të [Juridiksionit B], mbi baza automatike, informacionet e marra në bazë të rregullave të tilla dhe të specifikuara në paragrafin 2.
2. Informacioni që do të shkëmbehet lidhet me çdo Llogari të Raportueshme të [Juridiksionit B]:
  - a) emrin, adresën, NIPT-in, datën dhe vendin e lindjes (në rastin e një individi) të secilit Person të Raportueshëm që është Mbajtës Llogarie i llogarisë dhe, në rastin e çdo Njësie Ekonomike që është Mbajtëse Llogarie dhe që, pas zbatimit të procedurave të verifikimit të duhur në përputhje me Standardin e Përbashkët të Raportimit, është identifikuar se ka një ose më shumë Persona Kontrollues që janë Person i Raportueshëm, emrin, adresën dhe NIPT-in e Njesisë Ekonomike dhe emrin, adresën, NIPT-in, datën dhe vendin e lindjes së secilit Person të Raportueshëm;
  - b) numrin e llogarisë (ose ekuivalentin funksional në mungesë të një numri të llogarisë);
  - c) emrin dhe numrin identifikues (nëse ka) të Institucionit Financiar Raportues;
  - d) gjendjen e llogarisë ose vlerën (duke përfshirë, në rastin e Kontratës së Sigurimit në Vlerë në Para të Gatshme ose Kontratë Pensioni Vjetor, Vlerën në Para të Gatshme ose vlerën e mbylljes vullnetare) duke filluar në fund të vitit përkatës kalendarik ose në një periudhë tjetër të përshtatshme raportimi ose, nëse llogaria është mbyllur gjatë atij viti apo asaj periudhe, në mbylljen e llogarisë;
  - e) në rastin e një Llogarie Kujdestarie:
    - (1) shumën totale bruto të interesit, shumën totale bruto të dividendëve, dhe shumën totale bruto të të ardhurave të tjera të krijuara në lidhje me aktivet e mbajtura në llogari, në çdo rast paguar apo kredituar në llogari (ose në lidhje me llogarinë) gjatë vitit kalendarik ose një periudhe tjetër të përshtatshme raportimi; dhe
    - (2) të ardhurat totale bruto nga shitja apo shlyerja e aktiveve financiare të paguara apo të kredituara në llogari gjatë vitit kalendarik ose një periudhe tjetër të përshtatshme të raportimit në lidhje me të cilën Institucioni Financiar Raportues ka vepruar, si: kujdestar, ndërmjetës, kandidat ose ndryshe si një agent për Mbajtësin e Llogarisë;

- f) në rastin e ndonjë Llogarie Depozite, shumën totale bruto të interesit të paguar apo të kredituar në llogari gjatë vitit kalendarik ose një periudhe tjetër të përshtatshme raportimi; dhe
- g) në rastin e ndonjë llogarie të papërs shkruar në nënparagrafin 2 (e) ose (f), shumën totale bruto të paguar apo të kredituar për Mbajtësin e Llogarisë në lidhje me llogarinë gjatë vitit kalendarik ose një periudhe tjetër të përshtatshme raportimi në lidhje me të cilën Institucioni Financiar Raportues është institucioni që ka detyrim ose debitori, duke përfshirë edhe shumën totale të pagesave të shlyerjeve të bëra për Mbajtësin e Llogarisë gjatë vitit kalendarik ose një periudhe tjetër të përshtatshme raportimi.

## SEKSIONI 3

### *Koha dhe mënyra e shkëmbimit të informacionit*

1. Për qëllime të shkëmbimit të informacionit në seksionin 2, shuma dhe karakterizimi i pagesave të bëra në lidhje me një Llogari të Raportueshme mund të përcaktohen në përputhje me parimet e ligjeve tatimore të Juridiksionit që kryen shkëmbimin e informacionit.
2. Për qëllime të shkëmbimit të informacionit në seksionin 2, informacioni i shkëmbyer do të identifikojë monedhën në të cilën është shprehur çdo shumë përkatëse.
3. Në lidhje me paragrafin 2 të seksionit 2, informacioni do të shkëmbehet lidhur me [xxxx] dhe të gjitha vitet e specifikuar dhe do të shkëmbehet brenda nëntë muajve pas përfundimit të vitit kalendarik me të cilin lidhet informacioni.
4. Pavarësisht paragrafit 3, informacioni që do të shkëmbehet lidhur me [xxxx] është informacioni i përshkruar në paragrafin 2 të seksionit 2, me përjashtim të të ardhurave bruto të përshkruara në nënparagrafin 2 (e) (2) të seksionit 2.
5. Autoritetet kompetente të [Juridiksionit A] do të shkëmbejnë automatikisht informacionin e përshkruar në seksionin 2 në skemën standarde të raportimit të përbashkët në një gjuhë të zgjeruar të caktuar (XML).
6. Autoritetet Kompetente do të bien dakord mbi një ose më shumë metoda për transmetimin e të dhënave, duke përfshirë standardet e kodimit.

## SEKSIONI 4

### *Bashkëpunimi mbi pajtueshmërinë dhe zbatimin*

Autoriteti Kompetent i [Juridiksionit B] do të njoftojë Autoritetin Kompetent të [Juridiksionit A] kur Autoriteti i përmendur i pari ka arsye të besojë se një gabim mund të ketë çuar në informacione të pasakta ose të paplota, ose raportimi nuk është në pajtim, nga një Institucion Financiar Raportues, me kërkesat e zbatueshme të raportimit dhe procedurat e verifikimit në përputhje me Standardin e Përbashkët të Raportimit. Autoriteti Kompetent i [Juridiksionit A] do të ndërmarrë të gjitha masat e duhura, të disponueshme sipas legjislacionit të tij të brendshëm për të trajtuar gabimet ose papajtueshmërinë e përshkruar në njoftim.

## SEKSIONI 5

### *Konfidencialiteti dhe ruajtja e të dhënave*

1. I gjithë informacioni i shkëmbyer është objekt i rregullave të konfidencialitetit dhe masave të tjera mbrojtëse të parashikuara në [Konventë]/[Instrument], duke përfshirë dispozitat që kufizojnë përdorimin e informacionit të shkëmbyer dhe, në masën e nevojshme për të siguruar nivelin e

nevojshëm të mbrojtjes së të dhënave personale, në përputhje me masat mbrojtëse të cilat mund të specifikohen nga Autoriteti Kompetent i [Juridiksionit A], siç kërkohet sipas legjislacionit të tij të brendshëm.

2. Autoriteti Kompetent i [Juridiksionit B] do të njoftojë menjëherë Autoritetin Kompetent të [Juridiksionit A] në lidhje me çdo shkelje të konfidencialitetit apo dështimin e masave mbrojtëse dhe për çdo sanksion dhe veprime përmirësuese pasuese.

## SEKSIONI 6

### *Konsultimet dhe ndryshimet*

1. Në rast të ndonjë vështirësie që lind në zbatimin ose interpretimin e kësaj Marrëveshjeje, secili Autoritet Kompetent mund të kërkojë konsultime për zhvillimin e masave të duhura për sigurimin e përmbushjes së kësaj Marrëveshjeje.

2. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet me marrëveshje me shkrim të Autoriteteve Kompetente. Me përjashtim të rastit kur bihet dakord ndryshe, një ndryshim i tillë hyn në fuqi në ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe prej një muaji pas datës së nënshkrimit të fundit të marrëveshjes së tillë me shkrim ose datës së fundit të njoftimeve të shkëmbyera për qëllime të kësaj marrëveshjeje me shkrim.

## SEKSIONI 7

### *Afati i marrëveshjes*

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi [...] / [në datën e njoftimit të dhënë nga Autoriteti Kompetent i [Juridiksionit A] se juridiksioni i tij ka ligjet e nevojshme për të vënë në zbatim Marrëveshjen].

2. Një Autoritet Kompetent mund ta pezullojë shkëmbimin e informacionit sipas kësaj Marrëveshjeje duke njoftuar me shkrim Autoritetin tjetër Kompetent se ka konstatuar se ka ose ka pasur papajtueshmëri të konsiderueshme nga Autoriteti tjetër Kompetent me këtë Marrëveshje. Ky pezullim do të hyjë menjëherë në fuqi. Për qëllime të këtij paragrafi, papajtueshmëria e konsiderueshme përfshin, po nuk kufizohet me, papajtueshmërinë me dispozitat për konfidencialitetin dhe ruajtjen e të dhënave të kësaj Marrëveshjeje dhe të [Konventës]/[Instrumentit], pamundësinë e Autoritetit Kompetent për të dhënë informacion në kohë dhe të mjaftueshëm siç kërkohet në bazë të kësaj Marrëveshjeje ose për të përcaktuar statusin e Njësive Ekonomike ose të llogarive si Institucione Financiare Joraportuese dhe Llogari të Përgjashtuara në mënyrë të atillë që pengon qëllimet e Standardit të Përbashkët të Raportimit.

3. Secili Autoritet Kompetent mund ta zgjidhë këtë Marrëveshje duke i dhënë njoftim me shkrim për zgjidhjen Autoritetit tjetër Kompetent. Kjo zgjidhje do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe prej 12 muajsh pas datës së njoftimit të zgjidhjes. Në rast të zgjidhjes, i gjithë informacioni i marrë më parë sipas kësaj Marrëveshjeje do të mbetet konfidencial dhe do të jetë objekt i [Konventës]/[Instrumentit].

Nënshkruar në dy kopje në [...] më [...].

Autoriteti Kompetent për  
[Juridiksionin A]:

Autoriteti Kompetent  
për [Juridiksionin  
B]:

## *Shtojca 3*

# **Udhëzuesi i Përdorimit të Standardit të Përbashkët të Raportimit**

*Versioni 1.0*

## **Hyrje**

OECD duke punuar së bashku me vendet e G20-ës ka zhvilluar një standard të përbashkët për raportimin, verifikimin e duhur dhe shkëmbimin e informacionit të llogarisë financiare. Sipas këtij standardi të përbashkët, juridiksionet marrin nga institucionet financiare raportuese dhe shkëmbejnë automatikisht me partnerët e shkëmbimit, sipas rastit, çdo vit, informacion financiar për të gjitha llogaritë e raportueshme, të identifikuara nga institucionet financiare mbi bazën e rregullave të raportimit të përbashkët dhe të verifikimit të duhur.

Pjesë e zgjidhjes teknike për ta mbështetur këtë standard të përbashkët është skema dhe udhëzimet e lidhura me të.

Skema është një strukturë të dhënash për mbajtjen dhe transmetimin elektronik dhe në grup të informacionit. XML “gjuha e zgjeruar e caktuar” përdoret gjerësisht për këtë qëllim. Si shembuj shërbejnë Format Standard i Transmetimit “STF” i OECD-së ose formati Fisc 153 që përdoret për shkëmbimin e informacionit për Direktivën Evropiane “Për kursimet”.

Ky udhëzues shpjegon informacionin që kërkohet të përfshihet në çdo element të dhënash të CRS-së që duhet raportuar në skemën XML versioni 1.0 të CRS-së. Ai gjithashtu përmban udhëzime për mënyrën se si të bëhen korrigjimet në zërat e të dhënave brenda një skedari që mund të përpunohet automatikisht.

### ***Si lidhet udhëzuesi i CRS-së me skemën e CRS-së***

Ky udhëzues ndahet në seksione logjike bazuar në skemë dhe jep informacion për elementët specifikë të të dhënave dhe çdo atribut që përshkruan atë element të dhënash.

Seksionet e informacionit të skemës së CRS-së janë

- I Koka e mesazhit me dërguesin, marrësin, llojin e mesazhit, periudhën e raportimit
- II Detajet e Personit Kontrollues ose të Mbajtësit të Llogarisë nëse është individ
- III Mbajtësi i Llogarisë nëse është njësi ekonomike
- IV Trupi i CRS-së; Institucioni Financiar Raportues dhe Grupi i Raportimit dhe detajet e llogarisë

Numrat e seksioneve pasqyrohen në numërtimin e diagrameve në shtojcën A.

Skema XML e CRS-së është projektuar për t’u përdorur për shkëmbimin automatik të informacionit financiar ndërmjet Autoriteteve Kompetente (“AK”). Gjithashtu, CRS mund të përdoret edhe për raportimin e brendshëm nga Institucionet Financiare (“IF”) pranë autoriteteve tatimore në bazë të CRS-së. Zërat që lidhen vetëm me raportimin e brendshëm shfaqen në [kllapa].

Skema e CRS-së po ripërdor skemën e FATCA-s dhe elementë të STF-së, prandaj janë disa elemente në skemën e CRS-së të cilat nuk kërkohen për qëllime raportimi dhe

shkëmbimi sipas CRS-së (p.sh. Raporti përmbledhës dhe kombësia). Këto elemente shfaqen në udhëzues si fakultative, pasuar nga “*jo i CRS-së*”.

Komenti “*jo i CRS-së*” gjithashtu shfaqet në diagramat e shtojcës A sipas rastit.

Skema XML e CRS-së dhe udhëzuesi i saj parashikojnë elementë të cilët janë unik për CRS-në, p.sh. llogaritë e padokumentuara dhe të mbyllura.

Fusha e kërkesës për secilin element të dhënash dhe atributin e tij tregon nëse elementi është validim ose fakultativ në skemë. Çdo element është ose njëri ose tjetri në skemë.

Elementët e “validimit” DUHET të jenë të pranishëm për të gjithë regjistrat e të dhënave në skedar dhe mund të ndërmerret një kontroll validimi i automatizuar. Dërguesi duhet të kryejë një kontroll teknik të përmbajtjes së skedarit të të dhënave me anë të instrumenteve XML për të garantuar se të gjithë elementët e “validimit” janë të pranishëm dhe nëse jo, të korrigjojë skedarin. Edhe marrësi mund të veprojë në të njëjtën mënyrë dhe nëse është i pasaktë, mund ta refuzojë skedarin. Në rastin kur ka një zgjedhje ndërmjet 2 elementëve të validimit nën njësinë e validimit dhe nevojitet vetëm një, kjo shfaqet si “(zgjedhje) validimi”. Nëse elementët gjenden nën njësinë fakultative, ata shfaqen si fakultativë.

Mund të ketë rregulla të ndryshme biznesi për elementët që janë fakultativë në skemë:

- Disa fusha fakultative shfaqen si “të detyrueshme (fakultative)” – një element fakultativ që kërkohet për raportimin e CRS-së siç specifikohet në kërkesat e raportimit të CRS-së në varësi të disponueshmërisë së informacionit ose të faktorëve ligjorë. Elementët e detyrueshëm mund të jenë të pranishëm në shumicën (por jo në të gjitha) rrethanat, prandaj nuk mund të ketë një proces të thjeshtë validimi TI-je për t’i kontrolluar këto. (P.sh. CRS parashikon se IF raportues duhet të raportojë NIPT-in e një Mbajtësi Llogarie vetëm nëse lëshohet nga juridiksioni i tij i rezidencës / vetëm nga vendi i lindjes nëse në të kundërt kërkohet për ta ruajtur dhe për të raportuar dhe mbahet në të dhëna të kërkueshme në formë elektronike).
- Elementët fakultativë mund të paraqesin një zgjidhje ndërmjet një lloji apo një tjetri, në rastin kur duhet të përdoret njëri prej tyre (p.sh. zgjedhja ndërmjet adresës fikse ose adresës së lirë). Shfaqet si kërkesë “fakultative”.
- Elementi mund të mos kërkohet as për validimin e skemës dhe as për CRS-në. Ai nuk duhet të raportohet në një skedar vetëm CRS siç tregohet nga “Fakultativ (jo i CRS-së)”.

Shtojca A e udhëzuesit të përdorimit të CRS-së tregon paraqitjen diagramatike të skemës XML të CRS-së me të gjitha elementet e saj. Numrat pranë emrave janë numrat përkatës të seksionit në tekstin e udhëzuesit. Kutitë e komenteve përfshijnë si shpjegimet edhe ndryshimet nga versioni i mëparshëm i skemës së CRS-së që do të hiqet pasi të miratohet drafti.

Shtojca B e udhëzuesit të përdorimit të CRS-së përmban një glosar (fjalorth) të hapësirave të emrave për skemën XML të CRS-së.

## Informacioni i skemës së Standardit të Përbashkët të Raportimit

### *I. Koka e mesazhit*

Informacioni në kokën e mesazhit identifikon administratën tatimore që po dërgon mesazhin. Ai specifikon kohën kur është krijuar mesazhi, çfarë periudhe (normalisht një vit) mbulon raportin dhe natyrën e raportit (origjinal, i korrigjuar, suplementar, etj).



Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
NI i shoqërisë dërguese		E pakufizuar	xsd:fraza	Fakultative

[Pavarësisht se nuk përdoret për shkëmbim ndërmjet Autoriteteve Kompetente sipas CRS-së, për raportimin e brendshëm elementi i numrit të identifikimit të shoqërisë dërguese do të jetë i detyrueshëm dhe do ta identifikonte Institucionin Financiar që po i raporton autoritetit tatimor dërgues sipas NIPT-it (ose NI).]

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
Vendi transmetues		2-karakte	iso:Kodi i vendit_Lloji	Validimi

Ky element i të dhënave identifikon juridiksionin ku mbahet llogaria financiare e raportuar ose ku kryhet pagesa e raportuar nga Institucioni Financiar Raportues. Nëse dërguesi është administrata tatimore, vendi transmetues është juridiksioni i administratës tatimore. Ky element i të dhënave përdor kodin alfabetik të vendit me 2 karaktere dhe listën e emrave të vendeve<sup>1</sup> bazuar në standardin ISO 3166 Alfa 2.

[Për raportimin e brendshëm ky element do të ishte kodi i brendshëm i vendit.]

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
Vendi marrës		2-karakte	iso:Kodi i vendit_Lloji	Validimi

Ky element i të dhënave identifikon juridiksionin e administratës tatimore (Autoritetin Kompetent) që është marrësi i synuar i mesazhit. Ky element i të dhënave përdor kodin alfabetik të vendit me 2 karaktere bazuar në standardin ISO 3166-1 Alfa 2.

[Për raportimin e brendshëm ky element do të ishte kodi i brendshëm i vendit.]

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
Lloji i mesazhit			crs:Lloji i mesazhit_Lloji i enumeracionit	Validimi

Ky element i të dhënave specifikon llojin e mesazhit që dërgohet. E vetmja hedhje që lejohet në këtë fushë për AEOI të CRS-së është “CRS”.

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
kujdes			xsd:fraza	Fakultative

<sup>1</sup>Heqja dorë që vijon më poshtë i referohet të gjitha përdorimeve të listës së kodeve ISO të vendeve në skemën e CRS-së: Për arsye praktike, lista bazohet në listën e vendeve ISO 3166-1, e cila përdoret aktualisht nga bankat dhe institucionet e tjera financiare, dhe si rrjedhojë nga administratat tatimore. Përdorimi i kësaj liste nuk nënkupton shprehjen e ndonjë opinionit të çfarëdolloj nga OECD për statusin ligjor të territoreve të renditura. Përmbajtja e saj nuk cenon statusin ose sovranitetin e asnjë territori, demarkacionin e kufijve ndërkombëtarë dhe emrin e asnjë territori, qyteti ose zone.

Ky element i të dhënave është një fushë bosh për tekst që lejon futjen e udhëzimeve specifike të kujdesit rreth përdorimit të përmbajtjes së mesazhit të CRS-së, për shembull kushtet e Instrumentit ose Konventës sipas së cilës shkëmbehen të dhëna. Nëse të dhënat e raportuara janë për një periudhë të ndryshme nga raportimi për një vit të plotë, ky informacion mund të jepet këtu si narrativ p.sh. “periudhë dhjetë vjeçare”.

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
Kontakti			xsd:fraza	Fakultative

Ky element i të dhënave është një fushë bosh për tekst që lejon futjen e informacionit specifik të kontaktit për dërguesin e mesazhit. *[Mund të japë kontaktin e Institucionit Financiar ose të palës së tretë vetëm për raportim të brendshëm.]*

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
ID e ref së mesazhit			xsd:fraza	Validimi

Ky element i të dhënave është një fushë bosh për tekst që kap numrin unik të identifikimit të dërguesit (krijuar nga dërguesi) që identifikon mesazhin e caktuar që dërgohet. Identifikuesi e lejon si dërguesin dhe marrësin ta identifikojnë mesazhin specifik më vonë nëse lindin pyetje ose korrigjime. Për shkëmbimet ndërmjet Autoriteteve Kompetente, pjesa e parë duhet të jetë kodi i vendit të juridiksionit dërgues, pjesa e dytë, viti me të cilin lidhen të dhënat dhe pjesa e tretë, kodi i vendit marrës, përpara identifikuesit unik të krijuar nga juridiksioni dërgues (“pjesa e brendshme kombëtare”).

*[Nëse skema e CRS-së përdoret për raportimin e brendshëm, Institucioni Financiar mund të përfshijë një numër identifikimi të institucionit financiar në ID e ref së mesazhit në fillim të identifikuesit unik të krijuar nga institucioni financiar që rekomandohet si praktikë e mirë.]*

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
Treguesi i llojit të mesazhit		crs:Treguesi i llojit të mesazhit	Lloji i enumeracionit	Fakultative

Ky element i të dhënave e lejon dërguesin të përcaktojë llojin e mesazhit të dërguar. Ky është një element fakultativ meqë treguesi i llojit të dokumentit identifikon edhe nëse të dhënat janë të reja apo të korrigjuara (shih Udhëzimin për procesin e korrigjimit më poshtë). Mesazhet duhet të përmbajnë të gjitha të dhënat e reja dhe të korrigjuara, *[ose të njoftohet brenda vendit se nuk ka asnjë të dhënë për të raportuar]*.

*[Treguesi i llojit të mesazhit mund të përdoret brenda vendit për të treguar që Institucioni Financiar ka kryer kontrollin e duhura të të dhënave të klientit të tij, por nuk ka të dhëna për të raportuar (është në fuqi “zero raportimi”). Vetëm në këtë rast, IVc e Raportit të Llogarisë nuk duhet plotësuar.]*

Vlerat e mundshme janë:

CRS701= Mesazhi përmban informacion të ri

CRS702= Mesazhi përmban korrigjime për informacionin e dërguar më parë

CRS703= Mesazhi njofton se nuk ka asnjë të dhënë për të raportuar

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
ID e ref të mesazhit të korrigjuar			xsd:fraza	Fakultative

Ky element i të dhënave është një fushë bosh për tekst që kap numrin unik të identifikimit (siç përcaktohet nga dërguesi) që identifikon mesazhin e korrigjuar që dërgohet. Ky element i të dhënave DUHET t’i referohet ID-së origjinale të referencës së mesazhit të krijuar për mesazhin origjinal. Udhëzimet për procesin e korrigjimit jepen më

poshtë, për të shpjeguar se kjo përdoret vetëm në një CRS për anulimin e një mesazhi të mëparshëm.

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
Periudha e raportimit			xsd:data	Validimi

Ky element i të dhënave identifikon ditën e fundit të periudhës së raportimit (normalisht një vit tatimor) me të cilën lidhet mesazhi në formatin VVVV-MM-DD. Për shembull, nëse raportohet informacion për llogaritë ose pagesat e bëra në vitin kalendarik 2014, fusha do të lexohet si “2014-12-31”. Nëse në raste përjashtimore viti i raportimit nuk është një vit atëherë gjatësia e periudhës së raportimit të tregohet te pjesa kujdes.

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
Stampa e kohës			xsd:data ora	Validimi

Ky element i të dhënave identifikon datën dhe orën kur është hartuar mesazhi. Pritet që ky informacion të popullohet automatikisht nga sistemi i pritjes (host). Format i përdorim është VVVV-MM-DD”K” hh:mm:ss. Nuk përdoren fraksionet e sekondave. Për shembull: 2015-03-15K09:45:30.

## II. Person Palë\_Lloji

Elementet e të dhënave në këtë seksion përdoren për Mbajtësit Individualë të Llogarisë ose Personat Kontrollues të NFE-ve Pasive. Ky lloj kompleks përbëhet nga elementët vijues të dhënave:

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
Kodi i vendit rezident		2-karaktere	iso:Kodi i vendit_Lloji	Validimi

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
NIPT-i			cfc:NIPT_Lloji	E detyrueshme (Fakultative)

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
Emri			crs:Emri i personit_Lloji	Validimi

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
Adresa			cfc:Adresa_Lloji	Validimi

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
Kombësia			iso:Kodi i vendit_Lloji	Fakultative (Jo e CRS-së)

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
Informacioni i lindjes			E detyrueshme (Fakultative)	

### *Ila. Kodi i vendit i rezidencës*

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
Kodi i vendit të rezidencës		2-karaktere	iso:Kodi i vendit_LlojiValidimi	

Ky element i të dhënave përshkruan kodin tatimor të vendit të rezidencës për individin për të cilin po raportohet dhe duhet të jetë i pranishëm në të gjithë regjistrat e të dhënave për AEOI e CRS-së ndërmjet Autoriteteve Kompetente.

Kërkohej një raport i veçantë për çdo juridiksion rezidence të Personit të Raportueshëm duke përfshirë Personat Kontrollues të cilët janë Persona të Raportueshëm, së bashku me detajet e Njesisë Ekonomike, nëse ka më shumë se një juridiksion rezidence.

*[Për raportimin e brendshëm, nëse individ i është i certifikuar ose trajtuar si rezident tatimor në më shumë se një juridiksion atëherë ky element mund të përsëritet dhe të dhënat duhet t'i dërgohen autoritetit tatimor. Gjithashtu mund të këshillohet të mandatohet përdorimi i kodit të brendshëm të vendit për llogaritë e padokumentuara, i cili nuk do të shkëmbehet ndërmjet Autoriteteve tatimore.]*

Informacioni i plotë duke përfshirë të gjitha kodet e vendit të rezidencës që janë identifikuar si të zbatueshme për Personat e Raportueshëm mund t'i dërgohen çdo Autoriteti Kompetent të një juridiksioni rezidence me qëllim që të ketë një ndërgjegjësim të nevojës së mundshme për të zgjidhur statusin e rezidencës së dyfishtë ose çështje të tjera që lidhen me raportimin e shumëfishtë. Rekomandohet që Autoriteti Kompetent të dërgojë një dosje me të dhëna pranë secilit juridiksion të rezidencës duke treguar të gjitha juridiksionet e raportueshme të rezidencës.

Ose, në të kundërt, në disa rrethana të caktuara, juridiksioni dërgues mund të zgjedhë të dërgojë të dhëna vetëm me kodin e vendit të rezidencës së juridiksionit marrës të secili prej tyre dhe mund të përdorë një tjetër metodë për shkëmbimin e informacionit që lidhet me disa juridiksione të rezidencës në pajtim me instrumentet e zbatueshme ligjore, nëse dhe kur është e nevojshme.

### *Iib. Lloji i NIPT-it*

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
NIPT-i		Min 1 karakter	cfc:NIPT_Lloji	E detyrueshme (fakultative)

Ky element i të dhënave identifikon Numrin e Identifikimit të Tatimpaguesit (NIPT) që përdoret nga administrata tatimore marrëse për të identifikuar Mbajtësin Individual të Llogarisë. NIPT-i (nëse disponohet) duhet të jepet siç specifikohet në CRS.

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
NIPT-i	lëshuar nga	2-karaktere	iso:Kodi i vendit_Lloji	E detyrueshme (fakultative)

Ky atribut identifikon juridiksionin që ka lëshuar NIPT-in. Nëse juridiksioni lëshues nuk njihet, atëherë kjo mund të lihet bosh.

### *Iic. Emri i personit\_Lloji*

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
----------	----------	----------	-----------------	---------

Emri i personit_Lloji	Lloji i emrit	stf: Lloji i emrit OECD_Lloji i enumeracionit	Fakultative
-----------------------	---------------	---	-------------

Ky element i të dhënave i lejon Institucionit Financiar që të raportojë si mbiemrin në lindje dhe atë pas martese.

### **Lloji i emrit OECD\_Lloji i enumeracionit**

Ka mundësi që një individ ose njësi ekonomike e CRS-së të ketë disa emra. Ky është një kualifikues për të treguar llojin e emrit të caktuar. Këto lloje përfshijnë nofkat, emrat me të cilat pala bën biznes (“dba” një emër i shkurtër për njësinë ekonomike, ose një emër që përdoret për njohje nga publiku në vend të emrit zyrtar të biznesit) etj.

Vlerat e mundshme janë:

- OECD201= SMF(alias)Ndrysheosetjetër (nuk përdoret për CRS)
- OECD202= individ
- OECD203= alias (ndryshe)
- OECD204= nofka
- OECD205= aka
- OECD206= dba
- OECD207= ligjor
- OECD208= në lindje

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
Titulli paraardhës			xsd:fraza	Fakultative

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
Titulli			xsd:fraza	Fakultative

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
Emri i parë			xsd:fraza	Validimi

Ky element i të dhënave kërkohej për raportimin e CRS-së. Nëse Institucioni Financiar Raportues ose administrata tatimore që transmeton mesazhin nuk ka një emër të parë të plotë të Mbajtësit Individual të Llogarisë ose të Personit Kontrollues, mund të përdoret një inicial ose NFN (“S”ka emër të parë”).

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
Emri i parë	xnlLloji i emrit		xsd:fraza	Fakultative

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
----------	----------	----------	-----------------	---------



Emri i dytë	xsd:fraza	Fakultative
-------------	-----------	-------------

Ky element i të dhënave lejon vendosjen e emrit të dytë të individit. Të dhënat janë fakultative për raportimin e CRS-së. Nëse Institucioni Financiar Raportues ka një emër të dytë ose inicial mund të vendoset këtu.

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
Emri i dytë	xnlLloji i emrit		xsd:fraza	Fakultative

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
Parashtesa e emrit			xsd:fraza	Fakultative

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
Parashtesa e emrit	xnlLloji i emrit		xsd:fraza	Fakultative

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
Mbiemri			xsd:fraza	Validimi

Ky element i të dhënave kërkohet për raportimin e CRS-së. Institucioni Financiar Raportues ose administrata tatimore që transmeton mesazhin duhet të japë mbiemrin e Mbajtësit Individual të Llogarisë. Kjo fushë mund të përfshijë çdo parashtesë ose prapashtesë që përdoret ligjërisht nga Mbajtësi i Llogarisë.

Duke qenë se elementi është një frazë, kjo mund të përdoret për një emër me format të lirë ose dy mbiemra, megjithëse, kurdoherë që është e mundur, duhet të përdoret emri i parë dhe mbiemri i strukturuar.

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
Mbiemri	xnlLloji i emrit		xsd:fraza	Fakultative

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
Identifikuesi i gjeneratës			xsd:fraza	Fakultative

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
Prapashtesa			xsd:fraza	Fakultative

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
Prapashtesa e përgjithshme			xsd:fraza	Fakultative

### *IId. Adresa\_Lloji*

Ka dy opsione për llojin e adresës në skemë – Adresa fikse dhe adresa e lirë. Adresa fikse duhet të përdoret për të gjitha raportimet e CRS-së, përveçse nëse Institucioni Financiar Raportues ose administrata tatimore që transmeton mesazhin, nuk mund të përcaktojë pjesët e ndryshme të adresës së mbajtësit të llogarisë.

Ky element i të dhënave është adresa e përhershme e rezidencës, për shembull e mbajtësit individual të llogarisë. Nëse Institucioni Financiar Raportues ose administrata tatimore nuk ka një adresë të përhershme të rezidencës në dosjen për individin, atëherë adresa është adresa postare që përdoret nga institucioni financiar për të kontaktuar mbajtësin individual të llogarisë kur hartohet raporti.

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
Kodi i vendit		2-karaktere	iso:Kodi i vendit_Lloji	Validimi

Ky element i të dhënave jep kodin e vendit lidhur me adresën e mbajtësit të llogarisë. [Për llogaritë e padokumentuara, do të përdoret kodi i brendshëm i vendit pasi nuk ka asnjë adresë të disponueshme. Duke qenë se adresa kërkon një tjetër zë të dhëne për t'u kompletuar, atëherë “e padokumentuar” mund të përdoret në vend të adresës aktuale.]

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
Adresa e lirë			xsd:fraza	Fakultative*

Ky element i të dhënave lejon futjen e informacionit të adresës në tekst të lirë. Nëse përdoruesi zgjedh opsionin për të futur të dhënat e kërkuara në një mënyrë më pak të strukturuar në “Adresë e lirë”, të gjitha detajet e disponueshme të adresës duhet të paraqiten si një frazë bitësh, bosh ose “/” (vijë e pjerrët) ose me kthim të kursorit në pozicionin parë të rreshtit si një delimitues ndërmjet pjesëve të adresës. \*Ky opsion duhet të përdoret vetëm nëse të dhënat nuk mund të paraqiten në formatin e adresës fikse.

SHËNIM: Nëse Institucioni Financiar Raportues ose administrata tatimore që transmeton mesazhin zgjedh adresën fikse, ato do të kenë opsionin e futjes së adresës së plotë të rrugës të mbajtësit të llogarisë në elementin e adresës së lirë në vend që të përdorin elementet fikse të lidhura me të. Në këtë rast, informacioni për qytetin, nënjesinë ekonomike dhe kodin postar duhet të vijojë të hidhet në elementet e duhura fikse.

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
Lloji i adresës adresës ligjore	Lloji i adresës ligjore	stf:OECDLloji i enumeracionit	Lloji i adresës ligjore_Lloji i	Fakultative

### **OECDLloji i adresës ligjore\_Lloji i enumeracionit**

Ky është një lloj të dhëne për atribut në një adresë. Ai shërben për të treguar karakterin ligjor të asaj adrese (rezidence, biznesi, etj):

Vlera e mundshme janë:

- OECD301= rezidencëosebiznes

- OECD302= rezidencë
- OECD303= biznes
- OECD304= zyrë e regjistruar
- OECD305= e paspecifikuar

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
Rruga			xsd:fraza	Fakultative

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
Identifikuesi i ndërtesës			xsd:fraza	Fakultative

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
Identifikuesi i suitës			xsd:fraza	Fakultative

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
Identifikuesi i katit			xsd:fraza	Fakultative

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
Emri i rrethit			xsd:fraza	Fakultative

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
Kutia postare			xsd:fraza	Fakultative

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
Kodi postar			xsd:fraza	Fakultative

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
Qyteti			xsd:fraza	Validimi

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
Nënnjësi e vendit			xsd:fraza	Fakultative

Elementët e të dhënave të mësipërme përbëjnë llojin e adresës fikse. Elementi i të dhënave të “qytetit” kërkohet për validimin e skemës. Kodi postar duhet të përfshihet gjithmonë aty ku ekziston. Informacioni që i përket adresës së rrugës së mbajtësit të llogarisë mund të futet këtu ose në elementin e të dhënave të adresës së lirë.

### *Ile. Kombësia*

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
Kombësia		2-karaktere	iso:Kodi i vendit_Lloji (jo e CRS-së)	Fakultative

Ky element i të dhënave nuk kërkohet për CRS-në dhe nuk duhet të plotësohet.

### *IIf. Informacioni i lindjes*

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
Data e lindjes			xsd:data	E detyrueshme (fakultative)

Ky element i të dhënave identifikon datën e lindjes së Mbajtësit Individual të Llogarisë. Data e lindjes mund të lihet bosh kur nuk kërkohet të raportohet sipas CRS-së (kjo mund të ndodhë për Llogaritë Paraekzistuese nëse data e lindjes nuk është e disponueshme në regjistrat e Institucionit Financiar Raportues dhe gjithashtu nuk kërkohet të mblidhet nga ky Institucion Financiar Raportues sipas legjislacionit të brendshëm).

Formati i të dhënave është VVVV-MM-DD.

Tre elementët e të dhënave të mëposhtme zbatohen veçanërisht për vendin e lindjes dhe mund të jepen në pajtim me udhëzimet e CRS-së në rastin kur institucionit financiar i kërkohet të marrë dhe të raportojë informacion sipas legjislacionit të brendshëm, dhe kur ndodhet në të dhënat e kërkueshme në formë elektronike.

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
Qyteti			xsd:fraza	Fakultative

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
Nënnjësi e qytetit			xsd:fraza	Fakultative

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
Informacioni i vendit				Fakultative

Ky element i të dhënave jep një zgjedhje ndërmjet juridiksionit aktual (të identifikuar nga kodi me 2 karaktere i vendit) ose një juridiksioni të mëparshëm (të identifikuar nga emri).

Njëri ose tjetri duhet të jepet nëse raportohet vendi i lindjes, së bashku me qytetin ose qytetin dhe nënnjësinë e qytetit.

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
Kodi i vendit		2-karaktere	iso:Kodi i vendit_Lloji	Fakultative

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
Emri i vendit të mëparshëm			xsd:fraza	Fakultative

### III. Organizata palë\_Lloji

Ky lloj kompleks identifikon emrin e Mbajtësit të Llogarisë që është një Njësi Ekonomike krahasuar me Individin.

Ai përbëhet nga katër elementët vijues të të dhënave:

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
Kodi i vendit të rezidencës	2-karaktere		iso:Kodi i vendit_Lloji (fakultative)	E detyrueshme

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
Numri i identifikimit	Min 1 karakter		crs: Informacioni i organizatës_Lloji	E detyrueshme (fakultative)

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
Emri			cfc:Emri i organizatës_LlojiValidimi	

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
Adresa			cfc:Adresa_Lloji	Validimi

#### IIIa. Kodi i vendit të rezidencës

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
Kodi i vendit të rezidencës		2-karaktere	iso:Kodi i vendit_Lloji	E detyrueshme (fakultative)

Ky element i të dhënave përshkruan kodin e vendit të rezidencës për raportimin e organizatës ose për t'i raportuar.

#### IIIb. Numri i identifikimit të njësisë ekonomike (NI i organizatës\_Lloji)

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
Numri i identifikimit	Min 1 karakter		crs: NI i organizatës_Lloji	E detyrueshme (fakultative)

Ky element i të dhënave jep numrin e identifikimit (NI) që përdoret nga administrata tatimore dërguese dhe/ose marrëse për të identifikuar Mbajtësin e Llogarisë të Njësisë



Ekonomike. Për CRS-në ky mund të jetë US GIIN, NIPT-i, numri i regjistrimit të shoqërisë, Numri i Identifikimit Global të Njesisë Ekonomike (EIN) ose një numër tjetër i ngjashëm identifikues i specifikuar nga administrata tatimore.

Ky element i të dhënave mund të përsëritet nëse paraqitet një numër i dytë identifikimi.

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
Numri i identifikimit	lëshuar nga	2-karakte	iso:Kodi i vendit_Lloji	Fakultative

Ky atribut përshkruan juridiksionin që ka lëshuar numrin identifikues.

Nëse nuk dihet juridiksioni lëshues, atëherë ky mund të lihet bosh.

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
Numri i identifikimit	Lloji i numrit të identifikimit		xsd:fraza	Fakultative

Ky atribut përcakton llojin e numrit të identifikimit që dërgohet (p.sh. US GIIN, EIN, NIPT). Vlerat e mundshme normalisht duhet të dakordësohen ndërmjet Autoriteteve Kompetente.

### IIIc. Emri i organizatës

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
Emri			cfc:Emri i organizatës_Lloji	Validimi

Emri ligjor i njësisë ekonomike që raporton dhe i raportohet.

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
Emri	Lloji i emrit		stf:OECDLloji i emrit_Lloji e enumeracionit	Fakultative

### IV. Organi i CRS-së

Organi i CRS-së përbëhet nga elementë të Institucionit Financiar Raportues dhe të Grupit të Raportimit.

#### IVa. Institucioni Financiar Raportues

Identifikon institucionin financiar që mban llogarinë financiare të raportuar apo që kryen pagesën e raportuar.

Institucioni Financiar Raportues ose administrata tatimore përdor Organizata palë\_Lloji për të dhënë informacion identifikues

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
Institucioni Financiar raportues			crs:Organizata palë e korrigjueshme_Lloji	Validimi

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
Specifikimet e dokumentit			stf:Specifikimet e dokumentit_Lloji	Validimi

Specifikimet e dokumentit identifikon raportin e veçantë brenda mesazhit të CRS-së që po transmetohet. Ai lejon identifikimin e raporteve që kërkojnë korrigjim (shih gjithashtu udhëzimet për korrigjimet më poshtë).

#### IVb. Grupi raportues

Ky element i të dhënave jep detaje specifike për raportin e CRS-së që dërgohet nga Institucioni Financiar Raportues ose administrata tatimore që transmeton mesazhin.

Pavarësisht se në këtë skemë ky element është i përsëritshëm, për CRS-në jepet vetëm një Grup Raportues për secilin Organ CRS. Raporti i Llogarisë duhet të përsëritet sipas kërkesës.

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
Grupi raportues			crs:Organizata palë e korrigjueshme_Lloji	Validimi
Katër elementët vijues të dhënave përbëjnë Grupin Raportues:				
Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
Sponsori			crs:Organizata palë e korrigjueshme_Lloji CRS-së)	Fakultative (jo e

Në rastin kur Institucioni Financiar përdor një palë të tretë për të paraqitur informacion për llogari të tyre, për CRS-në nuk përdoret ky element, por të dhënat e kontaktit mund të jepen në elementin “Kontakti”.

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
Ndërmjetës			crs:Organizata palë e korrigjueshme_Lloji CRS-së)	Fakultative (jo e

#### IVc. Raporti i

##### Llogarisë

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
Raporti i Llogarisë			crs:Organizata palë e korrigjueshme_Lloji (Fakultative)	E detyrueshme

Raportimi i Llogarisë është i detyrueshëm sipas CRS-së (përveçse kur Treguesi i llojit të mesazhit CRS703 përdoret brenda vendit për të treguar se nuk asnjë të dhënë për të raportuar). Në çdo rast tjetër duhet të plotësohet Raporti i Llogarisë. Raporti i Llogarisë përfshin elementët vijues të të dhënave nën Raporti i Llogarisë së korrigjueshme\_Lloji:

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
Specifikimi i dokumentit			stf:Specifikimi i dokumentit_Lloji	Validimi

Specifikimi i dokumentit identifikon raportin e veçantë brenda mesazhit të CRS-së që po transmetohet. Ai lejon identifikimin e raporteve që kanë nevojë për korrigjim. Shih udhëzimet për korrigjimet dhe përshkrimin e llojit të specifikimit të dokumentit.

#### IVd. Numri i Llogarisë

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
----------	----------	----------	-----------------	---------

Numri i llogarisë	crs:Numri i llogarisë së IF_Lloji	Validimi
-------------------	-----------------------------------	----------

Jepet numri i llogarisë që përdoret nga institucioni financiar për të identifikuar llogarinë. Nëse institucioni financiar nuk ka një numër llogarie, atëherë të jepet identifikuesi unik funksional ekuivalent që përdoret nga institucioni financiar për të identifikuar llogarinë.

E detyrueshme për institucionet financiare që kanë një numër llogarie (duke përfshirë identifikuesit alfa numerikë).

Për shembull: Numri i llogarisë mund të jetë numri i llogarisë së një Llogarie Kujdestarie ose Llogarisë së Depozitës; ii) kodi (ISIN ose tjetër) lidhur me interesin në borxh ose kapital neto (nëse nuk mbahet në një llogari kujdestarie); ose iii) kodi i identifikimit të një Kontrate Sigurimi në Vlerë në Para të Gatshme ose të Kontratës së Pensionit Vjetor.

Nëse në raste përjashtimore nuk ka një sistem numërtimi të llogarisë, të përdoret NANUM në mungesë të një numri llogarie, pasi ky është një element validimi.

Ky format për numrin e llogarisë është i njëjtë me FATCA-n dhe mund të përdoret për numrat e strukturuar të llogarive si edhe si format i lirë; këtu mund të përfshihet një identifikues jostandard i llogarisë ose numri i kontratës së sigurimeve.

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
Numri i llogarisë	Lloji i numrit të llogarisë	cfc:Lloji i numrit të llogarisë_Lloji i enumeracionit		Fakultative

Ekziston opsioni për të përfshirë informacion për llojin e numrit të llogarisë si një enumeracion. Vlerat e mundshme janë:

- OECD601= IBAN Numri Ndërkombëtar i Llogarisë Bankare (ndjek një strukturë të njohur)
- OECD602= OBAN Numër Tjetër i Llogarisë Bankare
- OECD603= ISIN Numri Ndërkombëtar i Informacionit të Sigurimeve (ndjek një strukturë të njohur)
- OECD604= OSIN Numër Tjetër i Informacionit të Sigurimeve
- OECD605= Tjetër Çdo lloj tjetër numri llogarie, p.sh. kontrata e sigurimeve

Në rastin kur disponohet një IBAN ose ISIN, duhet të jepet së bashku me informacionin e duhur për llojin e numrit të llogarisë së dhënë.

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
Numri i llogarisë	Llogari e padokumentuar		xsd:boolean	E detyrueshme (fakultative)

*[Ky atribut përdoret në raportimin e brendshëm të CRS-së për të treguar që llogaria është e padokumentuar.]*

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
Numri i llogarisë	Llogari e mbyllur		xsd:boolean	E detyrueshme (fakultative)

Ky atribut përdoret për raportimin e CRS-së për të treguar se llogaria është e mbyllur.

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
----------	----------	----------	-----------------	---------

Numri i llogarisë	Llogari e fjetur	xsd:boolean	Fakultative
-------------------	------------------	-------------	-------------

Ky atribut mund të përdoret për raportimin e CRS-së për të treguar se llogaria është e mbyllur.

#### *IVe. Mbajtësi i Llogarisë*

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
Mbajtësi i llogarisë			crs:Mbajtësi i llogarisë_Type	Validimi

Për CRS-në ky element të dhënash mund të identifikojë një mbajtës llogarie të njësisë ekonomike që është

- një NFE Pasive me një ose më shumë persona kontrollues që është Person i Raportueshëm
- një Person i Raportueshëm i CRS-së

Meqë ka një zgjedhje të hedhjes së një individi ose të një organizate plus Llojin e Mbajtësit të Llogarisë, (por njëri ose tjetri duhet të hidhet si mbajtësi i llogarisë) këto shfaqen si validim (me zgjedhje) më poshtë.

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
Individ			crs:Person palë_Lloji	Validim (me zgjedhje)

Nëse Mbajtësi i Llogarisë që raportohet është një person fizik, duhet që këtu të raportohet informacioni i tij/saj identifikues.

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
Organizatë			crs:Organizatë palë_Lloji	Validim (me zgjedhje)

Nëse Mbajtësi i Llogarisë së raportuar nuk është një person fizik, të raportohet informacioni identifikues i njësisë ekonomike.

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
Lloji i mbajtësit të llogarisë			crs:Lloji i mbajtësit të llogarisë CRS_Lloji i enumeracionit (me zgjedhje)	Validim

Ky element i të dhënave identifikon një mbajtës llogarie të njësisë ekonomike që është

- një NFE Pasive me një ose më shumë persona kontrollues që është Person i Raportueshëm
- një Person i Raportueshëm i CRS-së
- një NFE Pasive që është një Person i Raportueshëm i CRS-së

Të plotësohet vetëm nëse llogaria financiare e raportuar mbahet nga një njësi ekonomike ose pagesa e raportuar i kryhet një njësi ekonomike të lartpërmendur. Hedhjet e lejueshme për CRS-në:

- CRS101= Njësi Ekonomike Jofinanciare me një ose më shumë persona kontrollues që është Person i Raportueshëm
- CRS102= Person i Raportueshëm i CRS-së
- CRS103= Njësi Ekonomike Jofinanciare Pasive që është një Person i Raportueshëm i CRS-së

#### IVf. Person Kontrollues

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
Person kontrollues			crs:Person kontrollues_Lloji E	detyrueshme (fakultative)

Të jepet emri i çdo Personi Kontrollues të një NFE-je Pasive që është Person i Raportueshëm. Është e detyrueshme vetëm nëse Mbajtësi i Llogarisë së njësishë ekonomike është një NFE Pasive me një ose më shumë Persona Kontrollues i cili është Person i Raportueshëm. Nëse NFE-ja Pasive ka më shumë se një Person Kontrollues që është Person i Raportueshëm, atëherë duhet të raportohet emri i të gjithë këtyre Personave të Raportueshëm.

Duhet të krijohet një raport i veçantë lidhur me secilin Juridiksion të Raportueshëm që është identifikuar si një juridiksion i rezidencës së Personave Kontrollues që janë Persona të Raportueshëm. Megjithatë, në raport duhet të përfshihet vetëm informacioni i Personave të Raportueshëm të secilit Juridiksion të Raportueshëm (duke përfshirë informacionin e NFE-së Pasive dhe të dhëna të tjera të lidhura me të).

Në rastin kur Mbajtësi i Llogarisë së Njësishë Ekonomike është një Person i Raportueshëm dhe është gjithashtu një NFE Pasive me një ose më shumë Persona Kontrollues që është Person i Raportueshëm, dhe si Njësia Ekonomike dhe secili prej këtyre Personave Kontrollues janë rezidentë në të njëjtin Juridiksion të Raportueshëm, informacioni lidhur me llogarinë mund të raportohet (i) si llogaria e një Njësie Ekonomike që është një NFE Pasive me një Person Kontrollues që është Person i Raportueshëm, ose (ii) si e tillë dhe si një llogari e një Njësie Ekonomike që është Person i Raportueshëm (d.m.th. sikur të ishte informacion lidhur me dy llogari).

Në rastin kur asnjë prej këtyre Personave Kontrollues nuk është rezident në të njëjtin Juridiksion të Raportueshëm si Njësia Ekonomike, informacioni lidhur me llogarinë duhet sidoqoftë që të raportohet si një llogari e një Njësie Ekonomike që është Person i Raportueshëm.

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
Individ			crs:Person palë_Lloji	Validimi

Përcakton Personin Kontrollues me emrin, adresën, vendin e tij të rezidencës.

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
Ctrlg_Lloji i personit			crs:CrsCtrlg_Lloji i personit_Lloji i enumeracionit	E detyrueshme (fakultative)

Ky element i të dhënave lejon identifikimin e llojit të secilit Person Kontrollues (“PK”), kur është e mundur, përmes përdorimit të atributit “Lloji i Personit Kontrollues” me opsionet vijuese:

- KP i një personi juridik – pronësia
- KP i një personi juridik – mjete të tjera
- KP i një personi juridik – zyrtar i lartë drejtues
- KP e strukturës ligjore – trust – krijues i trustit
- KP e strukturës ligjore – trust – administrator i besuar
- KP e strukturës ligjore – trust – mbrojtësi
- KP e strukturës ligjore – trust – përfituesi



- h) KP e strukturës ligjore – trust – tjetër
- i) KP e strukturës ligjore – tjetër – ekuivalent i krijuesit të trustit
- j) KP e strukturës ligjore – tjetër – ekuivalent i administratorit të besuar
- k) KP e strukturës ligjore – tjetër – ekuivalent i mbrojtësit
- l) KP e strukturës ligjore – tjetër – ekuivalent i përfituesit
- m) KP e strukturës ligjore – tjetër – ekuivalent i tjetër

Hedhjet e lejueshme për CRS-në:

- CRS801= KP e një personi juridik – pronësia
- CRS802= KP e një personi juridik – mjete të tjera
- CRS803= KP e një personi juridik – zyrtar i lartë drejtues
- CRS804= KP e strukturës ligjore – trust – krijues i trustit
- CRS805= KP e strukturës ligjore – trust – administrator i besuar
- CRS806= KP e strukturës ligjore – trust – mbrojtës
- CRS807= KP e strukturës ligjore – trust – përfitues
- CRS808= KP e strukturës ligjore – trust – tjetër
- CRS809= KP e strukturës ligjore – tjetër – ekuivalent i krijuesit të trustit
- CRS810= KP e strukturës ligjore – tjetër – ekuivalent i administratorit të besuar
- CRS811= KP e strukturës ligjore – tjetër – ekuivalent i mbrojtësit
- CRS812= KP e strukturës ligjore – tjetër – ekuivalent i përfituesit
- CRS813= KP e strukturës ligjore – tjetër – ekuivalent i tjetër

#### IVg. Bilanci i Llogarisë

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
Bilanci i llogarisë			cfc:Shuma monetare_Lloji	Validimi

Jepet bilanci ose vlera e llogarisë së llogarisë financiare të raportuar.

- Llogaritë e depozitës dhe të kujdestarisë. Bilanci dhe vlera e llogarisë duhet të jetë në pajtim me udhëzimet e CRS-së.
- Kontratat në vlerë në para të gatshme dhe kontratat e pensionit vjetor. Kontrata e sigurimit në vlerë në para të gatshme ose kontrata e pensionit vjetor është bilanci ose vlera e llogarisë.
- Llogaritë e borxhit dhe të kapitalit neto. Bilanci i llogarisë është vlera e interesit të borxhit ose kapitalit neto që mbajtësi i llogarisë ka në institucionin financiar.
- Vendosni zero nëse llogaria është mbyllur, së bashku me atributin e mbylljes së llogarisë.
- Karakteret numerikë (shifrat). Bilanci i llogarisë hidhet në shuma fraksioni me 2 shifra të monedhës në fjalë. Për shembull, 1000 USD mund të hidhet si 1000,00.

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
Bilanci i llogarisë	Kodi i monedhës	3 karaktere	iso:Kodi i monedhës_Lloji	Validimi

Të gjitha shumat duhet të shoqërohen nga kodi<sup>2</sup> i përshtatshëm i monedhës prej 3 karakteresh bazuar në standardin ISO 4217 Alfa 3.

#### IVh. Pagesa

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
Pagesa			crs:Pagesa_Lloji	Fakultative

Jepet informacion për pagesën e kryer të llogaria financiare e raportuar gjatë periudhës së raportimit.

<sup>2</sup>. Heqja dorë që vijon më poshtë i referohet të gjitha përdorimeve të listës së kodeve ISO të monedhave në skemën e CRS-së: Për arsye praktike, lista bazohet në listën e monedhave ISO 4217 Alfa 3, e cila përdoret aktualisht nga bankat dhe institucionet e tjera financiare, dhe si rrjedhojë nga administratat tatimore. Përdorimi i kësaj liste nuk nënkupton shprehjen e ndonjë opinioni të çfarëdolloj nga OECD për statusin ligjor të territoreve të renditura. Përmbajtja e saj nuk cenon statusin ose sovranitetin e asnjë territori, demarkacionin e kufijve ndërkombëtarë dhe emrin e asnjë territori, qyteti ose zone.

Informacioni i pagesës është një element përsëritës, nëse duhet të raportohet më shumë se një lloj pagese.

Për shembull llojet e pagesës mund të përfshijnë si më poshtë:

#### Llogaritë e depozitës:

- Shuma bruto e totalizuar e interesit që paguhet ose kreditohet në llogari gjatë vitit kalendarik.

#### Llogaritë e kujdestarisë:

- Shuma bruto e totalizuar e dividendëve që paguhet ose kreditohet në llogari gjatë vitit kalendarik (ose një periudhe përkatëse raportimi);
- Shuma bruto e totalizuar e interesit që paguhet ose kreditohet në llogari gjatë vitit kalendarik (ose një periudhe përkatëse raportimi);
- Të ardhurat bruto nga shitja ose shlyerja e pasurisë të paguara ose kredituara në llogari gjatë vitit kalendarik (ose një periudhe përkatëse raportimi) lidhur me të cilën Institucioni Financiar i Huaj ka vepruar si kujdestar, broker, përfaqësues ose si agent për mbajtësin e llogarisë dhe;
- Shuma bruto e totalizuar e të gjitha të ardhurave të tjera të paguara ose të kredituara në llogari gjatë vitit kalendarik (ose një periudhe përkatëse raportimi).

#### Llogaritë e borxhit ose të kapitalit neto:

- Shuma bruto e totalizuar e pagesave të paguara ose kredituara në llogari gjatë vitit kalendarik (ose një periudhe përkatëse raportimi), duke përfshirë pagesat e shlyerjeve.

#### Llogaritë e sigurimi në vlerë në para të gatshme dhe të kontratës së pensionit vjetor:

- Shuma bruto e totalizuar e pagesave të paguara ose kredituara në llogari gjatë vitit kalendarik (ose një periudhe përkatëse raportimi), duke përfshirë pagesat e shlyerjeve.

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
Lloji			crs:Lloji i pagesës së CRS-së_Lloji i enumeracionit	Validimi

Të zgjidhet kodi i duhur për të identifikuar llojin e pagesës. Llojet specifike të pagesave të renditura janë:

- CRS501= Dividendët
- CRS502= Interesi
- CRS503= Të ardhurat bruto/shlyerjet
- CRS504= Tjetër – CRS. (Shembull: të ardhura të tjera të gjeneruara lidhur me aktivet që mbahen në llogari)

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
Shuma e pagesës			cfc:Shuma monetare_Lloji	Validimi

Shumat e pagesave hidhen në shuma fraksionale me 2 shifra të monedhës në fjalë. Për shembull, 1000 USD do të hidhet si 1000,00.

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
Shuma e pagesës	Kodi i monedhës	3 karaktere	iso:Kodi i monedhës_Lloji	Validimi

Të gjitha shumatat e pagesave duhet të shoqërohen me kodin e duhur prej 3 karakteresh të monedhës bazuar në standardin ISO 4217 Alfa.

#### IVi. Raporti Përmbledhës

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
Raporti përmbledhës			ftc:Raport përmbledhës i korrigjueshëm_Lloji	Fakultative (Jo e CRS-së)

Raportimi përmbledhës nuk zbatohet për CRS-në.

### Transliterimi

Në rastin kur kërkohet transliterim për shkak se juridiksionet marrëse dhe dërguese nuk përdorin një alfabet të përbashkët, Autoritetet Kompetente mund të bien dakord për mënyrën se si do ta kryejnë këtë transliterim. Nëse nuk ka një marrëveshje të tillë, atëherë juridiksioni dërgues, nëse kërkohet kështu, duhet të bëjë transliterimin nga alfabeti ose shkronjat e tij vendase në alfabetin latin në pajtim me standardet ndërkombëtare për transliterimin (për shembull siç specifikohet në ISO 8859). Juridiksioni dërgues mund të dërgojë të dhëna indikative (p.sh. emrin ose adresën) si në alfabetin ose shkronjat vendase dhe veçmas në alfabetin latin brenda çdo të dhëne llogarie nëse zgjedhin këtë mënyrë. Juridiksioni marrës duhet të jetë i përgatitur të transliterojë edhe ndërmjet latinishtes dhe alfabetit ose shkronjave të tij vendase.

### Udhëzues mbi procesin e korrigjimit për Standardin e Përbashkët të Raportimit

1. Gjatë ecursë së AEOI, juridiksioni dërgues mund të ketë nevojë të korrigjojë disa elemente të të dhënave të dërguara më parë. Seksioni më poshtë përshkruan mënyrën se si të bëhen korrigjimet automatike duke dërguar dosjen e të dhënave të korrigjuara që mund të përpunohen në të njëjtat sisteme si të dhënat origjinale që janë marrë. Korrigjimet gjithashtu përfshijnë fshirjen e elementëve të të dhënave në seksionin vijues.

2. Nëse duhet të zëvendësohet e gjithë dosja e të dhënave, mund të bëhet anulimi i mesazhit të parë, dhe më pas mund të dërgohet një mesazh i ri me dosjen që përmban të dhënat e reja, pa asnjë lidhje me të dhënat e mëparshme përveç pjesës në kokën e mesazhit – “anulo dhe zëvendëso” jo “korrigjo”.

(Autoriteti Kompetent mund ta mbajë dosjen origjinale për të hetuar arsyet e gabimeve në të dhëna të cilat kanë çuar në anulimin dhe lëshimin e dosjes zëvendësuese.)

### *Udhëzuesi teknik*

3. Me qëllim identifikimin e elementëve për korrigjim, elementët e nivelit më të lartë të Institucionit Financiar Raportues dhe Raportit të Llogarisë përfshijnë një element të llojit Specifikimet e dokumentit\_Lloji, i cili jep informacionin e nevojshëm për korrigjimet.

#### *Lloji i Specifikimeve të Dokumentit*

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
Specifikimet e dokumentit			stf:Specifikimet e dokumentit_Lloji	Validimi

Specifikimet e Dokumentit identifikojnë atë të dhënë përkatëse brenda mesazhit të CRS-së që po transmetohet. Ato lejojnë identifikimin e të dhënave që kërkojnë korrigjim. Specifikimet e dokumentit\_Lloji përbëhet nga elementët vijues:

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
Treguesi i llojit të dokumentit			stf:OECDTreguesi i llojit të dokumentit_Lloji i enumeracionit	Validimi

Ky element specifikon llojin e të dhënave që po dorëzohen. Hedhjet e lejueshme janë:

- OECD0= Ridërgo të dhënat (nuk përdoren për raportimin e CRS-së)
- OECD1= Të dhëna të reja
- OECD2= Të dhëna të korrigjuara
- OECD3= Fshirje e të dhënave
- OECD10= Ridërgo të dhënat test (nuk përdoret për raportimin e CRS-së)
- OECD11= Të dhëna të reja test
- OECD12= Të dhëna të korrigjuara test
- OECD13= Fshirje e të dhënave test

3. Mesazhi mund të përmbajë të dhëna të reja (OECD1) ose korrigjime/fshirje (OECD2 dhe OECD3), por nuk duhet të përmbajë një përzierje të të dyjave. OECD10 – OECD13 duhet të përdoren vetëm gjatë periudhave të testimit që janë dakordësuar më parë ose pas një diskutimi dypalësh ku të dyja palët bien dakord për testimin. Kjo shërben për të eliminuar mundësinë që të dhënat e testit të mund të përzihen me të dhënat “live”.

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
ID e referencës së dokumentit		Minimumi 1 karakter	xsd:fraza	Validimi

Një identifikues unik për këtë dokument (d.m.th. një e dhënë dhe të gjitha elementet bija të të dhënës).

Korrigjimi (ose fshirja) duhet të ketë një ID unike të referencës së dokumentit për referencë në të ardhmen.

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
ID e korrigjuar e referencës së dokumentit		Minimumi 1 karakter	xsd:fraza	Fakultative

ID e korrigjuar e referencës së dokumentit lidhet me ID e referencës së dokumentit të elementit që do të korrigjohet/fshihet. Ajo duhet t'i referohet gjithmonë referencës më të fundit të këtij raporti llogarie (ID e referencës së dokumentit) që është dërguar.

Në këtë mënyrë, mund të trajtohen një sërë korrigjimesh ose ndryshimesh pasi çdo korrigjim e zëvendëson plotësisht versionin e mëparshëm. Shembujt e korrigjimit të CRS-së më poshtë tregojnë se si funksionon kjo gjë në praktikë.

Elementi	Atributi	Madhësia	Lloji i inputit	Kërkesa
ID e korrigjuar e referencës së dokumentit		Minimumi 1 karakter	xsd:fraza	Fakultative (Jo e CRS-së)

Duke qenë se ID e referencës së dokumentit është unike në hapësirë dhe kohë, ky element nuk përdoret për CRS-në në nivelin e specifikimeve të dokumentit.

### *Unikaliteti i ID-së së referencës së mesazhit dhe ID-së së referencës së dokumentit*

5. Me qëllim garantimin që mesazhi dhe të dhënat mund të identifikohen dhe të korrigjohen, ID-ja e referencës së mesazhit dhe ID-ja e referencës së dokumentit duhet të jetë unike në hapësirë dhe kohë (d.m.th. nuk duhet të ekzistojë asnjë mesazh ose e dhënë tjetër që ka të njëjtin identifikues referencë).

6. Identifikuesi mund të përmbajë çfarëdolloj informacioni që dërguesi përdor për të lejuar identifikimin e raportit të veçantë, por duhet të fillojë me kodin e vendit dërgues si elementi i parë për transmetimin nga Autoriteti Kompetent te Autoriteti Kompetent, më pas me vitin me të cilin lidhen të dhënat, më pas kodin e vendit marrës përpara identifikuesit unik.

p.sh. FR2013CA123456789

7. Identifikuesi unik në ID-në e referencës së dokumentit mund të jetë referenca e përdorur nga Institucioni Financiar për të raportuar brenda vendit, ose një referencë tjetër unike e krijuar nga administrata tatimore dërguese, por në çdo rast duhet të fillojë me kodin e vendit të juridiksionit dërgues.

p.sh. FRFI286abc123xyz ose FRabc123xyz


8. [Nëse skema e CRS-së përdoret për raportim të brendshëm, Institucioni Financiar mundet që po kështu të përfshijë një numër identifikimi të Institucionit Financiar si në ID-në e referencës së mesazhit dhe në ID-në e referencës së dokumentit, e cila rekomandohet si praktikë e mirë për të garantuar unikalitetin në kohë dhe hapësirë dhe ndihmon në lidhjen e dyshimeve me të dhënat burimore.]

### *Specifikimet e mesazhit dhe korrigjimet*

9. Mesazhet e korrigjimit duhet të kenë ID-në e tyre unike të referencës së mesazhit me qëllim që të korrigjohen në të ardhmen. Nuk ka asnjë ekuivalent për Treguesin e Specifikimeve të Dokumentit kur bëhet fjalë për mesazhet në tërësi.

10. Për të anuluar një mesazh të tërë, mund të përdoret ID-ja e referencës së mesazhit të korrigjuar të specifikimeve të mesazhit. Kini parasysh që qëllimi do të jetë që kjo të përdoret vetëm në rastet kur ka një gabim madhor, për shembull një gabim në përpunim. Në këtë rast, të gjitha dokumentet që ndodhen në këto mesazhe duhet të vendosen në karantinë.





11. Tre shembujt vijues tregojnë se si përdoren elementët e specifikimeve të dokumentit\_lloji për të korrigjuar një ose disa pjesë të të dhënave të dërguara më parë.


### ***Shembuj të korrigjimit të Standardit të Përbashkët të Raportimit***

Shembulli i parë: korrigjimi bëhet për shumën e pagesës.

Dosja e korrigjimit dërgohet nga Franca në Kanada (përmban vetëm korrigjimet, jo një përzierje të të dhënave të reja me ato të përzierja).


ID-ja e referencës së mesazhit: FR2013CAFranceNationalPart00001.

Për korrigjimin, duhet të ridërgohet i gjithë Raporti i Llogarisë me të gjithë informacionin e tij (Numri i Llogarisë, Mbajtësi i Llogarisë, Personi Kontrollues, Bilanci i Llogarisë, Pagesa).




Shembulli i dytë: bëhet një korrigjim në disa informacione: tek emri, adresa dhe shuma e pagesës. Korrigjimi bëhet në korrigjimin e parë (prandaj duhet t'i referohet ID-së më të fundit të referencës së dokumentit: FR2013456789).

ID-ja e referencës së mesazhit: FR2013CAFranceNationalPart00002.




Shembulli i tretë: korrigjimi bëhet vetëm për Institucionin Financiar Raportues, asnjë e dhënë për Raportin e Llogarisë nuk duhet të korrigjohet. Korrigjimi duhet t'i referohet Institucionit Financiar Raportues që do të korrigjohet përmes ID-së së tij të referencës së dokumentit (në këtë shembull, supozoni që ID-ja e mëparshme e referencës së dokumentit të Institucionit Financiar Raportues ishte FR2013FI007).

ID-ja e referencës së mesazhit: FR2013CAFranceNationalPart00003.




## Shtojca A

## Skema në XML e CRS-së v. 1.0 Diagramat




## Koka e mesazhit (Seksioni I)







Struktura e CRS-së (Seksioni IV)




Institucioni Financiar Raportues (Seksioni Iva)




Grupi Raportues (Seksioni IVb)



## Raporti i Llogarisë (Seksioni IVc)




Lloji i numrit të llogarisë (Seksioni IVd)







## Mbajtësi i Llogarisë (Seksioni IVe)




Individual/Organisation Account Holders (Section IVe)



## Personi Kontrollues (Seksioni IVf)




Lloji i pagesës (Seksioni IVb)




For practical reasons, the *CurrencyCode* list is based on the ISO 4217 currency code list which is currently used by banks and other financial institutions, and hence by tax administrations. The use of this list does not imply the expression by the OECD of any opinion whatsoever concerning the legal status of the territories listed. Its content is without prejudice to the status of or sovereignty over any territory, to the delimitation of international frontiers and boundaries and to the name of any territory, city or area.

Person Party Type (Section II)




For practical reasons, the ResCountryCode list is based on the ISO 3166-1 country list which is currently used by banks and other financial institutions, and hence by tax administrations. The use of this list does not imply the expression by the OECD of any opinion whatsoever concerning the legal status of the territories listed. Its content is without prejudice to the status of or sovereignty over any territory, to the delimitation of international frontiers and boundaries and to the name of any territory, city or area.

## Lloji i emrit të personit






Lloji i adresës




## Lloji i organizatës palë (Seksioni III)




*Për arsye praktike, lista e kodeve të vendit të rezidencës bazohet në listën e vendeve ISO 3166-1, e cila përdoret aktualisht nga bankat dhe institucionet e tjera financiare, dhe si rrjedhojë nga administratat tatimore. Përdorimi i kësaj liste nuk nënkupton shprehjen e ndonjë opinioni të çfarëdolloj nga OECD për statusin ligjor të territoreve të renditura. Përmbajtja e saj nuk cenon statusin ose sovranitetin e asnjë territori, demarkacionin e kufijve ndërkombëtarë dhe emrin e asnjë territori, qyteti ose zone.*

## Raporti përmbledhës (Jo i CRS-së) (Seksioni IVi)



## Sponsori dhe Ndërmjetësi (Jo të CRS-së)



## Shtojca B

## Glosari i hapësirave të emrave

### Hapësirat e emrave në skemën e CRS-së

Hapësira e emrit	Përshkrimi	Emri i skedarit
crs	Llojet specifike të CRS-së	CrsXML_v1.0.xsd
cfc	Llojet e përbashkëta për FATCA-n dhe CRS-në	CommonTypesFatcaCrs_v1.1.xsd

<b>ftc</b>	Llojet specifike të FATCA-s	FatcaTypes_v1.1.xsd
<b>stf</b>	Llojet e përbashkëta të OECD-së	OECDTypes_v4.1.xsd
<b>iso</b>	Llojet ISO (Kodet e vendeve dhe të monedhave)	isocrstypes_v1.0.xsd

---

## Shtojca 4

### Pyetësor shembull

#### 1. Kuadri ligjor

Kuadri ligjor duhet të garantojë konfidencialitetin e informacionit tatimor të shkëmbyer dhe ta kufizojë përdorimin e tij për qëllimet e duhura. Dy komponentët bazë të këtij kuadri janë kushtet e traktatit të zbatueshëm, Marrëveshja për Shkëmbimin e Informacionit Tatimor (TIEA) ose marrëveshje të tjera dypalëshe për shkëmbimin e informacionit, dhe legjislacioni i brendshëm i juridiksionit.

Fushat parësore për kontroll	<ul style="list-style-type: none"> <li>Dispozitat në traktatet tatimore, TIEA-të dhe marrëveshjet ndërkombëtare që kërkojnë konfidencialitetin e informacionit të shkëmbyer dhe që e kufizojnë përdorimin për ato qëllime të synuara</li> </ul>
<b>Si e garantojnë konfidencialitetin dhe si e kufizojnë përdorimin e informacionit në dalje drejt shteteve të tjera kontraktuese dhe informacionin në hyrje të marrë në përgjigje të kërkesës dispozitat për shkëmbimin e informacionit në Konventat tuaja Tatimore, TIEA-të ose marrëveshje të tjera për shkëmbim?</b>	
Fushat parësore për kontroll	<ul style="list-style-type: none"> <li>Legjislacioni i brendshëm duhet të zbatojë masat mbrojtëse për informacionin e shkëmbyer të tatimpaguesit sipas traktatit, TIEA-së ose marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare, dhe t'i trajtojë ato marrëveshje për shkëmbimin e informacionit si të detyrueshme, të kufizojë aksesin në të dhëna dhe të përdorë e vendosë penalitete për shkeljet.</li> </ul>
<b>Si e mbron legjislacioni dhe rregulloret tuaja të brendshme dhe si e kufizon përdorimin e informacionit të shkëmbyer për qëllime tatimore sipas Konventave Tatimore, TIEA-ve dhe instrumenteve të tjera për shkëmbim? Si e parandalon administrata tatimore keqpërdorimin e të dhënave konfidenciale dhe si e ndalon transferimin e informacionit tatimor nga organi administrativ tatimor tek organet qeveritare jotatimore?</b>	

#### 2. Menaxhimi i sigurisë së informacionit

Sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit që përdoren nga secila administratë tatimore e juridiksionit duhet të respektojnë standardet që garantojnë mbrojtjen e të dhënave konfidenciale të tatimpaguesit. Për shembull, duhet të ketë një proces vlerësimi (skanimi) për punonjësit të cilët përdorin informacionin, kufizime për ata të cilët mund të kenë akses tek informacioni dhe sisteme për të dalluar dhe gjurmuar publikimet e paautorizuara të informacionit. Standardet ndërkombëtare për sigurinë e informacionit njihen si “seritë ISO/IEC 27000”. Siç përshkruhet më në detaje në vijim, administrata tatimore duhet të jetë e aftë të dokumentojë se është në pajtim me standardet e serive ISO/IEC 27000 ose që ka një kuadër ekuivalent për sigurinë e informacionit dhe që informacioni i tatimpaguesit që mbahet sipas marrëveshjes për shkëmbim është i mbrojtur sipas atij kuadri.

--

Fushat parësore për kontroll	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Hetime të historikut dhe vlerësime për punonjësit dhe kontraktorët</li> <li>• Proces rekrutimi dhe kontrata</li> <li>• Pika kontakti të përgjegjshme</li> </ul>
<p><b>Çfarë procedurash rregullojnë hetimet e historikut nga administrata juaj tatimore për punonjësit dhe kontraktorët të cilët mund të kenë akses, përdorin dhe që janë përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave të marra përmes shkëmbimit të informacionit? A është i disponueshëm publikisht ky informacion? Nëse po, ju lutemi jepni referenca. Nëse jo, ju lutemi jepni një përmbledhje të procedurave.</b></p>	
Fushat parësore për kontroll	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Trajnim fillestar dhe trajnim periodik për ndërgjegjësimin mbi sigurinë bazuar në role, rreziqet e sigurisë dhe ligjet e zbatueshme</li> </ul>
<p><b>Çfarë trajnimi i ofron administrata juaj tatimore punonjësve dhe kontraktorëve lidhur me informacionin konfidencial duke përfshirë të dhënat e marra nga partnerët përmes shkëmbimit të informacionit? A disponon administrata juaj tatimore një version publik të kërkesave? Nëse po, ju lutemi jepni referenca. Nëse jo, ju lutemi jepni një përmbledhje të kërkesave.</b></p>	
Fushat parësore për kontroll	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Politikat e largimit për të përfunduar aksesin në informacionin konfidencial</li> </ul>
<p><b>Çfarë procedurash ka administrata juaj tatimore për të përfunduar aksesin në informacionin konfidencial për punonjësit dhe konsulentët e larguar? A janë të disponueshme publikisht këto procedura? Nëse po, ju lutemi jepni referenca. Nëse jo, ju lutemi jepni një përmbledhje të procedurave.</b></p>	

Fushat parësore për kontroll	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Masat e sigurisë për të kufizuar hyrjen në ambiente: roje sigurie, polici, procedura për hyrjen dhe aksesin</li> </ul>
<p><b>Çfarë procedurash ka administrata juaj tatimore për t'i dhënë akses punonjësve, konsulentëve dhe vizitorëve në ambientet ku ruhet informacioni konfidencial, dokumentet fizike dhe ato elektronike? A janë të disponueshme publikisht këto procedura? Nëse po, ju lutemi jepni referenca. Nëse jo, ju lutemi jepni një përmbledhje të procedurave.</b></p>	
Fushat parësore për kontroll	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Sigurimi i ruajtjes fizike për dokumentet konfidenciale: politika dhe procedura</li> </ul>
<p><b>Çfarë procedurash ka administrata juaj tatimore për marrjen, përpunimin, arkivimin, tërheqjen dhe eliminimin e kopjeve fizike të të dhënave konfidenciale të marra nga tatimpaguesit ose partnerët për shkëmbimin e informacionit. A ka procedura administrata juaj tatimore që duhet të ndiqen nga punonjësit kur largohen nga hapësira e tyre e punës në fund të ditës? A janë të disponueshme publikisht këto procedura? Nëse po, ju lutemi jepni referenca. Nëse jo, ju lutemi jepni një përmbledhje të procedurave.</b></p> <p><b>A ka administrata juaj tatimore një politikë për klasifikimin e të dhënave? Nëse po, ju lutemi përshkruani se si ndryshojnë procedurat tuaja për ruajtjen e dokumenteve për të dhënat në të gjitha nivelet e klasifikimit. A janë të disponueshme publikisht këto procedura? Nëse po, ju lutemi jepni referenca. Nëse jo, ju lutemi jepni një përmbledhje të procedurave.</b></p>	
Fushat parësore për kontroll	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Planifikimi i dokumentacionit për të zhvilluar, përditësuar dhe zbatuar sistemet e sigurisë së informacionit</li> </ul>
<p><b>Çfarë procedurash ka administrata juaj tatimore për të zhvilluar, dokumentuar, përditësuar dhe zbatuar sigurinë për sistemet e informacionit që përdoren për të marrë, përpunuar, arkivuar dhe tërhequr informacionin konfidencial? A janë të disponueshme publikisht këto procedura? Nëse po, ju lutemi jepni referenca. Nëse jo, ju lutemi jepni një përmbledhje të procedurave.</b></p> <p><b>Çfarë procedurash ka administrata juaj tatimore lidhur me përditësimin periodik të planit të sigurisë së informacionit për të trajtuar ndryshimet në mjedisin e sistemeve të sigurisë, dhe si zgjidhen problemet dhe rreziqet e identifikuara gjatë zbatimit të planeve të sigurisë së informacionit? A janë të disponueshme publikisht këto procedura? Nëse po, ju lutemi jepni referenca. Nëse jo, ju lutemi jepni një përmbledhje të procedurave.</b></p>	



Fushat parësore për kontroll	<ul style="list-style-type: none"> <li>Menaxhimi i konfigurimit dhe kontrollat e sigurisë</li> </ul>
<p><b>Çfarë politikash ka administrata juaj tatimore për të rregulluar përditësimet dhe konfigurimin e sistemit? A janë të disponueshme publikisht këto procedura? Nëse po, ju lutemi jepni referenca. Nëse jo, ju lutemi jepni një përmbledhje të procedurave.</b></p>	

Fushat parësore për kontroll	<ul style="list-style-type: none"> <li>Procedurat dhe politikat për kontrollin e aksesit: personel i autorizuar dhe shkëmbim ndërkombëtar i informacionit</li> </ul>
<p><b>Çfarë politikash ka administrata juaj tatimore për ta kufizuar aksesin në sistem te përdoruesit e autorizuar dhe për të mbrojtur të dhënat gjatë transmetimit në marrë dhe ruajtje? Ju lutemi përshkruani se si autorizimi për akses i administratës suaj tatimore dhe politikat për transmetimin e të dhënave shtrihen deri tek të dhënat e marra nga partneri i shkëmbimit të informacionit sipas traktatit ose TIEA-së apo një marrëveshjeje tjetër shkëmbimi. A janë të disponueshme publikisht këto politika? Nëse po, ju lutemi jepni referenca. Nëse jo, ju lutemi jepni një përmbledhje.</b></p>	
Fushat parësore për kontroll	<ul style="list-style-type: none"> <li>Autentifikimi i përdoruesve dhe pajisjeve identifikuese që kërkojnë akses në sistemet e informacionit</li> </ul>
<p><b>Çfarë politikash dhe procedurash ka administrata juaj tatimore për çdo sistem informacioni që lidhet me të dhënat konfidenciale? A janë të disponueshme publikisht këto politika? Nëse po, ju lutemi jepni referenca. Nëse jo, ju lutemi jepni një përmbledhje.</b></p> <p><b>Çfarë politikash dhe procedurash rregullojnë autentifikimin e përdoruesve të autorizuar të administratës tatimore nga sistemet e lidhura me të dhënat konfidenciale? A janë të disponueshme publikisht këto politika dhe procedura? Nëse po, ju lutemi jepni referenca. Nëse jo, ju lutemi jepni një përmbledhje.</b></p>	
Fushat parësore për kontroll	<ul style="list-style-type: none"> <li>Veprime elektronike të gjurmueshme brenda sistemeve</li> <li>Procedura auditimi të sistemit: monitorimi, analizimi, hetimi dhe raportimi i përdorimit të paligjshëm/paaautorizuar</li> </ul>
<p><b>Çfarë politikash dhe procedurash ka administrata juaj tatimore për të garantuar kryerjen e auditimeve të sistemit të cilat do të zbulojnë aksesin e paaautorizuar? A janë të disponueshme publikisht këto politika? Nëse po, ju lutemi jepni referenca. Nëse jo, ju lutemi jepni një përmbledhje.</b></p>	
Fushat parësore për kontroll	<ul style="list-style-type: none"> <li>Sisteme mirëmbajtjeje periodike dhe në kohë</li> <li>Kontrolle mbi: instrumentet, procedurat dhe mekanizmat për mirëmbajtjen e sistemit dhe përdorimin nga personeli</li> </ul>
<p><b>Çfarë politikash rregullojnë mirëmbajtjen periodike efikase të sistemit nga administrata juaj tatimore? A janë të disponueshme publikisht këto politika? Nëse po, ju lutemi jepni referenca. Nëse jo, ju lutemi jepni një përmbledhje.</b></p> <p><b>Çfarë procedurash rregullojnë zgjidhjen e defekteve në sistem të identifikuar nga administrata juaj tatimore? A janë të disponueshme publikisht këto procedura? Nëse po, ju lutemi jepni referenca. Nëse jo, ju lutemi jepni një përmbledhje.</b></p>	

Fushat parësore për kontroll	<ul style="list-style-type: none"> <li>Procedura për të monitoruar, kontrolluar dhe mbrojtur komunikimet drejt dhe nga sistemet e informacionit</li> </ul>
<p><b>Çfarë politikash dhe procedurash ka administrata juaj tatimore për marrjen dhe transmetimin elektronik të të dhënave konfidenciale. Ju lutemi përshkruani kërkesat e sigurisë dhe të kodimit që trajtohen në këto politika. A janë të disponueshme publikisht këto politika? Nëse po, ju lutemi jepni referenca. Nëse jo, ju lutemi jepni një përmbledhje.</b></p>	

Fushat parësore për kontroll	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Procedura për të identifikuar, raportuar dhe korrigjuar defektet në sistemin e informacionit në kohën e duhur</li> <li>• Mbrojtje nga kodet e këqija dhe monitorim si alarmeve të sigurisë nga sistemi</li> </ul>
<p><b>Çfarë procedurash ka administrata juaj tatimore për të identifikuar, raportuar dhe korrigjuar defektet në sistemin e informacionit në kohën e duhur? Ju lutemi përshkruani se si këto procedura parashikojnë mbrojtjen e sistemeve nga kodet e këqija që shkaktojnë dëme në integritetin e të dhënave. A janë të disponueshme publikisht këto procedura? Nëse po, ju lutemi jepni referenca. Nëse jo, ju lutemi jepni një përmbledhje.</b></p>	
Fushat parësore për kontroll	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Proceset e përdorura për të testuar, validuar dhe autorizuar kontrollet e sigurisë për mbrojtjen e të dhënave, korrigjimin e mangësive dhe reduktimin e cenueshmërive</li> </ul>
<p><b>Çfarë politikash ka administrata juaj tatimore dhe si i përditëson ato rregullisht për shqyrtimin e proceseve që përdoren për testimin, validimin dhe autorizimin e planit të kontrollit të sigurisë? A janë të disponueshme publikisht këto politika? Nëse po, ju lutemi jepni referenca. Nëse jo, ju lutemi jepni një përmbledhje.</b></p>	
Fushat parësore për kontroll	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Planet për përgjigjen ndaj emergjencave, operacionet rezervë dhe rikuperimin e sistemeve të informacionit pas fatkeqësive</li> </ul>
<p><b>Çfarë procedurash dhe planesh kontigjence ka administrata juaj tatimore për të reduktuar ndikimin e publikimit të papërshtatshëm të të dhënave apo humbjen e parikuperueshme të të dhënave? A janë të disponueshme publikisht këto plane dhe procedura? Nëse po, ju lutemi jepni referenca. Nëse jo, ju lutemi jepni një përmbledhje.</b></p>	
Fushat parësore për kontroll	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Rreziku potencial nga aksesit i paautorizuar në informacionin e tatimpaguesit</li> <li>• Rreziku dhe shkalla e dëmit nga përdorimi, publikimi i paautorizuar ose dëmtimi i sistemeve të informacionit të tatimpaguesit</li> <li>• Procedurat për përditësimin e metodologjive për vlerësimin e rrezikut</li> </ul>
<p><b>A kryen administrata juaj tatimore vlerësime të rrezikut për të identifikuar rreziqet dhe impaktin potencial të aksesit, përdorimit dhe publikimit të paautorizuar të informacionit, ose shkatërrimit të sistemeve të informacionit? Çfarë procedurash ka administrata juaj tatimore për të përditësuar metodologjitë për vlerësimin e rrezikut? A janë të disponueshme publikisht këto politika dhe vlerësime rrezikut? Nëse po, ju lutemi jepni referenca. Nëse jo, ju lutemi jepni një përmbledhje.</b></p>	
Fushat parësore për kontroll	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Metodot dhe proceset për të garantuar se ofruesit e tretë të sistemeve të informacionit e përpunojnë, ruajnë dhe transmetojnë informacionin konfidencial në pajtim me kërkesat e sigurisë kompjuterike</li> </ul>
<p><b>Çfarë procesi ka administrata juaj tatimore për të garantuar se ofruesit e tretë po zbatojnë kontrollet e duhura të sigurisë të cilat janë në pajtim me kërkesat e sigurisë kompjuterike për informacionin konfidencial? A janë këto procese publikisht të disponueshme? Nëse po, ju lutemi jepni referenca. Nëse jo, ju lutemi jepni një përmbledhje.</b></p>	
Fushat parësore për kontroll	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Procese për të mbrojtur informacionin në formë të printuar ose dixhitale</li> <li>• Masa sigurie që përdoren për të kufizuar aksesin në informacionin e medias vetëm për përdoruesit e autorizuar</li> <li>• Metoda për pastrimin dhe shkatërrimin e medias dixhitale përpara eliminimit ose ripërdorimit</li> </ul>
<p><b>Çfarë procesesh ka administrata juaj tatimore për të ruajtur në mënyrë të sigurt dhe kufizuar aksesin në informacionin konfidencial në formë të printuar ose dixhitale pas marrjes nga çfarëdo lloj burimi? Si e shkatërron administrata juaj tatimore në mënyrë të sigurt informacionin konfidencial në media përpara eliminimit të tij? A janë këto procese publikisht të disponueshme? Nëse po, ju lutemi jepni referenca. Nëse jo, ju lutemi jepni një përmbledhje.</b></p>	

Fushat parësore për kontroll	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Procedura për të garantuar se dosjet e shkëmbyera në bazë të traktatit janë të mbrojtura dhe të emërtuara qartë</li> <li>• Metodat e klasifikimit të dosjeve të shkëmbyera në bazë të traktatit</li> </ul>
<p><b>Çfarë politikash dhe procesesh ka administrata juaj tatimore për të ruajtur informacionin konfidencial dhe emërtuar atë qartë si të shkëmbyer në bazë të traktatit pas marrjes nga Autoritetet Kompetente të huaja? A janë këto politika dhe procese publikisht të disponueshme? Nëse po, ju lutemi jepni referenca. Nëse jo, ju lutemi jepni një përmbledhje.</b></p>	
Fushat parësore për kontroll	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Procedura për eliminimin e duhur të dosjeve fizike dhe elektronike</li> </ul>
<p><b>Çfarë procedurash ka administrata juaj tatimore për eliminimin e informacionit konfidencial? A shtrihen këto procedura tek informacioni i shkëmbyer nga Autoritetet Kompetente të huaja? A janë këto procedura publikisht të disponueshme? Nëse po, ju lutemi jepni referenca. Nëse jo, ju lutemi jepni një përmbledhje.</b></p>	

### 3. Monitorimi dhe zbatimi

Përveç mbajtjes konfidencial të informacionit të shkëmbyer në bazë të traktatit, administratat tatimore duhet të jenë të afta që të garantojnë se përdorimi i tij do të kufizohet për qëllimet e përcaktuara nga marrëveshja e zbatueshme për shkëmbimin e informacionit. Prandaj, pajtueshmëria vetëm me kuadër të pranueshëm të sigurisë së informacionit nuk mjafton për të mbrojtur të dhënat e shkëmbyera në bazë të traktatit. Gjithashtu, legjislacioni i brendshëm duhet të vendosë penalitete dhe sanksione për publikimin ose përdorimin e papërshtatshëm të informacionit të tatimpaguesit. Për të garantuar zbatimin, ky legjislacion duhet të përforcohet nga procedura dhe burime të përshtatshme administrative.

Fushat parësore për kontroll	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Penalitetet e vendosura për publikimet e paautorizuara</li> <li>• Praktikat për zbutjen e rrezikut</li> </ul>
<p><b>A e ka aftësinë administrata juaj tatimore për të vendosur penalitete për publikimet e paautorizuara të informacionit konfidencial? A shtrihen penalitetet deri te publikimi i paautorizuar i informacionit konfidencial të shkëmbyer me një partner në traktat ose TIEA? A janë këto penalitete publikisht të disponueshme? Nëse po, ju lutemi jepni referenca. Nëse jo, ju lutemi jepni një përmbledhje.</b></p>	
Fushat parësore për kontroll	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Monitorimi për zbulimin e shkeljeve</li> <li>• Raportimi i shkeljeve</li> </ul>
<p><b>Çfarë procedurash ka administrata juaj tatimore për të monitoruar shkeljet e konfidencialitetit? Çfarë politikash dhe procedurash ka administrata juaj tatimore që i kërkojnë punonjësve dhe kontraktorëve të raportojnë shkeljet reale dhe potenciale të konfidencialitetit? Çfarë raportesh përgatit administrata juaj tatimore kur ndodh një shkelje konfidencialiteti? A janë këto politika dhe procedura të disponueshme publikisht? Nëse po, ju lutemi jepni referenca. Nëse jo, ju lutemi jepni një përmbledhje.</b></p>	
Fushat parësore për kontroll	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Publikimet e mëparshme të paautorizuara</li> <li>• Modifikimet e politikave/proceseve për të parandaluar shkeljet në të ardhmen</li> </ul>
<p><b>A ka pasur raste në juridiksionin tuaj kur është publikuar informacion konfidencial në mënyrë të papërshtatshme? A ka pasur raste në juridiksionin tuaj kur informacioni konfidencial i marrë nga Autoriteti Kompetent nga partneri për shkëmbimin e informacionit është publikuar në mënyra të ndryshme nga ato të parashikuara në kushtet e instrumentit sipas së cilit është dhënë informacioni? A i vendos në dispozicion të publikut administrata juaj tatimore ose Inspektori i Përgjithshëm shkeljet, penalitetet/sanksionet e vendosura, dhe ndryshimet e vendosura për të zbutur rrezikun dhe parandaluar shkeljet në të ardhmen? Nëse po, ju lutemi jepni referenca. Nëse jo, ju lutemi jepni një përmbledhje.</b></p>	

## *Shtojca 5*

# **Qasje më e gjerë ndaj Standardit të Përbashkët të Raportimit**

### **Hyrje**

1. Procedurat e verifikimit të duhur në CRS (veçanërisht procedurat e kërkimit për indicie) janë hartuar për të identifikuar Llogaritë e Raportueshme që janë Llogaritë e rezidentëve në një juridiksion që është Juridiksion i Raportueshëm në momentin e kryerjes së procedurave të verifikimit të duhur. Megjithatë, ka arsye të mira përse juridiksionet mund të duan të shkojnë përtej dhe, për shembull, t'i zgjerojnë procedurat e verifikimit të duhur dhe të mbulojnë të gjithë jorezidentët dhe rezidentët e juridiksioneve me të cilët kanë një instrument shkëmbimi. Kjo qasje mund t'i reduktojë në mënyrë të konsiderueshme kostot për institucionet financiare sepse atyre nuk do t'u duhet të kryejnë verifikime shtesë sa herë që bashkohet një juridiksion i ri.
2. Ky dokument përmban një ekstrakt nga CRS-ja që është ndryshuar për të parashikuar këtë qasje më të gjerë. Ndryshimet kryesore në CRS janë si më poshtë vijon:
  - Çdo gjuhë që sugjeron se procedurat janë hartuar për të identifikuar Llogaritë që janë Llogari të Raportueshme në momentin e kryerjes së procedurave të verifikimit të duhur është fshirë ose ndryshuar.
  - Sipas procedurës për kërkimin e indicieve, Institucionit Financiar Raportues tashmë i kërkohet që të kërkojë për indicie që tregojnë se Mbajtësi i Llogarisë është rezident në një Juridiksion të Huaj dhe ta trajtojë Llogarinë si llogari që mbahet nga një Mbajtës Llogarie që është rezident i çdo Juridiksioni të Huaj për të cilin gjendet një indicie (përveçse nëse Institucioni Financiar ndjek “procedurën e korrigjimit”). Juridiksioni i Huaj do të përkufizohet si çdo Juridiksion i ndryshëm nga Juridiksioni i Institucionit Financiar Raportues. Avantazhi i kësaj qasjeje është që, nëse një juridiksion i ri i bashkohet sistemit, Institucioni Financiar Raportues mund të mbështetet në rezultatet e atij kërkimi për indicie për të përcaktuar se cila prej Llogarive të tij Paraekzistuese mbahet nga rezidentë të këtij juridiksioni.
3. Shembujt vijues ilustrojnë zbatimin e kësaj qasjeje më të gjerë:
  - Shembulli 1: Juridiksioni A vendos që të zbatojë Standardin e Përbashkët të Raportimit duke filluar nga data 1 janar 2016, që do të thotë se të gjitha llogaritë e hapura pas asaj date konsiderohen si Llogari të Reja.

Z. X është rezident i Juridiksionit Z dhe hap një llogari pranë institucionit financiar në Juridiksionin A më 1 mars 2016. Në atë moment, Juridiksioni Z nuk është një Juridiksion i Raportueshëm. Institucioni financiar do të duhet të marrë një vetëvërtetim nga Z. X, i cili do të duhet të përfshijë juridiksionin e tij të rezidencës për qëllime tatimore, por jo NIPT-in ose datën e tij të lindjes (duke qenë se llogaria nuk është një Llogari e Raportueshme në momentin e hapjes së saj). Nëse Juridiksioni Z bëhet një Juridiksion i Raportueshëm në vitin 2017, institucioni financiar mund të mbështetet te vetëvërtetimi për të përcaktuar se llogaria është Llogari e Raportueshme dhe do të duhet të marrë NIPT-in dhe datën e lindjes nga Z. X deri në fund të vitit 2019.
  - Shembulli 2: I njëjti shembull, por llogaria është hapur në vitin 2014. Nëse institucioni financiar e ka zbatuar kërkimin e indicieve lidhur me Llogaritë Paraekzistuese në vitin 2016, ai mund të mbështetet në informacionin e marrë sipas këtij kërkimi të indicieve

për të përcaktuar juridiksionin e rezidencës së Z. X dhe ta trajtojë këtë llogari si Llogari të Raportueshme në vitin 2017.

4. Në ekstraktin më poshtë, Institucionit Financiar Raportues nuk do t'i kërkohej që të raportojë NIPT-in dhe datën e lindjes lidhur me llogaritë që nuk kanë qenë të raportueshme në momentin e kryerjes së procedurave të verifikimit të duhur. Megjithatë, atij do t'i kërkohej që ta marrë këtë NIPT dhe datën e lindjes deri në fund të vitit të dytë kalendarik pas vitit në të cilin këto llogari janë identifikuar si Llogari të Raportueshme (njësoj si me Llogaritë Paraekzistuese). Deri në masën që është e pajtueshme me rregullat vendase për mbrojtjen e të dhënave, juridiksionet mund të marrin në konsideratë edhe të kërkojnë mbledhjen e NIPT-it dhe/ose datën e lindjes për të gjithë Mbajtësit e Llogarive që identifikohen si të huaj në momentin e hapjes së llogarisë (dhe jo vetëm ata që identifikohen si rezidentë të një Juridiksioni të Raportueshëm). Kjo ndoshta mund ta reduktojë më tej barrën për Institucionet Financiare duke qenë se është më e lehtë që ky informacion të mblidhet përpara se sa pas hapjes së llogarisë. Gjithashtu, kërkimi i NIPT-it të një Mbajtësi Llogarie do të jepte garanci shtesë për vërtetësinë e vetëvërtetimit të tij.
5. Pavarësisht se nuk kërkohej nga Standardi i Përbashkët i Raportimit, disa juridiksione mund të miratojnë një qasje që shkon përtej qasjes që ndodhet në këtë shtojcë dhe, për shembull, të zgjerojnë procedurat e verifikimit të duhur për të mbuluar rezidentët e tyre që janë Persona Kontrollues të NFE-së Pasive. Prandaj, ato do të marrin informacion edhe në rastet kur një prej rezidentëve të tyre është një Person Kontrollues i një NFE-je Pasive që mban një llogari pranë Institucionit Financiar Raportues. Kjo qasje do t'i kërkonte Institucioneve Financiare Raportuese që të raportojnë për rezidentët që, edhe pse nuk janë vetë Mbajtës Llogarie, janë Persona Kontrollues të një NFE-je Pasive që është Mbajtëse Llogarie. Kjo mund të bëhet për shembull duke zgjeruar qëllimin e termit "Person i Raportueshëm".

## **EKSTRAKT NGA CRS, I NDRYSHUAR, PËR TË KËRKUAR IDENTIFIKIMIN E STATUSIT TË TË GJITHA LLOGARIVE TË HUAJA**

### **Seksioni I: Kërkesat e përgjithshme të raportimit**

- A. Sipas paragrafëve C deri në F, secili Institucion Financiar Raportues duhet të raportojë informacionin e mëposhtëm lidhur me çdo Llogari të Raportueshme të këtij Institucioni Financiar Raportues:
  1. emrin, adresën, juridiksionet e rezidencës, NIPT-in, datën dhe vendin e lindjes (në rastin e një individi) të secilit Person të Raportueshëm që është Mbajtës Llogarie i llogarisë dhe, në rastin e çdo Njësie Ekonomike që është Mbajtëse Llogarie dhe që, pas zbatimit të procedurave të verifikimit të duhur në përputhje me Seksionet V, VI dhe VII, është identifikuar se ka një ose më shumë Persona Kontrollues që janë Person i Raportueshëm, emrin, adresën, juridiksionet e rezidencës dhe NIPT-in e Njesisë Ekonomike dhe emrin, adresën, juridiksionet e rezidencës, NIPT-in, datën dhe vendin e lindjes së secilit Person të Raportueshëm;
  2. numrin e llogarisë (ose ekuivalentin funksional në mungesë të një numri të llogarisë);
  3. emrin dhe numrin identifikues (nëse ka) të Institucionit Financiar Raportues;
  4. gjendjen e llogarisë ose vlerën (duke përfshirë, në rastin e Kontratës së Sigurimit në Vlerë në Para të Gatshme ose Kontratë Pensioni Vjetor, Vlerën në Para të Gatshme ose vlerën e mbylljes vullnetare) duke filluar në fund të vitit përkatës kalendarik ose në një



periudhë tjetër të përshtatshme raportimi ose, nëse llogaria është mbyllur gjatë atij viti apo asaj periudhe, në mbylljen e llogarisë;

5. në rastin e një Llogarie Kujdestarie:

- a) shumën totale bruto të interesit, shumën totale bruto të dividendëve, dhe shumën totale bruto të të ardhurave të tjera të krijuara në lidhje me aktivet e mbajtura në llogari, në çdo rast paguar apo kredituar në llogari (ose në lidhje me llogarinë) gjatë vitit kalendarik ose një periudhe tjetër të përshtatshme raportimi; dhe
- b) të ardhurat totale bruto nga shitja apo shlyerja e aktiveve financiare të paguara apo të kredituara në llogari gjatë vitit kalendarik ose një periudhe tjetër të përshtatshme të raportimit në lidhje me të cilën Institucioni Financiar Raportues ka vepruar, si: kujdestar, ndërmjetës, kandidat ose ndryshe si një agjent për Mbajtësin e Llogarisë;

6. në rastin e ndonjë Llogarie Depozite, shumën totale bruto të interesit të paguar apo të kredituar në llogari gjatë vitit kalendarik ose një periudhe tjetër të përshtatshme raportimi; dhe

7. në rastin e ndonjë llogarie të papërkshkruar në nënparagrafin A (5) ose A(6), shumën totale bruto të paguar apo të kredituar për Mbajtësin e Llogarisë në lidhje me llogarinë gjatë vitit kalendarik ose një periudhe tjetër të përshtatshme raportimi në lidhje me të cilën Institucioni Financiar Raportues është institucioni që ka detyrim ose debitori, duke përfshirë edhe shumën totale të pagesave të shlyerjeve të bëra për Mbajtësin e Llogarisë gjatë vitit kalendarik ose një periudhe tjetër të përshtatshme raportimi.

B. Informacioni i raportuar duhet të identifikojë monedhën në të cilën është shprehur çdo shumë përkatëse.

C. Pavarësisht nënparagrafit A(1), lidhur me çdo Llogari të Raportueshme që është një Llogari Paraekzistuese ose lidhur me çdo Llogari Financiare që është hapur përpara se të bëhet Llogari e Raportueshme, NIPT-i ose data e lindjes nuk është e nevojshme të raportohet nëse ky NIPT ose kjo datë lindjeje nuk është në regjistrat e Institucionit Financiar Raportues dhe nuk kërkohet të mblidhet nga ky Institucion Financiar Raportues sipas legjislacionit të brendshëm. Sidoqoftë, Institucionit Financiar Raportues i kërkohet të bëjë përpjekje të arsyeshme për të siguruar NIPT-in dhe datën e lindjes lidhur me Llogaritë Paraekzistuese deri në fund të vitit të dytë kalendarik pas vitit në të cilin këto Llogari janë identifikuar si Llogari të Raportueshme.

D. Pavarësisht nënparagrafit A(1), NIPT-i nuk kërkohet që të raportohet nëse (i) NIPT-i nuk është lëshuar nga Juridiksioni përkatës i Raportueshëm ose (ii) legjislacioni i brendshëm i Juridiksionit përkatës të Raportueshëm nuk e kërkon mbledhjen e NIPT-it të lëshuar nga ky Juridiksion i Raportueshëm.

E. Pavarësisht nënparagrafit A(1), vendi i lindjes nuk kërkohet të raportohet me përjashtim të rasteve kur Institucionit Financiar Raportues i kërkohet ta sigurojë dhe raportojë sipas legjislacionit të brendshëm dhe është i disponueshëm në bazën e të dhënave të kërkueshme në format elektronik e cila mbahet nga Institucioni Financiar Raportues.

F. Pavarësisht paragrafit A, informacioni që duhet të raportohet lidhur me [xxxx] është informacioni i përshkruar në këtë paragraf, me përjashtim të të ardhurave bruto të përshkruara në nënparagrafin A(5)(b).

## Seksioni II: Kërkesat e përgjithshme të verifikimit të duhur

A. Llogaria trajtohet si Llogari e Raportueshme duke filluar nga data në të cilën identifikohet si e tillë në bazë të procedurave të verifikimit të duhur në seksionin II deri



në VII dhe, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe, informacioni lidhur me një Llogari të Raportueshme duhet të raportohet çdo vit në vitin kalendarik pas vitit me të cilin lidhet informacioni.

- B. Institucioni Financiar Raportues, i cili sipas procedurave të përshkruara në seksionet II deri në VII, e identifikon çdo llogari si Llogari të Huaj që nuk është Llogari e Raportueshme në kohën kur kryhet verifikimi i duhur, mund të mbështetet në rezultatin e këtyre procedurave për të qenë në pajtueshmëri me detyrimet e raportimit në të ardhmen.
- C. Gjendja ose vlera e llogarisë përcaktohet duke filluar nga data e fundit të vitit kalendarik ose një periudhë tjetër e përshtatshme raportimi.
- D. Në rastin kur pragu i gjendjes ose vlerës do të përcaktohet duke filluar nga dita e fundit e vitit kalendarik, gjendja ose vlera përkatëse duhet të përcaktohet duke filluar nga dita e fundit e periudhës së raportimit që përfundon me vitin kalendarik ose brenda atij viti kalendarik.
- E. Secili Juridiksion mund t'i lejojë Institucionet Financiare Raportuese që të përdorin ofrues shërbimesh për të përmbushur detyrimet e raportimit dhe të verifikimit të duhur të cilat i janë vendosur këtyre Institucioneve Financiare Raportuese, siç parashikohet në legjislacionin e brendshëm, por këto detyrime mbeten përgjegjësi e Institucioneve Financiare Raportuese.
- F. Secili Juridiksion mund t'i lejojë Institucionet Financiare Raportuese që të zbatojnë procedurat e verifikimit të duhur për Llogaritë e Reja për ato Paraekzistuese, dhe procedurat e verifikimit të duhur për Llogaritë e Vlerës së Lartë për Llogaritë e Vlerës së Ulët. Në rastin kur një Juridiksion lejon procedurat e verifikimit të duhur për Llogaritë e Reja që të përdoren për Llogaritë Paraekzistuese, vijnë të zbatohen rregullat e zbatueshme për Llogaritë Paraekzistuese pavarësisht këtyre.

### Seksioni III: Verifikimi i duhur për Llogaritë Paraekzistuese Individuale

Për Llogaritë Paraekzistuese Individuale do të zbatohen procedurat vijuese.

- A. **Llogaritë që nuk kërkohen të shqyrtohen, identifikohen ose raportohen.** Një Llogari Paraekzistuese Individuale që është një Kontratë Sigurimi në Vlerë në Para të Gatshme ose një Kontratë Pensioni Vjetor nuk kërkohet të shqyrtohet, identifikohet ose raportohet, me kusht që Institucioni Financiar Raportues e ka të ndaluar me ligj që ta shesë një Kontratë të tillë te rezidentët e një Juridiksioni të Raportueshëm.
- B. **Llogaritë e Vlerës së Ulët.** Lidhur me Llogaritë e Vlerës së Ulët zbatohen procedurat vijuese.
  - 1. **Adresa e rezidencës.** Nëse Institucioni Financiar Raportues ka në regjistrat e tij një adresë aktuale rezidence për Mbajtësin e Llogarisë individuale bazuar në evidencat shkresore, Institucioni Financiar Raportues mund ta trajtojë Mbajtësin e Llogarisë individuale si një rezident për qëllime tatimore të juridiksionit në të cilin ndodhet adresa për qëllime të përcaktimit nëse ky Mbajtës i Llogarisë individuale është një Person i Raportueshëm.
  - 2. **Kërkimi Elektronik i të Dhënave.** Nëse Institucioni Financiar Raportues nuk mbështetet mbi një adresë aktuale rezidence për Mbajtësin e Llogarisë individuale bazuar në evidencat shkresore siç përcaktohet në nënparagrafin B(1), Institucioni Financiar Raportues duhet të shqyrtojë të dhënat e kërkueshme në formë elektronike që mbahen nga Institucioni Financiar Raportues për secilën nga indiciet vijuese dhe të zbatojë nënparagrafet B(3) deri në (6):
    - a) identifikimin e Mbajtësit të Llogarisë si rezident i një Juridiksioni të Huaj;

- b) adresën aktuale të postës ose të rezidencës (duke përfshirë kutinë postare) në Juridiksionin e Raportueshëm;
  - c) një ose më shumë numra telefoni në Juridiksionin e Huaj dhe asnjë numër telefoni në juridiksionin e Institucionit Financiar Raportues;
  - d) urdhërpagesat periodike (të ndryshme nga ato që lidhen me një Llogari Depozite) për të transferuar fonde në një llogari që mbahet në një Juridiksion të Huaj;
  - e) prokura e posaçme në fuqi momentalisht ose autoriteti nënshkrues që i jepet një personi me adresë në një Juridiksion të Huaj; ose
  - f) udhëzimin për “ruajtjen e postës” ose adresën “në vëmendje të” në një Juridiksion të Huaj nëse Institucioni Financiar Raportues nuk ka një adresë tjetër në dosjen e Mbajtësit të Llogarisë.
3. Nëse në kërkimin elektronik nuk zbulohet asnjë nga indiciet e renditura në nënparagrafin B(2), atëherë nuk nevojitet asnjë veprim tjetër deri sa të ketë ndryshime në rrethanat që rezultojnë në një ose më shumë indicie që lidhen me llogarinë, ose llogaria bëhet një Llogari e Vlerës së Lartë.
4. Nëse gjatë kërkimit elektronik zbulohet ndonjë prej indicieve të renditura në nënparagrafin B(2)(a) deri në (e), ose nëse ka ndryshime në rrethanat që rezultojnë në një ose më shumë indicie që lidhen me llogarinë, atëherë Institucioni Financiar Raportues duhet ta trajtojë Mbajtësin e Llogarisë si rezident për qëllime tatimore të secilit Juridiksion të Huaj për të cilin është identifikuar një indicie, përveçse nëse zgjedh të zbatojë nënparagrafin B(6) dhe një prej përjashtimeve në këtë nënparagraf zbatohet lidhur me atë llogari.
5. Nëse në kërkimin elektronik zbulohet një udhëzim për “ruajtjen e postës” ose adresë “në vëmendje të” dhe nuk identifikohet asnjë adresë tjetër dhe asnjë indicie tjetër e renditur në nënparagrafin B(2)(a) deri në (e) për Mbajtësin e Llogarisë, në rendin më të përshtatshëm me rrethanat, Institucioni Financiar Raportues duhet të zbatojë kërkimin manual të të dhënave të përshkruar në nënparagrafin C(2), ose të kërkojë të marrë nga Mbajtësi i Llogarisë një vetëvërtetim ose evidenca shkresore për të përcaktuar rezidencat e këtij Mbajtësi Llogarie për qëllime tatimore. Nëse kërkimi manual dështon të përcaktojë një indicie dhe përpjekja për të marrë vetëvërtetimin ose evidencat shkresore nuk është e suksesshme, Institucioni Financiar Raportues duhet ta raportojë llogarinë si një llogari e padokumentuar.
6. Pavarësisht gjetjes së indicieve sipas nënparagrafit B(2), Institucionit Financiar Raportues nuk i kërkohet ta trajtojë një Mbajtës Llogarie si rezident të një Juridiksioni të Huaj nëse:
- a) informacioni i Mbajtësit të Llogarisë përmban një adresë aktuale poste ose rezidence në Juridiksionin e Huaj, një ose më shumë numra telefoni në Juridiksionin e Huaj (dhe asnjë numër telefoni në juridiksionin e Institucionit Financiar Raportues) ose urdhërpagesa periodike (lidhur me Llogaritë Financiare të ndryshme nga Llogaritë e Depozitave) për të transferuar fonde në një llogari të mbajtur në një Juridiksion të Huaj, Institucioni Financiar Raportues merr, ose ka bërë shqyrtime të mëparshme dhe mban të dhëna për:
    - i) vetëvërtetimin nga Mbajtësi i Llogarisë i juridiksioneve të rezidencës së këtij Mbajtësi Llogarie që nuk e përfshin këtë Juridiksion të Huaj; dhe
    - ii) evidencat shkresore që përcaktojnë rezidencën e Mbajtësit të Llogarisë për qëllime tatimore të ndryshme nga ky Juridiksion i Huaj.

b) informacioni i Mbajtësit të Llogarisë përmban një prokurë të posaçme aktuale ose autoritet nënshkrues dhënë një personi me adresë në Juridiksionin e Raportueshëm, Institucioni Financiar Raportues merr, ose ka bërë shqyrtime të mëparshme dhe mban të dhëna për:

- i) vetëvërtetimin nga Mbajtësi i Llogarisë i juridiksioneve të rezidencës së këtij Mbajtësi Llogarie që nuk e përfshin këtë Juridiksion të Huaj; ose
- ii) evidencat shkresore që përcaktojnë rezidencën e Mbajtësit të Llogarisë për qëllime tatimore të ndryshme nga ky Juridiksion i Huaj.

**C. Procedurat e përmirësuara të shqyrtimit për Llogaritë e Vlerës së Lartë.** Lidhur me Llogaritë e Vlerës së Lartë, zbatohen procedurat vijuese të përmirësuara të shqyrtimit.

1. **Kërkimi elektronik i të dhënave.** Lidhur me Llogaritë e Vlerës së Lartë, Institucioni Financiar Raportues duhet të shqyrtojë të dhënat e kërkueshme në formë elektronike që mbahen nga Institucioni Financiar Raportues për secilën prej indicieve të përshkruara në nënparagrafin B(2).
2. **Kërkimi manual i të dhënave.** Nëse bazat e të dhënave të kërkueshme në formë elektronike të Institucionit Financiar Raportues përfshijnë fusha për, dhe kapin të gjithë informacionin e përshkruar në, nënparagrafin C(3), atëherë nuk është e nevojshme të kryhet një tjetër kontroll manual. Nëse bazat elektronike të të dhënave nuk e kapin të gjithë këtë informacion, atëherë lidhur me Llogarinë e Vlerës së Lartë, Institucioni Financiar Raportues duhet të shqyrtojë edhe dosjen aktuale kryesore të klientit dhe, nëse nuk ndodhet në dosjen aktuale kryesore të klientit, dokumentet vijuese që lidhen me llogarinë dhe që janë marrë nga Institucioni Financiar Raportues brenda pesë viteve të fundit për secilën prej indicieve të përshkruara në nënparagrafin B(2):
  - a) evidencat shkresore më të fundit të mbledhura lidhur me llogarinë;
  - b) dokumentacionin ose kontratën më të fundit për hapjen e llogarisë;
  - c) informacionin më të fundit të marrë nga Institucioni Financiar Raportues sipas Procedurave AML/KYC ose për qëllime të tjera rregullatore;
  - d) çdo prokurë të posaçme ose formë të nënshkruesve të autorizuar aktualisht në fuqi; dhe
  - e) çdo urdhërpagesë periodike (të ndryshme nga ato lidhur me Llogaritë e Depozitave) për të transferuar fonde, aktualisht në fuqi.
3. **Përfshirja deri në masën që bazat e të dhënave përmbajnë informacion të mjaftueshëm.** Institucionit Financiar Raportues nuk i kërkohet të kryejë kërkimin manual të të dhënave të përshkruar në nënparagrafin C(2) për sa kohë informacioni i kërkueshëm në format elektronik i Institucionit Financiar Raportues përfshin sa më poshtë:
  - a) statusin e rezidencës së Mbajtësit të Llogarisë;
  - b) adresën e rezidencës dhe adresën e postës së Mbajtësit të Llogarisë që ndodhet aktualisht në dosjen e Institucionit Financiar Raportues;
  - c) numrat e telefonit të Mbajtësit të Llogarisë që janë aktualisht në dosjen e Institucionit Financiar Raportues, nëse ka;
  - d) në rastin e Llogarive Financiare të ndryshme nga Llogaritë e Depozitës, nëse ka urdhërpagesa periodike për të transferuar fondet nga llogaria në një tjetër llogari (duke përfshirë llogarinë në një degë tjetër të Institucionit Financiar Raportues ose në një tjetër Institucion Financiar);

- e) nëse ka një adresë aktuale “në vëmendje të” ose udhëzim për “ruajtje të postës” për Mbajtësin e Llogarisë; dhe
  - f) nëse ka ndonjë prokurë të posaçme ose autoritet nënshkrues për llogarinë.
4. **Marrja në pyetje e Menaxherit të Marrëdhënieve mbi njohuri reale.** Përveç kontrolleve elektronike dhe manuale të të dhënave të përshkruara më lart, Institucioni Financiar Raportues duhet ta trajtojë si Llogari të Raportueshme çdo Llogari të Vlerës së Lartë që i caktohet menaxherit të marrëdhënieve (duke përfshirë çdo Llogari Financiare që i shtohet Llogarisë së Vlerës së Lartë) nëse menaxheri i marrëdhënies ka njohuri reale se Mbajtësi i Llogarisë është Person i Raportueshëm.
5. **Efektet e gjetjes së indicieve.**
- a) Nëse asnjë prej indicieve të renditura në nënparagrafin B(2) nuk zbulohet në shqyrtimin e përmirësuar të Llogarive të Vlerës së Lartë përshkruar më lart, dhe llogaria nuk është identifikuar si një llogari e mbajtur nga rezident për qëllime tatimore në një Juridiksion të Huaj në nënparagrafin C(4), atëherë nuk kërkohen veprime të mëtejshme deri sa të ketë një ndryshim në rrethana të cilat rezultojnë në një ose më shumë indicie që lidhen me llogarinë.
  - b) Nëse ndonjë prej indicieve të renditura në nënparagrafin B(2)(a) deri në (e) zbulohen në shqyrtimin e përmirësuar të Llogarive të Vlerës së Lartë përshkruar më lartë, apo nëse ka ndonjë ndryshim pasues në rrethana të cilat rezultojnë në një ose më shumë indicie që lidhen me llogarinë, atëherë Institucioni Financiar Raportues duhet ta trajtojë Mbajtësin e Llogarisë si rezident për qëllime tatimore të secilit Juridiksion të Huaj për të cilin identifikohet indicia, përveçse nëse zgjedh të zbatojë nënparagrafin B(6) dhe një nga përjashtimet në këtë nënparagraf zbatohet lidhur me atë llogari.
  - c) Nëse në shqyrtimin e përmirësuar të Llogarive të Vlerës së Lartë përshkruar më lartë zbulohet udhëzimi për “ruajtjen e postës” ose adresa “në vëmendje të”, dhe asnjë adresë tjetër dhe asnjë indicie tjetër e renditur në nënparagrafin B(2) deri në (e) nuk identifikohet për Mbajtësin e Llogarisë, Institucioni Financiar Raportues duhet të marrë nga ky Mbajtës i Llogarisë një vetëvërtetim ose evidencë shkresore për të përcaktuar rezidencat për qëllime tatimore të Mbajtësit të Llogarisë. Nëse Institucioni Financiar Raportues nuk e merr dot një vetëvërtetim të tillë ose evidencën shkresore, ai duhet ta raportojë llogarinë si një llogari të padokumentuar.
6. Nëse Llogaria Paraekzistuese Individuale nuk është një Llogari e Vlerës së Lartë duke filluar nga data 31 dhjetor [xxxx], por bëhet një Llogari e Vlerës së Lartë duke filluar nga dita e fundit e vitit pasues kalendarik, Institucioni Financiar Raportues duhet t’i përfundojë procedurat e shqyrtimit të përmirësuar të përshkruara në paragrafin C lidhur me këtë llogari brenda vitit kalendarik që pason vitin në të cilin llogaria bëhet një Llogari e Vlerës së Lartë. Nëse bazuar në këtë shqyrtim kjo llogari identifikohet si një Llogari e Raportueshme, Institucioni Financiar Raportues duhet ta raportojë informacionin e kërkuar mbi këtë llogari lidhur me vitin në të cilin ajo është identifikuar si Llogari e Raportueshme dhe çdo vit në vitet në vijim, përveçse nëse Mbajtësi i Llogarisë pushon së qeni një Person i Raportueshëm.
7. Pasi Institucioni Financiar Raportues zbaton procedurat e shqyrtimit të përmirësuar të përshkruara në paragrafin C për një Llogari të Vlerës së Lartë, Institucionit Financiar Raportues nuk i kërkohet t’i rizbatojë këto procedura, përveç marrjes në pyetje të menaxherit të marrëdhënieve të përshkruar në nënparagrafin C(4), për të njëjtën Llogari të Vlerës së Lartë në vitet në vijim me përjashtim të rasteve kur llogaria është e padokumentuar, raste në të cilat Institucioni Financiar Raportues duhet t’i rizbatojë ato çdo vit derisa kjo llogari të pushojë së qeni e padokumentuar.

8. Nëse ka ndryshim të rrethanave lidhur me një Llogari të Vlerës së Lartë që rezulton në një ose më shumë indicie të përshkruar në nënparagrafin B(2) që lidhet me llogarinë, atëherë Institucioni Financiar Raportues duhet ta trajtojë llogarinë si një Llogari të Raportueshme lidhur me çdo Juridiksion të Huaj për të cilin është identifikuar një indicie përveçse nëse zgjedh të zbatojë nënparagrafin B(6) dhe një prej përjashtimeve në këtë paragraf zbatohet lidhur me atë llogari.
  9. Institucioni Financiar Raportues duhet të zbatojë procedurat për të garantuar që menaxheri i marrëdhënieve identifikon çdo ndryshim në rrethanat e një llogarie. Për shembull, nëse menaxheri i marrëdhënieve njoftohet se Mbajtësi i Llogarisë ka një adresë të re postare në Juridiksionin e Huaj, Institucionit Financiar Raportues i kërkohet ta trajtojë adresën e re si një ndryshim në rrethana dhe, nëse ai zgjedh të zbatojë nënparagrafin B(6), i kërkohet të marrë dokumentacionin e duhur nga Mbajtësi i Llogarisë.
- D. Shqyrtimi i Llogarive Paraekzistuese Individuale duhet të përfundojë brenda datës [xx/xx/xxxx].

#### Seksioni IV: Verifikimi i duhur për Llogaritë e Reja Individuale

Për Llogaritë e Reja Individuale do të zbatohen procedurat vijuese.

- A. Lidhur me Llogaritë e Reja Individuale, pas hapjes së llogarisë, Institucioni Financiar Raportues duhet të marrë një vetëvërtetim, që mund të jetë pjesë e dokumentacionit për hapjen e llogarisë, i cili e lejon Institucionin Financiar Raportues të përcaktojë rezidencat e Mbajtësit të Llogarisë për qëllime tatimore dhe të konfirmojë arsyeshmërinë e këtij vetëvërtetimi bazuar në informacionin e marrë nga Institucioni Financiar Raportues lidhur me hapjen e llogarisë, duke përfshirë çdo dokumentacion të mbledhur sipas procedurave për AML/KYC.
- B. Nëse vetëvërtetimi përcakton se Mbajtësi i Llogarisë është rezident për qëllime tatimore në një Juridiksion të Raportueshëm, Institucioni Financiar Raportues duhet ta trajtojë llogarinë si një Llogari të Raportueshme dhe vetëvërtetimi duhet të përfshijë edhe NIPT-in e Mbajtësit të Llogarisë lidhur me këtë Juridiksion të Raportueshëm (sipas paragrafit D të Seksionit I) dhe datën e lindjes.
- C. Nëse ka ndryshime të rrethanave lidhur me një Llogari të Re Individuale që e vë Institucionin Financiar Raportues në dijeni të, ose ka arsye të jetë në dijeni të faktit që vetëvërtetimi fillestar është i pasaktë ose i pabesueshëm, Institucioni Financiar Raportues nuk mund të mbështetet në vetëvërtetimin fillestar dhe duhet të marrë një vetëvërtetim të vlefshëm që përcakton rezidencat për qëllime tatimore të Mbajtësit të Llogarisë.

#### Seksioni V: Verifikimi i duhur për Llogaritë Paraekzistuese të Njësive Ekonomike

Për Llogaritë Paraekzistuese të Njësive Ekonomike do të zbatohen procedurat vijuese.

- A. **Llogaritë e Njësive Ekonomike që nuk kërkohet të shqyrtohen, identifikohen ose raportohen.** Përveçse nëse Institucioni Financiar Raportues zgjedh të veprojë ndryshe, qoftë lidhur me të gjitha Llogaritë Paraekzistuese të Njësive Ekonomike ose, veçmas, lidhur me çdo grup të identifikuar qartë të këtyre llogarive, Llogaria Paraekzistuese e Njesisë Ekonomike me një bilanc total llogarie ose vlerë që nuk e kalon 250 000 USD duke filluar nga data 31 dhjetor [xxxx], nuk kërkohet të shqyrtohet, identifikohet ose raportohet si një Llogari e Raportueshme deri në momentin që bilanci ose vlera totale e llogarisë kalon nivelin 250 000 USD duke filluar nga dita e fundit e çdo viti pasues kalendarik.



- B. **Llogaritë e Njësive Ekonomike objekt i shqyrtimit.** Një Llogari Paraekzistuese e Njesisë Ekonomike që ka një bilanc ose vlerë totale të llogarisë që e kalon nivelin 250 000 USD duke filluar nga data 31 dhjetor [xxxx], dhe Llogaria Paraekzistuese e Njesisë Ekonomike që nuk e kalon nivelin 250 000 USD duke filluar nga data 31 dhjetor [xxxx], por që bilanci ose vlera e llogarisë të së cilës e kalon nivelin 250 000 USD duke filluar nga dita e fundit e çdo viti pasues kalendarik, duhet të shqyrtohet në përputhje me procedurat e parashtuara në paragrafin D.
- C. **Procedurat e shqyrtimit për identifikimin e Llogarive të Njësive Ekonomike për të cilat mund të kërkohet raportim.** Për Llogaritë Paraekzistuese të Njësive Ekonomike që përshkruhen në paragrafin B, Institucioni Financiar Raportues duhet të zbatojë procedurat vijuese të shqyrtimit:

1. **Të përcaktohet rezidenca e Njesisë Ekonomike.**

- a) Shqyrtimi i informacionit që mbahet për qëllime rregullatore ose të marrëdhënies me klientin (duke përfshirë informacionin e mbledhur sipas Procedurave për AML/KYC) për të përcaktuar rezidencën e Mbajtësit të Llogarisë. Për këtë qëllim, informacioni që tregon rezidencën e Mbajtësit të Llogarisë përfshin vendin e themelimit ose të organizimit, ose adresën në Juridiksionin e Raportueshëm.
- b) Nëse informacioni tregon se Mbajtësi i Llogarisë është Person i Raportueshëm, Institucioni Financiar Raportues duhet ta trajtojë llogarinë si Llogari të Raportueshme përveçse nëse ai merr një vetëvërtetim nga Mbajtësi i Llogarisë, ose në mënyrë të arsyeshme përcakton bazuar në informacionin që ka në dispozicion apo që është i disponueshëm publikisht, se Mbajtësi i Llogarisë nuk është një Person i Raportueshëm.

3. **Të përcaktohet rezidenca e Personave Kontrollues të një NFE-je Pasive.** Lidhur me Mbajtësin e Llogarisë të një Llogarie Paraekzistuese të Njesisë Ekonomike (duke përfshirë Njësine Ekonomike që është Person i Raportueshëm), Institucioni Financiar Raportues duhet të përcaktojë nëse Mbajtësi i Llogarisë është një NFE Pasive me një ose më shumë Persona Kontrollues dhe të përcaktojë rezidencën e këtyre Personave Kontrollues. Nëse ndonjë prej Personave Kontrollues të NFE-së Pasive është Person i Raportueshëm, atëherë llogaria duhet të trajtohet si Llogari e Raportueshme. Kur bën këto përcaktime, Institucioni Financiar Raportues duhet të ndjekë udhëzimet në nënparagrafët C(2)(a) deri në (c) sipas rendit më të përshtatshëm në varësi të rrethanave.

- a) **Përcaktimi nëse Mbajtësi i Llogarisë është një NFE Pasive.** Për qëllime të përcaktimit nëse Mbajtësi i Llogarisë është një NFE Pasive, Institucioni Financiar Raportues duhet të marrë një vetëvërtetim nga Mbajtësi i Llogarisë për të përcaktuar statusin e tij, përveçse nëse disponon informacion ose ka informacion të disponueshëm publikisht, bazuar në të cilin ai mund të përcaktojë në mënyrë të arsyeshme që Mbajtësi i Llogarisë është një NFE Aktive ose një Institucion Financiar i ndryshëm nga Njësia Ekonomike e Investimeve e përshkruar në nënparagrafin A(6)(b) të seksionit VIII që nuk është Institucion Financiar i Juridiksionit Pjesëmarrës.
- b) **Përcaktimi i Personave Kontrollues të një Mbajtësi Llogarie.** Për qëllime të përcaktimit të Personave Kontrollues të një Mbajtësi Llogarie, Institucioni Financiar Raportues mund të mbështetet në informacionin e mbledhur dhe mbajtur në pajtim me procedurat për AML/KYC.



- c) **Përcaktimi i rezidencës së Personit Kontrollues të një NFE-je Pasive.** Për qëllime të përcaktimit të rezidencës së Personit Kontrollues të një NFE-je Pasive, Institucioni Financiar Raportues mund të mbështetet në:
- i) informacionin e mbledhur dhe të mbajtur në pajtim me Procedurat për AML/KYC në rastin e një Llogarie Paraekzistuese të Njesisë Ekonomike të mbajtur nga një ose më shumë NFE Pasive me një bilanc ose vlerë totale të llogarisë që nuk e kalon nivelin 1 000 000 USD; ose
  - ii) vetëvërtetimin nga Mbajtësi i Llogarisë ose Personi Kontrollues i tij i juridiksioneve në të cilat Personi Kontrollues është rezident për qëllime tatimore. Nëse nuk jepet një vetëvërtetim, Institucioni Financiar Raportues do ta përcaktojë rezidencën duke zbatuar procedurat e përshkruara në paragrafin C të seksionit III.

**D. Afatet kohore të shqyrtimit dhe procedurat shtesë që zbatohen për Llogaritë Paraekzistuese të Njesisë Ekonomike.**

1. Shqyrtimi i Llogarive Paraekzistuese të Njësive Ekonomike me një bilanc ose vlerë totale të llogarisë që e kalon nivelin 250 000 USD duke filluar nga data 31 dhjetor [xxxx] duhet të përfundojë brenda datës 31 dhjetor [xxxx].
2. Shqyrtimi i Llogarive Paraekzistuese të Njësive Ekonomike me një bilanc ose vlerë totale të llogarisë që nuk e kalon nivelin 250 000 USD duke filluar nga data 31 dhjetor [xxxx], por që e kalon nivelin 250 000 USD duke filluar nga data 31 dhjetor e vitit pasues, duhet të përfundojë brenda vitit kalendarik që vjen pas vitit në të cilin bilanci ose vlera totale e llogarisë e kalon nivelin 250 000 USD.
3. Nëse ka ndryshime të rrethanave lidhur me një Llogari Paraekzistuese të Njesisë Ekonomike që e vë Institucionin Financiar Raportues në dijeni të, ose ka arsye të jetë në dijeni të faktit që vetëvërtetimi ose dokumentacioni tjetër i lidhur me llogarinë është i pasaktë ose i pabesueshëm, Institucioni Financiar Raportues duhet të ripërcaktojë statusin e llogarisë në përputhje me procedurat e parashtruara në paragrafin C.

**Seksioni VI: Verifikimi i duhur për Llogaritë e Reja të Njësive Ekonomike**

Për Llogaritë e Reja të Njësive Ekonomike zbatohen procedurat vijuese.

**A. Procedurat e shqyrtimit për identifikimin e Llogarive të Njësive Ekonomike për të cilat kërkohet raportim.** Për Llogaritë e Reja të Njësive Ekonomike, Institucioni Financiar Raportues duhet të zbatojë procedurat vijuese të shqyrtimit:

**1. Të përcaktohet rezidenca e Njesisë Ekonomike.**

- a) Marrja e një vetëvërtetimi, i cili mund të jetë pjesë e dokumentacionit për hapjen e llogarisë, që e lejon Institucionin Financiar Raportues të përcaktojë rezidencat e Mbajtësit të Llogarisë për qëllime tatimore dhe të konfirmojë arsyeshmërinë e këtij vetëvërtetimi bazuar në informacionin e marrë nga Institucioni Financiar Raportues lidhur me hapjen e llogarisë, duke përfshirë çdo dokumentacion të mbledhur në pajtim me Procedurat për AML/KYC. Nëse Njësia Ekonomike vërteton se nuk ka rezidencë për qëllime tatimore, Institucioni Financiar Raportues mund të mbështetet në adresën e selisë kryesore të Njesisë Ekonomike për të përcaktuar rezidencën e Mbajtësit të Llogarisë.

- b) Nëse vetëvërtetimi tregon se Mbajtësi i Llogarisë është rezident në një Juridiksion të Raportueshëm, Institucioni Financiar Raportues duhet ta trajtojë llogarinë si një Llogari të Raportueshme përveçse nëse ai përcakton në mënyrë të arsyeshme bazuar në informacionin që posedon ose që është publikisht i disponueshëm, se Mbajtësi i Llogarisë nuk është një Person i Raportueshëm lidhur me këtë Juridiksion të Raportueshëm.

2. **Të përcaktohet rezidenca e Personave Kontrollues të një NFE-je Pasive.** Lidhur me Mbajtësin e Llogarisë të një Llogarie të Re të Njesisë Ekonomike (duke përfshirë Njësine Ekonomike që është Person i Raportueshëm), Institucioni Financiar Raportues duhet të përcaktojë nëse Mbajtësi i Llogarisë është një NFE Pasive me një ose më shumë Persona Kontrollues që janë Persona të Raportueshëm. Nëse ndonjë prej Personave Kontrollues të NFE-së Pasive është Person i Raportueshëm, atëherë llogaria duhet të trajtohet si Llogari e Raportueshme. Kur bën këto përcaktime, Institucioni Financiar Raportues duhet të ndjekë udhëzimet në nënparagrafët A(2)(a) deri në (c) sipas rendit më të përshtatshëm në varësi të rrethanave.

- a) **Përcaktimi nëse Mbajtësi i Llogarisë është një NFE Pasive.** Për qëllime të përcaktimit nëse Mbajtësi i Llogarisë është një NFE Pasive, Institucioni Financiar Raportues duhet të marrë një vetëvërtetim nga Mbajtësi i Llogarisë për të përcaktuar statusin e tij, përveçse nëse disponon informacion ose ka informacion të disponueshëm publikisht, bazuar në të cilin ai mund të përcaktojë në mënyrë të arsyeshme që Mbajtësi i Llogarisë është një NFE Aktive ose një Institucion Financiar i ndryshëm nga Njësia Ekonomike e Investimeve e përshkruar në nënparagrafin A(6)(b) të seksionit VIII që nuk është Institucion Financiar i Juridiksionit Pjesëmarrës.
- b) **Përcaktimi i Personave Kontrollues të një Mbajtësi Llogarie.** Për qëllime të përcaktimit të Personave Kontrollues të një Mbajtësi Llogarie, Institucioni Financiar Raportues mund të mbështetet në informacionin e mbledhur dhe mbajtur në pajtim me procedurat për AML/KYC.
- c) **Përcaktimi i rezidencës së një Personi Kontrollues të një NFE-je Pasive.** Për qëllime të përcaktimit të rezidencës së Personit Kontrollues të një NFE-je Pasive, Institucioni Financiar Raportues mund të mbështetet mbi vetëvërtetimin nga Mbajtësi i Llogarisë ose e këtij Personi Kontrollues.

## Seksioni VII: Rregullat e veçanta të verifikimit të duhur

Në implementimin e procedurave të verifikimit të duhur përshkruar më lart do të zbatohen rregullat shtesë të mëposhtme:

- A. **Mbështetja te vetëvërtetimet ose evidencat shkresore.** Institucioni Financiar Raportues mund të mos mbështetet vetëm te vetëvërtetimi ose evidencat shkresore nëse Institucioni Financiar Raportues ka dijeni ose ka arsye të ketë dijeni që vetëvërtetimi ose evidencat shkresore janë të pasakta ose të pabesueshme.
- B. **Procedurat alternative për llogaritë financiare që mbahen nga përfituesit individualë të Kontratave të Sigurimeve në Vlerë në Para të Gatshme ose të Kontratave të Pensionit Vjetor.** Institucioni Financiar Raportues mund të prezumojë se përfituesi individual (i ndryshëm nga pronari) i Kontratës së Sigurimeve në Vlerë në Para të Gatshme ose i Kontratës së Pensionit Vjetor që merr pension familjar nuk është një Person i Raportueshëm dhe mund ta trajtojë këtë Llogari Financiare ndryshe nga Llogaria e Raportueshme përveçse nëse Institucioni Financiar Raportues ka njohuri reale ose ka arsye të dijë se përfituesi është një Person i Raportueshëm. Institucioni Financiar Raportues ka arsye të dijë se përfituesi i Kontratës së Sigurimeve në Vlerë në

Para të Gatshme ose i Kontratës së Pensionit Vjetor është një Person i Raportueshëm nëse informacioni i mbledhur nga Institucioni Financiar Raportues dhe që lidhet me përfituesin përmban indiciet e përshkruara në paragrafin B të seksionit III. Nëse Institucioni Financiar Raportues ka njohuri reale ose arsye të ketë dijeni që përfituesi është Person i Raportueshëm, Institucioni Financiar Raportues duhet të ndjekë procedurat në paragrafin B të seksionit III.

**C. Totalizimi (agregimi) i bilancit të llogarisë dhe rregullat e monedhës.**

1. **Totalizimi i Llogarive Individuale.** Për qëllime të përcaktimit të bilancit ose vlerës totale të Llogarive Financiare që mbahen nga një individ, Institucionit Financiar Raportues i kërkohet të totalizojë të gjitha Llogaritë Financiare që mbahen nga Institucioni Financiar Raportues, ose nga një Njësi Ekonomike e lidhur me të, por vetëm deri në masën që sistemet e kompjuterizuara të Institucionit Financiar Raportues i lidhin Llogaritë Financiare duke iu referuar një elementi të të dhënave si numri i klientit ose NIPT-i, dhe lejojnë totalizimin e bilanceve ose vlerave të llogarive. Secilit mbajtës të një Llogarie Financiare të mbajtur bashkërisht do t'i atribuohet i gjithë bilanci ose e gjithë vlera e Llogarisë Financiare të mbajtur bashkërisht për qëllime të zbatimit të kriterëve të totalizimit të përshkruara në këtë nënparagraf.
2. **Totalizimi i Llogarive të Njërive Ekonomike.** Për qëllime të përcaktimit të bilancit ose vlerës totale të Llogarive Financiare që mbahen nga një Njësi Ekonomike, Institucionit Financiar Raportues i kërkohet të marrë në konsideratë të gjitha Llogaritë Financiare që mbahen nga Institucioni Financiar Raportues, ose nga një Njësi Ekonomike e lidhur me të, por vetëm deri në masën që sistemet e kompjuterizuara të Institucionit Financiar Raportues i lidhin Llogaritë Financiare duke iu referuar një elementi të të dhënave si numri i klientit ose NIPT-i, dhe lejojnë totalizimin e bilanceve ose vlerave të llogarive. Secilit mbajtës të një Llogarie Financiare të mbajtur bashkërisht do t'i atribuohet i gjithë bilanci ose e gjithë vlera e Llogarisë Financiare të mbajtur bashkërisht për qëllime të zbatimit të kriterëve të totalizimit të përshkruara në këtë nënparagraf.
3. **Rregulli i veçantë i totalizimit që zbatohet për Menaxherët e Marrëdhënieve.** Për qëllime të përcaktimit të bilancit ose vlerës totale të Llogarive Financiare që mbahen nga një person për të përcaktuar nëse një Llogari Financiare është një Llogari e Vlerës së Lartë, Institucionit Financiar Raportues gjithashtu i kërkohet që t'i totalizojë të gjitha këto llogari, në rastin e çdo Llogarie Financiare që menaxheri i marrëdhënieve e di, ose ka arsye të dijë, që janë direkt ose indirekt të zotëruara, kontrolluara ose krijuara (të ndryshme nga ato të mbajtura në besueshmëri) nga i njëjti person.
4. **Shumat e lexuara për të përfshirë ekuivalenten në monedha të tjera.** Të gjitha shumat në dollarë janë në dollarë amerikanë dhe do të lexohen për të përfshirë shumat ekuivalente në monedha të tjera, siç përcaktohet nga legjislacioni i brendshëm.

## Shtojca 6

### Deklaratë mbi Shkëmbimin Automatik të Informacionit në Çështjet Tatimore (Miratuar më 6 maj 2014)

NE, MINISTRAT DHE PËRFAQËSUESIT e Argjentinës, Australisë, Austrisë, Belgjikës, Brazilit, Kanadasë, Republikës Popullore të Kinës, Kilit, Kolumbisë, Kosta Rikës, Republikës Çeke, Danimarkës, Estonisë, Finlandës, Francës, Gjermanisë, Greqisë, Hungarisë, Islandës, Indisë, Indonezisë, Irlandës, Izraelit, Italisë, Japonisë, Koresë, Letonisë, Lituanisë, Luksemburgut, Malajzisë, Meksikës, Holandës, Zelandës së Re, Norvegjisë, Polonisë, Portugalisë, Arabisë Saudite, Singaporit, Republikës Sllovake, Sllovenisë, Afrikës së Jugut, Spanjës, Suedisë, Zvicrës, Turqisë, Mbretërisë së Bashkuar, Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Evropian;

DUKE MIRËPRITUR *Standardin e OECD-së për Shkëmbimin Automatik të Informacionit të Llogarisë Financiare*, i cili ofron elementët kryesorë për krijimin e një standardi të vetëm të përbashkët global për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarisë financiare (në vijim referuar si “standardi i ri i vetëm global”), duke i pajisur në këtë mënyrë administratat tatimore në të gjithë botën me një instrument të ri shumë të fuqishëm për të zgjidhur papajtueshmërinë dhe evazionin tatimor ndërkufitar;

DUKE VËREJTUR ME KËNAQËSI miratimin e fuqishëm të tij nga Ministrat e Financës dhe Guvernatorët e Bankave Qendrore të vendeve të G20-ës, si edhe angazhimin e tyre për ta zbatuar atë në takimin e tyre të datës 22-23 shkurt 2014;

DUKE MARRË NË KONSIDERATË që mashtrimi me tatimet dhe evazoni tatimor rrezikojnë besimin e qytetarëve në drejtësinë dhe integritetin e sistemit tatimor si i tërë, duke minuar kështu pajtueshmërinë vullnetare tatimore nga të gjithë tatimpaguesit, e cila është thelbësore për administrimin efikas të tatimeve;

DUKE MARRË NË KONSIDERATË që lufta kundër mashtrimit me tatimet dhe evazionit tatimor do të sjellë si rezultat rritjen e të ardhurave që do të ndihmojnë në rritjen e investimeve publike, rikuperimin e mirëqenies së financave tona publike dhe ofrimin e shërbimeve publike thelbësore që kërkojnë qytetarët tanë;

TË NDËRGJEGJSHËM se me rritjen gjithnjë e më tepër të globalizimit të botës po bëhet më e lehtë për të gjithë tatimpaguesit që t’i bëjnë, mbajnë dhe menaxhojnë investimet e tyre nëpërmjet institucioneve financiare jashtë vendit të tyre të rezidencës, dhe që investimet të cilat mbahen në “offshore” (parajsa fiskale) nga tatimpaguesit mund të mbeten të patatuara deri në atë masë që këta tatimpagues të mos përmbushin detyrimet e tyre tatimore në kurriz të atyre të cilët i shlyejnë këto detyrime;

DUKE MARRË NË KONSIDERATË që mashtrimi me tatimet dhe evazoni tatimor ndërkufitar janë probleme serioze për juridiksionet në të gjithë botën, për vende të vogla dhe të mëdha, të zhvilluara dhe në zhvillim;

TË NDËRGJEGJSHËM se bashkëpunimi ndërmjet administratave tatimore është kritik në luftën kundër mashtrimit tatimor dhe evazionit tatimor dhe në promovimin e pajtueshmërisë tatimore ndërkombëtare, dhe se aspekti kyç në këtë bashkëpunim është shkëmbimi efikas i informacionit në baza automatike sipas masave të duhura mbrojtëse;

DUKE PRANUAR progresin e konsiderueshëm të arritur nga Forumi Global për Transparencën dhe Shkëmbimin e Informacionit për Qëllime Tatimore (në vijim referuar si “Forum Global”) në garantimin se standardet ndërkombëtare të transparencës dhe shkëmbimit të informacionit me kërkesë zbatohen plotësisht në të gjithë botën;

DUKE VËNË RE se ka një interes në rritje në shumë vende lidhur me mundësitë që ofrohen nga shkëmbimi i ndërsjellë automatik i informacionit ndërmjet autoriteteve tatimore;

DUKE MIRËPRITUR angazhimet që tashmë janë ndërmarrë për miratimin e hershëm të standardit të ri të vetëm global nga një numër i madh vendesh dhe juridiksionesh;

TË NDËRGJEGJSHËM se standardi i ri i vetëm global nuk duhet të vendosë kosto të padrejta administrative dhe biznesi;

DUKE VËNË RE se megjithëse standardi i ri i vetëm global mbulon informacionin e llogarisë financiare, ai nuk e kufizon mundësinë e vendeve për të shkëmbyer informacion financiar sipas llojeve të ndryshme të marrëveshjeve ligjore ose të shkëmbejnë lloje apo kategori të tjera të informacionit në baza automatike;

DUKE PRANUAR rolin e rëndësishëm që Konventa Shumëpalëshe për Ndihmën e Ndërsjellë Administrative në Çështjet Tatimore mund të luajë në lehtësimin e zbatimit të shpejtë të shkëmbimit automatik të informacionit dhe DUKE MIRËPRITUR faktin se mbi 60 vende tashmë e kanë nënshkruar Konventën, duke përfshirë pothuajse të gjitha vendet e OECD-së, të gjitha vendet e G20-ës dhe një numër gjithnjë e më të madh të qendrave financiare dhe vendeve në zhvillim;

DUKE MIRËPRITUR së fundmi krijimin e një Grupi Pune nga Forumi Global për Shkëmbimin Automatik të Informacionit, i cili do të zhvillojë një mekanizëm për monitorimin dhe shqyrtimin e zbatimit të standardit të ri të vetëm global për shkëmbimin automatik të informacionit dhe gjithashtu një kuadër për t'u ofruar asistencë teknike vendeve në zhvillim për të përmbushur standardin.

\*\*\*\*\*

1. DEKLAROJMË se jemi të vendosur që të zgjidhim mashtrimin tatimor dhe evazionin tatimor ndërkufitar dhe të promovojmë pajtueshmërinë tatimore ndërkombëtare përmes asistencës së ndërsjellë administrative në çështjet tatimore dhe të njëjtave rregulla të lojës;
2. KONFIRMOJMË se shkëmbimi automatik i informacionit të llogarisë financiare do t'i çojë përpara këto objektiva, veçanërisht nëse standardi i ri i vetëm global, duke përfshirë transparencën e plotë për interesat e pronësisë, zbatohet në të gjitha qendrat financiare;
3. PRANOJMË se informacioni i shkëmbyer mbi bazën e standardit të ri të vetëm global është objekt i masave të duhura mbrojtëse duke përfshirë kërkesat e caktuara për konfidencialitetin dhe kërkesën se informacioni mund të përdoret vetëm për qëllimet e parashikuara nga instrumenti ligjor sipas të cilit kryhet shkëmbimi;
4. JEMI TË VENDOSUR për ta zbatuar standardin e ri të vetëm global pa pengesa, mbi baza reciproke. Ne do ta përkthejmë standardin në legjislacionin e brendshëm, duke përfshirë garantimin se informacioni për pronësinë fitimprurëse të personave dhe strukturave ligjore mblidhet në mënyrë efikase dhe shkëmbehet në pajtim me standardin;
5. I BËJMË THIRRJE të gjitha qendrave financiare që ta zbatojnë standardin e ri të vetëm global pa vonesa;
6. THEKSOJMË nevojën për t'u ofruar asistencë vendeve në zhvillim me qëllim që ato të jenë të afta të korrin përfitimet e kësaj forme bashkëpunimi;
7. NXISIM Komitetin e OECD-së për Çështjet Fiskale, në bashkëpunim me anëtarët e G20-ës, që të veprojnë shpejt me hartimin e a) një komenti të detajuar për të ndihmuar në garantimin e zbatimit të qëndrueshëm të standardit të ri të vetëm global dhe b) masave mbrojtëse dhe modaliteteve teknike të mbetura duke përfshirë informacionin dhe udhëzimet për zgjidhjet e nevojshme teknike, formatin standard për raportimin dhe shkëmbimin dhe standardet minimale për konfidencialitetin;
8. PARASHIKOJMË që elementet e mbetura të punës të përmendura në paragrafin 7 do të përfundohen dhe miratohen deri në mesin e vitit 2014;

9. NXISIM të gjitha vendet që nuk e kanë nënshkruar që ta nënshkruajnë dhe ratifikojnë Konventën Shumëpalëshe për Ndihmën e Ndërsjellë Administrative në Çështjet Tatimore sa më shpejt të jetë e mundur;
10. PARASHIKOJMË krijimin e shpejtë nga Forumi Global të një mekanizmi për të monitoruar dhe shqyrtuar zbatimin e standardit të ri të vetëm global;
11. FTOJMË Sekretarin e Përgjithshëm të OECD-së që të raportojë mbi ecurinë e Komitetit për Çështjet Fiskale në zhvillimin e udhëzimeve të mëtejshme për zbatimin e standardit të ri të vetëm global në Takimin e vitit 2015 të Këshillit në nivel ministror dhe në forume të tjera ndërkombëtare sipas rastit.



## *Shtojca 7*

# **Rekomandim i Këshillit mbi Standardin për Shkëmbimin Automatik të Informacionit të Llogarisë Financiare në Çështjet Tatimore**

*(Miratuar më 15 korrik 2014)*

### **KËSHILLI,**

DUKE PASUR PARASYSH nenin 5 b) të Konventës për Organizatën për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik të datës 14 dhjetor 1960;

DUKE PASUR PARASYSH Rekomandimin e Këshillit për Shmangien dhe Evazionin Tatimor [C(77)149/FINAL], Rekomandimin e Këshillit për Përdorimin e Numrave të Identifikimit Tatimor në Kontekst Ndërkombëtar [C(97)29/FINAL] dhe Rekomandimin e Këshillit lidhur me Konventën Model Tatimore mbi të Ardhurat dhe Kapitalin [C(97)195/FINAL];

DUKE PASUR PARASYSH nenin 26 të Konventës Model Tatimore mbi të Ardhurat dhe Kapitalin;

DUKE PASUR PARASYSH Konventën për Ndihmën e Ndërsjellë Administrative në Çështjet Tatimore të datës 25 janar 1988, e ndryshuar me Protokollin e vitit 2010 [C(2010)10/FINAL], e cila ka një numër gjithnjë e më të madh të palëve dhe nënshkruesve, aktualisht një total prej 60 vendesh;

DUKE PASUR PARASYSH ecurinë e konsiderueshme të arritur nga Forumi Global për Transparencën dhe Shkëmbimin e Informacionit për Qëllime Tatimore në garantimin që standardet ndërkombëtare të transparencës dhe shkëmbimit të informacionit me kërkesë zbatohen plotësisht në të gjithë botën;

DUKE PASUR PARASYSH Deklaratën për Shkëmbimin Automatik të Informacionit në Çështjet Tatimore të miratuar më 6 maj 2014 nga 47 shtete, duke përfshirë të gjithë anëtarët, Argentinën, Brazilin, Republikën Popullore të Kinës, Kolumbinë, Kosta Rikën, Indinë, Indonezinë, Letoninë, Lituaninë, Malajzinë, Arabinë Saudite, Singaporin, Afrikën e Jugut si edhe Bashkimin Evropian [C/MIN(2014)5/FINAL];

DUKE MARRË NË KONSIDERATË se bashkëpunimi ndërkombëtar është kritik në luftën kundër mashtrimit tatimor dhe evazionit tatimor dhe në garantimin e pajtueshmërisë tatimore, dhe se një aspekt kyç i këtij bashkëpunimi është shkëmbimi efikas i informacionit mbi baza automatike sipas masave të duhura mbrojtëse;

DUKE MARRË NË KONSIDERATË se miratimi i një standardi të vetëm për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarisë financiare në çështjet tatimore do të shmangë përhapjen e standardeve të ndryshme të cilat do të rrisnin kompleksitetin dhe kostot për qeveritë dhe institucionet financiare;

DUKE MARRË NË KONSIDERATË se zbatimi i një standardi të vetëm nga të gjitha qendrat financiare do të garantonte rregulla të barabarta loje;

DUKE MARRË NË KONSIDERATË nevojën për të inkurajuar zbatimin dhe interpretimin konsistent në të gjitha vendet të standardit të vetëm;

DUKE MARRË NË KONSIDERATË mandatin e Forumit Global për Transparencën dhe Shkëmbimin e Informacionit për Qëllime Tatimore dhe evolucionin e shpejtë të standardeve të transparencës dhe të shkëmbimit të informacionit për qëllime tatimore;

DUKE MIRËPRITUR Standardin për Shkëmbimin Automatik të Informacionit të Llogarisë Financiare në Çështjet Tatimore i cili përbëhet nga Standardi i Përbashkët i Raportimit dhe Marrëveshja Model e Autoritetit Kompetent (në vijim referuar si “Standardi”), miratuar nga Komiteti për Çështjet Fiskale;

DUKE MARRË NË KONSIDERATË Komentet e Standardit të Përbashkët të Raportimit dhe Komentet e Marrëveshjes Model të Autoritetit Kompetent (në vijim referuar si “Komentet”), miratuar nga Komiteti për Çështjet Fiskale [C(2014)81/ADD1];

Me propozim të Komitetit për Çështjet Fiskale:

- I. REKOMANDON që anëtarët dhe joanëtarët që aderojnë në këtë Rekomandim (në vijim referuar si “Aderuesit”) të zbatojnë menjëherë mbi baza të ndërsjella Standardin e parashtruar në shtojcën e këtij Rekomandimi ku përbën një pjesë integrale.

Për këtë qëllim, Aderuesit duhet:

- (a) ta transpozojnë Standardin në legjislacionin e brendshëm, duke përfshirë garantimin se informacioni për pronësinë fitimprurëse të strukturave dhe personave ligjorë mbledhet dhe shkëmbehet në mënyrë efikase në pajtim me Standardin;
  - (b) të marrin masat e nevojshme në pajtim me legjislacionin e tyre të brendshëm për të zbatuar çdo ndryshim në Standard; dhe
  - (c) të garantojnë se ekzistojnë masa të përshtatshme mbrojtëse për të mbrojtur konfidencialitetin e informacionit të shkëmbyer dhe për të respektuar kërkesën që informacioni mund të përdoret vetëm për qëllimet e parashikuara nga instrumenti ligjor në bazë të të cilit shkëmbehet informacioni;
- II. REKOMANDON që Aderuesit të ndjekin Komentet kur zbatojnë dhe interpretojnë dispozitat përkatëse të legjislacionit të brendshëm;
- III. FTON Aderuesit dhe Sekretarin e Përgjithshëm që ta përhapin kudo këtë Rekomandim;
- IV. FTON joanëtarët që të zbatojnë Standardin dhe të aderojnë pranë këtij Rekomandimi;
- V. FTON Aderuesit që të mbështesin përpjekjet për ngritje kapacitetesh dhe asistencë ndaj vendeve në zhvillim me qëllim që të jenë të aftë të marrin pjesë dhe të korrin përfitimet e kësaj forme bashkëpunimi;
- VI. FTON të gjitha vendet që nuk e kanë nënshkruar që ta nënshkruajnë dhe ratifikojnë Konventën për Ndihmën e Ndërsjellë Administrative në Çështjet Tatimore të ndryshuar me Protokollin e vitit 2010;
- VII. FTON Forumin Global për Transparencën dhe Shkëmbimin e Informacionit për Qëllime Tatimore që të monitorojë zbatimin e Standardit;
- VIII. UDHËZON Komitetin për Çështjet Fiskale që:
  - (i) të monitorojë zbatimin e Rekomandimit dhe të raportojë për këtë në Këshill jo më vonë se tre vite pas miratimit të tij dhe rregullisht pas kësaj periudhe;
  - (ii) të jetë i gatshëm të shqyrtojë Standardin dhe Komentet nën frymën e përvijës së përfutur nga Aderuesit dhe në konsultim me grupet e interesit;
  - (iii) të miratojë çdo ndryshim të nevojshëm në Komente dhe të bëjë propozimet e duhura në Këshill për ndryshimet në Standard.

# ORGANIZATA PËR ZHVILLIM DHE BASHKËPUNIM EKONOMIK

OECD është një forum unik ku qeveritë punojnë së bashku për të adresuar sfidat ekonomike, sociale dhe mjedisore të globalizimit. Gjithashtu, OECD është në front të përpjekjeve për të kuptuar dhe për t'i ndihmuar qeveritë që t'i përgjigjen zhvillimeve dhe shqetësimeve të reja, si qeverisja e korporatave, ekonomia e informacionit dhe sfidat e plakjes së popullsisë. Organizata ofron një mjedis ku qeveritë mund të krahasojnë përvojat e politikave, të kërkojnë përgjigje për problemet e përbashkëta, të identifikojnë praktikatat e mira dhe të punojnë për të bashkërenduar politikatat e brendshme dhe ato ndërkombëtare.

Vendet anëtare të OECD-së janë: Australia, Austria, Belgjika, Kanadaja, Kili, Republika Çeke, Danimarka, Estonia, Finlanda, Franca, Gjermania, Greqia, Hungaria, Islanda, Irlanda, Izraeli, Italia, Japonia, Korea, Luksemburgu, Meksika, Holanda, Zelanda e Re, Norvegjia, Polonia, Portugalia, Republika Sllovake, Sllovenia, Spanja, Suedia, Zvicra, Turqia, Mbretëria e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara. Bashkimi Evropian merr pjesë në punimet e OECD-së. "OECD Publishing" shpërndan gjerësisht rezultatet e mbledhjes së statistikave dhe hulumtimeve të Organizatës për çështjet ekonomike, sociale dhe mjedisore, si edhe konventat, udhëzimet dhe standardet e rëna dakord nga anëtarët e saj.

## **Standardi për Shkëmbimin Automatik të Informacionit të Llogarisë Financiare në Çështjet Tatimore**

Në takimin e tyre në shtator të vitit 2013, liderët e vendeve të G20-ës e miratuan plotësisht propozimin e OECD-së për një model të vërtetë global për shkëmbimin automatik të informacionit dhe e ftuan OECD-në, në bashkëpunim me vendet e G20-ës, që të zhvillojnë një standard të ri të vetëm për shkëmbimin automatik të informacionit, duke përfshirë modalitetet teknike për të luftuar më mirë evazionin tatimor dhe për të garantuar pajtueshmërinë tatimore.

Standardi, i zhvilluar në përgjigje të kërkesës së G20-ës dhe i miratuar nga Këshilli i OECD-së më 15 korrik 2014, u bën thirrje juridiksioneve që të marrin informacion nga institucionet e tyre financiare dhe ta shkëmbejnë automatikisht atë informacion me juridiksionet e tjera mbi baza vjetore. Ai parashtron informacionin e llogarisë financiare që do të shkëmbehet, institucionet financiare që u kërkohet të raportojnë, llojet e ndryshme të llogarive dhe tatimpaguesve të mbuluar, si edhe procedurat e verifikimit të duhur që duhet të ndiqen nga institucionet financiare. Pjesa I jep një panoramë të përgjithshme të Standardit, Pjesa II përmban tekstin e Marrëveshjes Model të Autoritetit Kompetent (CAA Model) dhe Standardin e Përbashkët të Raportimit (CRS) dhe të Verifikimit të Duhur. Pjesa III përmban Komentet për CAA-në Model dhe CRS-në si edhe një sërë shtojcash.

Standardi mbështetet gjerësisht në punën e mëparshme të OECD-së në fushën e shkëmbimit automatik të informacionit. Ai përfshin progresin e bërë brenda Bashkimit Evropian, si edhe standardet globale kundër pastrimit të parave, me zbatimin ndërqeveritar të Aktit për Përputhshmërinë Tatimore të Llogarive të Huaja (FATCA) që ka shërbyer si një katalizator për lëvizjen drejt shkëmbimit automatik të informacionit në një kontekst shumëpalësh.